



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA
INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK
REVISTË TEORIKO-SHKENCORE
SHTATOR 2023

REVISTA USHTARAKE

(edicioni i tretë)

INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK © 2023

Botim i Akademisë së Forcave të Armatosura
Miratuar me vendim nr. 3, datë 27. 09. 2023
të Bordit Drejtues të Revistës Ushtarake

Bordi Drejtues i Revistës Ushtarake

Nënkryetari i Bordit

Kolonel Dr.*¹ **Ulsi Rexhaj**

Anëtarët e Bordit

Dr. **Etleva Smaçi**

Prof. Asoc. Dr. **Teki Kurti**

Kolonel (R) Dr. **Ahmet Leka**

Nënkolonel (R) Dr. **Enrik Ago**

Nënkolonel Dr. **Fitim Karasani**

Kolonel Dr.* **Hysni Gjergji**

Kolonel Dr.* **David Rroku**

Përgatiti për botim: Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit

Art design: Engjellushe Llulla

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2023 nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Akademia e Forcave të Armatosura zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Arsimin e Lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në “Revista Ushtarake” janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Autorët e shkrimeve nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve dhe pozicioneve të tyre individuale, edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes. Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Akademia e Forcave të Armatosura
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak
Shtypur: Shtator 2023

¹ VKM nr. 156, datë 19.02.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë AFA, si institucion i vetëm publik i Arsimit të Lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin e funksionimin e saj”, germa a) dhe b), pika 12.

PËRMBAJTJA

RUBRIKA E PARË

Analiza dhe vlerësime për sigurinë dhe gjeopolitikën..... 7

Fuqia në epokën e inteligjencës artificiale..... 9

Kolonel Msc. Ulsi REXHAJ

Drejtor i IKSHU

**“Fushëbeteja kibernetike”, arena e re e luftës
për avantazh gjeopolitik dhe ekonomik.....** 17

Kolonel Msc. Hysni GJERGJI

Shef Departamenti në IKSHU

Kolonel Msc. David RROKU

Zëvendësdrejtor i IKSHU

**Infrastruktura kritike dhe infrastruktura kritike e informacionit,
identifikimi i kërcënimeve, pasojave dhe nevoja për mbrojtjen e tyre.....** 29

Nënkolonel Msc. Dashnor BETA

Oficer shtabi në IKSHU

Influenca e Kinës në Ballkanin Perëndimor..... 51

Nënkolonel (R) Msc. Kristo RAPO

Specialist në IKSHU

Konflikti i armatosur dhe ndikimi i tij në mjedisin e sigurisë..... 69

Gjeneral brigade (R) Msc. Muhamet BUÇPAPA

Shef Grupi në IKSHU

Faktorët gjeopolitikë: gabimet e mundshme në analizë..... 83

Kolonel (R) Zeno JAHAJ

Lufta hibride: operacionet dhe kërcënimet hibride në të ardhmen..... 99

Nënkolonel (R) Msc. Kanan HIMAJ

Specialist në IKSHU

RUBRIKA E DYTË

Arsimimi dhe stërvitja.....	113
------------------------------------	------------

Akademia e Forcave të Armatosura - garanci në formimin e ushtarakut shqiptar si lider i ardhshëm.....	115
--	------------

Kolonel (R) Dr. Ahmet LEKA
Zëvendësdekan i FMS, AFA

Mbështetja logjistike e operacioneve dhe sfidat për të ardhmen.....	125
--	------------

Kolonel Msc. Avni BILBILAJ
Shef Departamenti në IKSHU

Klauzeviçi mbi luftën dhe lufta në Ukrainë.....	145
--	------------

Nënkolonel Msc. Nikolin LAZRI
Oficer shtabi në Forcën Tokësore

RUBRIKA E TRETË

Shkrime historike.....	157
-------------------------------	------------

Brigada IV Sulmuese dhe veprimtaria e saj luftarake në Operacionin e Dimrit.....	159
---	------------

Prof. Asoc. Dr. Edmond BRANESHI
Shef Grupi në FMS, AFA

Marrëdhëniet ushtarake midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë 1945-1948. Përpjekjet për unifikim e dy ushtrive.....	177
---	------------

Kapiten MSc. Hekuran BUDANI
Pedagog në FMS, AFA
MSc. Orgest XHANGOLI
Pedagog në FMS, AFA

Konflikti sirian.....	187
------------------------------	------------

Major Msc. Kujtim ZEKA
Koordinator në FMS, AFA

RUBRIKA E PARË

ANALIZA DHE VLERËSIME PËR SIGURINË DHE GJEOPOLITIKËN

FUQIA NË EPOKËN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE *

Kolonel Msc. Ulsi REXHAJ

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

HYRJE

“Një revolucion i ri industrial ka filluar. Ashtu si mekanizimi ose energjia elektrike përpara tij, inteligjenca artificiale do të prekë çdo aspekt të jetës tonë dhe do të shkaktojë të çara të thella në ekuilibrin e fuqisë globale, veçanërisht midis superfuqive të Inteligjencës Artificiale: Kinës, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Evropës”. Eksperti i armëve vetëvepruese, Paul Scharre hyn brenda konkurrencës së ashpër që zhvillohet midis fuqive, për të zbatuar këtë teknologji që ndryshon lojën e fuqisë për dominimin e të ardhmes.

Realisti klasik Hans Morgenthau identifikonte nëntë elemente të fuqisë kombëtare: gjeografinë, burimet, kapacitetin industrial, gatishmërinë ushtarake, popullsinë, karakterin kombëtar, moralin kombëtar, cilësinë e diplomacisë dhe cilësinë e qeverisjes. Sigurisht që këto janë elemente të domosdoshme për matjen e fuqisë kombëtare, por gjithsesi, janë përcaktuar në një kohë tjetër.

Në librin e tij “Katër Fushëbetejat”, Scharre lundron me mjeshtëri në çdo fushë, duke u ofruar lexuesve një kuptim gjithëpërfshirës mbi katër elementet kyçe të cilat përcaktojnë fuqinë dhe luftën sot: të dhënat, fuqia kompjuterike, talenti dhe institucionet.

* Për përgatitjen e këtij shkrimi, është punuar mbi vlerësime, komente, përshtatje, përvoja dhe mësimet rreth librit “Four Battlegrounds: Power in the Age of Artificial Intelligence” (Katër Fushëbetejat: Fuqia në Epokën e Inteligjencës Artificiale). Libri është shkruar nga Paul Scharre, në shkurt 2023. Shkrimi evidenton dhe shpreh vetëm gjykimin dhe opinionet e autorit.

Të dhënat janë një burim jetik si qymyri ose nafta, por ato duhet të mblidhen dhe të rafinohen. Çipat e avancuar kompjuterikë janë thelbi i **fuqisë kompjuterike** - kontrolli mbi zinxhirët e furnizimit me çipa të jep një levë mbi rivalët. **Talenti** ka të bëjë me njerëzit: cili vend tërheq studiuesit më të mirë dhe teknologjinë më të avancuar?. Fusha e katërt e “betejës” është ndoshta më kritike: lideri përfundimtar global në Inteligjencë Artificiale do të jetë ai që do të ketë **institucione** të cilat ndërfutin efektivisht Inteligjencën Artificiale në ekonominë, shoqërinë dhe, veçanërisht, në ushtrinë e tyre.

Pritshmëritë e Scharre rriten me teknologjinë e së ardhmes. Ai eksploron mënyrat se si sistemet e Inteligjencës Artificiale tashmë po zbulojnë strategji të reja përmes miliona simulimeve të lojërave luftarake, duke zhvilluar taktika luftimi më mirë se sa mund t'i zhvillojnë vetë ushtarakët, duke gjurmuar miliarda njerëz, duke përdorur biometrikë dhe duke kontrolluar në mënyrë delikate informacionin me algoritme sekrete. Ai viziton “ekipin kombëtar” të Kinës, domethënë kompanitë kryesore të Inteligjencës Artificiale, për të treguar sinergjinë rrëqethëse midis qeverisë, sektorit privat dhe shtetit si mbikëqyrës. Ai interviston udhëheqjen e Pentagonit dhe viziton zyrat e Departamentit të Mbrojtjes të SHBA-ve, duke zbuluar tensione të thella midis ushtrisë dhe gjigantëve të teknologjisë që kontrollojnë të dhënat, çipat dhe talentet. Megjithatë, ai arrin në përfundimin se ato tensione, të qenësishme për sistemin tonë demokratik, krijojnë elasticitet dhe rezistencë ndaj autokracisë përballë teknologjisë jashtëzakonisht të fuqishme. Angazhues dhe i drejtpërdrejtë, libri “Katër Fushëbetejat” ofron një pamje të gjallë të mënyrës se si intelijenca artificiale po transformon luftën, sigurinë globale dhe të ardhmen e lirisë njerëzore, duke ofruar, njëherësh, zgjidhje e rekomandime se çfarë do t’iu duhet demokracive që të mbeten në ballë të rendit botëror.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE, FUQIA E TRANSFORMIMIT TË SË ARDHMES

Besohet gjerësisht se bota është në prag të një revolucioni tjetër ushtarak. Intelijenca artificiale është gati të transformojë karakterin e luftës, siç kanë bërë baruti, tanket, avionët dhe bomba atomike në epokat e mëparshme. Sot, shtetet po kërkojnë në mënyrë aktive të shfrytëzojnë fuqinë e intelijencës artificiale për avantazhin ushtarak. Kina, për shembull, ka shpallur synimin për t’u bërë lider botëror në intelijencën artificiale deri në vitin 2030. “Plani i ri i Përgjithshëm i Inteligjencës Artificiale” shpalli se ajo “është një teknologji strategjike që do të udhëheqë të ardhmen”. Në mënyrë të ngjashme, presidenti rus Vladimir Putin ka deklaruar: “Kushdo që bëhet lider në këtë sferë, do të bëhet sundimtar i botës”. Në përgjigje të sfidës së paraqitur nga Kina dhe Rusia, Shtetet e Bashkuara janë angazhuar për një strategji të “kompensimit të tretë”. Ajo do të investojë shumë në intelijencën artificiale, autonomi dhe

robotikë për të ruajtur avantazhin e saj në mbrojtje.

Në dritën e këtyre zhvillimeve dramatike, komentuesit ushtarakë janë interesuar thellësisht për çështjen e aplikimit ushtarak të Inteligjencës Artificiale. Për shembull, në librin e tyre të fundit, autorët *Ben Buchanan* dhe *Andrew Imbrie*¹ kanë pohuar se Inteligjenca Artificiale është “zjarri i ri”. Armët vetëvepruese të kontrolluara nga Inteligjenca Artificiale – jo nga njerëzit – do të bëhen gjithnjë e më të sakta, të shpejta dhe vdekjeprurëse. Ato përfaqësojnë të ardhmen e luftës. Shumë studiues dhe ekspertë të tjerë pajtohen me këtë. Për shembull, *Stjuart Russell*, shkencëtari i shquar i kompjuterëve dhe pionieri i Inteligjencës Artificiale, i kushtoi një nga leksionet e tij më të fundit potencialit ushtarak të Inteligjencës Artificiale. Ai deklaroi ngritjen e robotëve therës e vrasës. Ai përshkroi një skenar, në të cilin, një dron katërkopter vdekjeprurës në madhësinë e një kavanozi, mund të armatosej me një mjet shpërthyes, mina kundër personelit, të afta të zhdukin të gjithë qytetarët në një qytet dhe, ndryshe nga armët bërthamore, infrastruktura e qytetit nuk do prekej. Shumë studiues të tjerë, duke përfshirë Christian Brose, Ken Payne, John Arquilla, David Hambling dhe John Antal, ndajnë besimin e Russell-it se me zhvillimin e gjeneratës së dytë të Inteligjencës Artificiale, armët vetëvepruese vdekjeprurëse - të tilla si tufat e dronëve vrasës, mund të jenë shumë të afërt në kohë.

Sidoqoftë, revolucionet ushtarake shpesh kanë qenë më pak radikale sesa supozohej fillimisht nga avokatët e tyre. Revolucioni i çështjeve ushtarake të viteve ‘90 ishte sigurisht i rëndësishëm në hapjen e mundësive të reja operacionale, por ai nuk eliminoi pasigurinë. Në mënyrë të ngjashme, disa nga debatet rreth autonomisë vdekjeprurëse dhe inteligjencës artificiale kanë qenë hiperbolike, duke keqinterpretuar se si funksionon aktualisht intelijjenca artificiale dhe cilat mund të jenë efektet e saj të mundshme në operacionet ushtarake, si rrjedhim, në çdo të ardhme të mundshme. Megjithatë sistemet e largëta dhe vetëvepruese po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, prapëseprapë ka pak mundësi që tufat autonome të dronëve të zëvendësojnë trupat në fushën e betejës, ose super kompjuterët të zëvendësojnë komandantët si element njeri. *Peter Thiel*, një sipërmarrës kryesor i teknologjisë në *Silicon Valley*, i ka artikuluar kufizimet e inteligjencës artificiale në mënyrë elokuede: “Harrojeni fantazinë e shfrenuar fantastiko-shkencore. Ajo që është e fuqishme për Inteligjencën Artificiale ekzistuese është aplikimi i saj në detyra relativisht të zakonshme si vizioni kompjuterik dhe analiza e të dhënave.” Rrjedhimisht, megjithatë njohja dhe përdorimi i makinerive është shumë më superior se një

¹ Ben Buchanan and Andrew Imbrie “The New Fire: War, Peace, and Democracy in the Age of AI”, March 8, 2022. <https://nextbigideclub.com/magazine/new-fire-war-peace-democracy-age-ai-bookbite/34479/>

njeri në detyra të kufizuara, prapëseprapë është shumë i brishtë. I varur plotësisht nga të dhënat mbi të cilat është trajnuar, edhe ndryshimi më i vogël në mjedisin aktual - ose të dhënat - e bën atë të padobishëm.

Në fund të fundit, tufat autonome të dronëve tashmë janë demonstruar në mjedise padyshim të krijuara dhe të kontrolluara. Sidoqoftë, në realitet, do të jetë shumë e vështirë të stërvitësh një dron për të operuar në mënyrë autonome, për të luftuar në luftën që zhvillohet në tokë. Mjedisi është dinamik dhe kompleks, veçanërisht në qytete, ku civilët dhe ushtarakët pleksen me njeri-tjetrin. Nuk duket të ketë ndonjë të dhënë të qartë mbi të cilën mund të stërvitet një tufë dronësh në mënyrë të besueshme. Situata në tokë është shumë e rrjedhshme. Në mënyrë të ngjashme, nuk është e lehtë të shihet se si një algoritëm mund të marrë vendime komanduese. Vendimet e komandës kërkojnë interpretimin e informacionit heterogjen, duke balancuar faktorët politikë dhe ushtarakë, të cilët të gjithë kërkojnë gjykim. Në një artikull të fundit, *Avi Goldfarb* dhe *Jon R. Lindsay* kanë argumentuar se të dhënat dhe Inteligjenca Artificiale janë më të mirat për vendime të thjeshta dhe me të dhëna shumë të sakta. Por, pothuajse me përkufizim, duhet pranuar se vetëm vendimet e komandës ushtarake mund t'iu japin rrugëzgjdhje situatave komplekse dhe të pasigurta. Ja, të marrim, për shembull, që, ndërsa Google dhe Amazon janë kompanitë kryesore të të dhënave, por menaxherët e tyre nuk mund të parashikojnë që ndonjë ditë, një algoritëm do të marrë vendime strategjike dhe operacionale në emër të menaxherëve. Të dhënat, të përpunuara me shpejtësi me algoritme, ndihmojnë drejtuesit e tyre të kuptojnë tregun në një thellësi dhe besnikëri që konkurrentët e tyre nuk mund t'i përputhin. Avantazhi i informacionit i ka shtyrë ata drejt dominimit. Por, sidoqoftë, njohja dhe përdorimi i makinerive nuk e zëvendëson funksionin ekzekutiv.

Funksioni i Inteligjencës Artificiale dhe i të dhënave nuk është kryesisht vdekjeprurës - ato nuk janë zjarri i ri, siç pretendojnë disa. Të dhënat - informacioni i digjitalizuar i ruajtur në hapësirën kibernetike - janë thelbësore sepse u ofrojnë shteteve një kuptim më të gjerë, më të thellë dhe më besnik të vetes dhe të konkurrentëve të tyre. Kur grupe masive të të dhënave përpunohen në mënyrë efektive nga inteligjenca artificiale, kjo do t'u lejojë komandantëve ushtarakë të perceptojnë hapësirën e betejës në një thellësi, shpejtësi dhe rezolucion deri tani të paarrtshme.

Sigurisht që është e pamundur që komandantët të zëvendësohen me kompjuter apo super kompjuter. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë se inteligjenca artificiale, të dhënat dhe përdorimi i makinerive, nuk janë vendimtare për operacionet ushtarake bashkëkohore dhe të ardhme. Të dhënat dhe Inteligjenca Artificiale mund të jenë vendimtare në operacionet kibernetike dhe fushatat informative. Ato janë bërë të domosdoshme për mbrojtje dhe sulm.

Inteligjenca Artificiale dhe të dhënat nuk janë aq “zjarri i ri”, sesa një formë e re e inteligjencës ushtarake të digjitalizuar, që shfrytëzon hapësirën kibernetike si një burim të ri të madh informacioni. Inteligjenca Artificiale është një mënyrë revolucionare për të parë “anën tjetër të kodrës”. *Paul Scharre*, dikur argumentoi se Inteligjenca Artificiale në mënyrë të pashmangshme do të çonte në autonomi vdekjeprurëse. Në vitin 2019, ai botoi librin e tij më të shitur, “Army of None” (Ushtri e Askujt), i cili tregon ngritjen e sistemeve të armëve të veprimit në distancë dhe me autonomi. Atje, *Scharre* propozoi që Inteligjenca Artificiale ishte gati të revolucionarizonte luftën: “Në luftërat e ardhshme, makinat mund të marrin vendime për jetën dhe vdekjen”.

Por, edhe nëse potenciali i Inteligjencës Artificiale ende e entuziazmon atë, ai tani ka ndryshuar rrënjësisht mendim. Libri i ri i tij, “Katër Fushëbetejat”, botuar në shkurt 2023, përfaqëson një rishikim të thellë të argumentit të tij origjinal. Në të, ai tërhiqet nga tabloja kataklizmike. “Katër Fushëbetejat” është një vepër e ekonomisë politike. Ai trajton çështjet konkrete të konkurrencës së fuqive të mëdha, strategjitë industriale dhe sistemet rregullatore që e mbështesin atë. Libri përshkruan implikimet e inteligjencës së digjitalizuar për konkurrencën ushtarake. *Scharre* analizon mjedisin rregullator që kërkohet për të shfrytëzuar fuqinë e të dhënave. Ai pretendon në mënyrë të besueshme se epërsia në të dhëna dhe katër fushëbetejat për t’i përpunuar ato, do të jenë ushtarakisht vendimtare në rivalitetin e superfuqive midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës. Të dhënat do të ofrojnë një avantazh të madh të inteligjencës. Sikurse e thamë që në fillim, për *Scharre*, ka katër burime kritike që do të përcaktojnë se kush do të fitojë këtë garë intelligence: të dhënat, kompjuterët, talentet dhe institucionet (kompanitë e teknologjisë). Këto do të kenë një avantazh të madh në fuqinë e ardhshme. Ai argumenton se Shtetet e Bashkuara dhe Kina janë të kyçur në një luftë vdekjeprurëse për këto katër burime, duke qenë plotësisht të vetëdijshme se kushdo që do të fitojë avantazhin në “katër fushëbetejat” do të përfitojë dukshëm politikisht, ekonomikisht dhe, më e rëndësishmja, ushtarakisht. Ata do të dinë më shumë se kundërshtari i tyre. Ata do të jenë më efikas në aplikimin e forcës ushtarake. Ata do të dominojnë informacionin dhe hapësirat kibernetike. Do të jenë më vdekjeprurës.

NË GARË ME KINËN?

Libri paraqet zhvillimet e fundit dhe vlerëson pikat e forta relative të të dy shteteve. Kina është ende pas Shteteve të Bashkuara, në disa fusha. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë talentin kryesor dhe janë përpara për sa i përket kërkimit dhe teknologjisë. Kina është një vend i prapambetur në prodhimin e çipave. Megjithatë, *Scharre* paralajmëron kundër vetëkënaqësisë së SHBA-ve. Në të vërtetë, ai priret nga vlerësimi se Shtetet e Bashkuara do të mbeten

prapa në garën e të dhënave. Prandaj, Scharre thekson avantazhet e Kinës dhe përparimet e saj të shpejta. Me 900 milionë përdorues të internetit tashmë, Kina ka shumë e më shumë të dhëna se Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Disa fusha të ekonomisë së saj janë shumë më të digjitalizuara sesa në Shtetet e Bashkuara. “WeChat”-i kinez, për shembull, nuk ka asnjë paralele amerikane. Shumë aplikacione kineze janë superiore ndaj atyre amerikane. Përveç kësaj, shteti kinez është gjithashtu i pafrenuar nga kufizimet ligjore ose nga shqetësimet civile për privatësinë. Partia Komuniste Kineze monitoron në mënyrë aktive profilet digjitale të qytetarëve të saj, mbledh të dhënat e tyre dhe regjistron aktivitetet e tyre. Në qytete, ajo përdor teknologjinë e njohjes së fytyrës për të identifikuar individët.

Sinergjitë midis qeverisë dhe teknologjisë në Kinë janë të ngushta. Kina gjithashtu ka avantazhe të rëndësishme rregullatore ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Partia Komuniste Kineze ka marrë nënshkrimin e gjigantëve të teknologjisë si Baidu dhe Alibaba: “Investimi kinez në teknologji po jep dividendë”. Scharre përfundon: “Kina jo vetëm që po krijon një model të ri të autoritarizmit digjital, por po e eksporton atë në mënyrë aktive.”

Forcat e armatosura duhet të krijojnë partneritete të thella me sektorin e teknologjisë. Ato “do të duhet të shikojnë përtej kontraktorëve tradicionalë të mbrojtjes dhe të angazhohen që në procedurat fillestare”. Kjo nuk është e lehtë. Scharre dokumenton mjedisin rregullator sfidues në Shtetet e Bashkuara, në krahasim me Kinën: “Në SHBA, korporatat e mëdha të teknologjisë Amazon, Apple, Meta (ish-Facebook) dhe Google janë qendra të pavarura pushteti, shpesh në kundërshtim me qeverinë për çështje specifike”.

Pra, kompanitë e teknologjisë sot funksionojnë ndryshe nga ato klasiket. Siç vuri në dukje një nga të intervistuarit e Scharre-it: “Ju nuk mund të blini Inteligjencë Artificiale, ashtu siç blini municion.” Kompanitë e teknologjisë nuk po shesin një kapacitet specifik, si për shembull, një armë. Ato po shesin të dhëna, softuer, fuqi kompjuterike. Në fund të fundit, ata po shesin ekspertizë. Algoritmet dhe programet zhvillohen më së miri në mënyrë të përsëritur në lidhje me një problem shumë specifik. Potenciali i plotë i disa softuerëve, apo algoritmeve për një detyrë ushtarake mund të mos jetë menjëherë i dukshëm edhe për një kompani teknologjike. Duke operuar në tregje konkurruese, kompanitë e teknologjisë, si rrjedhim, preferojnë një sistem kontraktual më elastik dhe të hapur me Departamentin e Mbrojtjes. Ato kanë nevojë për siguri dhe pagesa të shpejta financiare. Kompanitë e teknologjisë janë në kërkim të angazhimit bashkëpunues, jo thjesht një kontratë për të ndërtuar një platformë.

PËRFUNDIME

“Katër Fushëbetejat” është një shtesë e shkëlqyer dhe informuese në literaturën aktuale mbi Inteligjencën Artificiale dhe luftën. Ajo plotëson veprat e botuara së fundmi të Lindsay, Goldfarb, Benjamin Jensen, Christopher Huajt dhe Scott Cuomo. Mesazhi qendror i kësaj letërsie është i qartë: të dhënat dhe Inteligjenca Artificiale janë dhe do të jenë shumë të rëndësishme për forcat e armatosura. Megjithatë, të dhënat dhe Inteligjenca Artificiale nuk do ta transformojnë vetë luftën rrënjësisht. Do të jenë njerëzit që do të vazhdojnë të përdorin sistemet e armëve vdekjeprurëse, duke përfshirë ato në distancë, të cilat vrasin njerëz, siç tregon lufta e egër në Ukrainë. Situata në luftime është komplekse dhe konfuze. Kërkohet gjykimi, aftësia dhe dinakëria njerëzore për të përdorur armët me efektin e tyre më të madh. Sidoqoftë, çdo forcë ushtarake që dëshiron të mbizotërojë në fushat e betejës të së ardhmes, do të duhet të shfrytëzojë potencialin e të dhënave të mëdha, të zotërojë informacionin e digjitalizuar që vërshon nëpër hapësirën e betejës. Njerëzit, thjesht, nuk kanë aftësinë për ta bërë vetë këtë. Prandaj, shtabit do t’i duhen algoritme dhe softuerë për të përpunuar ato të dhëna. Ata do të kenë nevojë për partneritete të ngushta me kompanitë e teknologjisë për të krijuar këto sisteme, si dhe shkencëtarë, inxhinierë dhe programues të të dhënave në postet e komandës operacionale për t’i bërë ato të funksionojnë. Nëse forcat e armatosura janë në gjendje ta bëjnë këtë, të dhënat do t’i lejojnë ata të shohin në të gjithë thellësinë dhe gjerësinë e hapësirës së betejës.

Inteligjenca artificiale nuk do të zgjidhë problemet e operacioneve ushtarake. Të panjohurat do të vazhdojnë. Megjithatë, të fuqizuar nga të dhënat, komandantët mund të jenë në gjendje të përdorin forcat e tyre në mënyrë më efikase. Lufta ruso-ukrainase tashmë jep një pasqyrë të plotë për avantazhet që ofrojnë operacionet ushtarake të bazuara në të dhënat, ndaj një kundërshtari që ende vepron në mënyrë tradicionale.

“FUSHËBETEJA KIBERNETIKE”, ARENA E RE E LUFTËS PËR AVANTAZH GJEOPOLITIK DHE EKONOMIK

Kolonel Msc. Hysni GJERGJI

Shef Departamenti në IKSHU

Kolonel Msc. David RROKU

Zëvendësdyrëtor i IKSHU

Trajtesë e shkurtuar.

Ky studim sjell në vëmendjen e lexuesit, kryesisht drejtuesve ushtarakë, një qasje të re të transformimit të luftës tradicionale, mundësuar nga hapësira kibernetike. Ky domen i ri e ka tejkaluar tashmë hapësirën tokësore, ajrore dhe detare, duke zhvilluar konfliktin ndërshtetëror të padallueshëm, të padhunshëm, me mjete të pa hasura më parë.

Kombet mund t'i bëjnë dëme të mëdha njëri-tjetrit edhe pa hedhur bomba, mund të ulin besimin tek institucionet dhe të krijojnë atmosferë përbuzjeje, mosbesimi, pasigurie, rënie ekonomike, madje edhe luftë civile. Me anë të operacioneve të ndikimit politiko-ekonomik, këta aktorë duke përdorur këtë domen të ri të luftës, synojnë të përmbysin konkurrencën, epërsinë, fuqinë strategjike, ushtarake dhe ekonomike të shteteve.

Agresori në hapësirën kibernetike nuk e detyron armikun të pranojë vullnetin e tij me forcë por; në mënyrë manipulative, duke “bindur” votuesit e shtetit shënjestër, të marrë atë që do. Lideri, i mbështetur nga kundërshtari¹, arrin të

¹<https://www.balkanweb.com/zbulohet-plani-i-putinit-kush-eshte-ish-presidenti-pro-rus-qe-deshiron-ta-vere-ne-krye-te-ukraines/>

transformojë epërsinë gjeopolitike, ekonomike dhe ushtarake në avantazh të fuqisë që e ka përzgjedhur, pa qenë nevoja e përdorimit të forcës. Regjimet një partiake, Kina, Irani dhe Rusia, përdorin gjithë instrumentet e luftës hibride, për t'i manipuluar gjykimin zgjedhësve, me anë të platformave dhe medias sociale².

Punimi është i bazuar në analiza të instituteve dhe studiuesve amerikanë, rusë dhe evropiano-perëndimorë.

Fjalët kyçe: Operacion i ndikimit, agjent i kaosit, blerje e vëmendjes, projekti “Lakhta”, spiunazhi industrial, teknologjia 5G, Huawei, ZTE etj., mashtrues të pafajshëm, droga digjitale.

HYRJE

Në të ardhmen e afërt, “beteja” dhe akti i luftës do të bëhet gjithnjë e më pak i dhunshëm³, duke u transferuar nga toka, ajri, deti dhe hapësira drejt kibernetikës.

Sanksionet ekonomike të aplikuara në vitet e fundit, ndërhyrjet nga jashtë në zgjedhjet politike të vendeve sovraane, apo “operacionet e ndikimit” të vullnetit të votuesve, nisur nga synimi i tyre, janë akte të pastra lufte.

Aktorët shtetërorë ose edhe individë, megjithëse nuk përdorin armë tradicionale zjarri, mund të transformohen në palë kundërshtarë luftuese, nëpërmjet “operacioneve të ndikimit të audiencave” ose “blerjes së vëmendjes”. Vetëm me anë të aksesit në internet, Kremlinin përmes instrumenteve të “luftës hibride” synon të ndërhyjë në zgjedhjet e vendeve të tjera, me qëllim zgjedhjen e qeverive kukull në duar të tyre. Objektivi, përveç SHBA-ve, kanë qenë edhe vendosja e liderëve pro rusë në Evropën Lindore, përmes mbështetjes me para, për partitë politike si dhe blerje të votave. Kjo është metodë e përdorur dhe e raportuar pothuaj në të gjithë Evropën Lindore përfshirë edhe vendin tonë⁴.

Operacionet psikologjike të ndikimit, të gatuar nga “trollët rusë⁵”, për të ndikuar në vendimmarrjen politike, vazhdojnë paralelisht edhe kundër objektivave ekonomikë. “Puna” për të lokalizuar, vjedhur dhe transferuar informacione të ndjeshme nga kompani dhe individë në një shtet tjetër, bëhet nga aplikacionet e inteligjencës artificiale (IA).

² <https://dosja.al/si-ruset-kane-100-vjet-qe-nderhyjne-ne-zgjedhjet-e-vendeve-te-tjera>

³ <http://www.shtepiaelibrit.com/store/sq/filozofia-sociologjia/2243-nga-diktatura-ne-demokraci-gene-sharp.html>

⁴ <https://www.zeriamerikes.com/a/6746331.html>

⁵ <https://www.koha.net/tech/203192/hakeret-e-trolltet-ruse-pervjelin-menget-per-mbjellje-te-kaosit/>

1. AVANTAZHI GJEOPOLITIK DHE NDIKIMI I AUDIENCAVE VIRTUALE NËPËRMJET “AGJENTËVE TË KAOSIT NË PROCESET ZGJEDHORE

Kur flitet për ndikim të një shteti te një individ të një shteti tjetër me anë të medias, mendja shkon te “soft power”. Kjo fuqi e ashtuquajtur *e butë*, synon që, me anë të kulturës demokratike, shkencës, teknologjisë, publicistikës, standardit të jetesës etj., të “bëjë për vete” individë dhe shtresa të ndryshme sociale të një shteti tjetër, pa dhunë, pa forcë dhe pa manipulim. Por propaganda e rreme, dezinformacioni, informacion pozitiv për një kandidat dhe denigrues për një tjetër, megjithëse përdor forma dhe mjete të ngjashme me atë të fuqisë së butë, është krejtësisht diçka tjetër. Regjimet monopartiake të interesuara sulmojnë kundërshtarët në fushëbetejën kibernetike përmes operacioneve të ndikimit të “audiencave virtuale” dhe “agjentëve të kaosit”, duke transformuar vullnetin e zgjedhësve. “*Putini mendon se ku ka kaos, ka edhe mundësi. Kështu që konfuzioni dhe mashtrimi janë pjesë e trajnimit të agjentëve të tij*”⁶. Rusia, përmes operacioneve të ndikimit dhe agjentëve të kaosit në median sociale, synon të arrijë tre qëllime kryesore:

- Të minojë besimin e publikut në procesin demokratik të zgjedhjeve të lira, duke deformuar vullnetin e votuesit.
- Të denigrojnë përmes publikimeve “fake”, kandidaturën e papëlqyeshme për ta dhe të pengojë zgjedhjen e tij/saj si kryetar shteti.
- Të ndihmojnë tërthorazi kandidaturën e pëlqyer si zgjedhjen më të përshtatshme për interesin rus.

Synimi për të pasur në krye të shtetit “target” liderët e pëlqyer, vlerësohet si investim i leverdishëm i Moskës për të ardhmen e politikës, ekonomisë dhe diplomacisë ruse. Kjo për arsyen se qëndrimi për politikën ruse dhe sanksionet ndaj saj, kanë qenë të ndryshme për liderë botërorë të ndryshëm. Hilary Clinton, për shembull, shihej nga Putini përgjegjës për protestat masive në Rusi të viteve 2011-2012 kundër sundimit të tij, kështu që ai mendonte se Trump do ishte më i përshtatshëm si president i SHBA-ve. Kremli gjykoi se në pamundësi për të blerë kandidatin, ai do të ndikojë në vendimin e votuesit, me qëllim marrjen e rezultatit të dëshiruar. Qeveria ruse ndërhyri në zgjedhjet presidenciale amerikane të vitit 2016⁷, me qëllimin për të dëmtuar fushatën e Hillary Clinton nga njëra anë, si dhe duke përkrahur indirekt kandidaturën e Donald Trump, i cili vlerësohej më pak agresiv ndaj Moskës.

Por forma e blerjes me para e një lideri në Ballkan apo Afrikë nuk funksionon njëjloj edhe në SHBA⁸. Moska përdori në SHBA një metodë tjetër, e cila është

⁶ Orysia Lutsevych, studiuese në Chatham House, Mbretëri e Bashkuar.

⁷ https://en.wikipedia.org/wiki/2016_U.S._presidential_election

⁸ <https://www.aa.com.tr/sq/bota/presidenti-bullgar-kritikon-q%C3%ABndrimin-e->

quajtur lufta me “agjentët e kaosit”. Përmes rrjeteve sociale dhe platformave të krijuara posaçërisht, Rusia synoi dhe deri në një farë mase ia arriti të “blejë audiencat” e varura dhe besnike të rrjeteve sociale. Ky kaos krijohej edhe me qëllimin për të rritur mosmarrëveshjet politike, racore, gjeografike dhe sociale në Shtetet e Bashkuara. Sipas komunitetit të inteligjencës amerikane, operacioni është quajtur projekti “Lakhta”⁹, i cili u urdhërua drejtpërdrejt nga presidenti rus Vladimir Putin. “Fermat e trolleve” ruse ose agjitorët e organizuar në internet i identifikojnë ankesat dhe më pas përfshihen në ato debate me qëllim që t’i ndezin. Trollët profesionistë rusë përqendrohen në nxitjen e emocioneve armiqësore mbi tema të nxehta, si: çështjet e kontrollit të armëve, emigracioni, diskriminimi racor etj., për t’i kthyer amerikanët kundër amerikanëve. Taktika është e thjeshtë: përçaj dhe sundo.

Hakerët e punësuar nga GRU¹⁰ depërtuan në sistemet e informacionit të Komitetit Kombëtar Demokrat dhe zyrtarëve të fushatës së Clinton-it, veçanërisht të kryetarit John Podesta dhe publikuan skedarë të vjedhur dhe email-e përmes rrjeteve sociale dhe *WikiLeaks*-it. Shpërndarja e këtyre skedarëve bëhej, duke zgjedhur kohën kur efekti do të ishte maksimal, në dy drejtime kryesore: e para në dëmtim të imazhit të Clinton-it dhe e dyta në mbrojtje të Trump-it. Përpyekjet ruse për të ndërhyrë në zgjedhje u zbuluan nga agjencitë e inteligjencës amerikane në tetor 2016 dhe u detajuan më tej në janar 2017. Hetimi i Komitetit të Inteligjencës të Senatit, i udhëhequr nga republikanët, paraqiti në raportin e tij të parë prej 1313 faqesh prej pesë vëllimesh ¹¹ në korrik 2019.

Eksperti rus i sigurisë Andrei Soldatov ¹² deklaroi “Moska beson se me Clinton në Shtëpinë e Bardhë do të jetë pothuajse e pamundur të hiqen sanksionet kundër Rusisë. Kështu që është një çështje shumë e rëndësishme si për *Putinin personalisht, ashtu edhe një çështje e sigurisë kombëtare ruse*”¹³. Putin-i e ka mohuar çdo përfshirje të Kremlinit në fushatën zgjedhore, megjithëse në qershor 2017 u tha gazetarëve se “hakerët rusë me bindje “patriotike” mund të kenë qenë përgjegjës për sulmet kibernetike të fushatës kundër SHBA-së”.

Ndërsa në 2018, ai deklaroi se kishte dashur që Trump të fitonte zgjedhjet, pasi donte të kthente në normalitet marrëdhëniet SHBA-Rusi.

qeveris%C3%AB-p%C3%ABr-d%C3%ABrgimin-e-arm%C3%ABve-n%C3%AB-ukrain%C3%AB/2946117

⁹ <https://www.balkanweb.com/rusia-po-nderhyn-serish-ne-shba-kush-eshte-kuzhinieri-i-putinit/>

¹⁰ Shërbimi i zbulimit ushtarak rus.

¹¹ https://Senate_Intelligence_Committee_report_on_Russian_interfere

¹² https://en.wikipedia.org/wiki/Andrei_Soldatov

¹³ https://Russian_interference_in_the_2016_United_States_elections#cite_note-28

Për këtë operacion, reklamat e blera nga operativët rusë për faqen e *Facebook* vlerësohet të kenë arritur në 10 milionë përdorues. U krijuan 470 llogari në *Facebook* nga rusët gjatë fushatës dhe nga këto, 6 (gjashtë) gjeneruan dezinformacion që u shpërnda të paktën 340 milionë herë¹⁴. Artikujt e fabrikuar dhe dezinformatat u përhapën nga mediat e kontrolluara nga qeveria ruse, RT¹⁵ dhe Sputnik për t'u popullarizuar në llogaritë pro-ruse në Twitter dhe media të tjera sociale. Në 7,000 llogari të mediave sociale pro-Trump gjatë një periudhe 2-vjeçare, studiuesit zbuluan se llogaritë propagandonin madje edhe gënjeshtra për shëndetin e Clinton-it. Propaganda ruse kishte qëllim nxitjen e “konspiracioneve kundër qeverisë amerikane dhe institucioneve të saj”, deri në vjeshtën e 2016, duke shtuar sulmet ndaj Clinton-it dhe mbështetjen për Trump, nëpërmjet mediave sociale.

U shpërndanë 20 histori të rreme zgjedhore¹⁶ nga faqet e mashtrimit të cilët gjeneruan 8,711,000 rishpërndarje, reagime dhe komente në Facebook. Në shtator 2017, Facebook zbuloi se qindra llogari të rreme të lidhura me një fermë trollash ruse¹⁷ kishin blerë 100,000 dollarë për reklama që synonin audiencën e zgjedhjeve të vitit 2016 në SHBA. Reklamat u shfaqën midis qershorit 2015 dhe majit 2017 dhe ishin të fokusuara kryesisht në çështje sociale përçarëse. Përafërsisht 3,000 reklama u panë nga katër deri në pesë milionë përdorues amerikanë të *Facebook*-ut para zgjedhjeve.

Në krye të këtij operacioni u vendos GRU¹⁸, e cila grumbulloi dhe dërgoi email-e, të cilat u ruajtën, u përzgjedhën dhe u publikuan për votuesit, gjatë tre muajve përpara zgjedhjeve të 2016-ës. Disa email-e u publikuan në mënyrë strategjike për të shpërqendruar publikun nga ngjarjet mediatike që ishin të dobishme për fushatën e Klintonit dhe të dëmshme për Trump. Grupi i parë me 19,000 email-e dhe 8,000 video u publikua më 22 korrik 2016, tre ditë përpara konventës së Demokratëve. Një grup i dytë me email-e u publikua më 7 tetor, disa orë pasi Obama dhe drejtori i Inteligjencës Kombëtare të akuzonin qeverinë ruse për ndërhyrje në zgjedhje përmes hakerimit. Ky grup me email-e u publikua vetëm 29 minuta pasi *Washington Post* raportoi në videokasetën¹⁹ e “Access Hollywood” për skandalin seksual të D. Trump. Dokumentet e publikuara shpërqendruan vëmendjen e votuesve nga të dyja historitë dhe skandalet e publikuara.

¹⁴ Sipas hulumtimit të bërë nga Jonathan Albright, drejtor kërkimor për Qendrën tërheqëse për Gazetarinë Digjitale të Universitetit të Kolumbisë.

¹⁵ Russia Today

¹⁶ Sipas një analize nga *BuzzFeed News*

¹⁷ https://en.wikipedia.org/wiki/Internet_trolling

¹⁸ GRU - Shërbimi i inteligjencës ushtarake amerikane.

¹⁹ https://Donald_Trump_Access_Hollywood_tape

Në janar 2017, Komuniteti i Inteligjencës së Shteteve të Bashkuara arriti në përfundimin se GRU (duke përdorur emrat Cozy Bear dhe Fancy Bear²⁰) kishte fituar akses në rrjetin kompjuterik të, organit zyrtar i Partisë Demokratike nga korrik 2015 deri në qershor 2016, nëpërmjet personazhit *online* Guccifer 2.0 dhe *Wikileaks*. Në aktakuzën e korrikut 2018 ndaj dymbëdhjetë zyrtarëve të inteligjencës ruse të GRU-së, që paraqiteshin si “një person i Guccifer 2.0”, u akuzuan për komplot për të ndërhyrë në zgjedhjet e vitit 2016, ndaj të paktën treqind individëve të lidhur me fushatën e Klintonit”.

GRU u mor me kulturën e myslimanëve, të krishterëve dhe komunitetit LGBTQ, për t'i angazhuar këto komunitete si pjesë e një strategjie më të gjerë, për t'i thelluar ndasitë sociale dhe politike brenda SHBA-ve. Rreth 30 profile të hapura në *Facebook* nga amerikanët zezakë dhe 10 kanale në YouTube postuan 571 video në lidhje me dhunën e policisë kundër afrikano-amerikanëve. Të paktën 25 faqe të mediave sociale me 1.4 milionë ndjekës u krijuan nga agjentët rusë, për të promovuar kandidaturën e Trump-it. Një oligark, Viktor Vekselberg, u arrestua dhe pajisjet e tij elektronike u kontrolluan ndërsa ai mbërriti në një aeroport të zonës së Nju Jorkut me avionin e tij privat në fillim të vitit 2018.

Në konferencën e sigurisë në Aspen në verën e vitit 2016, drejtori i Inteligjencës Kombëtare James Clapper u shpreh se Vladimir Putin donte të hakmerrej kundër ndërhyrjes së “perceptuar” të SHBA-ve në çështjet ruse me protestat ruse të viteve 2011-2013²¹, si dhe rrëzimin e Viktor Janukoviçit. Më 7 tetor, qeveria amerikane akuzoi zyrtarisht Rusinë për hakerimin e rrjeteve kompjuterike të DNC-së për të ndërhyrë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 me ndihmën e organizatave si *WikiLeaks*. Departamenti i Sigurisë Kombëtare dhe Zyra e Drejtorit të Inteligjencës Kombëtare për Sigurinë Zgjedhore në deklaratën e tyre të përbashkët, u shprehën: “Zbulimet e fundit të email-eve të hakeruara në DCLeaks.com dhe WikiLeaks nga personat Guccifer 2.0 janë në përputhje me metodat dhe motivimet e përpjekjeve të drejtuara nga Inteligjenca ruse”.²² Më 21 prill 2020, Komiteti i Inteligjencës i Senatit publikoi një raport unanim, të redaktuar duke shqyrtuar vlerësimin e komunitetit të inteligjencës të janarit 2017 mbi ndërhyrjen ruse. Komiteti mendoi se vlerësimi solli një “bazë koherente dhe të mirëndërtuar të inteligjencës për rastin e ndërhyrjes së paprecedentë ruse në zgjedhjet presidenciale të SHBA-së 2016», veçanërisht se ndërhyrja ishte e paprecedentë në «mënyrën e saj dhe agresivitet. Komiteti i Senatit dëgjoi «raportimin specifik të inteligjencës për të mbështetur vlerësimin

²⁰ *Cozy Bear* and *Fancy Bear* janë grupe hakerësh në dy agjencitë e inteligjencës ruse. *Cozy Bear* punon për SVR, ndërsa *Fancy Bear* është pjesë e GRU.

²¹ https://en.wikipedia.org/wiki/2011%E2%80%932013_Russian_protests

²² https://Russian-interference_in_the_2016_United_States_elections#cite_note-201

se Putini dhe qeveria ruse demonstruan një preferencë për kandidatin Trump” dhe se Putin personalisht “aprovoi dhe drejtoi” ndërhyrjen.

Në 2018, Prigozhin është paditur së bashku me 12 shtetas të tjerë rusë dhe 3 firma ruse, si pjesë e hetimit të Robert Mueller për ndërhyrjen ruse në zgjedhje. Në vitin 2020, Departamenti i Drejtësisë ka hedhur poshtë aktakuzat kundër firmës së hotelerisë së Prigozhin, Concord, sepse pamundësia për të ndëshkuar të paditurin, mund të çonte në ekspozimin e teknikave të zbatimit të ligjit. Në korrik 2022, Departamenti i Shtetit ofroi një shpërblim prej 10 milionë dollarësh për informacion mbi Prigozhin-in dhe Agjencinë e Kërkimeve të Internetit përmes mekanizmave të tjerë të ndërhyrjes ruse. Në nëntor 2022, oligarku rus Yevgeny Prigozhin pranoi ndërhyrjen ruse në zgjedhjet amerikane. CNN raportoi se “deklarata e tij dukej se ishte pranimi i parë i një fushate ruse të nivelit të lartë për të ndërhyrë në zgjedhjet e SHBA nga dikush që është shumë afër Kremlinit.” Pranimi i ndërhyrjes në zgjedhje nga Prigozhin në nëntor pasoi pranimin e tij për financimin e mercenarit të ekstremit të djathtë të lidhur me Kremlinin, Wagner Group²³, në shtator 2022.

*Zotërinj ndërhyrës, ndërhyrës dhe do të ndërhyrës, me kujdes, saktësi kirurgjikale dhe në mënyrën tonë, siç ne dimë.*²⁴ Koha e pranimit të tij mund të përmbajë edhe elemente dezinformimi, si një nga narrativat ruse “që synojnë minimin e demokracisë”. Në korrik 2023 Prigozhin²⁵, me një vetëbesim të tepruar, tentoi të sfidonte Putinin me mercenarët Wagner, por pati të njëjtin përfundim me të eliminuarit²⁶ e Putinit, përgjatë 20 viteve të pushtetit të tij²⁷. Inteligjenca britanike dhe holandeze i kanë dhënë informacion Shteteve të Bashkuara në lidhje me takimet në qytetet evropiane midis zyrtarëve rusë, bashkëpunëtorëve të Putinit dhe bashkëpunëtorëve të presidentit të atëhershëm të zgjedhur, Trump. Hetimi i publikuar nga një universitet britanik²⁸ në shtator 2021, zbulon se faqet e internetit të mediave perëndimore janë sulmuara nga trollët pro-rusë për të përhapur propagandë dhe dezinformacion në mbështetje të Kremlinit. Mes tyre janë “Daily Mail”, “Daily Express” dhe “The Times” në Britani; “Fox News” dhe “Washington Post” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; “Figaro” franceze; “Der Spiegel” dhe “Die Welt” gjermane; dhe La Stampa në Itali. Hulumentuesit kanë gjetur 242 “story” në të cilat janë publikuar

²³ <https://www.dw.com/sq/shp%C3%ABrthen-hapur-lufta-p%C3%ABr-pushtet-mes-osk%C3%ABs-dhe-trup%C3%ABs-wagner/a-66019494>

²⁴ https://Russian_interference_in_the_2016_United_States_elections#cite_note-2-396

²⁵ <https://www.theguardian.com/world/2023/jul/14/putin-says-he-tried-but-failed-to-oust-prigozhin-after-wagner-mutiny-fighters-ukraine-war>

²⁶ Më datë 22 gusht 2023, avioni ku udhëtonte Prigozhin hidhet në erë dhe deklarohet zyrtarisht i vdekur.

²⁷ Hysni Gjergji, *Prigozhin një mercenar i dehur*, Gazeta “Ushtria”, 30 qershor 2023.

²⁸ <https://www.themoscowtimes.com/2021/09/06/russian-trolls-targeting-western-media-uk-research-a74985>

“deklarata provokuese pro-ruse ose antiperëndimore”, si reagim ndaj historive të lidhura me Rusinë. Mediat në gjuhën ruse më pas i përdorin ato si bazë për referenca, për të sugjeruar mbështetje më të gjerë publike përëndimore për politikën ruse dhe presidentin Vladimir Putin. Duke analizuar përhapjen dhe pasojat e këtij fenomeni të ri, që po huazohet nga Rusia në marrëdhëniet ndërkombëtare, nuk mund të mos reflektohet për shqetësimet, që kjo strategji ruse mund të shkaktojë edhe në Shqipëri.

Profesori Juri Radkovec i Qendrës Analitike të Studimeve Gjeopolitike në Kiev, shkruante më 28 shtator 2022: “Përpyekjet kryesore të Rusisë tani janë drejtuar dhe fokusuar në kundërshtimin e integritit evropian dhe euroatlantik të Ballkanit nëpërmjet presioneve politiko-diplomatike, ekonomike (përfshirë dhe energjinë), tekniko-ushtarake dhe informative mbi një numër shtetesh dhe konkretisht mbi Kroacinë, Shqipërinë²⁹, Malin e Zi, Serbinë, Maqedoninë, Bosnjë-Hercegovinën”.

2. EKONOMIA DHE TEKNOLOGJIA, “FUSHËBETEJAT E REJA” NË HAPËSIRËN KIBERNETIKE

Jo vetëm politika dhe diplomacia janë në shënjestër të fuqive botërore për ndikim, por edhe ekonomia dhe teknologjia, si instrumente të fuqisë kombëtare. Në krye të luftës për avantazh ekonomik dhe teknologjik është Kina, si ekonomia e dytë më të madhe në planet pas SHBA-ve. Pekini synon të bëhet sundimtar ekonomik global dhe të kapërcejë teknologjikisht dhe për rrjedhojë ekonomikisht, konkurrentët evropianë dhe amerikanë. Por si arrihet ky objektiv dhe si zhvillohet kjo luftë? Spiunazhi ekonomik është një lojë që luhet nga dy aktorë, por kur bëhet fjalë për Kinën, kjo lojë është ngritur në perfeksion si cilësi dhe në masivitet në fusha veprimi. Incidenti i fundit, në shfaqjen e balonës spiune mbi tokën e tyre, amerikanët nuk e shohin si të izoluar, pasi balona në fjalë është pjesë e një programi ndërkombëtar grumbullimi informacioni ushtarak dhe ekonomik nga Pekini. Balona, e cila fluturonte në një lartësi prej rreth 6 kilometrash, ishte “ideale” për vëzhgim, në krahasim me avionët luftarakë, më e vështirë për t’u zbuluar nga sistemet e vëzhgimit ajror, dhe ndërkohë nuk pengonte korridoret ajrore ndërkombëtare. Forcat e Armatosura të SHBA-ve raportojnë se Kina ka një flotë me balona të tilla, të madhësive, formave dhe përdorimeve të ndryshme. Të paktën tre fluturime mbi SHBA, gjatë administratës së Trump-it dhe të Biden-it, janë konfirmuar dhe janë shmangur nga zbulimi dhe sistemet e mbrojtjes ajrore amerikane. Sekretari Blinken thekson se SHBA-të nuk janë objektivi i vetëm i mbikëqyrjes dhe i monitorimit të Kinës, pasi një balonë kineze kaloi Havain dhe Floridën, ndërsa “rrethonte gjithë globin” në vitin 2019.

²⁹ <https://top-channel.tv/2023/04/13/liste-e-zeze-me-emra-te-lidhur-me-rusine-escobar-ne-top-story-ka-persona-qe-jane-te-gatshem-te-pranojne-financimet-34p/>

Duke përdorur inteligjencën artificiale, këto balona “lexojnë” erërat dhe drejtimet e tyre për të arritur në destinacionin e tyre duke ndryshuar lartësinë. Për shkak të materialeve të lehta dhe lartësisë që fluturojnë, ato nuk zbulohen nga radarët dhe sistemet e mbrojtjes ajrore dhe dërgojnë të dhëna, për instalimet ushtarake dhe ekonomike, si dhe mund të ndërhyjnë në sistemet e telekomunikacionit. Kompanitë e specializuara në teknologjinë 5G si Huawei³⁰, ZTE dhe Hytera, janë aktualisht në fokus të agjencive perëndimore të zbulimit, pasi ato grumbullojnë informacion sensitiv, lidhur me sigurinë kombëtare të shteteve të ndryshme dhe i transferojnë në Kinë. Në fund të viteve 2000, dominuesi global në furnizimin e tij ishte gjiganti kinez Huawei, i cili filloi aktivitetin nga një dyqan i vogël i ish-ushtarakut Wen Zhengfei³¹. Autoritetet amerikane akuzuan Huawei, për lidhje të ngushta me qeverinë kineze dhe përdorimin e pajisjeve të në operacionet e spiunazhit pro-Kinës. Ka pasuar akuza për përgjim të sekreteve tregtare nga kompanitë amerikane dhe keqpërdorim të robotikës. Kjo u pasua me arrestime të drejtuesve të Huawei-t në vende të ndryshme, me akuzën e spiunazhit dhe një drejtuesi të grupit nga autoritetet kanadeze.

Pentagoni ka një listë të zezë të kompanive të lidhura me regjimin e Pekinit të cilat mund të jenë agjencitë e tij të spiunazhit. Në vitin 2018, atyre iu shtua prodhuesi kinez i telefonave celularë Xiaomi dhe ZTE. Pentagoni e ka ndaluar personelin e Departamentit të Mbrojtjes të SHBA-ve të përdorë celularë, tableta, kompjuterë dhe router nga këto kompani, për arsye se kompanitë mund të përdorin teknologjinë e tyre për të spiunuar amerikanët që ata i shënjestrojnë.

Një pajisje mund të “skanojë” bisedat në rrjetet sociale, dokumentet e dërguara përmes postës elektronike, madje edhe çdo gjë që tregon ekrani i pajisjes. Kjo qasje kishte “qarkulluar” gjerësisht në qarqet e biznesit, duke çuar në një fenomen mjaft të çuditshëm: biznesmenët më të fuqishëm në botë filluan të përdorin pajisje të teknologjisë shumë më të vjetër, dhe se në bisedat që kërkojnë fshehtësi, telefonat celularë dhe pajisjet e tjera elektronike lihen në një vend të largët nga vendi i takimit.

Në “luftën” e gjysmëpërçuesve që shkaktoi përçarje masive në tregun global kur kompanitë amerikane ndaluan transferimin e teknologjisë në Kinë dhe furnizimin e vendit me mikroçipe, janë bërë zbulime që e bëjnë skenarin më të egër të filmit me spiunazh, të duket si një komedi e vjetruar. Vendimi i Britanisë së Madhe për të kufizuar përdorimin e kamerave të marra nga gjigandi kinez i telekomunikacionit Hikvision, prodhuesi më i madh në botë i tyre ka logjikë

³⁰ <https://www.ericsson.com/en/5g>

³¹ <https://www.bbc.co.uk/neës/business-47286166>

pasi mikroçipet ruajnë imazhe që dërgohen në një server të shërbimeve sekrete kineze.

Sipas një raporti nga *think tank* OODA³², pajisjet shtëpiake të pajisura me *smart* si frigoriferë inteligjentë, televizorë, makina, jo domosdoshmërisht me origjinë kineze, kanë mikroçipe të ndërtuara në kinë, të cilat lejojnë Pekinin të përgjojnë jetën e qytetarëve që i posedojnë dhe nuk dyshojnë te këto pajisje. Raporti madje thekson se pajisjet e prodhuara në Kinë paraqesin një kërcënim më të madh se komponentët 5G. Falë kësaj teknologjie dikush mund të regjistrohet thjesht duke hapur derën e frigoriferit, ose duke folur pa u kujdesur para televizorit, i cili e transmeton bisedën e tyre. Kërcënimi bëhet edhe më i tmerrshëm për orët inteligjente, të cilat kanë akses në të dhënat biometrike të përdoruesit.

Mikroçipet e instaluar në një sërë pajisjesh, duke përfshirë laptopët, orët, celularët, televizorët, frigoriferët, kamerat e ziles së derës, makinat, kartat SIM dhe madje llambat mund të luajnë rolin e Kalit të Trojës, duke mbledhur dhe dërguar të dhëna te prodhuesi i tyre. Tani, ky kërcënim po pranohet, pasi gjigantët e teknologjisë “Dell” kanë ndaluar së përdoruri jo vetëm mikroçipet me origjinë kineze, por edhe gjysmëpërçuesit nga furnitorët në kompani perëndimore që i prodhonin.

Rrjeti social kinez TikTok, i bazuar në video të shkurtra me përdorimin e filtrave të inteligjencës artificiale, nuk u bë rastësisht i popullarizuar në mbarë planetin, pasi ka një varësi për përdoruesit e tij. Fillimisht është përdorur nga adoleshentët, që filmonin dhe shkarkonin video argëtuese. Vitet e fundit, ligjvënësit amerikanë që kanë vënë në tavolinë ndalimin e saj, e përshkruajnë atë si një “drogë digjitale”. Kompania mëmë e rrjetit social “ByteDance” është në mes të një vorbulle spiunazhi pro-Kinës kundër përdoruesve të saj nga autoritetet amerikane dhe evropiane. TikTok pranoi se përdorte aplikacionin e vet për të spiunuar gazetarët dhe për të gjurmuar burimet e tyre. Për gazetarët evropianë dhe amerikanë, burimi i informacionit është “i shenjtë”, prandaj Kina i gjurmoi adresat IP të gazetarëve me aplikacionin TikTok³³.

Ndërsa aplikacioni është bllokuar nga pajisjet e punonjësve federalë në SHBA, në Evropë më shumë se 250 milionë qytetarë përdorin rrjetin social, të cilët kanë pasur shqetësime për “mungesën e sigurisë” dhe mbrojtjen e të dhënave, sigurinë e të dhënave personale dhe veçanërisht të fëmijëve. Presidenti francez Macron e karakterizon aplikacionin si “mashtues të pafajshëm” dhe shkaktar të një “varësie të vërtetë” dhe gazetën franceze “Le Parisien” për një “Rrezik real për trurin e fëmijëve”. Drejtori i FBI-së, Christopher Wray, thotë se zyra e

³² <https://www.bing.com/ck/>

³³ <https://gazetadita.al/si-po-spiunon-kina-me-balona-nga-ajri-tiktok-dhe-frigorifere/>

tij hap një dosje spiunazhi financiar ekonomik që përfshin Kinën, çdo 10 orë. Po kështu, Departamenti Amerikan i Drejtësisë raporton se më shumë se 80% e rasteve të spiunazhit financiar janë të lidhura me Kinën.

BE-ja dhe shtabet e NATO³⁴-s e kanë vlerësuar kërcënim përdorimin e Tik-Tok -ut për personelin zyrtar³⁵, si dhe kanë përjashtuar kompanitë kineze nga furnizimi i pajisjeve për kalimin në rrjetet e gjeneratës së ardhshme të 5G³⁶. Këtë tendencë dhe vijë sjellje po e ndjek dhe duhet ta ndjekë edhe vendi ynë.

PËRFUNDIME

- Strategjia e fuqive të huaja për të vendosur liderë pro saj në shtete të tjera, përmes grushtit të shtetit apo blerjes, është më efektive dhe më pak e kushtueshme sesa operacionet ushtarake. Me anë të liderëve rajonalë³⁷ dhe botërorë pro saj³⁸, Rusia arrin më lehtë objektivat e saj strategjikë³⁹.
- Shtrirja përmes teknologjisë 5G dhe platformave të tjera të lidhura me Kinën është sfidues global i lirive themelore dhe konkurrencës ekonomike. Sipas ligjit të vitit 2017⁴⁰ 1.5 miliardë kinezë kanë detyrim ligjor të kryejnë spiunazh politik dhe industrial në favor të shtetit një partiak.
- Ndikimi politik, ekonomik, dezinformimi dhe aftësia për të përfituar nga skemat dhe personat e korruptuar, janë katër elementet kyçe përmes së cilave Rusia e shtrin ndikimin e saj në pengimin e integritetit euroatlantik të Kroacisë, Shqipërisë⁴¹, Malit të Zi, Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Bosnje-Hercegovinës⁴².
- Operacion “ndikimi” në Shqipëri mund të konsiderohet nxitja e anti-amerikanizmit⁴³ në rritje kohët e fundit dhe për herë të parë në historinë tonë. Kjo do të ishte fitorja më e madhe e Moskës, pasi e izolon dhe i heq Shqipërisë mbështetjen dhe besimin tek aleati kryesor strategjik i saj, SHBA.

³⁴ Natasha Bertrand CNN, 31 mars 2023

³⁵ <https://www.cnn.com/2023/03/31/tech/nato-tiktok-ban/index.html>

³⁶ <https://www.linkedin.com/pulse/aleanca-e-kin%C3%ABs-me-rusin%C3%AB-kund%C3%ABr-shba-qemal-lame>

³⁷ <https://www.gazetaexpress.com/si-fshihet-dora-e-putinit-pas-grushtit-te-shtetit-ne-niger/>

³⁸ <https://gazetasi.al/kush-eshte-politikani-qe-rusia-deshiron-qe-ta-udheheqe-ukrainen/>

³⁹ <https://abcnews.al/orban-dhe-vucic-dy-nacionalistet-qe-hiqen-si-pro-europiane/>

⁴⁰ <https://top-channel.tv/2023/08/03/shba-e-shqetesuar-rreth-shtrirjes-se-ligjit-kunder-zbulimit-ne-kine/>

⁴¹ Brixhilda Xhuraj, *Albanian post*, 29 shtator 2022.

⁴² <https://sbunker.net/kremlin-shah/91025/rusia-eshte-ne-mesdhe-dhe-se-ka-mendjen-te-largohet/>

⁴³ <https://tiranatoday.al/shaban-murati-si-po-ushton-ndikimin-e-saj-ne-shqiperi-forca-e-lobit-rus/>

- Vartësia politike, klienteliste dhe pa kontroll e medias në Shqipëri⁴⁴, krijon premisa për përdorim të platformave të saj për operacione ndikimi dhe dezinformimi nga shtete dhe individë, me qëllime keqdashëse ndaj vendit tonë.

BURIME TË SHFRYTËZUARA

1. Murati, Shaban, *Rusët po vijnë*, viti 2022.
2. NBC News. Retrieved April 22, 2020.
3. Corn, David, *Columbia Journalism Review's Big Fail: It Published 24,000 Words on Russiagate and Missed the Point*. Mother Jones, 2 February 2023.
4. Conason, Joe, *The Reporter Who Hyped Whitewater Now Backs Trump On 'Russiagate'*. The National Memo. 4 February 2023.
5. Chait, Jonathan, *Columbia Journalism Review Had a Different Russiagate Story - and Spiked It*, New York. 9 February 2023.
6. Maddow, Rachel. *Friday's Mini-Report, 2.3.23*. MSNBC. 3 February 2023.
7. Young, Cathy. *Why 'Russiagate' Skeptics Are Cackling—But Shouldn't Be*. The Bulwark. 9 February 2023
8. Kennedy, Dan, *The CJR's critique of 'Russia Russia Russia' coverage is all trees, no forest*. 9 February 2023.
9. Campbell, Duncan, *Who Watches the Watchdog? The CJR's Russia Problem*. Byline Times. Retrieved February 10, 2023. 7 February 2023.

⁴⁴ <https://telegrafi.com/5-familje-dhe-27-individe-zoterojne-mediat-kryesore-televizive-ne-shqiperi/>

INFRASTRUKTURA KRITIKE DHE INFRASTRUKTURA KRITIKE E INFORMACIONIT. IDENTIFIKIMI I KËRCËNIMEVE, PASOJAVE DHE NEVOJA PËR MBROJTJEN E TYRE

Nënkolonel Msc. Dashnor BETA
Oficer shtabi në IKSHU

Trajtesë e shkurtuar.

Infrastruktura kritike është një aset/sistem thelbësor për ruajtjen e funksioneve jetësore shoqërore. Dëmtimi i një infrastrukture kritike (IK), shkatërrimi/prishja e saj nga fatkeqësitë natyrore, terrorizmi, veprimtaria kriminale ose sjellja keqdashëse mund të ketë një ndikim të rëndësishëm negativ për sigurinë, ekonominë apo mirëqenien e qytetarëve. Ndërprerja përkohësisht ose mbyllja e plotë e shërbimeve të ofruara nga IK, si p.sh., ato që lidhen me shpërndarjen e ujit, rrjetin elektrik, sektorin e energjisë apo fusha të tjera, mund të kenë efekte katastrofike në nivel lokal, kombëtar madje edhe ndërkombëtar. Sot, kërcënimet kibernetike po rriten në numër, lloj dhe sofistikim. Raporte të ndryshme e theksojnë këtë pikë jetike, duke sjellë në fokus rreziqet e shumta kibernetike që mund të lindin nga përdoruesit e sistemeve të bazuara në teknologji. Në dritën e teknikave të shumta dhe vektorëve kërcënues në dispozicion të hakerëve që synojnë kryerjen e një sulmi, subjektet përgjegjëse mbrojtëse të IK dhe zinxhirët e tyre të furnizimit duhet të kenë protokollet e duhura të sigurisë për t'u mbrojtur nga sulmet kibernetike dhe infiltrimi dhe të kenë aftësitë e nevojshme e të tregojnë elasticitet në rast të një sulmi real. Mbrojtja e IK është sistemi proaktiv i aktiviteteve të përdorura me qëllim që të mbrojnë njerëzit, asetet fizike dhe sistemet kibernetike nga të cilat ne

varemi. Mbrojtja e aseteve më kritike të vendit është detyrë e vështirë dhe kërkon bashkëpunim në vijimësi mes agjencive kryesore dhe strukturave të të gjitha niveleve dhe zbatim të teknologjive e proceseve të përmirësuara të mbrojtjes së IK.

Fjalët kyçe: Infrastrukturë kritike (IK), Infrastrukturë Kritike e Informacionit (IKI), mbrojtje e IKI (MIKI), shërbime kritike, operatorët IK/IKI.

HYRJE

Në botën e sotme shumë të ndërthurur e të ndërruar, disa sektorë të Infrastrukturës Kritike (IK), siç janë ata të kujdesit shëndetësor, telekomunikacionit, financat, transporti, ushtria, energjia (një nga më kryesoret), mbështeten gjithnjë e më shumë në Teknologjinë e Informacionit (TI) dhe Teknologjinë Operacionale (TO). Këto Infrastruktura Kritike të Informacionit (IKI) jo vetëm që janë më vete, por ato mbështesin gjithashtu shumë shërbime të tjera kritike, p.sh., furnizimin me ujë, rrjetet e energjisë, furnizimin me tubacione karburanti etj. (shih figurën nr. 1).




Figura nr. 1

Mosfunjionimi apo ndërprerja e këtyre shërbimeve kritike mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme ekonomike dhe sociale dhe madje edhe humbje jetësh njerëzore. Për këtë arsye, palët kryesore të interesit nga ekosistemi IK/IKI duhet të adoptojnë një qëndrim të fortë në lidhje me sigurinë kibernetike, për të garantuar mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë kibernetike të sektorëve dhe shërbimeve të IK/IKI. Për të arritur këtë, operatorët e IKI duhet të ndajnë burime të mjaftueshme për të miratuar dhe zbatuar mjete kibernetike dhe standarde të njohura ndërkombëtarisht të sigurisë dhe gjithashtu të jenë në përputhje me politikat e brendshme të Mbrojtjes së Infrastrukturës Kritike të Informacionit (MIKI), kornizat ligjore për mbrojtjen e informacionit dhe Infrastrukturën e Teknologjisë së Komunikimit (TIK), si dhe me të dhënat nga rritja e rreziqeve kibernetike dhe drejtimit të sulmit. Nga ana tjetër, qeveritë,

nëpërmjet autoriteteve koordinuese, duhet gjithashtu të ndajnë burime të mjaftueshme për të zbatuar dhe monitoruar politika dhe korniza rregullatore për MIKI me mandate të qarta ligjore, role dhe përgjegjësi të përcaktuara, kërkesa të sigurisë dhe detyrime ligjore për të siguruar që sektorët dhe shërbimet e IKI janë të mbrojtura në mënyrë adekuate.

Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike (MIK) dhe Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike të Informacionit (MIKI) është një temë komplekse, por që gjithsesi konsiderohet e një rëndësie të veçantë për shtetet/vendet/kombet. Shoqëritë në përgjithësi varen në mënyrë kritike nga funksionimi i duhur i IK të tyre të tilla si: furnizimi me energji, telekomunikacioni, sistemet financiare, uji i pijshëm, shërbimet shtetërore etj. Aktualisht, prishja fizike apo shkatërrimi i elementeve kritike të IK nuk është i vetmi faktor që kërcënon funksionimin normal të IK. Nga ana tjetër, këto IK shpeshherë varen nga funksionimi në mënyrën e duhur të IKI, mbi bazën e të cilit ato funksionojnë, dhe që përfshijnë si IKI dhe mjetet e komunikimit (p.sh., shërbimet e telefonisë celulare, të internetit) ashtu dhe sistemet kritike të informacionit dhe të kontrollit të komunikimit që janë pjesë e secilës prej IK-ve dhe pjesë kritike e ofrimit të shërbimit të IK. Këto sisteme përfshijnë sisteme kontrolli që monitorojnë dhe kontrollojnë proceset kritike kibernetike si dhe sisteme administrative dhe logjistike.

Nevoja për MIKI në ditët e sotme po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme dhe e theksuar. Rreziku për shoqërinë vjen për shkak të masave të pamjaftueshme të mbrojtjes së këtyre infrastrukturave të cilat rriten nga dita në ditë. Ndërsa infrastrukturat e informacionit dhe komunikimit ndërthuren globalisht, IKI e një vendi/shteti/kombi mund të jetë një objektiv për sulme malware, hakerë, apo operacione të cilat i kundërvihen shtetit. Në të njëjtën kohë IKI e një vendi mund të bëhet një mjet për të sulmuar IKI të një vendi tjetër. Nëse IKI kërcënohet atëherë IK e një vendi nuk mund të funksionojë në mënyrën e duhur dhe pa probleme dhe kjo mund të ketë pasojat e veta në shoqëri, ekonomi e jetën e përditshme dhe mund ta vejë atë në rrezik. Për më tepër, ndërlidhja globale e IKI do të thotë se nëse një infrastrukturë e tillë mund të cenohet në një vend, kjo do të çojë në rrezikun e cenimit të IKI në vende të tjera të botës. Disa vende janë duke marrë masa për mbrojtjen e IK, por hasin vështirësi në përpjekjet e tyre për mbrojtjen e IK dhe IKI. Vende të tjera janë në fillimet e marrjes së masave të ndërthura për mbrojtjen e tyre, në mënyrë që të ngrenë barrierë mbrojtëse, referuar praktikave më të mira aktuale. Ndërprerja e IKI mund të shkaktohet nga dështimet teknike ose nga fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu, ashtu siç mund të ndodhë dhe me IK. Megjithatë, përfitimet e IKI (monitorimi në distancë, besueshmëria, reduktimi i kostos) nuk janë gjithmonë të baraspeshuara me efektet e negative të mosfunksionimit të IKI. Infrastruktura Kritike e Informacionit është gjithnjë

e më shumë pjesë kritike e IK, është “ngjitës” ndërmjet dhe brenda IK dhe po ndërlidhet globalisht.

Për më tepër, këto praktika të mira mund të jenë të dobishme në nivele kombëtare si dhe për operatorët e IK që operojnë ndërkombëtarisht. Praktikrat më të mira nuk janë të “gdhendur në gur” por ato ndihmojnë vendet që kanë struktura të ndryshme ligjore dhe rregullatore, model të ndryshëm të qeverisjes dhe qasje të ndryshme mbi IK dhe IKI, nivel të ndryshëm të përshtatjes me TIK, dhe kulturë të ndryshme në mënyrë që të përshtatin qasjet e mbrojtjes së tyre me nevojat kombëtare.

1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM PËR IK DHE KONCEPTIN E MBROJTJES SË IKI

Në fillim të viteve 2000 koncepti i MIK u bë një shqetësim i madh për shumë vende, sidomos pas sulmeve terroriste në SHBA (2001), në Spanjë (2004) dhe UK (2005). Këto sulme patën një ndikim të madh jo vetëm në mënyrën se si ofroreshin shërbimet kritike (p.sh., transporti ajror apo nëntokësor), por edhe në perceptimin e sigurisë kombëtare. Pas këtyre sulmeve, autoritetet e SHBA dhe BE u detyruan të rishikojnë dhe ripërcaktojnë konceptin e IK dhe të vendosin masa të forta sigurie e ligjore si; miratimi i Aktit Patriot (2001) dhe i Direktivës 2008/114/EC, për të siguruar mbrojtjen e sektorëve dhe shërbimeve të IK. MIKI u krijua për herë të parë në vitet 2000 kur ekspertët vendosën të gjenin zgjidhje për mbrojtjen e ndërlidhjeve të Teknologjisë së Informacionit (TI) dhe Teknologjisë Operacionale (TO) midis sektorëve dhe shërbimeve të ndryshme të IK. Kjo konvergjencë/ndërlidhje midis sistemeve TI dhe TO (aktualisht me komponentët e internetit në fushën industriale) kanë krijuar një grup të ri kërcënimesh, rreziqesh dhe dobësish kibernetike, që përfaqësojnë një çështje thelbësore të sigurisë në mbarë botën. Kjo situatë kërkon që operatorët e IKI dhe palët e interesuara të IK/IKI duke përfshirë rregullatorët e TIK, të hartojnë dhe miratojnë disa përpjekje të koordinuara dhe të përmirësojnë qëndrimin e tyre të sigurisë kibernetike për të mbrojtur sektorët dhe shërbimet e IK/IKI.

Çfarë është Infrastruktura Kritike (IK)?

Nuk ka një përkufizim të gjithëpranuar në botë për Infrastrukturën Kritike. Çdo vend i përcakton ato bazuar në nevojat dhe prioritetet e veta aktuale, kështu që ka qasje të ndryshme për përcaktimin e kësaj fushe. Nëse krahasohen grupet e sektorëve të IK të vendeve të ndryshme, mund të gjendet një grup bazë i ngjashëm i kësaj infrastrukture, por gjithashtu mund të gjenden dhe dallime të mëdha. Një shërbim i veçantë i IK mund të jetë jetik për një vend (p.sh., Kanali i Panamasë), por jo për një vend tjetër.

Përgjithësisht IK përkufizohen ata sektorë, përfshi nënsektorët, shërbimet dhe

asetet (shih tabelën e mëposhtme), të cilët janë jetik për funksionimin dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë (p.sh., telekomunikacioni, energjia, shëndetësia, shërbimet financiare) dhe që cenimi pjesërisht ose shkatërrimi total i tyre do të rezultonte me ndikim negativ të konsiderueshëm jo vetëm për sigurinë kombëtare, por edhe për ekonominë kombëtare e mirëqenien sociale të njerëzve. Qeveria e UK e përkufizon IK si “element/et kritike të infrastrukturës (d.m.th., asetet, objektet, sistemet, rrjetet ose proceset dhe punonjësit thelbësorë që i operojnë dhe lehtësojnë ato)”, humbja/komprometimi i të cilave do të rezultonte në:

- a) dëme të mëdha (ndikim) në disponueshmërinë, integritetin ose ofrimin e shërbimeve thelbësore - duke përfshirë ato shërbime të cilave, nëse u cenohet integriteti, mund të rezultojnë në humbje të konsiderueshme të jetës ose viktime - duke marrë parasysh ndikimet e rëndësishme ekonomike ose sociale; dhe/ose
- b) ndikim të rëndësishëm në mbrojtjen kombëtare ajrore, apo funksionimin e shtetit”.¹

Në vitin 2019, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) në një raport të publikuar për IK, zbuloi se rreth 90 % e anëtarëve të saj kishin identifikuar sektorët e tyre kombëtarë të kësaj infrastrukture dhe se përkufizimet e tyre ndryshonin nga një vend në tjetrin. Disa vende e theksojnë rëndësinë e mbrojtjes së objekteve/sectorëve të IK duke e parë nga perspektiva e mirëqenies ekonomike e sociale, ndërsa vende të tjera e theksojnë rëndësinë e tyre parë nga pikëpamja e sigurisë kombëtare. Një grup i tretë vendesh si UK, i kombinon këto dy qasje në përkufizimin e tyre të IK.

Disa përkufizime kombëtare të Infrastrukturës Kritike

Austri - IK janë ato infrastruktura ose pjesë të tyre të cilat kanë rëndësi vendimtare për sigurimin e funksioneve të rëndësishme shoqërore. dështimi ose shkatërrimi i tyre ka efekte të rënda në shëndetin, sigurinë ose mirëqenien ekonomike dhe sociale të popullsisë ose funksionimin e institucioneve qeveritare (Strategjia e Sigurisë Kibernetike e Austrisë, 2013).

Kanada - IK janë procese, sisteme, objekte, teknologji, rrjete, asete dhe shërbime thelbësore për shëndetin, ruajtjen, sigurinë ose mirëqenien ekonomike të kanadezëve dhe funksionimin efektiv të qeverisë (Një Menaxhim Emergjent për Kanadanë, 2011).

Francë - Infrastruktura jetësore është çdo institucion, objekt/strukturë për të cilën dëmtimi, mosdisponueshmëria ose shkatërrimi nga një veprimi keqdashës

¹ Burimi: Centre for the Protection of National Infrastructure, Critical National Infrastructure.

ose si rezultat direkt ose tërthorazi i një veprimi sabotues ose terrorist, nëse aktiviteti i tij është vështirë i zëvendësueshëm, mund të të cenojë rëndë potencialin e luftës ose potencialin ekonomik, sigurinë kombëtare ose mbijetesën e kombit, ose të ndikojë seriozisht në shëndetin apo jetën e popullsisë (Udhëzimi i Përgjithshëm Ndërministror për Sigurinë e Veprimtarive Jetësore, Sekretariati i Përgjithshëm i Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare).

Gjermani - IK janë struktura fizike, organizative dhe objekte të një rëndësie kaq jetike për shoqërinë dhe ekonominë e një kombi, sa që dështimi ose degradimi i tyre do të sillte mungesa të qëndrueshme të furnizimit, ndërprerje të konsiderueshme të mbrojtjes dhe sigurisë publike, ose pasoja të tjera dramatike (Strategjia Kombëtare për MIK, 2009).

Itali - IK është sistem, burim, proces, strukturë, qoftë edhe virtuale, shkatërrimi, ndërprerja apo dhe mosdisponueshmëria e pjesshme apo e përkohshme e të cilit ndikon në dobësimin e ndjeshëm të efikasitetit e funksionimit normal të një vendi dhe të sigurisë dhe të sistemeve ekonomike, financiare e sociale, përfshi organet e administratës publike qendrore e vendore (Agjencia e Mbrojtjes Civile, fjalorth).

Kenia - IK përshkruajnë asete që janë thelbësore për funksionimin e një shoqërie dhe ekonomie (p.sh., rrjeti elektrik, telekomunikacioni, furnizimi me ujë) (SKSK e Kenias).

Norvegji - IK janë sistemet thelbësore për të ruajtur tiparet kritike të shoqërisë që mbulojnë nevojat themelore të shoqërisë dhe ndjenjën e sigurisë së popullatës (SKS e Norvegjisë).

Pakistan - IK përfshin infrastrukturën, asetet, sistemet, rrjetet e tjera, fizike apo virtuale, përfshi drejtësinë, aq jetike për shtetin/organet e tij, sa që paaftësia/shkatërrimi i të cilave mund të ketë një efekt dobësues në sigurinë kombëtare, ekonominë, shëndetin publik, sigurinë ose çështje që lidhen me to (Ligji për krimin kibernetik 2015).

Katar - Asetet fizike, sistemet/instalimet, të cilat nëse ndërpriten, komprometohen ose shkatërrohen, mund të kenë një ndikim serioz në shëndetin, sigurinë ose mirëqenien ekonomike të Katarit ose në funksionimin efektiv të qeverisë së këtij vendi. (Strategjia e Sigurisë Kibernetike e Katarit).

Sektorët e IK

Sektorët e IK	N/Sekt. e IK	Shërbimet kritike	Burimet / Asetet
Energjia (Nafta, Gazi, Qymyri, Elektriciteti, Të rinovueshme)	Nafta	- Nxjerrja - Transporti - Shpërndarja - Rafinimi/ Përpunimi - Magazinimi	- Njësitë e shpimeve në det të hapur (anije shpuese, krikët e ngritjes etj.) - Platformat e shpimit në tokë - Puset e naftës në breg - Puset e naftës në det të hapur/ platformat - Tubacionet e naftës në det/ tokë - Stacionet e pompimit të naftës - Anije cisternë, kamionë, mjete hekurudhore - Portet - Objektet e depozitimit të naftës - Terminalet detare - Rafineritë e naftës - Sistemet e ftohje - Ruajtja e produkteve të rafinuara - Rezervuarët e magazinimi - Ndërtesat - Punonjësit

Tabela nr 1. Sektori i energjisë, nënsektorët, shërbimet kritike dhe asetet ²

Natyra e sektorëve të Infrastrukturës Kritike Kombëtare ndryshon në vende të ndryshme, sepse procesi i identifikimit të kësaj infrastrukture bazohet në rreziqet kombëtare dhe në prioritizimin e vlerësimeve. Disa vende kanë një numër të madh sektorësh të IK. P.sh., SHBA-të kanë 16 sektorë (shih fig. nr. 2), Malawi ka 15, UK ka 13, Australia ka 8 sektorë. Ka vende të tjera të cilat kanë identifikuar më pak sektorë të IK, p.sh., Brazili ka 5 të tillë. Gjithsesi e përbashkëta për të gjitha këto vende është se telekomunikacioni dhe energjia janë pjesë e sektorëve të IKK.

² Burimi: https://www.researchgate.net/figure/Oil-critical-infrastructure-sectors-and-subsectors_tbl1_337549204.




Figura nr. 2. 16 Sektorë të Infrastrukturës Kritike në SHBA³

Sipas një raporti të OECD (2019) energjia, TIK, transporti, shëndetësia, uji dhe financat ishin sektorët më të përcaktuar si IK në këtë organizatë, krahasuar me sektorët bërthamorë dhe të mbrojtjes që janë më pak të përcaktuara. Çdo vend ka nevojat dhe prioritetet e veta të cilat përcaktojnë identifikimin kombëtar të sektorit të IK (tabela nr. 2). P.sh., në SHBA, numri i sektorëve të IK ka ndryshuar me kalimin e kohës. Në 1996, SHBA kishte vetëm tetë sektorë të kësaj infrastrukture (Urdhri Ekzekutiv-13010), por në 1998, Direktiva e Vendimit Presidential 63 identifikoi 15 sektorë. Në 2001, me Urdhrin Ekzekutiv-13228 numri i sektorëve u zvogëlua në 9, ndërsa aktualisht janë 16 sektorë të tillë.

Vendi	Numri	Lista e sektorëve të IK
SHBA	16	Sektori Kimik, Objektet Tregtare/komerciale, Prodhimet kritike, Digat, Shërbimet e Emergjencave, <u>TIK</u> , Reaktorët Bërthamorë, Materialet dhe Mbetjet, Ushqimi dhe Bujqësia, Bazave Industriale e të Mbrojtjes, <u>Energjia</u> , Kujdesi Shëndetësor dhe Shëndeti Publik, Sektori i Shërbimeve Financiare, Sistemet e <u>Ujit</u> dhe Ujërave të Zeza, Objektet Qeveritare, Sistemet e Transportit.
Kanada	10	Shëndeti, ushqimi, financat, <u>uji</u> , <u>TIK</u> , siguria, <u>energja</u> dhe shërbimet komunale, prodhimi, qeveria dhe transporti.

³ Burimi: <https://etn-peter.eu/2021/04/06/basics-of-any-critical-infrastructure/>.

Japoni	13	Shërbimet e informacionit & <u>komunikimit</u> , financiare, aviacionit, hekurudhore, furnizimit me <u>energji elektrike</u> , furnizimit me gaz, qeveritare dhe administrative, mjekësore, uji , logjistike, kimike, e kartave të kreditit dhe industritë e naftës.
Malawi	15	Uji , transporti, turizmi, kërkimi dhe zhvillimi, miniera, prodhimi dhe industria, <u>TIK</u> , shëndetësia, qeveria, ushqimi dhe bujqësia, financa, mjedisi, <u>energjia</u> , arsimi, mbrojtja dhe siguria.
Singapor	11	Qeveria, siguria & urgjenca, shëndetësia, media, bankat dhe financat, <u>energjia</u> , uji , <u>komunikimet informative</u> , transporti detar, tokësor, dhe ajror.
Emiratet e Bashkuara Arabe	9	Energjia, <u>TIK</u> , qeveria, <u>energji elektrike</u> & uji , financat & sigurimet, shërbimet e urgjencës, të shëndetësisë, transporti dhe ushqimi, bujqësia.

Tabela nr. 2. Lista e sektorëve të IK në SHBA, Kanada, Japoni, Malawi (shtet në Afrikën JL), Singapor dhe Emiratet e Bashkuara Arabe ⁴

Çfarë është Infrastruktura Kritike e Informacionit (IKI)?

Për IKI ashtu si për IK nuk ka një përkufizim të pranuar universalisht. IK dhe IKI shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë, por absolutisht ato nuk janë të njëjta. Ka dallime thelbësore që duhen sqaruar në mënyrë që politikëbërësit, rregullatorët dhe palët e tjera të interesuara të kuptojnë më mirë konceptet dhe aktivitetet rregullatore të lidhura me to. Akti i Teknologjisë së Informacionit (v. 2000) përcakton IKI-në si një burim kompjuterik, paaftësia/shkatërrimi i të cilit do të ketë ndikim në dobësimin e sigurisë kombëtare, të ekonomisë, të shëndetit publik ose sigurisë. IKI janë sisteme socio-teknike që përfshijnë komponentë thelbësorë të softuerit dhe sisteme informacioni me ndikim kryesor tek individët, organizatat, qeveritë, ekonomitë dhe shoqëria. Përkufizimi fillestar për IKI u formulua në vitin 2001 nga ekspertët kërkues/profesorë zviceranë). Ata e përcaktuan IKI si “komponentë” - (si telekomunikacion, kompjuter/softuerë, internet, satelitë, fibra optike etj., si dhe të gjithë kompjuterët dhe rrjetet e ndërlidhura dhe informacioni kritik/sensitiv që “rrjedh” në to).

Në vitin 2003, G8 shpалosi versionin e saj, i cili jepte mendime e sugjerime për praktikatat më të mira për të përkufizuar sa më qartë konceptin për mbrojtjen e IKI. Kjo u konkretizua në vitin 2005 në “Dokumentin e Gjelbër” për një program evropian të mbrojtjes së IK.

⁴ Burimi: <https://etn-peter.eu/2021/04/06/basics-of-any-critical-infrastructure/>

Komisioni Evropian e përkufizoi IKI si “sistemet TIK, që janë IK ose që janë thelbësore për funksionimin e IK (telekomunikacion, softuerë, satelit, internet). Pas kësaj, shtetet filluan të formulojnë konceptin e tyre për IKI.

Disa koncepte/përkufizime të Infrastrukturës Kritike të Informacionit.

Bashkimi Afrikan (BA) - “IK kibernetike/TIK është infrastruktura kibernetike e cila vlerësohet thelbësore për shërbimet e sigurisë publike, stabilitetit ekonomik, sigurisë kombëtare, stabilitetit ndërkombëtar dhe qëndrueshmërisë dhe restaurimit të hapësirës kibernetike kritike”.⁵

“Komponenti TIK i infrastrukturës kritike konsiderohet infrastrukturë kritike informacioni”.⁶

Brazili - “IKI janë nëngrupet e aseteve të informacionit që ndikojnë drejtpërsëdrejti në arritjen dhe vijimësinë e misionit të shtetit dhe sigurinë e shoqërisë”.⁷

UK - “IKI u referohet të gjitha sistemeve të TIK që mbështesin asetet dhe shërbimet kryesore brenda infrastrukturës kombëtare”.⁸

Republika e Shqipërisë - “IKI është tërësia e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, cenimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishte impakt serioz në shëndetin, sigurinë dhe/ose mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe/ose funksionimin efektiv të ekonomisë në RSH”.⁹

Komisioni Evropian (KE) e përcakton IKI si TIK, sisteme që janë IK për veten e tyre ose thelbësore për operacionet e IK (telekomunikacionet, kompjuterë/softuerë, internet, satelitë etj.).¹⁰

Forumi Global për Ekspertizën Kibernetike e përkufizon IKI si informacion i ndërthurur dhe infrastrukturë komunikimi, të cilat janë thelbësore për mbajtjen e funksioneve jetësore të shoqërisë (shëndeti, siguria, ekonomia dhe mirëqenia sociale e popullsisë) - prishja/ndërprerja ose shkatërrimi i të cilave

⁵ Burimi: African Union, African Union Convention on Cyber Security and Personal Data Protection, LC12490.

⁶ Burimi: Victorian Government CIO Council Critical Information Infrastructure Risk Management, Australia 2012

⁷ Burimi: Guia de referência para a segurança das infraestruturas críticas da informação Versão 01 (Nov. 2010).

⁸ Burimi: Cyber Security in the UK Postnote Number 389 September 2017.

⁹ Burimi: Metodologji për identifikimin dhe klasifikimin e infrastrukturave kritike dhe infrastruktura të rëndësishme të informacionit.

¹⁰ Burimi: Commission of the European Communities. 2005. Green Paper on a European Programme for Critical Infrastructure Protection. <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2005:0576:FIN:EN:PDF>;

mund të ketë pasoja serioze.¹¹

Bashkimi Afrikan përcakton IKI si IK kibernetike/TIK, e cila është thelbësore për shërbimet jetike për sigurinë publike, stabilitetin e ekonomisë, sigurinë normale, stabilitetin ndërkombëtar dhe për qëndrueshmërinë dhe restaurimin e hapësirës kritike kibernetike.¹²

*Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), në 2019 vendosi një qasje të re për IKI, duke i përcaktuar «aktivitetet kritike» si «aktivitete ekonomike dhe sociale ndërprerja/shkatërrimi i të cilave do të mund të kishte pasoja serioze për shëndetin, ruajtjen dhe sigurinë e qytetarëve ose në funksionim efektiv të shërbimeve thelbësore të ekonomisë, të shoqërisë e të qeverisë, ose prosperitetit ekonomik dhe social më gjerësisht».*¹³

Përgjithësisht IKI-të janë ato infrastruktura të ndërlidhura të informacionit e të komunikimit të cilat janë thelbësore për mirëmbajtjen e funksioneve jetësore të shoqërisë - si shëndeti, ruajtja, siguria, mirëqenia ekonomike/ sociale e njerëzve - dëmtimi, ndërprerja apo shkatërrimi i të cilave do të kishte pasoja të rënda. Shembuj të kësaj infrastrukture janë sistemet e kontrollit të procesit që monitoron dhe kontrollon prodhimin e energjisë elektrike, një sistem satelitor i navigimit global (p.sh., BeiDou, Galileo, GLONASS, GPS), shërbimet e informacionit ndërmjet bankave dhe aksesit në infrastrukturë për të arritur dhe përdorur shërbimet globale të internetit.

*Mbrojtja e IKI është një derivat i përkufizimit të IKI dhe përfshin “të gjithë aktivitetet që synojnë të sigurojnë mirëfunksionimin, vijimësinë dhe pacenueshmërinë e IKI, për pengimin apo parandalimin, zbutjen dhe neutralizimin e kërcënimit, rrezikut apo cenueshmërisë ose minimizimin e ndikimit të ndonjë incidenti”.*¹⁴

2. IDENTIFIKIMI I INFRASTRUKTURËS KRITIKE TË INFORMACIONIT

Sot operojnë shumë operatorë publikë e privatë, të cilët ofrojnë mallra dhe shërbime, lloji i të cilave dhe mënyra se si klientët i përdorin ato përcaktojnë nëse një shërbim infrastrukturë është kritik ose jo. Disa shembuj të sektorëve

¹¹ Burimi: TNO. 2017. The GFCE-Meridian Good Practice Guide on Critical Information Infrastructure Protection for governmental policy-makers. <https://www.meridianprocess.org/siteassets/meridian/gfce-meridian-gpg-to-ciip.pdf>

¹² Burimi: African Union. Convention on Cyber Security and Personal Data Protection. https://au.int/sites/default/files/treaties/29560-treaty-0048_-_african_union_convention_on_cyber_security_and_personal_data_protection_e.pdf;

¹³ Burimi: OECD. 2019.

¹⁴ Burimi: OECD ICCP Committee and Working Party on Information Security and Privacy, OECD Recommendation on the Protection on Critical Information Infrastructures.

IK¹⁵: - shërbimi bankar dhe financat, - qeverisja qendrore/shërbimet qeveritare, - telekomunikacioni sektori TIK, - shërbimet e emergjencës dhe të shpëtimit, - furnizimi me energji elektrike, - transporti/logjistika/furnizimi, - shërbimi shëndetësor, - furnizimi me ujë, - ushqimi, - mbrojtja e mjedisit.

Identifikimi i IKI zakonisht është më kompleks sesa identifikimi i IK. Referuar OECD, IKI zakonisht përfshijnë një ose më shumë nga: - komponentët e informacionit që mbështesin IK; - dhe/ose, infrastrukturat e informacionit që mbështesin komponentët thelbësor të shërbimit qeveritar; - dhe/ose, infrastrukturat e informacionit thelbësor për ekonominë kombëtare¹⁶.

Siç shihet në figurën nr. 3, IKI në përgjithësi përfshin si IKI dhe të komunikimit në aspektin ndërsektorial (p.sh. shërbimet e telekomunikacionit celular), ashtu dhe IK dhe IKI brenda secilës prej sektorëve të veçantë, sepse disa sektorë të IK, si energjia, furnizimi me ujë të pijshëm dhe financa, përdorin të njëjtat teknologji për të operuar dhe për këtë arsye, ato gjithashtu janë të ekspozuar ndaj rreziqeve dhe dobësive kibernetike në shumicën e proceseve kritike. Mbështetja në sistemet e TIK ka sjellë më shumë kompleksitet, ndërvarësi dhe dobësi, duke rritur kështu rrezikun dhe mundësitë e sulmit. (në figurë shihen gjithashtu dhe dallimet midis IK dhe IKI)




Figura nr. 3. Ndërvarësia midis IKI në përgjithësi dhe IKI të komunikimit ndërsektorial dhe IK dhe IKI brenda çdo sektori të veçantë, si dhe dallimet mes IK dhe IKI.

Sipas ENISA¹⁷, kriteret dhe faktorët për identifikimin dhe klasifikimin e infrastrukturave të informacionit mund të listohen si vijon: ¹⁸

¹⁵ Burimi: CIPedia©: a common international reference point for CIP and CIIP concepts and definitions.

¹⁶ Burimi: OECD ICCP Committee and Working Party on Information Security and Privacy, OECD Recommendation on the Protection on Critical Information Infrastructures.

¹⁷ ENISA - The European Union Agency for Cybersecurity

¹⁸ Burimi: The GFCE-Meridian Good Practice Guide on Critical Information Infrastructure Protection-for Governmental Policy-Makers.

Kritere	Faktorë
Ndikim ekonomik	Efekti financiar
Ndikim politik/qeveritar	Efekti në kohë
Ndikim industrial/mjedisor	Shpërndarje gjeografike
Ndikim shëndetësor	

Faktorët që duhen aplikuar në identifikimin e IK dhe infrastrukturës së rëndësishme janë:

- Efekti financiar, që ka të bëjë me ndikimin financiar, kur infrastruktura është jashtë funksionimit.
- Efekti kohë, që përcaktohet në orë, ditë, muaj dhe vite, i cili tregon ndikimin humbës që një shërbim do të ketë nëse është jashtë funksionimit.
- Shpërndarja gjeografike, që përcakton numrin e individëve që mund të ndikohen nëse infrastruktura është jashtë funksionit.

Në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) ka për mision arritjen e një niveli të lartë të sigurisë kibernetike, përcaktimin e masave të sigurisë, të të drejtave, detyrimeve, bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet subjekteve që operojnë në fushën e sigurisë kibernetike, garantimin e sigurisë për shërbimet e besuara, në veçanti besueshmërisë dhe sigurisë në transaksionet elektronike ndërmjet qytetarëve, biznesit e autoriteteve publike, duke rritur efektivitetin e shërbimeve publike e private dhe tregtisë elektronike, si dhe përcaktimin e standardeve minimale teknike për sigurinë e të dhënave dhe rrjeteve/sistemeve të informacionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare në këtë fushë, me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt elektronik.¹⁹

Ky autoritet në dokumentin “Metodologji për identifikimin dhe klasifikimin e IK dhe infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, mbështetur në praktikat evropiane ka përcaktuar se mosfunksionimi i sistemit/rrjetit ka ndikim kritik në sektorin ku operon institucioni nëse:

- ndikimi financiar është më shumë se 3.3 milionë lekë, dhe/ose
- më shumë se 39000 individë ndikohen nga mosfunksionimi i infrastrukturës, dhe/ose
- shkëputja ndodh në intervale më të gjata se 24 orë.

Sipas ligjit nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, Këshilli i Ministrave (KM)

¹⁹ Burimi: <https://cesk.gov.al/rreth-nesh/index.html>

miraton listën e IKI, e cila rishikohet të paktën një herë në dy vjet. Vendimi i fundit i KM (nr. 553, datë 15.7.2020 “Për miratimin e listës së IKI dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”), është përafuar pjesërisht me direktivën (BE) 2016/1148, të PE dhe Këshillit, datë 06.07.2016 “Masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në BE”, numri CELEX 32016L1148, fletorja zyrtare e BE, seria L, nr. 194, datë 19 korrik 2016, faqe 1-30.

Në VKM e sipërcituar, në listën e IKI dhe listën e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit, përcaktohen: sektorët, nënsektorët, operatori administrues, sistemi kritik, dhe rrjeti kritik. Në sektorët përfshihen: sektori energjetik, shëndetësor, financiar, transporti, qeveritar dhe infrastruktura digjitale.

3. IDENTIFIKIMI I KËRCËNIMEVE NDAJ INFRASTRUKTURËS KRITIKE TË INFORMACIONIT

Për shkak të rëndësisë që kanë IKI, sistemet gjenden në çdo kohë nën kërcënimin e sulmeve ndaj tyre dhe të pasojave të mundshme që sjell një IKI e dobët apo e sulmuar. Kërcënimet mund të përfshijnë:

- hyrje e paautorizuar në informacione sensitive apo të klasifikuara;
- shkatërrim, modifikim apo zëvendësim i softuerit që përdoret në infrastrukturën/at kritike;
- hyrje e kufizuar e agjentëve që parandalojnë apo zbusin efektet e këtyre sulmeve.

Disa pasoja të mundshme të sulmeve ndaj IKI mund të jenë:

- bllokim i transportit, bllokim i furnizimit me energji elektrike ose me ujë,
- bllokim i komunikimit, i transmetimit të të dhënave, i centraleve bërthamore, kaos ose bllokim i kontrollit të trafikut ajror,
- falimentim i sistemeve financiare dhe i strukturave tregtare,
- dështim i transaksioneve ndërkombëtare të biznesit, destabilizim i tregjeve dhe institucioneve të financave,
- viktima në njerëz ose humbje në materiale si rezultat i dëmtimit serioz/shkatërrimit të infrastrukturës kritike (që mund të shkaktohen nga sabotimi kibernetik në industrinë ushqimore, në rrjetin hekurudhor apo në trafikun ajror),
- hyrje në të dhënat personale dhe përdorimi, tjetërsimi apo modifikimi i paautorizuar i tyre,
- vjedhje të parave dhe e informacionit,

- mundësi për nxitje të akteve terroriste të një vendi ndaj një tjetri për të përkeqësuar apo shkatërruar marrëdhëniet mes tyre si dhe marrëdhëniet ndërkombëtare,
- humbje e pronësisë intelektuale apo humbje e reputacionit.

**Përmbledhje e sulmeve kibernetike
ndaj organizatave/institucioneve në Shqipëri²⁰**

Caku	Data	Sulmuesi
Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP)	1 dhjetor 2019	Anonymous Albania
7 incidente: - AKSHI. - Tirana Bank, - Iute Credit, - DPSHTR, - OSHEE, - Autoriteti Portual Durrës, - Alpha Bank.	2021	Të ndryshëm
Radiotelevizionit Shqiptar (RTSH)	Shtator 2021	
Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA)	21 shtator 2021	
Platforma shtetërore e-Albania	Platforma shtetërore e-Albania	
Sistemi i kontrollit kufitar TIMS	10 shtator 2022	

Theksojmë se rimëkëmbja pas një sulmi ndaj një IKI, në disa raste mund të jetë e lehtë dhe e shpejtë, por efektet që vijnë pas sulmit mund të lënë pasoja për një kohë të gjatë, pasi ato mund të dëmtojnë besimin e publikut apo të biznesit, tregtinë elektronike si dhe iniciativat qeveritare. Në rast të një sulmi të tillë shpenzimet si njerëzore ashtu dhe ato ekonomike për zbutjen e sulmit apo rimëkëmbjen pas tij janë të mëdha. Kështu p.sh., sulmet kibernetike në Estoni (2007) apo në Gjeorgji (2008) kanë treguar se sa të pamundur e kanë shtete të ndryshme për të funksionuar normalisht nëse këto sulme prekin IKI-në. Për shkak të zhvillimit të vullshëm të teknologjisë dhe natyrës ndërlidhëse të sistemeve për shkak të internetit, bëhet e mundur që sulmet kibernetike të realizohen nga çdo vend i globit. Një pjesë e mirë e këtyre sulmeve janë të motivuara politikisht.

²⁰ Burimi: https://sq.wikipedia.org/wiki/Lista_e_sulmeve_kibernetike_n%C3%ABShqip%C3%ABri

4. NEVOJA PËR MBROJTJEN E INFRASTRUKTURËS KRITIKE TË INFORMACIONIT

Mbrojtja e IKI është një temë komplekse por e rëndësishme për vendet/kombet. Kombe/vende të mëdha varen nga shërbimet e IK si: furnizimi me ujë të pijshëm, me energji, telekomunikacioni, sistemet financiare dhe bankare, shërbimet qeveritare. Sistemet shëndetësore, siguria, mirëqenia ekonomike, funksionimi normal dhe efektiv i qeverive ndoshta dhe mbijetesa e botës së industrializuar mbështeten në sisteme kritike të ndërlidhura. Një vend mund të kalojë në kaos ose mund të pësojë humbje të mëdha njerëzore nëse këto sisteme bëhen jo funksionale. Besueshmëria, stabiliteti dhe mbrojtja e ndërlidhjes së infrastrukturave të informacionit janë bërë çelës për funksionimin e sistemeve kritike të një vendi.




Figura nr. 4. Lidhja midis mbrojtjes së IK, mbrojtjes së IKI dhe Sigurisë Kibernetike

Ndonjëherë koncepti i IKI mund të japë përshtypjen e gabuar se mbrojtja e IKI është një zonë e veçantë nga mbrojtja e IK. Ndërsa mbrojtja e IK përfshin të gjithë sektorët kritikë të infrastrukturës së një vendi, mbrojtja e IKI është vetëm një nëngrup i një përpjekjeje gjithëpërfshirëse të mbrojtjes, pasi fokusohet në masat për të siguruar IKI²¹. P.sh., Kanadaja (Strategjia Kombëtare për IK), Republika Çeke (Akti mbi sigurinë kibernetike të v. 2014) dhe vende të tjera e njohin këtë lidhje të drejtpërdrejtë midis MIK dhe MIKI brenda politikave dhe kornizave të tyre ligjore. Megjithëse ka vende të tilla si p.sh., Serbia që kanë krijuar korniza të veçanta ligjore si për MIK ashtu edhe për MIKI.

Realiteti është se si IK ashtu edhe IKI mund të mbrohen në mënyrë adekuate vetëm nëse shihen si një bllok i vetëm - duke ruajtur dallimet teknike dhe rregullatore (shih fig. nr. 4).

²¹ Burimi: Burnett 2016 and Brunner & Suter 2008).

MIKI dhe siguria kibernetike janë koncepte që shpesh plotësojnë njëra-tjetrën kur diskutohet për sigurinë e infrastrukturës së informacionit, megjithatë siguria kibernetike nuk është e njëjtë me MIKI.

MIKI është një pjesë integrale e mbrojtjes së IK. Nga ana tjetër, MIKI është bërthama e sigurisë kibernetike dhe njëkohësisht është dhe qëllimi më i rëndësishëm i saj, por nuk është e njëjtë me sigurinë kibernetike dhe përjashton krimin kibernetik të zakonshëm, çështjet e privatësisë, të të drejtave të njeriut si dhe çështjet e kibernetikës ekonomike²².

Siguria Kibernetike (SK): “është koleksioni i mjeteve, politikave, koncepteve dhe masave të sigurisë, udhëzimeve, politikave të menaxhimit të rrezikut, veprimeve, trajnimit, praktikave më të mira, sigurimit dhe teknologjive që mund të përdoren për të mbrojtur mjedisin kibernetik dhe asetet e përdoruesve dhe organizatës”²³. Në ditët e sotme, ndërprerja fizike/shkatërrimi i elementëve kritikë të IK nuk është i vetmi faktor që kërcënon seriozisht funksionimin e kësaj infrastrukture. Shërbimet e bazuara në TIK po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për funksionimin normal të IK. Ndërprerja/shkatërrimi i infrastrukturës së informacionit mund të shkaktojë dëme serioze në një vend/komb. Kjo çon në nevojën e IKI për të përfshirë telekomunikimin (p.sh. shërbimet e telefonisë mobile, qasjes në internet) dhe sistemet e kontrollit të TIK e të proceseve, të cilat janë pjesë kritike e ofrimit të shërbimit të IK.

IKI po bëhet gjithnjë e më shumë pjesë kritike e IK dhe të dyja së bashku po bëhen më të ndërlidhura globalisht. Në të njëjtën kohë IKI e një vendi mund të jetë objektiv për malware-t, hakerët, si dhe një mjet për të sulmuar IKI-në e një vendi/kombi tjetër. Një IKI e dobët apo e kompromentuar mund të rrezikojë sigurinë dhe stabilitetin kombëtar, ekonominë e një vendi, jetën dhe prosperitetin e qytetarëve si dhe mund të shtrijë ndikimin në vende të tjera për shkak të ndërlidhjes globale të IKI. Kjo shtrton nevojën dhe rrit rëndësinë për strategji, politika dhe aktivitete për një mbrojtje efektive të IKI në shumë vende.

Shërbimet thelbësore dhe aktivitetet kritike.

Megjithëse qasjet e shumta në përkufizimet e IK/IKI nuk duhet të largojnë vëmendjen nga nevoja për MIKI, është e rëndësishme të kuptohen terminologjitë dhe qasjet e ndryshme IK/IKI të miratuara nga organizata të ndryshme ndërkombëtare apo rajonale, si BE dhe Bashkimi Afrikan ose individualisht nga shtete/vende të caktuara. P.sh., Direktiva e BE për Sigurinë

²² Burimi: CSIRT Maturity Kit: A step-by-step guide towards enhancing CSIRT Maturity, NCST, The Hague.

²³ Burimi: Nickolov E, Critical Information Infrastructure Protection: Analysis Evaluation and Expectations.

e Rrjeteve dhe Informacionit, nuk përdor termin IK, por përdor termin e drejtuar nga ekonomia - “Shërbime Thelbësore”. Po kështu direktiva përcakton “Operatorët e Shërbimeve Thelbësore” si një ent publik ose privat në sektorët e energjisë, transportit, bankës, infrastrukturës së tregut financiar, shëndetësisë, furnizimit, shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe infrastrukturës digjitale, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 5 të Direktivës (BE) 2016/1148 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 6 korrik 2016)²⁴.

Në vitin 2008, OECD miratoi një seri rekomandimesh për Mbrojtjen e IKI (Rekomandimet CIIP)²⁵, të cilat përcaktuan një kornizë të nivelit të lartë për të udhëhequr zhvillimin e strategjive kombëtare për të mbrojtur IKI brenda dhe jashtë kufijve. Më 2015, OECD miratoi Rekomandimin e Rrezikut të Sigurisë 2015,²⁶ në të cilin miratoi një qasje të re lidhur me konceptin e sigurisë digjitale, i cili ka evoluar nga siguria e aseteve teknike (p.sh., sistemet e informacionit e rrjetet) në sigurinë e aktiviteteve ekonomike dhe sociale që mbështeten në to (p.sh., ofrimi i energjisë ose shërbimet shëndetësore emergjente). Me pak fjalë, OECD zëvendësoi konceptin e “Sigurisë Kibernetike” me termin “Siguri Digjitale”, sepse ky i fundit ka implikime ekonomike dhe sociale.

Në 2016, OECD rishikoi raportin e rekomandimeve të “MIKI 2008” dhe ekspertët vunë në dukje se koncepti i IKI është përdorur rrallë për të zhvilluar kornizat e politikës së brendshme dhe se kjo çështje mund të jetë për shkak të vështirësisë në përcaktimin e IKI në praktikë.

Në vitin 2019, OECD miratoi një grup të ri rekomandimesh MIKI ²⁷ dhe zëvendësoi konceptin e IKI me “Aktivitete Kritike”. Kalimi nga IKI në “Aktivitete Kritike” siguron konsistencë/qëndrueshmëri me qasjen e sigurisë digjitale të Rekomandimit të Riskut të Sigurisë 2015.²⁸ Aktualisht, nuk ka të dhëna që ndonjë vend i OECD të ketë miratuar konceptin e “Aktiviteteve Kritike” brenda politikave dhe kuadrit të vet ligjor dhe vetëm disa vende, përfshi Francën dhe Kolumbinë, e kanë adoptuar konceptin e “sigurisë digjitale” në strategjitë dhe politikat e tyre të sigurisë digjitale.

Si rezultat i një ndërhyrje/shkelje të papritur në një sistem elektrik, stafi i sigurisë të një kompanie rajonale të shpërndarjes së energjisë elektrike zbuloi se kompania po sulmohej. Ndërhyrësit përdorën teknika të shumta keqdashëse për të fituar akses të paligjshëm në infrastrukturën e TIK dhe sistemin e Kontrollit

²⁴ Burimi: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/T/?uri=uriserv:OJ.2016.194.01.0001.01.ENG&toc=OJ.L:2016:194:TOC>

²⁵ Burimi: <https://legalinstruments.oecd.org/en/instruments/OECD-LEGAL-0361>

²⁶ Burimi: <https://www.oecd.org/sti/ieconomy/digital-security-risk-management>

²⁷ Burimi: <https://legalinstruments.oecd.org/en/instruments/OECD-LEGAL-0456>

²⁸ Burimi: OECD. 2019. Recommendation of the Council on Digital Security of Critical Activities.

të Mbikëqyrës dhe Marrjes së të Dhënave (SCADA-Supervisory Control and Data Acquisition). Prej ndërhyrjes së paautorizuar gjashtë nënstacione elektrike u fikën totalisht për më shumë se gjashtë orë, duke shkaktuar humbjen e shërbimit të energjisë në qytete të ndryshme, në disa vende të tjera të rajonit, 800,000 konsumatorë. Ky incident preku gjithashtu IK të tjera të lidhura dhe të varura nga shërbimi i energjisë elektrike si telekomunikacioni, shëndetësia, financat, uji, shërbimet qeveritare dhe transportin.

Këto trazira patën gjithashtu një ndikim të jashtëzakonshëm në shërbimet e tjera kritike të TIK. Kështu, qendra e rëndësishme e të dhënave në rajon u cenua për shkak se funksionimi i saj varej nga shërbimet e furnizimit me energji dhe ujë (pa energji, pompat e ujit nuk funksionuan). Si rezultati i kësaj u ndërpre në transaksionet bankare, të dhënat e kujdesit shëndetësor, të dhënat publike dhe shërbimet e tjera elektronike të qeverisjes. Njëkohësisht u prekën infrastrukturat dhe shërbimet e telekomunikacionit, duke përfshirë shërbimet e internetit dhe celularit, (bateritë e brendshme rezervë të kullave të celularëve zgjatën disa orë para se të humbnin energjinë). Po kjo kompani rajonale e shpërndarjes së energjisë elektrike furnizonte me energji disa qytete në vendet fqinje, duke shkaktuar ndërprerje në sektorët e IK dhe shërbimet në vende të tjera të rajonit.

Ky lloj sulmi kibernetik nuk konsiderohet më një shqetësim teorik. P.sh., sulmet kibernetike në rrjetet energjetike të Ukrainës në vitin 2015 dhe 2016 parashikuan se çfarë mund të ndodhte në të ardhmen. Si rrjedhojë e sulmeve kibernetike në v. 2016, rezultoi se platformat dhe shërbimet kryesore të internetit (p.sh., Airbnb, Amazon, CNN) dolën jashtë funksionit për disa kohë, duke ndikuar në shërbimin e përdoruesve përfundimtarë, në SHBA, Evropë dhe rajone të tjera. *Në fund të vitit 2020, New York Times raportoi vdekjen e parë të njohur si pasojë indirekte e një sulmi kibernetik.* Kriminelët kibernetikë goditën një spital në Gjermani me një sulm ransomware, i cili “pushtoi” 30 serverë dhe prishi sisteme duke e detyruar spitalin të largonte pacientët nga sallat e urgjencës. Një grua të cilës i kërcënohej jeta u dërgua në një spital 20 milje larg dhe vdiq nga vonesat e trajtimit.²⁹

PËRFUNDIME

1. Infrastruktura kritike është një aset/sistem thelbësor për ruajtjen e funksioneve jetësore shoqërore. Sot, kërcënimet kibernetike po rriten në numër, lloj, dhe po bëhen më të sofistikuara, kështu që vendet duhet të sigurojnë burime të mjaftueshme për mbrojtjen e IK dhe infrastrukturës së saj dhe të përcaktojnë mirë bazën ligjore e përgjegjësi të qarta për t'i mbrojtur ato në mënyrën e duhur.

²⁹ Burimi: The ransomware attack involved servers at University Hospital Dusseldorf. <https://www.nytimes.com/2020/09/18/world/europe/cyber-attack-germany-ransomware-death>.

2. Si IK përkufizohen sektorët, nënsektorët, shërbimet apo asetet, të cilët janë jetikë për funksionimin dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë dhe që cenimi pjesërisht apo shkatërrimi total i tyre do të kishte ndikim të konsiderueshëm negativ për sigurinë dhe ekonominë kombëtare dhe mirëqenien sociale të njerëzve. Natyra e sektorëve të IK kombëtare ndryshon në vende të ndryshme, pasi procesi i identifikimit të saj bazohet në rreziqet kombëtare dhe në prioritizimin e vlerësimeve. Por shumë vende kanë të përbashkët disa nga IK. Identifikimi i IK përcaktohet nga faktorë të rëndësishëm si: efekti financiar, efekti kohë dhe shpërndarja gjeografike.
3. IKI përcaktohet si burim kompjuterik, paaftësia/shkatërrimi i të cilit do ketë ndikim në dobësimin e sigurisë kombëtare, të ekonomisë, ose shëndetit publik. Identifikimi i IKI zakonisht është më kompleks sesa identifikimi i IK. Përgjithësisht IKI janë ato infrastruktura të ndërlidhura të informacionit dhe komunikimit të cilat janë thelbësore për mirëmbajtjen e funksioneve jetësore të shoqërisë, dëmtimi, ndërprerja apo shkatërrimi i të cilave do të kishte pasoja të rënda.
4. Mbrojtja e IK dhe IKI vlerësohet e një rëndësie të veçantë dhe është temë komplekse për vendet pasi shoqëria në përgjithësi varet nga funksionimi normal i IK të veta si; furnizimi me energji, ujë, telekomunikacion, financat, shërbimet shtetërore etj. Nevoja për MIKI aktualisht po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme pasi rreziku për shoqërinë vjen nga masat e pamjaftueshme të mbrojtjes së këtyre infrastrukturave të cilat rriten çdo ditë. Mbrojtja e IKI përfshin gjithë aktivitetet që sigurojnë mirëfunksionimin, vijimësinë dhe pacenueshmërinë e IKI, për pengimin, parandalimin, zbutjen e neutralizimin e kërcënimit, rrezikut apo cenueshmërisë/minimizimin e ndikimit të ndonjë incidenti. Mbrojtja e IKI është komplekse por e rëndësishme për vendet pasi vendi mund të shkojë në kaos ose mund të pësojë humbje njerëzore të mëdha nëse këto sisteme bëhen jo funksionale.
5. Ndërlidhja globale e IKI mundëson që nëse një infrastrukturë mund të cenohet në një vend, kjo dobësi mund të çojë në rrezikun e cenimit të IKI në vende të tjera të botës. Rekomandohet që palët e ekosistemit IK/IKI të punojnë së bashku nën një qasje multidisiplinare e bashkëpunuese për të zhvilluar dhe zbatuar politikat kombëtare dhe kornizat rregullatore të MIK/MIKI, të cilat duhet të përmbajnë dispozita të forta për sigurimin e aftësive adekuatë të reagimit ndaj incidenteve, mekanizma të shkëmbimit të informacionit, menaxhimin e krizës kibernetike dhe procedura të gatishmërisë për të rritur elasticitetin e IK dhe përfitimet e transformimit digjital.
6. Pranimi e miratimi i procesit të transformimit digjital të operatorët IK/

IKI përmirëson produktivitetin e efikasitetin e tyre, rrit shkëmbimin e të dhënave, fleksibilitetin dhe shkathtësinë, dhe bën që ata të përfitojnë nga investimi i kryer, por një nga sfidat e tij kryesore është minimizimi i ndikimit të rreziqeve dhe dobësive të lidhura me kibernetikën. Ky proces rrit kompleksitetin, dinamizmin, dhe varësitë e ndërvarësive ndërsektoriale e ndërkufitare të ekosistemeve globale të IK/IKI, duke maksimizuar potencialin për ndërprerje sistematike dhe me ndikim të lartë.

7. Operatorët IK/IKI duhet të pranojnë e adoptojnë qasje proaktive të menaxhimit të rrezikut. Nëse ata kuptojnë peizazhin aktual të kërcënimit kibernetik dhe dinë të menaxhojnë rreziqet e tyre të lidhura me kibernetikën (që d.m.th. vlerësim e reduktim të tyre në një nivel të pranueshëm), kjo rrit probabilitetin e përfitimeve ekonomike dhe sociale. Kjo qasje nuk mund të eliminojë të gjithë faktorët e rrezikut, por nëse trajtohet efektivisht, përfitimet e transformimit digjital në operacionet IK/IKI mund të kenë kosto minimale.

BURIME TË SHFRYTËZUARA

1. Nickolov E, Critical Information Infrastructure Protection: Analysis Evaluation and Expectations.
2. CISA. 2021. Critical Infrastructure Sectors. <https://www.cisa.gov/critical-infrastructure-sectors>;
3. OECD. Canada's National Strategy for Critical Infrastructure. <https://www.oecd.org/governance/toolkit-on-risk-governance/goodpractices/page/canadasnationalstrategyforcriticalinfrastructure.htm>
4. Telecommunications and Digital Government Regulatory Authority (2021). National Cybersecurity Strategy. <https://www.tdra.gov.ae/en/national-cybersecurity-strategy.aspx>.
5. Cybersecurity Act of Singapore. 2021. https://www.ifaq.gov.sg/csa/apps/fcd_faqlmain.aspx?
6. African Union, African Union Convention on Cyber Security and Personal Data Protection, LC12490.
7. Victorian Government CIO Council Critical Information Infrastructure Risk Management, Australia 2012
8. Guia de referência para a segurança das infraestruturas críticas da informação Versão 01 (Nov. 2010).
9. Cyber Security in the UK Postnote Number 389 September 2017.

10. Commission of the European Communities. 2005. Green Paper on a European Programme for Critical Infrastructure Protection. <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2005:0576:FIN:EN:PDF>;
11. CSIRT Maturity Kit: A step-by-step guide towards enhancing CSIRT Maturity, NCST, The Hague.
12. https://www.researchgate.net/figure/Oil-critical-infrastructure-sectors-and-subsectors_tbl1_337549204.
13. <https://etn-peter.eu/2021/04/06/basics-of-any-critical-infrastructure/>.
14. <https://etn-peter.eu/2021/04/06/basics-of-any-critical-infrastructure/>
15. <https://cesk.gov.al/rreth-nesh/index.html>
16. https://sq.wikipedia.org/wiki/Lista_e_sulmeve_kibernetike_n%C3%AB_Shqip%C3%ABri
17. https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.L_.2016.194.01.0001.01.ENG&toc=OJ:L:2016:194:TOC
18. <https://legalinstruments.oecd.org/en/instruments/OECD-LEGAL-0361>
19. <https://www.oecd.org/sti/ieconomy/digital-security-risk-management>
20. <https://legalinstruments.oecd.org/en/instruments/OECD-LEGAL-0456>

INFLUENCA E KINËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Nënkolonel (R) Msc. Kristo RAPO
Specialist në IKSHU

Trajtesë e shkurtuar.

Pozicionimi i politikës së jashtme të Kinës, në marrëdhëniet moderne ndërkombëtare, përcaktohet nga dimensionimi gjeopolitik i përvojës së saj historike dhe qëllimeve strategjike afatgjata. Kina, që me ritme të shpejta po forcon ushtrinë dhe aktivitetin ushtarak duke rritur rivalitetin me SHBA-në, paraqet “një sfidë të paprecedent dhe më të madhe strategjike” për paqen dhe sigurinë në rajonin e Indo-Paqësorit dhe të komunitetit ndërkombëtar. Përveç dhënies një vëmendje të veçantë luftës në Ukrainë, Liderët e G7 të mbledhur në Hiroshima, nuk kishin në qendër të kritikave vetëm Moskën, por edhe ndikimin e Pekinit, duke e parë atë si kërcënim në rritje. Në takim u kritikua përdorimi i “trysnisë ekonomike” nga ana e Kinës, rritja e pranisë ushtarake në Detin e Kinës Jugore dhe “veprimet e saj ndërhyrëse” që synojnë të cenojnë sigurinë e diplomatëve, integritetin e institucioneve demokratike dhe zhvillimin ekonomik.

Në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të SHBA-ve, Pekini përcaktohet si një kërcënim më i madh sesa Moska për rendin ekzistues botëror. Uashingtoni ka filluar të flasë për një pushtim kinez të Tajvanit demokratik si një perspektivë gjithnjë e më realiste sesa një mundësi e largët. Ndryshe nga koha kur deklarohesh se pasurimi i ndërsjellë do të tejkalonte dallimet ideologjike dhe tensionet midis një superfuqie të krijuar dhe një superfuqie në rritje.

Së fundmi, Kina ka shprehur mbështetjen për përpjekjet e Serbisë “për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial”, pas përleshjeve mes

protestuesve serbë në Zveçan dhe trupave paqeruajtëse të NATO-s, duke ia lënë fajin dështimit për të respektuar të drejtat politike serbe.

“Ne kundërshtojmë veprimet e njëanshme të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës”, tha zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme kineze, gjatë një konference për media, duke iu referuar Qeverisë së Kosovës. Partia në pushtet, Partia Komuniste për një kohë të gjatë është kritike e aleancës së NATO-s. Mospajtimet me KFOR-in pjesërisht burojnë nga bombardimi i Ambasadës kineze në Beograd, gjatë fushatës ajrore të aleancës më 1999, që i dha fund luftës në Kosovë. Kina, së bashku me Rusinë dhe Serbinë, nuk e njohin pavarësinë e Kosovës të shpallur më 2008. Duket se ato janë në sinkron për të dënuar Kosovën lidhur me situatën në veri.

Fjalë kyçe: marrëdhënie ndërkombëtare, mjedis i sigurisë, Kina, Ballkani Perëndimor, infrastruktura kritike, ekonomia globale, koncepti strategjik

HYRJE

Në bazë të Konceptit të ri Strategjik të NATO-s, Republika Popullore e Kinës vlerësohet si një fuqi në rritje dhe po aq edhe konkurruese në sferën globale të mjedisit të sigurisë dhe agjendën e avancimit teknologjik e hapësinor. Në konkluzionet e raportit të grupit reflektues të NATO 2030, “Të bashkuar për një epokë të re”, paraqiten sfidat komplekse dhe kritike, me të cilat përballlet komuniteti transatlantik në këtë dekadë, ndër të cilat është dhe: rritja e ndikimit të Kinës.

Kina është bërë një lojtar i rëndësishëm në skenën botërore. Ambiciet e deklaruara dhe politikat shtrënguese të saj sfidojnë interesat, sigurinë dhe vlerat tona. Ajo përdor një gamë të gjerë mjetesh politike, ekonomike dhe ushtarake për të rritur ndikimin dhe fuqinë e projektit të saj, duke qenë e pa qartë në lidhje me strategjinë, synimet dhe ndërtimin ushtarak të saj. Operacionet keqdashëse hibride dhe kibernetike të Kinës, retorika e saj konfrontuese dhe dezinformimi synojnë të dëmtojnë sigurinë e Aleancës, duke kërkuar të kontrollojë sektorët kryesorë teknologjikë dhe industrialë, infrastrukturën kritike, materialet strategjike dhe zinxhirët e furnizimit. Nëpërmjet fuqisë ekonomike synon të krijojë varësi strategjike dhe ndikimin e saj, si dhe përpiqet të përmbysë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, duke përfshirë fushat hapësinore, kibernetike dhe detare. Thellimi i partneritetit strategjik me Rusinë dhe përpjekjet e tyre të për të nënvlerësuar rendin ndërkombëtar, bien ndesh me vlerat dhe interesat tona.

Pozicionimi i politikës së jashtme të Kinës, në marrëdhëniet moderne ndërkombëtare, përcaktohet nga dimensionimi gjeopolitik i përvojës së saj historike dhe qëllimeve strategjike afatgjata, të pavarura nga programet individuale

të liderëve të saj. Gjithashtu cilësimet themelore të sistemit të saj politik dhe ekonomik konsiderohen si faktorët kyç që përcaktojnë kuadrin dhe dinamikën e politikës së jashtme kineze. Nga ana historike dhe kulturore, marrëdhënia midis shtetit dhe shoqërisë në Kinë ka një lidhje të thellë morale dhe një formë gjithnjë e më të sofistikuar të autoritetit social dhe ideologjik të Partisë Komuniste, me vazhdimësinë e pushtetit politik në thelb të politikës elitare.

Për të kuptuar arritjet e RPK, si në politikën e brendshme ashtu edhe në atë të jashtme, është e nevojshme të merret në konsideratë mendësia e fuqive të mëdha brenda një kuadri të qytetërimit dhe jo kombëtar. Ambiciet e vizionit të Kinës në krye të hierarkisë botërore janë të dukshme si nëpërmjet shpërndarjes së fuqisë së saj ekonomike në shkallë globale ashtu dhe të sintezës së fuqisë politike, ekonomike dhe ushtarake. Në qasjet teorike ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare, politika paqësore në rritje e Kinës shpjegohet nga parimet e modelit liberal të ndërvarësisë tregtare dhe parimet e realizmit strukturor. Prandaj, tregtia dhe investimet ndërkombëtare zvogëlojnë mundësinë e shpërthimeve të konflikteve të armatosura. Megjithatë, duke pasur parasysh një armatosje të fortë dhe të intensifikuar të Kinës dhe politikave agresive ndaj fqinjëve në Detin e Kinës Jugore, rolin që ajo ka në përhapjen e armëve bërthamore, bashkëpunimin me regjimet autokratike dhe organizatat terroriste, pozicioni i saj në marrëdhëniet ndërkombëtare moderne, mbetet i pa kuptuar dhe pa u interpretuar brenda kornizave të politikës reale klasike.

Mënyra e sjelljes së Kinës në arenën ndërkombëtare në thelb përcaktohet nga faktorë historikë që pasqyrojnë gjykimet dhe paragjykimet e politik bërësve kinezë për politikën e jashtme. Synohet pozicionimi i Kinës duke shmangur sistemin ndërkombëtar, nëpërmjet rivitalizimit kombëtar, viktimizimit dhe politikave të sigurisë e mbrojtjes.

Strategët kinezë e shohin ngritjen aktuale të Kinës si një proces historik të rinovimit të kombit në rrugën drejt kthimit të statusit të fuqisë së madhe që nga koha e dinastive perandorake. Ky besim bazohet në idenë e një shoqërie të përparuar ekonomikisht, shumë e zhvilluar nga ana kulturore e teknologjike dhe e respektuar në arenën ndërkombëtare. Argumentohet me numrin e madh të popullsisë, historinë mijëvjeçare, ekonominë e integruar globalisht dhe pozicionin e fuqisë bërthamore, si dhe anëtar i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të OKB. Sipas Kinës, të gjitha kombet në zonën civilizuese konfuciane¹ duhet të pranojnë të drejtën e tyre natyrore për udhëheqje.

Mendimi tjetër i përqendruar në të gjitha shkrimet e rëndësishme kineze ka të bëjë me tregimin e 100 viteve të turpit dhe poshtërimit në të cilin ishte Kina e

¹ Konfuci, filozofi i njohur kinez, i pari që me dijet e tij sintetizoi bazat e arsytimit të popullit kinez.

sulmuar, e dobësuar dhe e ndarë. Roli i mentalitetit të viktimës është veçanërisht i dukshëm në fushën e ushtrimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të cilat shkelen sistematikisht me pretekstin e mbrojtjes së vlerave themelore socialiste.

1. SISTEMI I QEVERISJES NË KINË

Në Kinë mënyra e qeverisjes është e sistemit një partiak. Sundimi i Partisë Komuniste (PKK) fillon me krijimin e saj në vitin 1949 dhe deri më sot, si një shtet socialist i bazuar në parimin e një diktature demokratike popullore të udhëhequr nga klasa punëtore. Nomenklatura kineze përbëhet nga dy institucione të integruara dhe të ndërlidhura vertikalisht: PKK dhe aparati shtetëror. Gjyqësori është nën juridiksionin e legjislativit dhe mbikëqyrjen e partisë. Megjithëse i ngarkuar me sfida të shumta të jashtme dhe të brendshme, sistemi politik dhe partiak kinez ka treguar qëndrueshmëri dhe aftësi për t'u përshtatur institucionalisht me rrethanat e reja politike përmes një procesi tranzicioni (të kufizuar). Kina ka një histori të gjatë reformash politike, por vlerat e politikës së saj janë katërcipërisht të ndryshme nga vlerat demokratike të vendeve perëndimore.

Kongresi i partisë, tradita politike kineze nuk njeh zgjedhje të lira dhe demokratike, për sa i përket mekanizmit përmes të cilit qytetarët i japin drejtpërdrejt legjitimitet qeverisë. Në vend të kësaj, kongreset e partisë konsiderohen si ngjarjet më të rëndësishme kombëtare publike në politikën kineze. Kongresi është organi më i lartë vendimmarrës që përcakton politikën e partisë dhe zgjedh liderët, mbahet çdo pesë vjet dhe thirrja e tij nënkupton përgatitje të gjata dhe masa represive që nxehin atmosferën sociale. Kongresi më i rëndësishëm në historinë politike të Kinës, është Kongresi i 18-të, i mbajtur në nëntor 2012, që shënoi fillimin e tranzicionit të pushtetit, kur drejtimi iu dha një gjenerate të re, të liderëve kinezë të udhëhequr nga ish-Zv. Presidenti Xi Jinping. Kongresi i 19-të, konsiderohet një pikë kthese në politikën kineze, Xi Jinping konfirmoi veten si kreu i partisë dhe shtetit, konsolidoi ngritjen e tij politike dhe akumuloi fuqi politike dhe ushtarake. Ky kongres nuk ishte një përjashtim nga kongreset e mëparshme, por tregoi vazhdimësinë e udhëheqjes së PKK. Mësimet e detyrueshme të marksizmit janë zëvendësuar nga studimi i Mendimit të Xi Jinping.

Doktrina e re është një plan gjithëpërfshirës për ta bërë Kinën një superfuqi botërore, jo vetëm ekonomikisht të begatë, por edhe politikisht të fuqishme, dhe zbatimi i saj është planifikuar në disa faza:

- Periudha nga 2020 deri në 2035 parashikon realizimin e modernizimit socialist;
- Realizimi i fazës së dytë është planifikuar në 100 vjetorin e themelimit të RPK në vitin 2049, kur Kina synon numrin një të botës në llojin e ri të

marrëdhënieve ndërkombëtare.

Edhe pse pushteti i zotit Xi brenda vendit forcohet, në skenën ndërkombëtare situata si rrallëherë duket më e pazgjidhur. Sa më shumë që ai të përforcojë modelin autoritar të Kinës, aq më shumë sfidon supozimin përcaktues të epokës së globalizimit se: “ndërsa Kina bëhet më e pasur, ajo do të bëhet më e lirë”. Ky supozim nxiti për dekada zhvillimin në tregti dhe angazhimin midis Uashingtonit dhe Pekinit, duke bërë që partneriteti ekonomik të arrinte në mallra me vlerë më shumë se gjysmë trilion dollarë çdo vit. Tani kur Xi fillon mandatin e tij të tretë, përballat me një luftë tregtare të vazhdueshme me SHBA-në dhe mohimit të aksesit në teknologjinë amerikane me qëllim për të ngadalësuar rritjen e Kinës. Pekini argumenton se krisja e marrëdhënieve po nxitet nga dëshira e Amerikës për të ruajtur pozicionin e saj si fuqia botërore e shquar.

Ideologjia komuniste dhe biznesi kapitalist, tregon se Kina është vendi me ekonominë me rritje më të shpejtë, bartëse e politikës së saj të jashtme, por që nuk arrin ta përthithë nga brenda. Pritshmëria se zhvillimi i stimuluar nga liberalizimi ekonomik do të ndjekë procesin e tranzicionit dhe demokratizimit të shoqërisë rezultoi i gabuar. Për të treguar qasjen jo konvencionale të tregut të Kinës, përdoret termi model kinez, i cili shpjegon kombinimin kompleks të autoritarizmit politik me hapjen ekonomike, të ashtuquajturin kapitalizëm autoritar. Ajo është ekonomia e dytë më e madhe në botë dhe një bartëse e tregtisë dhe investimeve globale, por edhe pse ka zgjeruar kapitalin e saj në 139 vende përmes programit për zhvillimin ekonomik Brez dhe Rugë, nuk ka një strategji ekonomike gjithëpërfshirëse në vend. Procesi i reformave të tregut në Kinë po kryhet pa privatizim dhe reforma politike. Kontrolli partiak mbi kompanitë dhe ekonomia politike socialiste pengojnë hapjen ndaj kompanive të huaja që të përballen me konkurrencën e ashpër me kompanitë shtetërore kineze.

Kina ndjek politikën e instituteve të fuqisë së butë, zbatimi i fuqisë së butë nuk do të ishte i mundur pa një rrjet të lidhur mirë organizatash, shoqatash dhe përfaqësuesish me veprime të koordinuara, mbi të cilat bazohen aktivitetet e PKK. Pozicioni i një vendi në ekonominë globale, në sistemin botëror, varet jo vetëm prej saj, por edhe nga faktorë “të butë”, nga reputacioni ose perceptimet e vendeve të tjera për to. Kapaciteti për të ndikuar nënkupton zotërimin e burimeve të tilla si popullsia, toka, burimet natyrore, ekonomia, forcat e armatosura dhe stabiliteti politik.

Ndër organizatat më të shquara janë Instituti Konfuci; Fronti i Bashkuar i PKK; Konferenca Konsultative Politike e Popullit Kinez; Kongresi Popullor Kombëtar; Komisioni i Çështjeve Etnike dhe Fetare; Zyra me jashtme dhe për të huajt; Federata e industrisë dhe tregtisë; Zyra e këshillit të informacionit shtetëror; Komiteti për Punët e Jashtme i Komitetit Qendror; Fondacioni i

shkëmbimit Kinë - Shtetet e Bashkuara etj.

Fuqia e butë dhe e fortë nuk janë padyshim alternativa të veçanta, por plotësuese të njëra tjetrës. “Ingranazhet e fuqisë së fortë mund të funksionojnë pa probleme vetëm me lubrifikantin e fuqisë së butë”². Në mungesë të komponentit të fuqisë së butë, Kina ka filluar të plotësojë fuqinë e saj të fortë duke u mbështetur më intensivisht në fuqinë e butë të bazuar në gjashtë shtylla: tërheqja kulturore, vlerat politike, modeli i zhvillimit, institucionet ndërkombëtare, imazhi ndërkombëtar dhe tundimi ekonomik (Li dhe Worm)³. Megjithatë, ajo nuk përpiqet të eksportojë aq shumë “modelin e saj unik politik, indigenizimin e kapitalizmit, diçka hibride dhe e vështirë për t’u kategorizuar”⁴, siç bëri Bashkimi Sovjetik, por kryesisht ndjek interesat e saj globale ekonomike.

2. KINA DHE PERSPEKTIVA GLOBALE

Roli i ndikimit të Kinës në të ardhshmen në ekonominë globale do të thotë se zhvillimi i saj është qendror për strategjinë e zhvillimit të çdo vendi. Forcimi i bashkëpunimit me të është jetik si politikisht ashtu edhe ekonomikisht. Ne duhet që të konsiderojmë veçanërisht rolin e Kinës në ekonominë globale, transformimin e saj teknologjik, politikën e BE-së (pjesë e së cilës aspirojmë të bëhemi) ndaj Kinës dhe si të kapërcehen dallimet e mëdha kulturore që mund të gërryejnë besimin, përkatësisht një aset të rëndësishëm në këtë botë të paqëndrueshme të VUCA-s.⁵

Nëse deri përpara vitit 2010, Kina nuk mori asnjë përmendje të veçantë, tani ajo përshkruhet si një “sfidë sistematike” për sigurinë euroatlantike. Për më tepër, marrëdhëniet midis Rusisë dhe Kinës përshkruhet si një “partneritet strategjik në thellim”, i cili gjithashtu ka të ngjarë të kërcënojë rendin global dhe Aleancën. NATO njeh gjithashtu sfida shtesë: praninë e shtuar të Kinës në Evropë përmes iniciativës së saj “Një brez dhe një rrugë”, varësia ekonomike e disa vendeve evropiane nga Kina dhe shtimi i kapaciteteve ushtarake kineze në Detin e Kinës Jugore.

Kina mund të ndjekë edhe në mënyrë indirekte ideologjinë e saj duke përhapur fuqinë e saj të butë, duke e konsideruar atë si “tregimi i një historie të mirë të Kinës” dhe koncepti i “Ëndrrës Kineze”⁶, që janë përdorur për t’u përballuar me “teorinë e kërcënimit të Kinës”, për të përhapur dhe të përmirësuar statusin dhe imazhin e Kinës. Me përprjekje të tilla, ajo kërkon të largohet nga imazhi i

² Jan Melissen is a Senior Fellow International Relations and Diplomacy at ISGA.

³ Është një lloj karremi hibrid.

⁴ Brown University, USA, Trending Globally, 22, 2020.

⁵ Paqëndrueshmëri, pasiguri, kompleksitet dhe paqartësi.

⁶ “Prosperitet kinez, përtëritje kombëtare dhe lumturi e njerëzve”

përgjithshëm si një kërcënim, në një imazh më të përzemërt si një komb miqësor dhe paqedashës. Një përpjekje e tillë e re po zëvendëson konceptin më të vjetër të “charm offensive”⁷ që synon të përmirësojë statusin dhe imazhin e saj global. Ndërsa ideja që Kina të magjeps botën me aftësitë e saj ekonomike dhe kulturore nuk ka ndryshuar shumë. Ndikimi i saj kulturor nuk është rritur aq shpejt sa ekonomia e saj. Prandaj, për këtë në vitin 2007, presidenti Hu Jintao deklaroi se arritja që vendet e tjera të pëlqejnë Kinën ishte një prioritet kombëtar. Nëse “ëndrra kineze” është aspekti i brendshëm i vizionit aktual holistik global të Republikës Popullore të Xi, atëherë Iniciativa Brez dhe Rrugë (BRI)⁸ është fytyra e saj e jashtme.

Si rezultat, Koncepti i ri Strategjik i NATO-s thekson rëndësinë e Indo-Paqësorit, duke vënë në dukje se ka gjasa që NATO të luajë gjithnjë e më shumë një rol në këtë pjesë të botës. Ndërsa NATO mbetet e hapur për dialog konstruktiv me Kinën, koncepti i ri demonstroi një bashkim të pikëpamjeve të ndryshme në të dyja anët e Atlantikut të kërcënimit që Kina paraqet për rendin global, pjesërisht për shkak të perceptimeve në zhvillim të Kinës në Evropë.

Marrëdhëniet dypalëshe Kinë - SHBA.

Marrëdhëniet midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara janë mjaft komplekse. Të dy vendet gjejnë interesa të përbashkëta në tregti, investime, teknologji dhe arsimim. Megjithatë, marrëdhëniet mes dy vendeve rëndohen nga çështja e Tajvanit, e cila është pika më e paqëndrueshme; mosmarrëveshjet territoriale detare në Detin e Kinës Jugore; të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike; mbrojtja e mjedisit; lufta kibernetike dhe rrjeti 5G; si dhe çështje të tjera të sigurisë. Pavarësisht marrëdhënieve të tensionuara politike, Kina ka nevojë për qasje të vazhdueshme me SHBA si një treg eksporti për prodhimin e saj. Çështjet kryesore që rëndojnë marrëdhëniet e tyre mbeten ende të pazgjidhura. Këto kanë bërë që Kina dhe Rusia të gjejnë midis tyre interesa dhe gjuhë të përbashkëta, kryesisht në kundërshtimin e Amerikës në arenën gjeopolitike, duke i përcaktuar marrëdhëniet midis dy vendeve si një partneritet pa kufij. Agresioni rus ndaj Ukrainës është një lloj testi për marrëdhëniet mes Moskës dhe Pekinit.

Në situatën e re, Kina nga njëra anë fajëson përfundimin për kërcënimin e supozuar ndaj sigurisë ruse, duke dënuar SHBA për vendosjen e sanksioneve. Nga ana tjetër, ajo nuk mund të mbështesë agjendën separatiste të presidentit rus Vladimir Putin për Ukrainën lindore, sepse janë negociatat që çojnë në zgjidhjen e konfliktit, të cilin ai e quan Kriza e Ukrainës.

⁷ Një fushatë e përdorimit të qëllimshëm të sharmit dhe lajkave për të arritur një qëllim, veçanërisht në politikë ose diplomaci.

⁸ Iniciativa Belt and Road (BRI) është një strategji zhvillimi e propozuar nga qeveria kineze që fokusohet në lidhjen dhe bashkëpunimin midis vendeve euroaziatike.

Marrëdhëniet Kinë – Bashkimi Evropian.

Kina kërkon të zgjerojë ndikimin e saj politik në Evropë, gjë që duhet të jetë një arsye e mjaftueshme për të ndryshuar sjelljen evropiane në lidhje me të. Ajo është përpjekur gjithashtu të përmirësojë marrëdhëniet e tensionuara me Evropën pasi tregtia e saj me BE-në është një motor i rëndësishëm i rritjes ekonomike së saj. Por këto përpjekje ka të ngjarë të pengohen nga neutraliteti i saj pro-rus.

Marrëdhëniet midis Kinës dhe Komunitetit Ekonomik Evropian, fillojnë në vitin 1975 dhe janë intensifikuar që kur Kina hyri në Organizata Botërore e Tregtisë. Megjithatë, me kalimin e kohës, marrëdhëniet kanë fituar një rëndësi shumë më të gjerë sesa marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare, Kina është kthyer nga një partner strategjik i BE në një rival sistematik që po përpaket të marrë përparësinë në Evropë. Këto marrëdhënie janë përkeqësuar që kur BE akuzoi Kinën për shkelje të të drejtave të njeriut ndaj ujgurve, shtypje të lirive në Hong Kong dhe Tajvan dhe mungesë transparence në projektet e saj. Projektet dhe investimet kineze në shtetet anëtare të BE shoqërohen me mos transparencë, mosrespektim të standardeve ligjore, sociale dhe mjedisore dhe mos përbushje të premtimeve të dhëna. Veprime të tilla janë pjesë e strategjisë gjithëpërfshirëse të Kinës, e cila synon të ruajë praninë dhe ndikimin në sektorë të caktuar në vendet evropiane dhe të marrë përparësinë dhe duke krijuar kushte për distancimin e Evropës nga SHBA. Kina ushtron fuqinë e saj të butë përmes armës më të fuqishme institucionale të PKK - Frontit të Bashkuar. Ajo promovon me mjeshtëri fuqinë e saj ekonomike, duke fituar kështu më shumë publicitet dhe së bashku me Rusinë vendosin një renditje që fokusohet në të drejtat sovraane të vendeve dhe jo në të drejtat e njeriut.

Baza e aktiviteteve kineze në Evropë dhe veçanërisht në Ballkan janë Iniciativa Brez dhe Rrugë (BRI) dhe platforma shumëpalëshe 16+1. Krahësferës ekonomike, ajo kërkon të forcojë praninë e saj përmes bashkëpunimit politik dhe kulturor me vendet e Ballkanit. Kjo dëshmohe me efektive veçanërisht në Ballkanin Perëndimor. Niveli i ulët i zhvillimit, infrastruktura e dobët, mungesa e kapaciteteve demokratike, por edhe qëndrimi i rezervuar i Perëndimit, i kanë mundësuar Kinës të pozicionohet si një faktor dhe partner i rëndësishëm në Ballkan. Evropa ka filluar të rishqyrtojë politikat e saj ndaj Kinës. Pavarësisht dallimeve midis vendeve anëtare të BE për çështjet me praninë kineze, ndryshimet e përgjithshme janë gjithnjë e më të dukshme dhe reflektohen në një politikë më të rreptë dhe të kujdesshme në marrëdhëniet dhe aktivitetet me të.

3. KINA DHE VENDET EVROPËS JUGLINDORE

Kriza ekonomike dhe veprimi i ngadaltë i BE-së i kanë hapur dyert Kinës, që paraqitet si një shpëtimtare që do të inkurajojë zhvillimin e mëtejshëm të

rajonit. Përveç kësaj, ajo tregohet shumë e aftë në përpjekjet për t'u lidhur me vendet e Ballkanit përmes bashkëpunimit në fushat e kulturës dhe teknologjisë.

Shembulli më i dukshëm për këtë është Greqia. Ajo është vendi me të cilin Kina kishte lidhjet më të forta në Evropë. Duke përfituar nga kriza ekonomike që e goditi atë, Kina doli si shpëtimtare dhe filloi të investonte në këtë vend. Janë 11 projekte kineze të hartuara dhe po zbatohen aktualisht, nga investimet e huaja direkte te tregtia, diplomacia kulturore dhe donacione të ndryshme për të ndihmuar dhe në pandeminë e covid 19.

Pozicioni gjeostrategjik i Sllovenisë, si dhe Porti i Koperit (terminali më i madh i kontejnerëve në Adriatik dhe i dyti për makinat në Mesdhe), janë arsyeja pse Kina po përpaket të profilizohet si një partner kyç i këtij vendi. Nga ana logjistike, ky port ofron aksesin më të mirë në tregjet evropiane, veçanërisht në Evropën Qendrore, në vitin 2018 iu bashkua zyrtarisht Iniciativës kineze Brez dhe Rrugë.

Modus operandi⁹ kinez është profilizuar qartë përmes bashkëpunimit brenda projekteve të infrastrukturës. Kompanitë kineze ofrojnë gjithmonë shërbime më të lira krahasuar me konkurrentët e tyre amerikanë apo evropianë dhe në këtë mënyrë bashkëpunojnë me vendet e Evropës Juglindore. Shembulli më i qartë i një veprimi të tillë është Kroacia. Duke hapur Forumin Kroaci-Kinë në 2018, kryeministri kroat Andrej Plenković u bëri thirrje kompanive kineze të investojnë në vend, veçanërisht në infrastrukturën hekurudhore dhe portet.

Nga ana tjetër, Rumania është një shembull ku bashkëpunimi afatgjatë ekonomik nëpërmjet investimeve kineze nuk ka dhënë rezultate të rëndësishme. Vitet e fundit, qeveria rumune ka filluar të rishikojë politikat e saj në përputhje me udhëzimet e BE-së për të përmirësuar mekanizmin e shqyrtimit të investimeve të huaja. Kjo është një çështje veçanërisht problematike për Kinën, duke pasur parasysh shqetësimet e Evropës dhe SHBA për pjesëmarrjen e kompanive kineze në zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturës 5G në Evropë. Sllovenia dhe Greqia janë vende që kanë nënshkruar një deklaratë për sigurinë e rrjetit 5G, e cila po shqyrton shpalljen e Huawei¹⁰ si një furnizues me rrezik të lartë, duke bllokuar potencialisht aksesin e gjigantit kinez të telekomunikacionit në treg.

4. STRATEGJIA E KINËS NË BALLKAN

Gadishulli Ballkanik ka një rëndësi të madhe për Kinën dhe arritjen e synimeve të saj strategjike. Prania e intensifikuar e saj në këtë rajon do t'i mundësonte asaj vazhdimin e përparimit drejt BE. Gjithashtu, Ballkani

⁹ Një mënyrë ose metodë e veçantë për të bërë diçka.

¹⁰ Huawei është ofruesi kryesor botëror i infrastrukturës dhe pajisjeve inteligjente të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK).

përfaqëson një bastion të rëndësishëm në Evropë për t'u përballur me SHBA. Kina ka një fokus të veçantë në vendet e Ballkanit, ku për shkak të mungesës së kapaciteteve demokratike dhe zhvillimit më të dobët ekonomik, është më e lehtë të arrijë qëllimet e saj gjeopolitike. Kina bashkëpunon me vendet e Ballkanit përmes platformës shumëpalëshe 16+1,¹¹ e cila u formua në vitin 2012 në Budapest dhe është pjesë e BRI.

Kina dhe vendet e Ballkanit Perëndimor.

Bosnje dhe Hercegovina. Bi&H është vendi në të cilin Kina ka pasur ndikimin më të rëndësishëm ekonomik dhe politik në BP. Projektet kineze atje arrijnë një vlerë më shumë se 5 miliardë euro. Një numër i madh investimesh kineze kryesisht në energji dhe transport janë në entitetin e Republikës Srpska. Lidhja politike dhe ekonomike mes atij entiteti dhe Kinës është logjike, duke pasur parasysh se vëmendja politike në Serbi po kalon drejtpërdrejt në Republikën Srpska. Ashtu si në Serbi, jo-transparenca dhe praktikat e mundshme korruptive janë diçka që kryesisht akordon kompanitë kineze në projekte në BI&H.

Mali i Zi. Qasja e gjerë e Kinës në Mal të Zi, fokusohet në zhvillimin e marrëdhënieve në nivele të ndryshme, duke përfshirë gjithçka, nga infrastruktura, energjia, kultura dhe partitë politike me synimin që të promovojë treguesit dhe interesat e saj. Projekti më i dukshëm është ai i seksionit të autostradës Bar - Boljare, që synon të lidhë jugun dhe verin e Malit të Zi, si dhe lidhjen e saj me korridorin e Mesdheut në BP, duke e bërë atë pjesë të rrjetit të transportit evropian. Kjo marrëveshje kredie ka shkaktuar shumë polemika për shkak të mos transparencës si dhe procesit të ndërtimit, të cilin OJQ-të që përballen me korrupsionin e kanë lidhur me ish-zyrtarë të qeverisë. Përveç autostradës, ka një sërë projektesh të tjera energjetike dhe infrastrukturore (jo)transparente.

Serbia. Ajo që i mungon kryesisht Kinës në vendet e tjera evropiane është bashkëpunimi i drejtpërdrejtë dhe mbështetja nga liderët politikë, të cilën e ka gjetur në Serbi, e cila është një nga partnerët kryesorë të saj në Evropë. Një ndryshim domethënës në krahasim me vendet e tjera është mbështetja e qartë e Kinës nga liderët politikë serb. Angazhimi politik i Beogradit ndaj Kinës ka mundësuar ndikimin ekonomik, si mjet kryesor i lulëzimit të ndikimit kinez në vend. Në dekadën e fundit, të paktën 61 projekte janë identifikuar në Serbi në faza të ndryshme të përfundimit me mbështetjen ose në bashkëpunim me aktorët kinezë, me vlerë të paktën 18.7 miliardë €. Presidenti i Serb ka bërë të ditur se Serbia do të nënshkruajë një marrëveshje të tregtisë së lirë me Kinën.

¹¹ Iniciativë Bashkëpunimi ndërmjet Kinës dhe vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore e Ministrisë së Punëve të Jashtme Kineze. (gjithashtu 14+1; më parë 17+1 nga 2019 në 2021 dhe 16+1 nga 2021 në 2022).

Maqedonia e Veriut. Maqedonia e Veriut është një tjetër vend ku Kina filloi të investojë fuqishëm në fillim të dekadës së dytë të shekullit të 21-të. Vlera totale e 15 projekteve në këtë vend është 654,434,689 euro.

Shqipëria. Shqipëria është një nga vendet e pakta të Evropës Juglindore që ka pasur një rënie të investimeve kineze në gjashtë vitet e fundit. Kulmi i flukseve hyrëse të investimeve kineze ishte në shtator 2016, kur kompania kineze Geo-Jade Petroleum pagoi 384.6 milionë euro për një koncesion të nxjerrjes së naftës në vendburimin Patos-Marinzë.

Shtetet anëtare të Iniciativës 16+1. Bashkëpunimi ndërmjet Kinës dhe shteteve të Ballkanit është zhvilluar kryesisht përmes Platformës së lartpërmendur 16+1. Kina ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe me të gjitha vendet e BP në fushën e turizmit, kulturës dhe arsimit, ekonomisë dhe shëndetësisë. Modus operandi kinez i profilizuar për pjesëmarrje në kuadër të projekteve të infrastrukturës, nëpërmjet ofertave dhe shërbimeve më të lira në krahasim me konkurrentët amerikanë apo evropianë, i lehtëson Kinës bashkëpunim me këto vende. Megjithatë, BE dhe SHBA, që nga fillimi i pandemisë COVID-19, kanë filluar të kenë më shumë vëmendje për angazhimin ekonomik të Kinës dhe identifikimin e pasojave negative. Siç është krijimi i borxhit të paqëndrueshëm, i cili kërcënon stabilitetin ekonomik e atë social dhe ndikon në mjedisin e sigurisë.

Vendet që përbëjnë Platformën aktuale 16+1 janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Greqia, Hungaria, Letonia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Polonia, Rumania, Serbia, Sllovakia dhe Sllovenia. Fushat prioritare të identifikuara nga Kina janë infrastruktura dhe teknologjia e avancuar. Duket sikur 16+1 jep përshtypjen e multilateralizmit, por Kina e përdor kryesisht këtë platformë për të lidhur marrëveshje dypalëshe.

Edhe pse Pekini pretendon se është një projekt thjesht ekonomik, dimensionit i tij gjeopolitik është i padiskutueshëm. Kjo iniciativë është një mekanizëm që Kina përdor për të zgjeruar ndikimin e saj duke përdorur fuqinë e butë. Në vitin 2016, Komunikimi i Përbashkët i Komisionit Evropian mbi Elementet për një Strategji të re të BE-së për Kinën kërkonte që çdo marrëveshje dypalëshe, si dhe marrëveshjet brenda 17+1 (në momentin e hartimit dokumenti, Lituania ishte anëtare e Nismës), të miratohet në koordinim me BE-në, në mënyrë që rezultati i përgjithshëm të jetë i dobishëm për BE-në si një e tërë.

5. RASTI KINA DHE MALI I ZI

Në vitet e fundit, Mali i Zi ka qenë në qendër të debateve të shumta politike dhe akademike duke diskutuar mundësitë dhe rreziqet e bashkëpunimit me Kinën. Qasja e gjerë e Kinës në rajon, duke përfshirë Malin e Zi, përfshin zhvillimin

e marrëdhënieve në nivele të ndryshme, nga infrastruktura të energjia dhe kultura, dhe synon të promovojë narrativat dhe interesat kineze. Për këtë qëllim, Pekini ka shfrytëzuar hapësirën e krijuar për shkak të preokupimit të Perëndimit me çështjet e veta për të investuar në sektorë të rëndësishëm strategjikë në BP.

Prania e Kinës në Mal të Zi është relativisht e re dhe është nxitur nga shmangia e BE-së dhe SHBA-së nga rajoni i BP, për shkak të një sërë problemesh të brendshme dhe krizës financiare globale të vitit 2008. Një vend me dalje në det dhe kandidat për anëtarësim në BE, por me institucione të dobëta dhe të politizuara, përfaqëson një mundësi për Kinën për t'u pozicionuar në një vend tjetër me rëndësi strategjike me port dhe akses në tregun e BE-së. Që nga njohja e Malit të Zi nga RPK në vitin 2006, shumë zyrtarë malazezë kanë vizituar Kinën apo kanë pritur zyrtarë kinezë, kanë kryer studime dhe janë nënshkruar marrëveshje të dypalëshe që rezultuan në projekte të shumta të financuara nga kreditë kineze. Në publikun malazez, Kina përgjithësisht perceptohet si një fuqi botërore e fuqishme, por me qëllime të mira. Kjo mund të interpretohet si rezultat i qasjes jo kritike të medias ndaj raportimit mbi Kinën dhe pranisë së saj publike jo agresive në Mal të Zi. Marrëdhëniet e tyre si dhe të vendeve të tjera në BP nuk mbështeten në lidhje historike, kulturore apo identiteti. Megjithatë, 43% e malazezëve e shohin Kinën në një këndvështrim pozitiv dhe jo si një kërcënim për vendin e tyre.

Përfshirja e Kinës në projektet energjetike/infrastrukturore në Mal të Zi u bë gjatë qeverisjes kryesisht e përbërë nga Partia Demokratike e Socialistëve (DPS), e cila ka mbajtur kontakte të rregullta me zyrtarët kinezë përmes takimeve shumëpalëshe dhe dypalëshe që nga periudha e pas referendumit. Projekti më i dukshëm është seksioni i parë i autostradës Bar-Boljare, i cili është një hap kyç në afrimin e Malit të Zi me rrjetin trans-evropian të transportit. Marrëveshja e kredisë ka shkaktuar një sërë polemikash për shkak të mungesës së transparencës të marrëveshjes së huas, si dhe procesit të ndërtimit, që duke u përballur me çështjen e korrupsionit të lartë, OJQ-të e lidhin ish-zyrtarë të qeverisë. Por përveç autostradës, ka edhe projekte të tjera energjetike dhe infrastrukturore (jo)transparente.

Thellimi i lidhjeve vërehet edhe në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor. Kështu, Universiteti i Donja Goricës gradualisht u bë qendër e bashkëpunimit me projektet e shumta kërkimore, që u shoqërua me ndryshimet dhe programet e përbashkëta të studimit.

Dhoma e Tregtisë e Malit të Zi ka organizuar disa vizita të delegacioneve të biznesit nga Kina dhe nënshkroi disa memorandume bashkëpunimi me disa shoqata dhe qendra biznesi, me Dhomën e Tregtisë së Pekinit dhe Këshillin Kinez për Promovimin e Tregtisë Ndërkombëtare.

Zyrtarët kinezë, në daljet e tyre sporadike në media, këmbëngulin për publikun se Kina do të përmbahet në mos ndërhyrjen në çështjet politike dhe do të ruajë imazhin e një partneri ekonomik që ofron një strategji të favorshme për të gjithë palët e përfshira. Kjo kontribuon në përshtypjen se prania kineze nuk është e motivuar nga aspiratat politike apo ndërhyrje të drejtpërdrejta në punët e brendshme apo orientimit të politikës së jashtme të vendit.

Projektet kineze në Mal të Zi.

Megjithëse Kina perceptohet si një investitor i madh në Ballkan, shumica e investimeve të saj janë kredi nga bankat kineze, shpesh të kushtëzuara nga normat e interesit më të larta sesa kreditë e ofruara nga institucionet financiare perëndimore. Procedurat e kreditimit nuk kërkojnë aq shumë mbikëqyrje dhe kjo lejon që fondet e projektit të qarkullojnë jashtë kontrollit dhe Kina shpesh i jep këto kredi me kusht që të angazhojë fuqinë punëtore kineze në projektet që investon:

Prokurimi i anijeve me kontratë të drejtpërdrejtë për dy kompani shtetërore, Crnogorska dhe Barska plovdba.

Projekte të energjisë së rinovueshme në Mal të Zi, filluan që nga viti 2016 e në vazhdim, ku kompanitë shtetërore kineze shprehën interes për ndërtimin e hidrocentraleve.

Projekti i rindërtimit të urës në Durdevica Tara me një donacion kinez prej 7.05 milionë euro.

Nëpërmjet China Pacific Construction Group u mor përsipër financimi i autostradës midis Malit të Zi dhe Shqipërisë, si pjesë e autostradës Adriatiko -Joniane, por publiku nuk është në dijeni të zhvillimeve të mëtejshme në këtë çështje.

Projektin për rikonstruksionin e hekurudhës Kolashin-Kos e fitoi korporata kineze e ndërtimit (CCECC) dhe përfundoi në dhjetor 2017.

Në ndërtimin e infrastrukturës rrugore, autostradave, qeveria zgjodhi partnerët kinezë për disa nga projektet e këtij procesi. Shumë dokumente që kanë të bëjnë me planifikimin dhe ndërtimin e tyre janë të mbrojtura me konfidencialitet duke mos pasur një pasqyrë të plotë të tyre edhe sot. Parashikohet që disa prej tyre të kenë një barrë të madhe për financat publike në vitet në vijim.

Kushtëzimi i disa marrëveshjeve nga partnerët kinezë, duke përfshirë arbitrazhin e mundshëm në Pekin në rast mosmarrëveshjeje, dhe përjashtimin nga taksat e hyrjes dhe importit në një projekt që mbështetet shumë në punësimin e fuqisë punëtore kineze, shtrën një pikëpyetje të madhe.

Frika nga skllavëria e borxhit, FMN paralajmëroi se nxitimi për të përfunduar autostradat ka të ngjarë të rrezikojë qëndrueshmërinë fiskale të Malit të Zi, kjo

e rendit atë si një nga tetë vendet me rrezik të lartë, së bashku me Xhibutin, Maldivë, Laos, Mongoli, Taxhikistan, Kirgistan dhe Pakistan.

Në fund të marsit 2021, BE shprehu gatishmërinë e saj për të ndihmuar Malin e Zi për të gjetur një zgjidhje për të shlyer borxhin. Në korrik 2021, u zbatua një marrëveshje mbrojtëse me partnerët perëndimorë (dy banka amerikane dhe një franceze) dhe norma e interesit u ul nga 2% në 0.88%, dhe kësti i parë prej 29 milionë euro u kthye në Exim Bank të Kinës.

Investimet dhe tregtia, në Mal të Zi, pjesa e pjesëmarrjes së kapitalit nga vendet me regjime autoritare hibride në investimet e huaja direkte është rritur ndjeshëm në shtatë vitet e fundit. Edhe pse politika e orientimit properëndimor të shtetit u shpall publikisht në atë periudhë, marrëdhëniet ekonomike me vendet e huaja vareshin kryesisht nga shtetet që nuk i përkisnin atij sistemi vlerash. Nga 2006 deri në 2019, investimet kineze në Mal të Zi arritën në rreth 10 milionë euro. Por rezulton se vetëm në vitin 2020, Kina investoi 10 herë më shumë para sesa në të gjithë dekadën e mëparshme. Ajo ende nuk është një investitor i madh në Mal të Zi, por si një huadhënës dhe kontraktues i madh merr pjesë dukshëm në bilancin e tregtisë së jashtme.

Kina ishte partneri i dytë tregtar më i madh i Malit të Zi kur bëhet fjalë për importet në vitin 2021, pas Serbisë. Importet totale në vitin 2021 arritën në 2.5 miliardë euro, që do të thotë se 10% e mallrave të importuara në vend vinin nga Kina. Sipas të dhënave të marra nga DFC nga Regjistri Qendror i Subjekteve të Biznesit, janë 208 kompani aktive të themeluara nga shtetas kinezë, gjë që është një rritje në krahasim me mars 2021, kur numri ishte 179.

Kina dhe turizmi, që nga viti 2008, janë realizuar vazhdimisht aktivitete promovuese në tregun e emetimit të RPK. Dhoma e Tregtisë e Malit të Zi merr pjesë rregullisht në seminare dhe forume për të promovuar vendin, për të shkëmbyer përvoja, përmes paraqitjeve dhe artikujve në media, si dhe përmes një fushatave *online*.

Që nga fillimi i marrëdhënieve diplomatike kino-malazeze në vitin 2006, të dy vendet kanë nënshkruar gjithsej 17 marrëveshje bashkëpunimi dhe memorandume mirëkuptimi. Fushat e bashkëpunimit të formalizuara përfshijnë diplomën, kulturën, arsimin, infrastrukturën, shëndetësinë dhe bujqësinë. Edhe pse Kina është një fuqi globale, ndikimi i saj politik në Mal të Zi është i kufizuar për momentin, kryesisht për shkak të potencialit të vogël të ekonomisë malazeze, anëtarësimit në NATO dhe orientimit të qytetarëve drejt BE-së.

PËRFUNDIME

Përpyekjet e Partisë Komuniste për të ndërtuar një mur izolimi rreth Kinës, duke krijuar një perceptim që ndryshon në mënyrë drastike nga versioni i ngjarjeve në pjesë të tjera të botës, bazohen në sinergjinë e mediave shtetërore, rrjeteve sociale dhe censurës.

Rritja globale e Kinës paraqet një sfidë serioze për SHBA-të, BE-në dhe disa qeveri evropiane. Kjo ka bërë që ato të kenë afruar pozicionet e tyre ndaj veprimeve të Kinës dhe kanë filluar të kuptojnë se bashkëpunimi dhe partneriteti mes aleatëve janë çelësi për të përballuar sfidat e paraqitura nga ajo. Interesat e Kinës variojnë nga sigurimi i prosperitetit ekonomik të qëndrueshëm drejt Perëndimit, përmes projekteve të tilla si Iniciativa Brez dhe Rrugë; pozicionimin e Kinës në Evropë dhe Amerikë dhe përpjekjen për të riformëzuar rendin aktual botëror në atë që do të përshtatet me interesat dhe qëllimet strategjike të Kinës.

Kina ka shfrytëzuar me mjeshhtëri vakumin politik në Ballkan, duke forcuar praninë e saj në rajon. Drejtimi kryesor i ndikimit të Pekinit në vendet e EJ është pritshmëria që Kina mund të ndihmojë rajonin të përmirësojë infrastrukturën e tij, të forcimin ekonomik dhe kështu të arrijë Evropën e zhvilluar. Ballkani është një gur themeli dhe një urë për zgjerimin e linjave të investimeve dhe kredive kineze dhe vendosjen e pranisë ekonomike në Evropë.

Në thelb, Pekini nuk është kundër integritetit në BE të vendeve të BP, por ndikimi i tij padyshim që ngadalëson demokratizimin e rajonit. Që nga fillimi i pandemisë së Covid 19, BE është fokusuar në mënyrë të konsiderueshme ndaj ndikimit kinez në shtetet anëtare, por edhe për vendet candidate, duke dhënë disa rezultate, veçanërisht tek vendet anëtare.

Pavarësisht pranisë së konsiderueshme ekonomike, ndikimi aktual i Kinës është i kufizuar dhe pa ndikim të fortë politik. Pushtimi Ukrainës e ndërlikon më tej veprimin kinez në rajon. Megjithatë Kina mbështet një rend botëror të bazuar në rregullat e respektimit të sovranitetit dhe integritetit territorial, ajo ende nuk ka bërë një zgjedhje të qartë mbi këtë luftë.

Ndryshimet gjeopolitike në Ballkan i kanë nxitur vendet e rajonit të rforcojnë lidhjet e sigurisë me dhe mbështetjen e tyre tek Uashingtoni dhe NATO si garantues të sigurisë. Qëndrimet negative ndaj Rusisë kanë rritur gjithashtu skepticizmin ndaj Kinës. Përveç kësaj, ajo po humb ngadalë imazhin e saj si një shpëtimtare ekonomike në vende si Greqia dhe nuk ka ndikim të rëndësishëm në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut. Bi&H dhe Serbia vazhdojnë të jenë aktualisht bastione të rëndësishme kineze në Evropë.

REKOMANDIME

Një prani në rritje e BE-së në BP do të forconte më tej rolin dhe ndikimin e saj. Kjo vlen për të gjitha vendet e rajonit, të cilat po kalojnë një fazë shumë të ndjeshme të zhvillimit demokratik të shoqëruar me paqëndrueshmëri të brendshme politike dhe thellim të ndarjeve fetare dhe etnike, duke i bërë ato disi të ndjeshme ndaj ndikimit të huaj. Kombinimi i instrumenteve politike dhe ekonomike të ndihmës në rrugën e integritit evropian, por edhe konfirmimi pa mëdyshje i perspektivës së anëtarësimit në rast të përmbushjes së të gjitha kushteve, do të forconte më tej autoritetin e BE-së dhe do të dërgonte një mesazh të qartë për vendet e BP. Nuk do të lihet në ndikimin e palëve të treta që duan të distancojnë ato nga partnerët dhe aleatët perëndimorë dhe të inkurajojnë procese në kundërshtim me vlerat e komunitetit evropian.

Hendeku i zhvillimit midis vendeve të rajonit dhe BE-së tregon nevojën për rritjen e angazhimit të BE dhe SHBA në luftimin e ndikimit kinez. Duke qenë se rritja e pranisë së Kinës në rajon bazohet kryesisht në bashkëpunimin ekonomik, përmes aspektit të fuqisë së butë apo të kulturës, atëherë BE përmes iniciativave të tilla me objektiv planet e investimeve në energji dhe infrastrukturë, si dhe mbështetje për mediat në BP.

Në këtë drejtim, duhet të ofrohet mbështetje shtesë për të forcuar kapacitetin e mediave për të vlerësuar apo prodhuar materiale dhe për të publikuar informacione që do të adresojnë në mënyrë kritike faktorët e huaj, interesat dhe aktivitetet e të cilëve nuk janë plotësuese me strategjinë, interesat dhe synimet pro të pretenduara të BP.

Qeveritë, si dhe të gjitha institucionet dhe organet e tjera shtetërore në të ardhmen, duhet të vlerësojnë me kujdes hyrjen e kapitalit të huaj në vendet e BP duke pasur parasysh jo vetëm interesat kombëtare të çdo vendi dhe ato rajonale, angazhimet strategjike dhe synimet në përputhje me zhvillimin ekonomik, por edhe standardet, rregullat dhe politikat e BE-së dhe NATO-s. Duke pasur parasysh faktin se regjimet autoritare dhe hibride po kërkojnë të investojnë gjithnjë e më shumë në rajon, është e nevojshme të merren masa për të ndaluar dominimin e kapitalit të tyre që mund të ndikojë negativisht në politikën e jashtme dhe funksionimin e shtetit.

Partnerët e biznesit në vendet e BP dhe ata kinezë duhet të angazhohen për respektimin e rreptë të standardeve, procedurave dhe legjislacionit të BE-së në zbatimin e të gjitha investimeve dhe projekteve të huaja.

Kritika e vazhdueshme e BE-së ndaj vendeve të BP për tendencën e tyre për të hyrë në marrëveshje të ndryshme me Kinën pa masa konkrete, duhet mbajtur gjithmonë në konsideratë prej tyre. BE-ja duhet të kombinojë

instrumentet politike dhe ekonomike të mbështetjes, sidomos nëpërmjet grandeve ekonomike, duke kundërshtuar përpjekjet e palëve të treta, duke e demonstruar angazhimin për të luajtur një rol kyç gjeopolitik në fqinjësinë e saj të afërt.

BURIME TË SHFRYTËZUARA

1. Cooperation between China and CEEC <http://www.china-ceec.org/eng/>
2. Between East and West, Democracy, Disinformation and Geopolitics in Central and SEE, NDI, <https://www.ndi.org/sites/default/filesREAPPS2021researchpublicversion.pdf>
3. “21st CA, Freedom House”, <https://www.refworld.org/docid/4a6d62352.html>
4. Bill Gertz, Treachery: “How America’s Friends and Foes Are Secretly Arming Our Enemies”
5. Evan S. Medeiros, “China’s Foreign Policy Outlook”, <https://www.jstor.org/stable/10.7249>
6. Marjan Svetličić, “China in the WE and its ER with Slovenia”, <https://www.fdv.uni-lj.si/>
7. Milica Kovačević, “Podsticaj ekonomskom razvoju ili put u zavisnost?”, <https://atlantskainicijativa.org/>
8. Dragan Koprivica, “Neophodna nova politika privlačenja stranih investicija”, <https://www.cdtmn.org/>
9. Biljana Matijašević, Raste kineski uticaj u CGori”, <https://www.vijesti.me/vijesti/ekonomija/>
10. Anderson, Kym and Strutt, Anna, “The Changing Geography of World Trade, Projections to 2030”, <https://www.gtap.agecon.purdue.edu/resources/download/5232.pdf>
11. Joint Communication to the European Parliament and the Council, “Elements for a new EU strategy on China”, https://eeas.europa.eu/archives/docs/china/docs/joint_china.pdf
12. Sophie Beach, Confucius Institutes and Academic Freedom, China Digital Times, <https://chinadigitaltimes.net/2017/05/nas-confucius-institutes-jeopardize-academic-freedom/>
13. State-owned enterprises, <https://www.economist.com/china/2012/10/06/the-state-advances>

14. <https://foreignpolicy.com/2021/07/07/china-pla-military-bases-kiribati-uae-cambodia-tanzania-djibouti-indo-pacific-ports-airfields>
15. Public debt went up in Montenegro, <https://countryeconomy.com/national-debt/montenegro>
16. Balkan Insight, <https://china.balkaninsight.com/>
17. World Report 2021: China, Human Rights Watch,
18. <https://www.hrw.org/world-report/2021/country-chapters/china-and-tibet>

KONFLIKTI I ARMATOSUR DHE NDIKIMI I TIJ NË MJEDISIN E SIGURISË

Gjeneral brigade (R) Msc. Muhamet BUÇPAPA
Shef Grupi në IKSHU

Trajtesë e shkurtuar

Ky studim është një përpjekje për të hedhur sado pak dritë mbi një fenomen që ka impakt të jashtëzakonshëm mbi mjedisin e sigurisë në tërësi dhe zhvillimet social-ekonomike të shoqërisë njerëzore në veçanti, dhe në mënyrë më specifike, mbi marrëdhëniet ndërshtetërore dhe arkitekturën e sigurisë në rang global.

Për të përforcuar sado pak këtë konstatim duhet t'i referohemi konfliktit të tanishëm Rusi - Ukrainë dhe impaktit të tij aq të ndjeshëm në planin gjeopolitik, implikimet në fushën ekonomiko-financiare, zinxhirin ushqimor e deri te rreziku i përshkallëzimit të tij në një konflikt NATO - Rusi, e aq më keq në një përplasje bërthamore mes këtyre dy të fundit apo edhe më gjerë.

Kryesisht për trajtimin e kësaj çështje të një rëndësie të veçantë dhe aktuale janë studiuar dhe analizuar veçanërisht konfliktet pas dy luftërave botërore, pas rënies së Murit të Berlinit dhe kalimit të rendit Botëror nga dy polar në një polar, si dhe përpjekjet e fuqive të mëdha sot për të ndryshuar këtë strukturë nëpërmjet rritjes dhe ashpërsimit të konkurrencës së tyre në nivel strategjik, si dhe shkaqet, pasojat dhe implikimet e mjedisit të sigurisë rajonale, euroatlantike e globale sot e në të ardhmen.

Kjo trajtesë pasuron në mënyrë modeste, analizën mbi konfliktin e armatosur dhe impaktin e gjithanshëm të tij mbi zhvillimet shoqërore në tërësi dhe

marrëdhëniet ndërkombëtare në veçanti, si dhe rrugët apo mundësitë për shmangien e tyre, mbështetur në ligjet ndërkombëtare dhe marrëveshjet një apo shumëpalësh, nëpërmjet dialogut, bashkëpunimit dhe zgjidhjes së papajtueshmërive me mënyra e me mjete paqësore.

Fjalët kyçe: konflikt i armatosur, mjedis i sigurisë, NATO, Rusi, Ukrainë, marrëveshje, dialog.

HYRJE

Ky punim ka si qëllim të sjellë në vëmendje dhe të prezantojë një realitet të lënë pas dore për një periudhë pak a shumë të qetë të mjedisit të sigurisë i shoqëruar edhe nga relaksimi i marrëdhënieve lindje - perëndim apo NATO - Rusi, duke menduar se konfliktet e armatosura ishin një tematikë apo çështje e tejkaluar dhe pa ndikim të madh për mjedisin e sigurisë, veçmas për mentalitetin euro-perëndimor e platformat paqësore të zgjidhjes së mospajtimeve problematike të marrëdhënieve midis vendeve, shteteve apo kombeve të ndryshme.

Objekti i kësaj teme është të sjellim edhe njëherë në vëmendje para aktorëve vendimmarrës faktin se konfliktet e armatosura janë një realitet i kohës dhe faktorët me efekte shkatërrimtare të mjedisit të sigurisë, mjafton t'i referohemi konfliktit të fundit, Rusi – Ukrainë, por edhe i dhjetëra konfliktesh të tjera të shoqëruara edhe nga potencialet që mbartin sot konfliktet e ngrira anë e kënd globit, duke përfshirë edhe ato bërthamore me pasoja rrënuese mbi mjedisin tonë të sigurisë euroatlantike, por edhe më gjerë në rang global.

Mendoj se ky studim do të jetë edhe një nxitje për lidhshirëni ushtarak, për të pasur një qasje më reale ndaj asaj që mund të jetë vendimtare në ndalimin apo minimizimin e konflikteve, njëkohësisht edhe në dekurajimin apo zmbarsjen e aktorëve me tendencë apo burim konflikti.

1. KONFLIKTI I ARMATOSUR SI SJELLJE SPECIFIKE E SHOQËRISË NJERËZORE

Një nga sjelljet më specifike të shoqërive njerëzore që nga fillimet e krijimit e deri në ditët e sotme moderne ka qenë përplasja midis grupeve, fraksioneve, shteteve apo kombeve të ndryshme për territore, burime jetësore, pushtet, ndikim, imponim, influencë, ideologji apo botëkuptime të ndryshme etj. Tipar i veçantë i kësaj sjellje specifike që ka përcjellë ecejaket e ndryshimeve në tërësi, por edhe zhvillime të papritura dhe drastike jo rrallë herë të jetës njerëzore dhe mjedisit të sigurisë, kanë qenë veçanërisht përplasjet apo konfliktet e armatosura mes palëve në konflikt, rezultatet e të cilave janë shoqëruar me ndryshime në rendet shoqërore, krijimin e shteteve të reja, tjetërsim dhe ndryshime të autorësisë së territoreve, shkatërrim të pronës, e

ajo që është më drastikja humbje jetësh njerëzore e asimilim të popujve të vegjël apo pakicave kombëtare, deri te gjenocidi dhe krimet e rënda kundër njerëzimit.

Ngjarje të tilla makabre për fat të keq nuk kursyen as jetët njerëzore në konfliktin e fundit të shkaktuar nga sulmi i paprovokuar dhe pajustificuar rus mbi Ukrainën. Institucionet e pavarura perëndimore verifikuan dhe zbuluan varreza masive në qytetin Bucha të Ukrainës, nga ku dalin në pah krimet çnjerëzore të shkaktuara nga forcat ruse në përpjekjet e dështuara për të kapur kryeqytetin Kiev. Fakte tashmë të konfirmuara nga shumë burime sjellin një shifër rishtuese të humbjes së jetëve gjatë luftimeve gjashtëmujore në qytetin Bakhmut, ku shifra prej 20000 humbje jete vetëm nga grupi paramilitarë Wagner tejkalon humbjet njerëzore të ish-Bashkimit Sovjetik në konfliktin dhjetëvjeçar në vitet '70-80 të shekullit të kaluar në Afganistan. Ngjarje të tilla tronditëse po shoqërojnë sot konfliktet mes fraksioneve apo grupeve të ndryshme ndërluftuese si në Lindjen e Mesme, Gadishullin Arabik, Afrikën ndërsahariane, Mali, Sudani e Jugut etj.

Siç vërehet edhe më lart, ashtu si shumë përkufizime që lidhen me aspektet e ndryshme të zhvillimeve shoqërore, edhe përkufizimi për konfliktin e armatosur ka qasjet e veta të shumanshme. Më poshtë po parashtrojmë një nga përkufizimet më të përgjithshme, në lidhje me konfliktin e armatosur:

“Një konflikt i armatosur është një papajtueshmëri e kontestuar që ka të bëjë me qeverinë dhe/ose territorin ku përdorimi i forcës së armatosur midis dy palëve, nga të cilat të paktën një është qeveria e një shteti, rezulton në të paktën 25 vdekje të lidhura me betejat në një vit kalendarik. Koment: “Konflikti i armatosur” referohet gjithashtu si “konflikt me bazë shteti”, në krahasim me ‘konfliktin jo shtetëror’, në të cilin asnjë nga palët ndërluftuese nuk është qeveri.”¹

Një konflikt i armatosur ekziston sa herë që ka një përdorim të forcës së armatosur midis shteteve ose dhunë të armatosur të zgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose midis grupeve të tilla brenda një shteti, shembujt janë nga më të ndryshmit por po t'i referohemi realitetit, mund të analizojmë më në thellësi atë çfarë po ndodh sot në Ukrainë apo konfliktin mes fraksioneve në Sudanin e Jugut etj.

Debatet dhe polemikat jo vetëm në të kaluarën, por edhe sot e kësaj dite janë të pranishme rreth mendimit akademik e intelektual mbi raportet dhe marrëdhënien midis dhunës, paqes dhe mjedisit të sigurisë apo sigurisë në tërësinë e saj. Në këtë kontekst, konflikti i armatosur përmbledh pak a shumë në një sfond objektivat politike, operacionet luftarake dhe pjesëmarrjen e

¹ <http://www.pcr.uu.se/research/ucdp/definitions>.

qeverive, por nuk përjashtohen as aktorët e tjerë jo qeveritarë, fraksionet e ndryshme të armatosura, grupet terroriste, grupet e ekstremit të dhunshëm, sektet e ndryshme fetare, kartelet e drogës etj. Nisur nga rrethana dhe kontekst tjetër në ligjin për të drejtën humanitare ndërkombëtare, konflikti i armatosur shprehet thjesht në aspektin e përfaqësimit ndërkombëtar dhe jo ndërkombëtar, duke marrë në konsideratë aktorët relevantë pjesëmarrës në konflikt, i cili vlerësohet si më poshtë.

E drejta ndërkombëtare humanitare dallon dy lloje të konflikteve të armatosura, përkatësisht:

- konfliktet e armatosura ndërkombëtare, që përfshihen apo përballen dy ose më shumë shtete, dhe
- konfliktet e armatosura jo ndërkombëtare, ndërmjet forcave qeveritare dhe grupeve të armatosura joqeveritare, ose vetëm ndërmjet grupeve të tilla.²

Siç jemi përpjekur të shpjegojmë edhe më lart, në terma juridikë gama e gjerë konflikteve vlerësohet më i kufizuar dhe specifik. Në varësi të aktorëve të përfshirë në konflikt apo faktorëve dhe rrethanave që kanë sjellë atë dhe atyre që sado pak do të ndikonin në parandalimin apo zgjidhjen e tij, ligjërisht në dokumentin e lartpërmendur cilësohet si vijon:

*“Nga pikëpamja juridike, nuk ekziston asnjë lloj tjetër konflikti i armatosur. Megjithatë është e rëndësishme të nënvizoni se një situatë mund të evoluojë nga një lloj konflikti i armatosur në tjetrin, pavarësisht fakteve që mbizotërojnë në një moment të caktuar”.*³

Në kohët e sotme moderne ku mundësitë, dija, eksperiencia dhe mjetet diplomatike mund të jenë të mjaftueshme për të parandaluar dhe zgjidhur çdo keqkuptim, mosmarrëveshje apo konflikt, ekzistojnë mendje të errëta të etura për pushtet, pasuri, influencë apo ideologji që mund ta çojnë botën e qytetëruar drejt shkatërrimit pa kthim. Harxhohen miliarda për të vrarë e shkatërruar, kur mund të kishin dalë nga varfëria miliarda njerëz, nëse ato përdoren për mirëqenie, arsim, shëndetësi dhe zhvillim të infrastrukturës së vendeve në gjithë globin, apo financiar rritja e prodhimit bujqësor, programe për të luftuar efektet shkatërruese të ndryshimeve klimaterike, për parandalimin apo përballje me pandemitë e ndryshme, apo zhvillimeve teknologjike në fushë e shëndetësisë arsimit, pra në të mirë të njerëzimit e progresit shoqëror në tërësinë e tij.

Po t'i referohemi historisë, do të shohim nga afër pasojat e paimagjinueshme që sjellin konfliktet e armatosura. Për shembull lufta e SHBA-ve në Irak, ku

² Ligji për të drejtën humanitare ndërkombëtare, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit Kuq (ICRC), mars 2008, faqe 1.

³ Po aty.

mund të vlerësojmë shpenzimet marramendëse, të cilat sipas Harvard School ato arrijnë shifrën 3 trilion dollarë⁴, pa evidentuar këtu post-trajtimet e veteranëve nga kjo luftë. Po ta krahasojmë me një nga vendet më të zhvilluara të kontinentit siç është Italia, kjo shumë është e barabartë me GDP e saj që në vitin 2022 që kap vlerën prej 3.1 trilion dollarë⁵.

Një rast tjetër aktual studimi i përafërt, pa pritur për një analizë të tillë përfundimtare, është konflikti Rusi-Ukrainë, ku shpenzimet ditore të luftës vetëm nga pala ruse arrijnë në rreth 500 milionë dollarë në ditë⁶. Kjo shumë do të vlente për të mbështetur afërsisht për 5 shekuj rusët me sëmundje të veçanta ose harxhimet e vlerësuara të shpenzuara për dy muajt e parë të luftës, do të mjaftonin për mirëmbajtjen e kryeqytetit Moskës, për 9 apo 1 nga qytetet më të rëndësishme të Federatës Ruse, St. Petersburg për 31 vite, ose 2600 dollarë për person të një popullsie prej 146 milionë që ka Rusia sot⁷.

Këto vlera, po të konvertohen apo krahasohen me investimet në rajonin tonë, rruga e Kombit, një nga projektet më të mëdha infrastrukturore në rajon, ka kushtuar sa dy ditë shpenzime për luftën atje, apo po ta krahasojmë me vlerën që pritet të ndërtohet në infrastrukturë nga Maqedonia e Veriut, shpenzimet janë rreth 3 ditë lufte.

Nga më sipër, po sjellim në vëmendje se në botë janë sot sipas vlerësimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara një e katërta e popullsisë prej rreth 1.8 miliardë njerëz në varfëri me nën 3 dollarë në ditë për person në vitin 2022, me një parashikim për një rritje vjetore të kësaj shifre me rreth 46 milionë⁸.

Konfliktet e armatosura çojnë direkt në humbjen e kohezionit të shteteve apo koalicioneve të ndryshme apo kanë efekte të kundërta me pasoja të rënda dhe të paparashikueshme për të ardhmen e shumë vendeve. Konfliktet e armatosura e veçmas ato me qasje apo ngjyime nacionaliste me njëanshmëri edhe etnike në ndonjë rast, ishin disa nga shkaqet kryesore të shkatërrimit e kohezionit shtetëror të ish-Federatës Jugosllave. Konflikti i fundit në Ukrainë bëri efekt të kundërt nga çfarë Putini kishte llogaritur. Sipas parashikimeve të tij, Ukraina do të shpërbëhej dhe NATO dhe Perëndimi do të përçaheshin, dike çuar në shpërbërjen e kohezionit kombëtar të Ukrainës dhe atij euroatlantik e perëndimor në përgjithësi.

⁴ Harvard Kennedy Schol, [hks.harvard.edu/publication/true-cost Irak-war](https://hks.harvard.edu/publication/true-cost-Irak-war).

⁵ World Economy, GDP estimates.2022

⁶ Geneva solution. news.ukraine-stories.com/what-is-the-cost-of-war-of-russia-and-what-could-be-done-with-this-money/.

⁷ Po aty.

⁸ Human development undp.org/content/2022-global-multidimensional-poverty-index.

Duke marrë shkak nga këto përlllogaritje jo të sakta të Putinit, mund të fokusohemi te një nga pasojat e konfliktit më të madh dhe të rrezikshëm në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore, tendencat për të hapur një konflikt të ri në Ballkan, duke instrumentalizuar serbët në rajon në mënyrë të veçantë, jo vetëm në Republikën Serbska, por edhe në Veriun e Kosovës, Mal të Zi, Maqedoni etj.

Lindja dhe rënia e shtetit Islamik unifikoi kurdët në rajon, të cilët ishin forca më efektive në përmbajtjen e një situatë të paparashikueshme në hapësirat e Levantit, Siri, Irak e më gjerë, pa anashkaluar këtu kontributin e aktorëve të tjerë të përfshirë në konflikt e veçanërisht mbështetjen e SHBA-ve dhe jo vetëm, por edhe të vendeve të tjera perëndimore.

2. LLOJET E KONFLIKTIT TË ARMATOSUR DHE EVOLUIMI I NATYRËS DHE OBJEKTIT TË TIJ

Siç trajtuam edhe më lart, përcaktimi i përkufizimeve për fenomene kaq të prekshme e të rëndësishme të zhvillimeve shoqërore siç është agresioni, lufta, konfliktet e armatosura, llojet e tij etj., kërkojnë një konsensus të gjerë intelektual dhe akademik, e pse jo edhe shoqëror.

Një konflikt i armatosur ekziston sa herë që ka përdorim të forcës së armatosur ndërmjet shteteve ose dhunë të armatosur të tejzgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura, të organizuara brenda një shteti. Konflikt i armatosur jondërkombëtar, sinonim i termit “luftë civile”, karakterizohet nga lufta midis forcave të armatosura të një shteti dhe forcave të armatosura disidente ose kryengritëse.

Nëse i referohemi realitetit në ditët e sotme, kemi shembuj të shumtë nga ku mund të gjejmë referencat për t’iu afruar këtyre përkufizimeve si në aspektin teorik të trajtimit të konflikteve apo situatave kërcënuese, aq më tepër në planin real të konflikteve dhe impaktit të tyre mbi mjedisin e sigurisë.

Konflikti i armatosur që ka hyrë në gjysmën e dytë të viti të dytë në Ukrainë, është shembëlltyra më e gjetur e një konflikti ndërkombëtar në tërë përbërësit dhe komponentët e tij, bile nga disa analistë ai vlerësohet si një konflikt më i madh që ka si subjekt jo vetëm federatën Ruse e Ukrainën, por edhe aktorë të tjerë në hapësira më të gjëra dhe pjesëmarrje direkte apo indirekte të shumë aktorëve të tjerë me natyrë dhe ndikim jo vetëm rajonal, por edhe global.

Nga ky konflikt deri tani janë shkaktuar mijëra të vrarë dhe po aq të tjerë të plagosur apo zhdukur rreth 4 milion njerëz të dëbuar nga vendi dhe rreth 10 milion të afektuar. Brenda dhe jashtë vendit qindra fëmijë të vrarë dhe dëbuar dhe humbje miliarda dollarësh në ekonomi dhe infrastrukturë, një konflikt që vazhdon pa pasur një dritë jeshile për t’u përfunduar dhe shkuar drejt paqes

dhe rimëkëmbjes. Ky konflikt po karakterizohet nga një dhunë barbare, nga krime lufte siç ishin krimet në qytetin e Buças deri në prag të katastrofës në centralin atomik të Shaporishtës, apo përmbytjen në zonën e Kerhsonit për shkak të katastrofës industriale të shkaktuar nga shkatërrimi i një pjese të digës mbi lumin Dnieper në Nava Kakhova nga forcat ruse në fillim të muajit qershor. Ky akt është vlerësuar si një akt “terrorizmi ekologjik”⁹ me pasoja katastrofike për jetën e njerëzve dhe mjedisin në tërësi.

Për sa i përket konfliktit të armatosur jo ndërkombëtar, mendojmë se më afër realitetit në kontekstin e sotëm mund të përmendim konfliktin e armatosur disavjeçar në Sudanin e Jugut, një konflikt që në fakt rezultoi në luftë civile midis përkrahësve të qeverisë dhe opozitës, sot numërohen mbi 400 000 mijë viktima e mbi 4 milion; të zhvendosur dhe miliona të tjerë jetojnë në një mjedis sigurie totalisht të pasigurt dhe një e treta në varfëri ekstreme¹⁰.

Disa nga çështjet më të rëndësishme në lidhje me një konflikt të armatosur duhet t'i shohim të lidhur ngushtësisht me atë që vlerësohet në korrelacion me interesat kombëtare, të cilat duke i kategorizuar në tre nivele të ashtuquajtura interesa kombëtare të mbijetesës, madhore dhe periferike, mund të themi se përcaktuese për të çuar drejt një konflikti të armatosur janë interesat kombëtare të mbijetesës, nëse ato kërcënohen haptas dhe drejtpërsëdrejti dhe më pak ato madhore dhe përjashtohen interesat kombëtare periferike si një shkak për konflikt të armatosur.

E drejta ndërkombëtare njihet së paku katër lloje të ndryshme të situatave të konfliktit dhe secila prej tyre ka norma ligjore të veçanta.¹¹

- Situatë e tensioneve dhe shqetësimeve të brendshme.
- Konflikt i armatosur ndërkombëtar.
- Luftë për çlirim kombëtar.
- Konflikt i armatosur i brendshëm.

Situatë e tensioneve dhe shqetësimeve të brendshme. I referohet situatave që nuk arrijnë në konflikt të armatosur, por përfshijnë përdorimin e forcës dhe masave të tjera represive nga një qeveri për të ruajtur ose rivendosur rregullin dhe qetësinë publike. Në situata të tilla zbatohet vetëm e drejta ndërkombëtare që merr në mbrojtje të drejtat e njeriut. Megjithatë qeveritë lejohen të kufizojnë të drejtat e njeriut në këto situata tensioni.

Konflikt i armatosur ndërkombëtar. I referohet situatave që përfshijnë dy

⁹ Scot Riffer “New explosion change everything in Ukraine Rusi- War”, Youtube 09.06.23.

¹⁰ Civil war in South Sudan, By the Center for Preventive Action, June, 2022.

¹¹ International Law and International Armed Conflicts, Mark Flaerman, September 2000, f.2.

ose më shumë shtete të angazhuara në konflikt të armatosur. Në situata të tilla vepron e drejta ndërkombëtare humanitare, veçanërisht ajo që përfshihet në katër konventat e Gjenevës dhe në Protokollin e Parë Shtesë. Mbeten gjithashtu të zbatueshme në këto situata garancitë e të drejtave njerëzore, përveç disa kufizimeve që u lejohen qeverive në situata tensionesh.

Luftë për çlirim kombëtar. I referohet konflikteve të armatosura, në të cilat “popujt luftojnë kundër sundimit kolonial, okupimit të huaj dhe regjimeve raciste, në zbatim të së drejtës për vetëvendosje”.¹² Në përgjithësi të njëjtat parashikime të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar, që merr në mbrojtje të drejtat e njeriut, zbatohen edhe në luftërat për çlirim kombëtar.

Konflikt i armatosur i brendshëm. I referohet të gjitha konflikteve të armatosura, që nuk mund të konsiderohen as si konflikte të armatosura ndërkombëtare dhe as si luftë për çlirim kombëtar që zbatojnë këtë protokoll.¹³ Në konfliktet e armatosura të brendshme zbatohet neni i përbashkët 3 i katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollin i Dytë Shtesë i vitit 1977.

Konflikti i armatosur i brendshëm dhe sovraniteti. Në qoftë se bëhet një krahasim ndërmjet konfliktit të armatosur të brendshëm dhe atij ndërkombëtar rezulton se pika e referimit që i dallon është kufiri shtetëror. Luftërat midis dy ose më shumë shteteve konsiderohen konflikte të armatosura ndërkombëtare, ndërsa përlëshjet me armë që ndodhin në territorin e një shteti të vetëm janë konflikte të armatosura jo ndërkombëtare, (të brendshme), ose siç njihen zakonisht, luftëra civile.¹⁴

Historikisht shtetet kanë hartuar pa mbarim akte që rregullojnë marrëdhëniet midis tyre, qoftë edhe në kohë luftë. Por kur bëhet fjalë për “luftë civile”, ata pretendojnë se është çështje e brendshme.

Konfliktet e armatosura jondërkombëtare, si konflikte të armatosura që ndodhin brenda territorit të një shteti, pra midis qeverisë nga njëra anë dhe grupeve të armatosura kryengritëse nga ana tjetër, ndodhin për shkaqe të ndryshme. Në rast se pjesëtarët e këtyre grupeve të armatosura bien në duart e

¹² Paragraph 1 of article 43 of Protocol provides that: “The armed forces of a Party to a conflict consist of all organized armed forces, groups and units which are under a command responsible to that Party for the conduct of its subordinates, even if that Party is represented by a government or an authority not recognized by an adverse Party. Such armed forces shall be subject to an internal disciplinary system which, inter alia, shall enforce compliance with the rules of international law applicable in armed conflict”.

¹³ Protokollin i II-të shtesë i konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jo ndërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 1

¹⁴ Hans Peter Gasser, E drejta ndërkombëtare humanitare, dhjetor 2000, f.26.

palës që është në pushtet, ata nuk gëzojnë të drejtën e statusit të robit të luftës dhe gjykojnë në bazë të së drejtës së vendit për çdo shkelje që mund të kenë kryer gjatë operacioneve të tyre të armatosura. Në mënyrë të ngjashme, në rast se një pjesëtar i forcave të armatosura bie në duart e kryengritësve, ai nuk është rob lufte.

Sovraniteti shtetëror tashmë është një çështje e debatueshme në komunitetin ndërkombëtar. Dihet rëndësia e sovranitetit shtetëror në krijimin e kushteve brenda një vendi, sipas gjykimit të qeverisë së atij vendi. Mirëpo, konfliktet e brendshme shkaktojnë po aq plagë dhe shkatërtime sa edhe konfliktet midis shteteve. Mund të thuhet se luftërat civile sjellin më shumë vuajtje se luftërat ndërkombëtare, për shkak të urrejtjes dhe egërsisë së tyre. Ideja e zbatimit të së drejtës ndërkombëtare humanitare në rast përplasje të brendshme nuk është diçka e pabazuar. Neni 3 i përbashkët i konventave të Gjenevës të vitit 1949, trajton pikërisht konfliktet e armatosura jo ndërkombëtare, po ashtu edhe protokollin i dytë shtesë i vitit 1977.

Neni 3 i përbashkët i të katër konventave të Gjenevës të vitit 1949, përfaqëson përpjekjen e parë për të vendosur rregulla që drejtonin konfliktet e armatosura jo ndërkombëtare. Ai është përshkruar si një “konventë në miniaturë”, sepse përmban standardet minimale bazë të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të zbatueshme në situatë konflikti.

Protokolli i II-të është përfundimi i përpjekjeve serioze për të përcaktuar më në detaje mbrojtjen e dhënë në konfliktet e armatosura jo ndërkombëtare. Qëllimi i tij është të zhvillojë dhe të plotësojë nenin 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës. Kur shtetet miratuan nenin 3 të përbashkët dhe Protokollin e Dytë Shtesë të konventave të Gjenevës, ata nuk parashikuan dënim penal për shkeljet. Kjo u bë ngaqë ngurronin të ndërhynin në punët e brendshme të shtetit. Në paragrafin II, të nenit I, të Protokollit të II-të shtesë të Konventave të Gjenevës, aktet e izoluar, individuale të dhunës, si dhe çrregullimet e brendshme janë përkufizuar si “tensione dhe çrregullime të brendshme” dhe janë përjashtuar nga koncepti i “konfliktit të armatosur jo ndërkombëtar”. Në këtë kontekst duhet theksuar se gjatë tensioneve dhe çrregullimeve të brendshme, fakti që qeveria mund t’i drejtohet policisë dhe forcave të tjera të brendshme të sigurisë dhe madje edhe forcave ushtarake, me qëllim që të rivendosë rendin, nuk e bën këtë situatë konflikt të armatosur të brendshëm.¹⁵

Ajo pjesë e të drejtës që merret me trajtimin e konfliktit të armatosur të brendshëm nuk i referohet konceptit të statusit të luftuesit.¹⁶

¹⁵ Protokolli i II shtesë i konventës së Gjenevës, 1949, neni 1/2.

¹⁶ Qeveritë kanë të drejtë të shtypin rebelimet kundër tyre, në konfliktin e brendshëm nuk ka status apo privilegj luftuesi.

Pjesëtarët e forcave të armatosura disidente nuk e gëzojnë statusin e robit të luftës. Në të njëjtën mënyrë, në qoftë se një pjesëtar i forcave qeveritare kapet nga rebelët, as ai nuk është rob lufte. Në qoftë se rebelët kontrollojnë një zonë gjysmë autonome, duke pasur sistemin e tyre ligjor dhe gjykatat, ata mundën padyshim të gjykojnë personat e kapur për çdo veprim të tyre.

Në konfliktin e armatosur jo ndërkombëtar personat që nuk marrin pjesë në veprime ushtarake nuk mund të sulmohen. Ata duhet të mbrohen dhe të respektohen.¹⁷ Ndalohet që të bëhet dallim për shkak të racës, ngjyrës, besimit, seksit, pasurisë, ose ndonjë kriter tjetër të ngjashëm.

Të ndaluarit në konfliktin e armatosur të brendshëm nuk gëzojnë statusin e robit të luftës. Trajtimi i të ndaluarve rregullohet nga ligji i brendshëm i vendit të ndalimit dhe në parimet humanitare bazë.

Të ndaluarit në konfliktin e armatosur të brendshëm duhen trajtuar në çdo rrethanë në mënyrë njerëzore, pa asnjë dallim.¹⁸ Për sa i përket këtyre personave ndalohet: dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike; ndëshkimet kolektive; marrja e pengjeve; aktet e terrorizmit; shkeljet e dinjitetit personal, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi poshtërues dhe degradues; përdhunimi, sterilizimi, ose shtatzënia e detyruar; skllavërimi; dhënia e dënimeve dhe ekzekutimet e tyre pa asnjë gjykim të përshtatshëm nga një gjykatë e rregullt. Askush nuk mund të dënohet për një shkelje, përveçse mbi bazë të përgjegjësisë penale personale. Dënimi me vdekje nuk mund të jepet ndaj një të akuzuari, i cili nuk ka mbushur moshën 18- vjeç në kohën e kryerjes së krimit dhe nuk mund të zbatohet ndaj grave shtatzëna, ose me fëmijë në gji.¹⁹

Ndaj civilëve dhe ushtarakëve të ndaluar, për arsye që lidhen me konfliktin e armatosur zbatohen rregullat e mëposhtme:

- Të plagosurit dhe të sëmurët duhet të trajtohen.
- Të ndaluarit duhet të lejohen të marrin dërgesa individuale ose kolektive.
- Të ndaluarit duhet të sigurohen me ujë dhe ushqim, mjedise të përshtatshme për shëndetin dhe higjienën, dhe strehë nga moti dhe rreziqet e konfliktit të armatosur.
- Ata duhet të lejohen të praktikojnë besimin e tyre dhe të kenë asistencën e personelit fetar.
- Përveçse kur familjet akomodohen së bashku, gratë duhet të qëndrojnë në mjedise të ndara nga burrat dhe të mbikëqyren nga gra.

¹⁷ Protokolli i II shtesë i konventës /së Gjenevës, 1949, neni 4/1.

¹⁸ Protokolli i II-të shtesë i Konventës /së Gjenevës, 12 gusht 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jo ndërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 4.

¹⁹ Po aty, neni 6.

- Vendet e ndalimit duhet të jenë larg nga zona e luftimit dhe nëse i ekspozohen rrezikut, të ndaluarit duhet të evakohen në zona më të sigurta dhe evakuimi të jetë i sigurt.
- Të ndaluarve duhet t'iu sigurohet ekzaminim dhe trajtimi mjekësor, në përputhje me gjendjen e tyre shëndetësore.
- Të ndaluarit, kur lirohen, duhet të sigurohen, që nënkupton se nëse i dorëzohen fraksionit të gabuar kjo mund të shkaktojë vdekjen e tyre.

Konfliktet e armatosura ndërkombëtare, të brendshme apo jondërkombëtare, kanë evoluar dhe mund të themi se sot natyra e tyre nga konflikte të armatosura konvencionale qartësisht të dallueshme, sot ato janë bërë më të paqartë sidomos në interpretimin e tyre dhe aspektin e planifikimit dhe ekzekutimit, duke i transformuar ato në një lloj konflikti hibrid, duke kamufluar deri diku edhe objektin e një sulmi të armatosur, apo produktin që lind prej këtij konflikti të armatosur.

Shembujt mund të jenë lehtësisht të dallueshëm për secilin lloj, duke sjellë dy shembuj të thjeshtë për t'u kuptuar. Sulmi rus mbi Gjeorgji kishte si qëllim largimin e kësaj të fundit dhe pengimi për një kohë të gjatë të anëtarësimit të saj euroatlantik dhe rasti dytë mund të ilustruhet nga sulmi izraelit mbi Egjipt në konfliktin 7 ditor të vitit 1967.

3. KONFLIKTET E ARMATOSURA PAS LUFTËS SË FTOHTË

Ngjarjet madhore të viteve 1989-90, ishin një ndryshim epokal në rendin e ri botërorë nga bipolar në njëpolar dhe mjedisin e sigurisë në Kontinentin Evropian por jo vetëm, pasi ndikimi i saj influencoi në një konceptim krejt tjetër të mjedisit të sigurisë edhe në rang global. Këto ndryshime dhe lëvizjet e tjera në të pastajmen zhvilluan besimin se konfliktet e armatosura konvencionale nuk do të përbënin më një rrezik të drejt për drejt për sigurinë në tërësi dhe së kontradiktat dhe mospajtimet do të ishin pjesë e një agjende më të moderuar dhe se me gjithëpërfshirës, dialog dhe mirëkuptim, gjerat do të qetësoheshin dhe do të jetonim në një habitat njerëzor më miqësor dhe pa dallime të thella që çojnë drejt përplasjeve apo konflikteve siç ishim mësuar më parë.

Megjithëse një klimë mjaft optimiste kjo situatë u zbeh shpejt, krahas afrimit të NATO-s dhe Rusisë dhe krijimit të një komiteti të përbashkët dolën kontradikta dhe mosmarrëveshje të reja e për dominim dhe influence dhe Evropës si në fillimin e luftës së Parë Botërore. Fillimi i një konflikti të ri nisi nga Ballkani, përpjekjet serbe për dominim dhe nacionalizmi në rritje, dëshirat për mëvetësi u përballen mes tyre duke shkaktuar një konflikt që zgjati rreth 10- vite në Ballkan e duke lanë pas jo vetëm krijimin e shteteve të reja, por edhe pluhurin e shkatërrimit dhe të harresës për të nxjerrë mësim nga historia e konfliktet e

përgjakjet e fillim shekullit të 20-të në këto territor.

Konflikti trevjeçar (1992-95) apo Lufta e Bosnjës dhe më vonë ajo e Kosovës (1998-99) pa u ndalur në konfliktet në Slloveni dhe Kroaci, të cilat ishin të një intensiteti më të ulët dhe me humbje jetësh njerëzore apo dëme më të vogla, dy konfliktet e tjera u karakterizua nga luftime të ashpra, granatime pa dallim të qyteteve dhe qendrave të tjera të banimit, spastrim etnik, vrasje e përdhunime masive sistematike, kryesisht të kryera nga forcat serbe. Vlerësimet sugjerojnë se rreth 100.000 njerëz u vranë gjatë luftës. Mbi 2.2 milionë njerëz u zhvendosën, duke e bërë atë, në atë kohë, konfliktin më shkatërrues në Evropë që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Për më tepër, rreth 12,000-50,000 gra u përdhunuan, kryesisht të kryera nga forcat serbe, ku shumica e viktimave ishin gra boshnjake.²⁰ Po ashtu konflikti la mbi 15000 të vrarë në Kosovë, mbi 20000 gra dhe vajza të përdhunuar, rreth 1500 fëmijë të vrarë e mbi 5000 të zhdukur edhe sot e kësaj dite, të gjitha të shkaktuara nga forcat paramilitare, policia dhe ushtria e udhëhequr nga satrapi i Ballkanit Slllobodan Millosheviçi.

Sot po përrjetojmë një konflikt tjetër të armatosur në përmasat çnjerëzore të fabrikuar dhe aplikuar nga një satrap tjetër siç është Vladimir Putin, me rreth gjysmë milionë humbje jetësh njerëzore, infrastrukturë kritike të rrënuar deri tek aplikimi i gjenocidi, siç ishte rasti i qytetit Bucha tashmë një fantazmë apo rreziku i katastrofave bërthamore deri tek ajo industrial me shkatërrimin e digës mbi lumin Dnieper²¹.

Përveç analizës së konflikteve në territorin evropian që janë më të ndjeshme, për ne dhe mjedisin tonë të sigurisë, periudha pas luftës së ftohte është karakterizuar nga konflikte të përgjakshme dhe humbje të jashtëzakonshme jetë njerëzore edhe në kontinentet e tjera, veçmas atë Afrikan e Aziatik, pa lënë pas dore konfliktet në Amerikën Latine e sidomos konfliktet e brendshme. Lufta në Irak, Afganistan, Siri, Konflikti i Armatosur i nxitur nga ISIS në rajonin e Levantit, konflikti Izraelit - Palestinës, Jemen, Mali, Uganda, Nogorna - Karabak mes Azerbajxhanit dhe Armenisë e së fundmi ai në Sudanin e Jugut. Ruajtja e një mjedisi të sigurt dhe promovimi i paqes së qëndrueshme vazhdon të mbetet një nga dilemat më të mëdha dhe sfiduese të shoqërisë njerëzore në ditët e sotme. Që nga rënia e Murit të Berlinit në vitin 1989, sipas UCDP (Uppsala Conflict Data Program), një nga forumet më prestigjioze në çështjet e sigurisë, janë regjistruar 144 konflikte të armatosura në mbi 80 rajone, në gjithë Globin, ku jo më pak se 47 prej tyre, për nga shkalla e angazhimit dhe pasojave, vlerësohen në përmasat e luftërave. Vetëm në 10 vitet e fundit numri i konflikteve aktive është rritur nga 31 në 37, ndërsa janë realizuar

²⁰ https://sq.wikipedia.org/wiki/Lufta_e_Bosnj%C3%ABs

²¹ Scot Rffer: "New explosion change everything in Ukraine- Russia War", you toob.09.0623.

vetëm 6 marrëveshje për ndërprerje konflikti. Dukuria tjetër lidhet me pasojat, veçanërisht numri i viktimave të konflikteve të armatosura, që nga viti 1989 i ka kaluar të 6 milionë persona.

Konflikti i armatosur në Ukrainë i shkaktuar nga agresioni i paprovokuar dhe pajustificuar rus, analizuar jo vetëm në aspektin gjeografik, ku ndajmë përkatësinë Evropiane relativisht jo shumë i largët për ne, por edhe lidhjet tradicionale të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor e veçanërisht Serbisë dhe specifikisht Republika Serbska, e bëjnë konfliktin shumë më të rrezikshëm dhe sjellin vatrën e tij shumë pranë nesh duke çuar rajonin në një përballje apo përplasje me sfond gjeopolitik, shtuar këtu edhe krizat nga rajoni i Lindjes së Mesme, Afrika nënsaharjane, Iraku, Afganistan e tjerë, rrisin fluksin dhe intensitetin e rrezeve të drejtpërdrejta e do të përkeqësojnë akoma ma shumë mjedisin e sigurisë duke imponuar njëkohësisht kërkesa për burime dhe energji shtesë për ruajtjen edhe mirëmbajtjen tij në nivele të pranueshme dhe minimizimin e përkeqësimit të tij jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe euroatlantik si pjesë integrale e këtij mjedisi si në rrafshin gjeografik ashtu edhe në kontekstin gjeopolitik.

PËRFUNDIME

E drejta ndërkombëtare humanitare e njohur ndryshe si e drejta e luftës, ose e drejta e konfliktit të armatosur nuk merret me çështjen e ligjshmërisë së luftës. Ajo zbatohet në konflikte të armatosura, pa marrë parasysh nëse një luftë është e përligjur, ose jo dhe pavarësisht faktit në se shteti ka të drejtë apo jo të përdorë forcën.

Konfliktet e armatosura përbëjnë sot një nga kërcënimet më reale dhe të drejtpërdrejta të mjedisit të sigurisë, dhe sot krahas shumë shkaqeve apo kontradiktave të njohura si tradicionale, kanë në thelb konkurrencën strategjike të fuqive të mëdha botërore për ndikim, influencë dhe ndryshim të rendit botëror të bazuar në ligje dhe rregulla.

E drejta ndërkombëtare humanitare zbatohet vetëm në konflikt të armatosur ndërkombëtar, ose të brendshëm dhe nuk merret me situatat shqetësimeve e tensioneve të brendshme, të cilat nuk arrijnë deri në konflikt të armatosur.

Duke qenë se lufta është një mundësi reale, pavarësisht ndalimit të përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, nga Karta e Kombeve të Bashkuara, ekziston nevoja e zhvillimit të normave të së drejtës së luftës, me qëllim që të shmangen mizoritë dhe vuajtjet e panevojshme. Pa kufizime ligjore, lufta mund të degjenerojë në barbarizma absolute, që shkaktojnë vështirësi të mëdha në rindërtimin e paqes ndërmjet palëve, pas përfundimit të luftës.

BURIME TË SHFRYTËZUARA

1. Tim MARSHALL The Power of Geography 2021 ISBN978-1-78396-538-0
2. Saul Bernard KOHEN, Geopolitics: "The geography of international relations".
3. Yuval Noa HARARI "21 Lessons for the 21-st Century", Vintage books, 2019 ISBN: 9781784708283.
4. Johan R ALLEN; Frederik Ben HODGHES and Julian LINDEN " Future war and the defence of Europe", 8 tetor 2020
5. Protokoli II Shtesë i konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949
6. https://sq.wikipedia.org/wiki/Lufta_e_Bosnj%C3%ABs
7. Scot Rffer: "New explosion change everything in Ukraine- Russia war
8. Protokoli i II Shtesë i konventës së Gjenevës, 1949.
9. Statute of the International Criminal Court, done at Rome, on 17 July 1998.
10. Hans Peter Gasser, E drejta Ndërkombëtare Humanitare, Dhjetor 2000.
11. Civil war in South sudan, By the Center for Preventive Action, June, 2022.
12. International Law and International Armed Conflicts, Mark Flaerman, September 2000.
13. Ligji për të drejtën humanitare ndërkombëtare, Komiteti ndërkombëtar i kryqit kuq (ICRC).
14. Harvard Kennedy Schol, hks.havard.edu/publication/true-cost Irak-war.
15. World Economy, GDP estimates, 2022.
16. Geneva solution. news/ukraine-stories/what is the cost of war of russia end what could be done with this maney.
17. Human development undp.org/content/2022-global-multidimensional-poverty-index.

FAKTORËT GJEOPOLITIKË: GABIMET E MUNDSHME NË ANALIZË

Kolonel (R) Zeno JAHAJ

Trajtesë e shkurtuar.

Njeriu mbetet një “kafshë” territoriale, po aq sa edhe politike. Bazuar në këtë parim, gjeopolitika, deri vonë, është konsideruar të jetë studimi i ndikimit të ndërsjellë midis gjeografisë, fuqisë kombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, pra, midis faktorëve tradicionalë.

Ndërkohë, globalizimi i ekonomisë dhe i jetës, si dhe revolucioni teknik e teknologjik, përveçse kanë sjellë në skenë fuqi e marrëdhënie të reja, kanë ndikuar në ridimensionimin e faktorëve tradicionalë.

Sepse çdo faktor gjeneron rendin e vet gjeopolitik.

Gjithsesi, asnjë faktor nuk mund të jetë vendimtar, pavarësisht nga ligji i numrave të mëdhenj. Gjeopolitika është qasje ndërdisiplinore, që përfshin tërësinë e faktorëve aktualë dhe të pritshëm, dinamikën dhe ndikimet e ndërsjella midis tyre. Prandaj analiza kërkon një proces gjykimi gjithëpërfshirës të lëndëve “të njoma”, jo një matematikë të thatë. Mbivlerësimi i një apo disa faktorëve, duke nënvlerësuar një apo disa të tjerë, bart rrezikun e dështimit të mundshëm të parashikimeve dhe, rrjedhimisht, të dështimit të vendimmarrjeve strategjike.

Fjalë kyçe: faktor gjeopolitik, fuqi, marrëdhënie ndërkombëtare, pushtet, analizë, gjithëpërfshirje.

HYRJE

Ku do të zhvillohet beteja për të ardhmen: në ngjarjet e zhurmshme që shohim apo në prirjet e padukshme, të cilat mund të mos kenë të bëjnë fare me këto ngjarje? Kush do ta qeverisë botën, njerëzit e gjithëpushtetshëm apo fuqitë që fshihen pas tyre? Dhe, kur vjen puna te fuqitë, a mundet që fatet e zhvillimit t'i përcaktojë një faktor i vetëm?

Një nga shkencëtarët më me peshë të shekullit të 20-të në studimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ndër realistët më me ndikim, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, gjermano-amerikani Hans Morgenthau, tërheq vëmendjen se gabimi më i madh në studimet gjeopolitike është “gabimi i një faktori të vetëm”.¹

1. GJEOPOLITIKA SI RAPORT FUQISH

Gjeopolitika mund të kuptohet vetëm në marrëdhënie. Dhe marrëdhënia nuk mund të kuptohet pa fuqinë. Sipas përcaktimeve më klasike, në gjeopolitikë, fuqia përcaktohet nga aftësia për të detyruar të tjerët të veprojnë sipas dëshirave dhe imponimeve tuaja, në atë masë sa që, në rrethana të tjera, nuk do t'iu bindeshin. Pra, gjeopolitika është luftë për të fituar fuqi, sigurim fuqie dhe vënie në punë e fuqisë për të arritur dhe mbajtur përparësinë ndaj fuqive të tjera. Më saktë, për të parandaluar sfidën nga fuqi të tjera.

2. FUQIA E GJEOGRAFISË

2.1. Vendosja gjeografike.

Vendosja gjeografike, pavarësisht se duket si faktor statik i fuqisë, në fakt, është marrëdhënie. Për shembull, Gjermania shtrihet në zemër të kontinentit Evropian, por përreth saj gjelojnë popuj e shtete. Kështu që, vendvendosja, krahas madhësisë së territorit e të popullsisë, i jep Gjermanisë atë fuqi që i jep zemra një trupi, madje që e kërkon vetë trupi. Gjermania nuk është rastësisht fuqia më e madhe ekonomike e Evropës dhe fuqia e katërt ekonomike më e madhe e botës. Duke qenë e pozicionuar në zemër të kontinentit, ajo ka dhënë, ka marrë dhe, madje, ka diktuar më shumë sesa çdo fuqi tjetër në Evropë. Mund të pranohet pa frikë se “që nga bashkimi i Gjermanisë në 1871, fati i Gjermanisë ka përcaktuar të ardhmen e Evropës.”² Është kjo arsyeja që, Gjermania është e interesuar, më shumë se çdo fuqi tjetër evropiane, për një zonë të madhe të tregtisë së lirë, e cila të jetë e uritur për të konsumuar volumin e madh të eksporteve gjermane. Prandaj, qëndrueshmëria e Bashkimit Evropian është interes jetësor gjerman.

¹ Morgenthau J., Hans, *Politics among nations the struggle for power and peace*, Alfred A. Knopf, 1949, p.116.

² George Friedman, “The German Question”, *Geopolitical Futures*, February 26, 2018.

Aspekti, ndoshta themelor i vendosjes gjeografike, është marrëdhënia tokë-det. Rusisë, për shembull, shtetit më të madh në botë për nga sipërfaqja, ia kontrollon NATO të tria daljet në det,³ njëra nga të cilat, Ngushtica e Bosforit kontrollohet nga Turqia - një kartë shumë e fortë gjeopolitike e saj, për të përfituar rolin e ndërmjetësit në raportet NATO-Rusi.



(Marrë nga: George Friedman, *Mauldin Economics*, “10 maps that explain Russia’s strategy”)

Pozicioni gjeografik përcakton një marrëdhënie tjetër, po aq vendimtare: atë me klimën dhe me pjellorinë e tokës. Shumica e vendeve më të zhvilluara dhe, madje, më të mëdhatë në botë, ndodhen në brezin midis paraleleve 30° dhe 60° të gjerësisë gjeografike veriore. (shih hartën në vijim, brezi jeshil). Pikërisht aty është bërë historia e botës, përfshi dy luftërat botërore. Çka do të thotë se vendosja gjeografike kushtëzon edhe marrëdhëniet me historinë.

Pjelloria e tokës mund të përdoret si një armë gjeopolitike. Kështu, p.sh., Ukraina dhe Rusia prodhojnë 30% të eksporteve botërore të grurit, 60% të vajit të lulediellit. Dhe për 26 shtete, kryesisht ato afrikane, ato sigurojnë gjysmën e nevojave për drithëra.

³ George Friedman, *Mauldin Economics*, “10 maps that explain Russia’s strategy”.



Shpërndarja e tokës bujqësore në botë (ngjyrë jeshile) (Sources/Usage: Public Domain)

Ky avantazh gjeopolitik u përdor dhe vijon të përdoret nga Rusia që nga momenti kur pushtoi Ukrainën, duke bllokuar Detin e Zi, me qëllim që këto shtete të gjendeshin në kaos e, prej këtij, në prishje të ekuilibrave botërorë të sigurisë.

2.2. Sipërfaqja e përgjithshme.

Bota është shtëpia e popujve të vendosur në hapësira të ndryshme tokësore dhe të organizuar aty në shtete. “Shtëpia” e Rusisë është 1.7 herë më e madhe se “shtëpia” e Kanadasë, SHBA-ve apo Brazilit. Normalisht, një sipërfaqe e madhe, potencialisht, ofron edhe burime më të mëdha natyrore, rrjedhimisht edhe për popullsi proporcionalisht më të madhe. Rusia, për shembull, zotëron rreth 25% të rezervave të gazit natyral të të gjithë botës, ndërkohë që renditet ndër pesë vendet me popullsinë më të madhe në botë.

Sipërfaqja e madhe siguron thellësi strategjike të madhe, e cila, si term ushtarak, i referohet largësisë midis vijave të para frontit dhe objekteve kritike të mbijetesës (kryeqytetit, qendrave kryesore të popullsisë, industrisë apo prodhimit ushtarak). Një thellësi e madhe strategjike “të jep dorë” për të sakrifikuar hapësirë tokësore dhe për të fituar kohë, sidomos në kushtet e një agresioni të befasishtëm e të shpejtë ushtarak. Në këto kushte, mbrojtësi, për të ruajtur forcat dhe për të akumuluar energji, mund të lëshojë pe duke kryer manovër me tërheqje të shkallës operative, ndërkohë që agresori largohet gjithnjë e më shumë nga bazat e tij logjistike. Por, sipas parimeve të luftës,

fuqia e një mësymjeje është në përpjesëtim të zhdrejtë me largësinë nga bazat logjistike: sa më e madhe largësia nga këto baza, aq më e vogël fuqia e saj. Prandaj, kushdo që mendon se mund të futet për qëllime vendimtare në vende me hapësira të gjera tokësore dhe thellësi të mëdha strategjike, si rregull, “e hanë” hapësirat. Këtë pësuan Napoleoni në vitin 1812 dhe Hitleri në vitin 1941.

Por, a është e mjaftueshme madhësia e sipërfaqes, si kartë gjeopolitike, për të zgjidhur të gjitha problemet e tjera politike, ekonomike e sociale? Mbajmë parasysh se sipërfaqja e ish-Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS) ishte sa 1/6 e sipërfaqes së tokës dhe dy herë e gjysmë më e madhe sesa ajo e SHBA-ve, çka mund të përbënte një faktor vendimtar gjeopolitik. Por, ishte BRSS që humbi, pas 74 vite mbijetese!

2.3. Fqinji, miku, armiku apo ekonomia?

Vendosja gjeografike, detyrimisht krijon marrëdhënie fqinjësie midis shteteve. Fqinjët i gjen, nuk mund t'i zgjedhësh dhe nuk mund të jetosh dot pa ta, edhe pse “gardhi i mirë bën miq të mirë”. “Gjeografia na ka bërë fqinjë. Historia na ka bërë miq. Ekonomia na ka bërë partnerë dhe nevoja na ka bërë aleatë” - u thoshte Presidenti amerikan Kenedi, kanadezëve.⁴

Në kontekstin e peshës së fqinjëve, le të shohim llogaritjet gjeopolitike të Turqisë, të cilat mund të jenë ndoshta unike për të përcaktuar balancat e sjelljes politike e diplomatike.

Kufiri tokësor prej 2,816 km dhe vija bregdetare prej 7200 km, e “ngjitin” Turqinë me shtete, me të cilat ka qenë historikisht dhe është aktualisht në konflikte, përveç Azerbajxhanit, vendi i dytë me popullsi dominuese turke. Por, sipas llogaritjeve gjeopolitike, me dy prej tyre, Bullgarinë dhe Greqinë, formalisht është aleat në siguri, duke u “mbërthyer” së bashku si anëtarë të NATO-s.

Por ka një siguri tjetër që i përmbys raportet gjeopolitike: siguria ekonomike. Statistika ekonomike na thotë se, për vitin 2022, Turqia importoi: nga Rusia 18%, Kina 13%, Gjermania 7.4%, SHBA 4.7%, Italia 4.3%, etj.⁵ Pra, në rendin e parë të sigurisë ekonomike, Turqia është e lidhur pikërisht me Rusinë dhe Kinën - dy konkurrentët më të mëdhenj, e madje më të rrezikshëm ndaj SHBA-së e, respektivisht, ndaj NATO-s.

Në kontekstin e sigurisë ekonomike, mund të shtrohet pyetja: a do të kemi luftë midis SHBA dhe Kinës? SHBA e cilëson Kinën se ka qëllime “më shumë se konkurrencte”. Por, partnerët kryesorë të Kinës në eksport janë: SHBA-të 17%,

⁴ Fjala e Presidentit të SHBA-ve, John F. Kennedy, mbajtur në Parlamentin e Kanadasë, 17 maj, 1961.

⁵ The World Factbook - CIA

Hong Kongu 10%, Japonia 6%, ndërsa partnerët kryesorë nga ku ajo importon janë: Koreja e Jugut 9%, Japonia 8%, Australia 7%, Gjermania 7%, SHBA-të 7%, Tajvani 6%, Rusia 4%.⁶ Pra, partneri kryesor në ekonomi është vetë SHBA së bashku me të gjithë miqtë dhe aleatët e saj perëndimorë e lindorë. I vetmi partner “mik” nga ku importon Kina, është Rusia, por me vetëm 4%, një shifër pothuajse simbolike në raport me importet nga “armiqtë” e saj. Kësisoj, duke lënë mënjanë të drejtat, kapacitetet, kufizimet dhe konsekuencat e shkuarjes në luftë, siguria ekonomike e të dy palëve iu imponon që të mos shkojnë në luftë, të paktën për një të ardhme të afërt.

3. BURIMET NATYRORE

Sigurisht që burimet natyrore përbëjnë një fuqi, e cila mund të kushtëzojë rregullat e lojës në gjeopolitikë. Por, si faktor i vetëm, burimet natyrore nuk mund të bëhen vendimtare, pikërisht për shkak të dinamikave në ndryshim të përhershëm. Rusia, për shembull, me rreth 25% të rezervave të gazit natyral të të gjithë botës, renditet në vendin e parë në botë, e cila, me shpalljen e luftës në Ukrainë, u përpoq ta përkthente në armë gjeopolitike, me shpresë se do të blinte heshtjen e botës për agresionin dhe do të “hidhte në erë” unitetin e NATO-s, për faktin se shumë vende të NATO-s ishin të varur nga Moska 45% për këtë burim energjie, ndërsa Gjermania importonte 55%, Italia 46 %, Hungaria 80-85%, etj. Por, ja që robërimit gjeopolitik nga Rusia për shkak të gazit natyral, iu gjet shpejt zgjidhja duke importuar gaz natyral të lëngët dhe duke vënë në punë reaktorë bërthamorë - dy asete për të cilat Perëndimi nuk vuan. Sot BE varet nga Rusia vetëm 12.9%!

4. REGJIMI POLITIK

Duket se vendin e konkurrencës ideologjike e politike midis demokracisë dhe komunizmit, që zgjati 74 vjet, po e zë konkurrenca midis demokracisë dhe autoritarizmit. Në jo pak shtete, demokracia liberale po zëvendësohet me demokraci joliberale dhe autoritarizëm populist, për aq sa qytetarët ndjejnë t’u rrezikohen sigurinë e tyre. Çështja ka marrë madje vëmendje teorike se cili nga regjimet është më produktiv. Udhëheqësi kinez Xi Jinping, ideologu dhe shtetari më i shquar kinez pas Mao Ce Dunit, predikon: “Kina ofron një mundësi të re për vendet dhe kombet e tjera që duan të përshpejtojnë zhvillimin e tyre, duke ruajtur pavarësinë e tyre.”⁷

Duke marrë rolin e liderit për këtë qëllim, Kina operon në dy drejtime gjeopolitike: eksportimin e modelit të qeverisjes autokratike kineze dhe krijimin e një koalicioni të autokracive botërore, me qëllim krijimin e një poli

⁶ The World Factbook - CIA

⁷ Fjala në Kongresin e 19-të Partisë Komuniste të Kinës, tetor 2017

gjeopolitik ndaj aleancës së vendeve demokratike. Në këtë lojë kanë hyrë dhe po hyjnë pikërisht shtetet me demokraci të cunguar, me regjime hibride ose autoritare: Argjentina, Brazili, Bolivia, Kina, Rusia, Arabia Saudite, Venezuela, Egjipti, Kazakistani, etj.⁸

Por, a do të ndodhë që fuqia e autoritarizmit të “hedhë në erë” demokracinë? Sigurisht që nuk ka rend të përjetshëm. Edhe rendet politiko-ideologjike nuk janë të përjetshme. Siç nuk ka rend të pastër “demokratik” apo të pastër “autoritarist”. Ka lindur, madje, termi “autoritarizëm demokratik”,⁹ që parakupton përdorimin e instrumenteve demokratike për të forcuar pikërisht regjimet autoritare. Por, ka të ngjarë të ndodhë e kundërta: do të jetë demokracia, së cilës do t’i duhet të përdorë instrumente shtrënguese për të mbrojtur si vlerat demokratike të tronditura nga mosbesimi në legjitimitetin e zgjedhjeve dhe nga korrupsioni “demokratik”, ashtu edhe interesat kombëtare nga globalizmi i shfrenuar.

Fuqia e individit - qytetar.

Çfarë i bën disa vende më të fuqishme se të tjerat? Kjo është pyetja më e rëndësishme për studimin dhe praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Shumica e studiuesve e matin fuqinë në pikëpamje të burimeve, veçanërisht të pasurisë, numrit të popullsisë dhe aseteve ushtarake. Logjika e kësaj qasjeje është e thjeshtë dhe relativisht bindëse: vendet me më shumë pasuri dhe me më shumë asete ushtarake në dispozicion të tyre, vlerësohen më të fuqishme.

Kina është ekonomia e dytë më e madhe në botë për sa i përket PPB (Prodhimit të Përgjithshëm Bruto), ekonomia e parë më e madhe në totalin e eksporteve dhe e dyta në totalin e importeve, e kështu, më e fuqishmja. Dhe si e tillë, edhe e frikshme. Por, Kina renditet e 58-ta për PPB për frymë: një qytetar kinez merr 6 herë më pak në vit nga ai amerikan dhe 3 herë më pak nga një tajvanez. Është kjo një arsye thelbësore pse sot, pas shtatëdhjetë vjetëve pas përfundimit të Luftës Civile Kineze dhe ndarjes së Tajvanit nga Kina, rreth 67% e të rriturve në Tajvan ndjehen tajvanezë, 28% prej tyre e shohin veten edhe tajvanezë edhe kinezë dhe vetëm 4% e shohin veten vetëm kinezë.¹⁰ Le të shkojmë në Siri, ku Presidenti Assad dhe të gjithë ministrat e tij, vijnë nga pakica alavite që përbën më pak se 10% të popullsisë 22 milionëshe shumë - etnik të këtij vendi, me sunitët arabë që përbëjnë 70-75% të popullsisë e kristianët që përbëjnë rreth 10% të popullsisë dhe ku, një qytetar merr 530

⁸ Democracy Index 2022 | Economist Intelligence Unit

⁹ Dawn Brancati, *Democratic Authoritarianism: Origins and Effects*, Annual Review of Political Science, Vol. 17, May 2014, p. 313-326

¹⁰ <https://www.pewresearch.org/global/2020/05/12/in-taiwan-views-of-mainland-china-mostly-negative/>

dollarë në vit. Edhe Belgjika, për shembull, është shtet shumë-etnik, por qytetari i saj është i përfaqësuar barazisht deri në qendrën vendimmarrëse, e, ndërkohë, merr 50.000 dollarë në vit. Janë këto arsye pse prej 10 vjetësh, Siria ndodhet në luftë civile dhe vijon të mbetet, krahas Ukrainës, një nga dy vendet me krizën më të madhe botërore të “prodhimit” të refugjatëve.

5. FUQIA NË HAPËSIRËN ATMOSFERIKE

Vlerësohet se në hapësira atmosferike mbitokësore është “populluar” me më shumë se 11,000 objekte të dërguara nga njeriu: satelitë, anije kozmike me ekuipazh, sonda, pajisje fluturimi stacioni hapësinor. Sondat kanë ndihmuar shkencëtarët të eksplorojnë planetë të tjerë. Satelitët ofrojnë nevoja të përditshme, si shërbimi i telefonisë celulare, sinjalet e largëta televizive, imazhet satelitore dhe GPS. Formalisht, ato ndahen në objekte për qëllime tregtare, ushtarake ose civile, por praktikisht këto qëllime mbivendosen, përderisa edhe fushat përkatëse ndërfiten te njëra-tjetra.

Prej vitit 1970 deri në vitin 2019, hapësira atmosferike është dominuar nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe pasardhësja e saj, Rusia. Pas vitit 2019, janë SHBA-të që dominojnë pothuajse në mënyrë absolute. Sipas disa vlerësimeve të vitit 2022, në të gjithë botën janë lëshuar dhe funksionojnë 4,550 satelitë në orbitë, nga të cilët 2804 i përkasin SHBA-ve, 467 Kinës, 349 Mbretërisë së Bashkuar, 168 Rusisë dhe 93 Japonisë.¹¹

Pavarësisht nga pushteti apo fuqia që kanë shtetet në hapësirë dhe hendeku që SHBA ka formuar tashmë me të tjerët, një dukuri e re synon ta përmbysë këtë kuadër gjeopolitik: pushteti në hapësirë ka filluar të privatizohet! Terminalet e internetit satelitor “Starlink” të prodhuara nga “SpaceX” e Elon Musk u bënë një burim jetik komunikimi për ushtrinë ukrainase, që nga dita e parë e invazionit rus, duke i mundur Ukrainës të luftojë dhe të qëndrojë pothuajse e paprekur në komunikimin brendapërbrenda administratës shtetërore dhe komandave ushtarake, deri te ushtari në front. Ukrainës iu siguruan rreth 20,000 njësi satelitore Starlink, për çka Musk deklaroi se ky operacion i ka kushtuar rreth 100 milionë dollarë!¹² Me këtë investim, individ i privat, në dallim nga deri më sot, kur i shiste shtetit vetëm mjete me efekte taktike (tanke, avionë apo armë të tjera), tanimë i shet shtetit shërbime që vendosin fatin e luftës, d.m.th., shërbime me efekte strategjike. Kështu, individ i shndërrohet në aktor strategjik, duke detyruar shtetin të varet prej tij.

A është ky një “privatizim” i luftës? Sigurisht që shtetet mbeten aktorë kryesorë me ushtritë e tyre, forcat paraushtarake dhe agjencitë e inteligjencës.

¹¹ The World Factbook-CIA, The connected World, pg. 2

¹² <https://www.businessinsider.com/elon-musk-says-starlink-ukraine-cost-spacex-100-million-dollars-2022-10>

Por, futja në tregun e luftës e privatëve me fuqi strategjike, do të krijojë, me siguri, edhe një kuadër të ri gjeopolitik. Elon Musk (Tesla), për shembull, me një pasuri neto prej 340 miliardë dollarësh, është më i pasur se sa shumë shtete në botë. Me fuqinë e tij financiare dhe me specifikën e teknologjisë së shkallës së lartë që konkurron si biznes, ai (si dhe shumë të tjerë, jo vetëm në SHBA), është shndërruar tashmë në aktor strategjik.

6. PUSHTETI NË UJËRAT BLU

“Ai që komandon detin, komandon tregtinë dhe ai që është zot i tregtisë së botës është zot i pasurisë së botës”,¹³ - shkruante shtetari, ushtaraku, shkrimtari dhe eksploratori anglez Sir Valter Raleigh në vitin 1829. Kemi parasysh që transporti detar zë 90 % të tregtisë ndërkombëtare. Ndërkohë, rrjetet e kabllove me fibra optike nënujore bartin rreth 95% të komunikimeve ndërkombëtare dhe trafikut të të dhënave dhe janë po aq vendimtare për revolucionin digjital, sa edhe zgjerimi i fuqisë kompjuterike dhe përparimet në inteligjencën artificiale. Shumica e trafikut të internetit në botë udhëton me shpejtësinë e dritës nëpërmjet kabllove të shtruara në dyshemetë e oqeanëve dhe deteve të botës.¹⁴ Në këto kushte, dominanca e oqeanëve dhe deteve përkthehet në një instrument gjeopolitik vendimtar.

Duke përdorur oqeanet e detet, të cilat mbulojnë pothuajse tre të katërtat e Tokës, forcat detare mund të ofrojnë shërbime, të cilat forcat tokësore, sado masive, nuk mund t'i kryejnë. Aktualisht, forcat detare të SHBA-ve (ashtu si një shekull më parë Marina Mbretërore Britanike), zotërojnë pothuajse në mënyrë absolute “ujërat blu”, domethënë oqeanet e botës dhe detet e mëdhenj. Por, luftania që bën diferencën dhe i klasifikon SHBA-të në fuqinë më të madhe dhe të vetme detare oqeanike, është aeroplanmbajtësja, e cila mund të cilësohet si një “bazë e madhe ushtarake e lëvizshme”. Për nga numri, SHBA-të kanë njëmbëdhjetë aeroplanmbajtëse, ndërsa Kina ka tre, Mbretëria e Bashkuar ka dy. Rusia, Franca, India dhe Italia kanë nga një secila, me pretendime për t'u bërë me dy. Po të konsiderojmë se prodhimi i një aeroplanmbajtëseje kërkon rreth gjashtë vjet, atëherë përmbysja e raporteve aktuale duket një mision i vështirë.


Por, a janë aeroplanmbajtëset të vetmet mjete për përqendrim fuqie në zona apo pika të caktuara të globit? Për më tepër që edhe aeroplanmbajtëseve iu gjendet kundërrarma! Mbytja e kryqëzorit të rëndë rus Moskva - anija më e madhe e Flotës Ruse të Detit të Zi, e goditur me vetëm dy raketa Neptun

¹³ Hasret ÇOMAK, Burak Şakir ŞEKER, Mehlika Özlem ULTAN, *Global Maritime Geopolitics*, Transnational Press London, 2022, p. 382

¹⁴ Italian Institute for International Political Studies, *The Geopolitics of Submarine Cables, the Infrastructure of the Digital Age*, 22 June 2022.

relativisht të teknologjisë së ulët të lëshuara nga forcat ukrainase, është një kujtesë e ashpër se anijet mbiujëse, duke përfshirë edhe aeroplanmbajtëset, do të gjenden shpejt përballë të papriturave.¹⁵

Ndërkohë, ka një alternativë gjeopolitike ndaj aeroplanmbajtëseve: bëj miq shtete kyçe! Alexander Haig¹⁶ është shprehur se “Izraeli është aeroplanmbajtësja më e madhe amerikane në botë që nuk mund të mbytet, nuk mban as edhe një ushtar amerikan dhe ndodhet në një rajon kritik për sigurinë kombëtare amerikane”. Pra, të bësh miq e aleatë në pika kyçe detare e oqeanike të globit është një alternativë më efektive fuqie, sesa fuqia e lëvizshme me aeroplanmbajtëse.



Burimi: <https://vividmaps.com/current-military-alliances-world/>

Harta e mësipërme përvijon aleancat sot në botë. SHBA-të, përveçse së bashku me Kanadanë dhe pothuajse tërë Evropën formësojnë “aeroplanmbajtëse” gjigante mbrojtëse, të cilat mbajnë nën kontroll Atlantikun e Veriut dhe Detin Mesdhe, ato kanë dhe një duzinë tjetër “aeroplanmbajtësesh” në Azinë Juglindore dhe në Oqeanin Paqësor (Japonia, Australia, Koreja e Jugut, etj.) për mbajtjen nën kontroll edhe të këtij oqeani.

Ndërkohë, Rusia ka një aleancë ushtarake me Kinën, Iranin dhe Sirinë, çka, si e tillë, nënkupton vetëm mbështetje të ndërsjellë me teknikë dhe teknologji ushtarake, pra jo aleancë mbrojtëse, sepse nuk kanë hapësira të përbashkëta unike gjeografike, tokësore, detare dhe oqeanike, siç kanë, për shembull, shtetet e Evropës me njëra-tjetrën, ose edhe me SHBA-të, me të cilën ndajnë hapësirën e përbashkët oqeanike të Atlantikut të Veriut. Por, në

¹⁵ Admiral James Stavridis (ish-komandant Suprem i NATO-s dhe komandant i Forcave Amerikane në Evropë), *Russia's Sunk Warship Is A Warning To All Navies*, Bloomberg, April 19, 2022.

¹⁶ Gjeneral, ish-komandant Suprem i Forcave Aleate të NATO-s në Evropë, ish-Sekretar i Shtetit të SHBA.

një rast hipotetik, nëse aleanca ushtarake midis Rusisë, Kinës, Iranit dhe Sirisë transformohet në aleancë mbrojtëse, atëherë kjo aleancë vë nën kontrollin e saj pothuajse tërë Euroazinë, ishullin më të madh të botës, e prej këtej, sipas gjeopolitikanëve të shquar, Mackinder, Spykman, etj., merr në dorë fatet e gjithë botës.

Kemi, kështu, dy alternativa aleancash, fuqia e të cilave përcaktohet jo nga një faktor apo dy faktorë të vetëm. Gjithsesi, tani për tani, sistemi i aleancave të SHBA-ve është unik në historinë njerëzore”,¹⁷ ngaqë është i institucionalizuar si asnjë aleancë tjetër dhe se gëzon 75% të PPB të botës, ndërkohë që mbulon vetëm 25% të popullsisë së botës.¹⁸

7. GJEOPOLITIKA E MINERALEVE KRITIKE DHE METALEVE TË RRALLA

Gjeopolitika, aq shumë e lidhur historikisht me gjeografinë, me pozicionin gjeografik, vendndodhjen apo madhësinë e sipërfaqes, terrenin, e të tjera asete “statike”, po përfshin, gjithnjë e më shumë, asete të tjera “jo statike”. Ndër to, mineralet kritike, të cilat po bëjnë revolucion në teknologji dhe i kanë dhënë përmasa të tjera gjeopolitikës.

Disa nga mineralet më kritike, të vlerësuara nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë dhe institute të tjera¹⁹ janë litiumi (për prodhimin e të cilit është Australia që zë vendin e parë në botë me 45%, por është Kina ajo që importon 55% të prodhimit botëror), kobalti (50% e rezervave globale të të cilit janë përqendruar në Republikën Demokratike të Kongos, por 68-84% e rafinimit të tij bëhet në Kinë), grafiti sintetik dhe natyral (afro 65% të prodhimit dhe 73% të operacioneve globale të rafinimit të të cilit kryhen në Kinë), metalet e rralla (për të cilin Kina mbulon 70% të minierave globale) dhe galiumi e germaniumi (ku Kina dominon në mënyrë dërmuese prodhimin me përkatësisht 98% dhe 67 % të atij global).

Pesha gjeopolitike e mineraleve kritike dhe metaleve të rralla përcaktohet nga fakti që, pa to, nuk mund të kryhet tranzicioni i domosdoshëm në energjinë e gjelbër që po bëhet prirje në atë shkallë, sa që shekulli i 21-të konsiderohet shekulli i energjisë së gjelbër. Po kështu, pa to, nuk mund të bëhet revolucion i kibernetikë, në inteligjencën artificiale, në teknologjinë e luftës, etj. Sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë, nevojat e përgjithshme të sektorit të

¹⁷ Kathleen J. McInnis, *The Competitive Advantages and Risks of Alliances*, Heritage Foundation, October 30, 2019 <https://www.heritage.org/militarystrength-essays/2020-essays/the-competitive-advantages-and-risks-alliances>.

¹⁸ Michael Beckley, *The Myth of Entangling Alliances: Reassessing the Security Risks of US Pacts*, *International Security* 39, no. 4 (Spring 2015), https://www.belfercenter.org/sites/default/files/legacy/files/IS3904_pp007-048.pdf.

¹⁹ International Energy Agency: “Critical Minerals Market Review 2023”. Contributors & Contacts: “Critical Materials: Geopolitics, Interdependence, and Strategic Competition”, May, 2023.

energjisë për minerale kritike mund të rriten deri në gjashtë herë deri në vitin 2040 dhe fitimet nga ky treg do të jenë aq të mëdha, saqë do të konkurrojnë deri edhe buxhetet e mbrojtjes së vendeve më të zhvilluara.

Por, nga analiza se cili shtet investon më shumë për importimin, depozitimin, prodhimin dhe rafinimin e mineraleve dhe metaleve të rralla kritike, duket qartazi se Kina, po krijon një avantazh gjeopolitik. Kështu, sigurimi i mineraleve kritike, me shumë gjasë, do të jetë sheshi i betejës së ardhshme gjeopolitike, ashtu siç ishte nafta në shekullin e kaluar.

8. ZBULO PYLLIN PAS PEMËS!

Sado të komplikua të jenë fuqitë e reja, ato nuk do mund të zëvendësojnë kurrë analizat, gjykimet dhe vendimet e atyre që i komandojnë. Është komanda, domethënë njeriu, ai që mund të bëjë interpretimin e informacionit heterogjen, duke balancuar të gjithë faktorët e lidhur me një situatë të caktuar. Për këtë arsye, gjeopolitika, më shumë se çdo fushë tjetër studimi, është qasje ndërdisiplinore që përfshin tërësinë e faktorëve aktualë dhe të pritshëm, dinamikën dhe ndikimet e ndërsjella midis tyre. E konceptuar ndryshe dhe, sidomos, e referuar ndryshe, atëherë rrezikohet të prodhohen parashikime që nuk do të ndodhin dhe, në këtë rrugë, do të shkohet në vendimmarrje të gabuara strategjike. Madje, kur analizohen çështjet gjeopolitike, është thelbësore që analiza të bëhet jo vetëm gjithëpërfshirëse, por çdo faktor të studiohet nga perspektiva të shumta, duke identifikuar provat që e mbështesin apo që kundërshtojnë rëndësinë, peshën gjeopolitike të tij.

Mbivlerësimi apo përdorimi i një faktori të vetëm, sado i fuqishëm në raport me të tjerët, me besimin se ky faktor mund të zgjidhë imperative vendimtarë, rrezikon të udhëheqë në aventurë. Arsyeja qëndron në faktin se, përveçse injoron faktorët e vet, “prodhon” edhe aleancën e faktorëve të tjerë të konkurrentit, kundërshtarit apo armikut tënd. Kështu, mbivlerësimi që Hitleri i bëri fuqisë gjermane në Luftën e Dytë Botërore, prodhoi aleancën e “çuditshme” të perëndimit demokratik (Britanisë së Madhe dhe SHBA-ve) me Bashkimin Sovjetik Komunist. Rreth 80 vjet më vonë, pushtimi rus në Ukrainë prodhoi aleancën e madhe ushtarake “pa ushtarë” të perëndimit me Ukrainën, e cila u gjend përballë Rusisë atomike si Çekosllovakia përballë Gjermanisë naziste.

Shpesh, numrat e mëdhenj të një apo dy faktorëve, të palidhur me faktorë të tjerë, krijojnë paragjykime, mbivlerësime apo frikë. Në vitin 1979, Bashkimi Sovjetik i frikshëm i Luftës së Ftohtë, pushtoi Afganistanin e vogël fqinj, ku “mbeti brenda” në një konflikt të përgjakshëm dhjetëvjeçar, nga ku doli i humbur. Ushtria sovjetike, e përgatitur dhe e armatosur të pushtonte tërë Evropën me luftë konvencionale, humbi kundër grupeve të vogla guerile

afgane, të cilat përdornin taktika goditëse në shkretëtirat, luginat e grykat të thella, pllajrat e larta dhe malet e mbuluara me borë. Në vitin 2001 do të ishin SHBA-të, bashkë me një koalicion të gjerë ndërkombëtar, të cilët ndërmorën të njëjtin veprim ushtarak ndaj Afganistanit, për të mbetur po ashtu brenda tij plot 20 vjet, pra dy herë më gjatë në kohë në krahasim me sovjetikët dhe po aq të përgjakshëm në njerëz. Dhe për të dalë prej tij po aq të humbur.

Gjeopolitika, pra, nuk është një fuqi fikse, së cilës duhet t'i falesh apo t'i trembesh, por një raport fuqish. Kështu, për shembull, Koreja e Veriut ka një sipërfaqe totale (tokë dhe ujëra) 1.2 herë më të madhe sesa Koreja e Jugut dhe 1.27 herë më shumë tokë të punueshme, me të cilën ushqen një popullsi dy herë më të vogël sesa Koreja e Jugut. Koreja e Veriut, shtet diktatorial, është një nga vendet më të militarizuara në planet, që shpenzon afro 26% të buxhetit të saj për mbrojtjen, ndërkohë që Koreja e Jugut, vend demokratik, shpenzon 2.7%, pra 10 herë më pak. Ndërkohë, në krejt rajonin e Azisë Juglindore, vetëm Kina dhe Koreja e Veriut janë dy fuqitë e vetme që zotërojnë armatim bërthamor.

Por, a është Koreja e Veriut, në kompleks, një shtet i fuqishëm? Një sërë faktorësh të tjerë e përmbysin raportin. Koreja e Jugut ka arritur të bëhet ndërtuesi dominues i anijeve në botë me 50,6% të tregut global të anijeve që nga viti 2008. Po kështu, një nga prodhuesit më të mëdhenj të automobilave në botë. Në vitin 2017, rreth 17% të eksporteve të Koresë së Jugut ishin gjysmëpërcësues, ndërkohë që mbetet një nga prodhuesit e mëdhenj në pajisjet elektronike si televizorët, telefonat inteligjentë, ekranet dhe kompjuterët. Duke investuar, kësisoj, për qytetarin, PPB për frymë i Koresë së Jugut arrin 44.200 dollarë, ndërsa ai Koresë së Veriut është 1.700 dollarë, çka do të thotë se qytetari koreano-jugor është 26 herë më i pasur sesa ai koreano-verior. Historia na thotë se një shtet është aq i fuqishëm sa i fuqishëm dhe i lirë është qytetari i tij.

Themeli i gjeopolitikës janë imperativët (çka kërkon të arrish), fuqitë që ke (me të cilat beson se mund t'i arrish imperativët) dhe kufizimet (mangësitë e fuqive që ke). Pra, krijohet një njësi matëse. Por, kjo njësi është e pasaktë nëse nuk merr parasysh “anën tjetër”, pra, si ndikojnë ndryshimet e peizazheve politike, ekonomike, ushtarake, sociale, teknologjike në balancën globale të fuqisë. Sepse matja e fuqisë brenda vetes është, si rregull, gënjeshtarë. Për më tepër që, të gjitha fuqitë, si ato “brenda vetes” edhe ato “jashtë vetes”, janë dinamike, në ndryshim të përhershëm, jo të dhëna njëherë e mirë.

Ngjarjet “trumbetuese” mund të fshehin me të vërtetë një prirje gjeopolitike, por mund të jenë edhe krejt anësore, pa asnjë lidhje.

Një ngjarje e tillë pritet të ndodhë në 22-24 gusht të vitit 2023, kur, në Afrikën

e Jugut do të zhvillohet Samiti i 15-të i vendeve të BRICS (Brazil, Rusia, India, Kina, Afrika e Jugut) dhe ku janë ftuar të marrin pjesë edhe udhëheqës të 70 vendeve të tjerë, shumica afrikane. Ndër çështjet kryesore, parashikohet të diskutohet edhe krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm të pagesave për tregtinë e ndërsjellë midis tyre, duke reduktuar varësinë nga dollari amerikan.

Kryelajmi, pra, është: de-dollarizimi i botës! Dhe ka mbështetje: vendet e BRICS mbulojnë rreth 26.7% të sipërfaqes dhe 41.5% të popullsisë globale. Blloku BRICS llogaritet të zotërojë 31.5 për qind të PPB-së globale, duke tejkaluar grupimin G7 (Kanada, Francë, Gjermani, Itali, Japoni, Mbretëri e Bashkuar dhe SHBA), i cili zotëron 30.7 për qind.²⁰ Rreth 40 vende të tjera kanë shprehur interes të aplikojnë për anëtarësim në BRICS. Aktualisht, Arabia Saudite, ekonomia më e madhe arabe, duket se është larguar, duke kaluar nga sfera e ndikimit të SHBA-ve, në atë të Kinës dhe Rusisë. Ndërkohë, edhe aleatët e Amerikës priren të shohin se ku u del më mirë. Lidhjet direkte hekurudhore Evropë-Azi e diversifikojnë dhe e bëjnë më të lirë tregtinë midis tyre. Korridoret e autostradave dhe hekurudhave, ku Kina investon veçanërisht në kontinent, përmes donacionesh financiare miliarda dollarë, paralelizojnë, për nga rëndësia, linjat e kablove nëndetëse dhe pse jo, konkurrojnë edhe linjat e transportit oqeanik. Ka pra, zhvillime dhe prirje për balancim e, deri përmbysje raportesh gjeopolitike, çka do të thotë se de-dollarizimi mund të shndërrohet në një perspektivë reale.

Kjo është jehona. Po realiteti?

Sipas të dhënave nga FMN dhe vlerësimeve nga banka e financierë të njohur, nga 7.5 milionë transaksione valutore që kryheshin çdo ditë në prill 2022, dollari amerikan përbënte 6.6 milionë të tyre, pra, 88% të të gjithë tregtisë globale. Ky tregues ka mbetur relativisht i qëndrueshëm në 35 vitet e fundit. Monedha kineze, që aspiron të zërë vendin e dollarit amerikan, në vitin 2022 përbënte vetëm 7% të të gjitha transaksioneve të këmbimit valutor.²¹

Historia thotë se monedhat rrëzohen kur shteti që e emeton destabilizohet, si politikisht ashtu edhe ekonomikisht. Ky nuk është rasti me SHBA-të, e cila mbetet e qëndrueshme politikisht dhe konkurruese ekonomikisht. Madje, mund të duket pak si e çuditshme që, pikërisht Kina nuk ka interes për rrëzimin e dollarit, për aq sa SHBA mbeten klienti më i madh eksportues i saj.²²

²⁰ Global Times, "BRICS to discuss dollar alternatives at August summit: Russia", Jul 23, 2023

²¹ Jennifer Sor, *Dollar dominance isn't going anywhere. Here are 5 myths about de-dollarization*, Insider, June 2, 2023.

²² Në vitin 2022, Kina eksportoi në SHBA 582.8 miliardë dollarë amerikanë (16.2% të eksporteve të përgjithshme të saj), në Hong Kong: 297.5 miliardë dollarë (8.3%), në Japoni 172.9 miliardë dollarë (4.8%), në Korenë e Jugut 162.6 miliardë dollarë (4.5%), etj. (<https://www.worldstopexports.com/chinas-top-import-partners/>)

PËRFUNDIME

Gjeopolitika, zonja e madhe që hyri në sallonin e mendimit dhe të studimeve në fillimshkullin e kaluar, deri vonë është konsideruar të jetë studimi i ndikimit të ndërsjellë midis faktorëve tradicionalë: gjeografisë, fuqisë kombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Ndërkohë, globalizimi i ekonomisë dhe i jetës, si dhe revolucioni teknik e teknologjik, përveçse kanë sjellë në skenë fuqi e marrëdhënie të reja, kanë ndikuar në ridimensionimin e faktorëve tradicionalë. Për më tepër, zhvillime të tjera të pritshme në këto fusha, do të krijojnë kuadër më komplekse të studimeve gjeopolitike.

Fuqia e re që po lind, është ajo e inteligjencës artificiale dhe komunikimit tej-territorial e tej-politik, e cilësuar si “zjarri i ri” i njerëzimit. “Çdo teknologji gjeneron rendin e vet gjeopolitik. Kur tregtoni lëndë djegëse fosile, kontrolli mbi pusët, minierat, tubacionet dhe transportin detar është kritik. Kur ekonomia juaj bazohet në teknologjitë digjitale, perceptimi ndryshon. Lojtarët e mëdhenj nuk janë Arabia Saudite apo Rusia, por Alphabet apo Microsoft. Në vend të linjave të transportit detar, ajo që ka rëndësi tani janë kabllot nëndetëse”- shkruan shkencëtari i shquar politik, spanjolli José Ignacio Torreblanca.²³

Prandaj, një analizë objektive gjeopolitike duhet patjetër të bëhet jo vetëm gjithëpërfshirëse, por edhe dinamike, mbi bazën e informacionit që ndryshon gjithnjë e më dendur në botën moderne të komunikimit. Kështu, duke gërshetuar influencën reale të të gjithë aktorëve, faktorëve dhe vektorëve të fuqisë, në historinë dhe dinamikën e tyre, mund të arrihet në parashikime me probabilitet të lartë. Ky është një proces që kërkon gjykim të të gjitha lëndëve, prurjeve, gjetjeve, konfirmimeve, pikëpyetjeve dhe kundërshtimeve, pra, një matematikë idesh logjike.

BURIME TË SHFRYTËZUARA

1. Morgenthau J., Hans, “Politics among nations the struggle for power and peace”, Alfred A. Knopf, 1949
2. George Friedman, “The German Question”, Geopolitical Futures, 2018.
3. George Friedman, Mauldin Economics, “10 maps that explain Russia’s strategy”
4. The world Factbook – CIA
5. Joel Acosta, “EU places confidence in U.S. LNG”, 2023

²³ José Ignacio Torreblanca, Drejtor i Institutit Politik në Këshillin Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë në Madrid, <https://www.mapfreglobalrisks.com/en/risks-insurance-management/article/a-complex-world-geopolitical-analysis/>.

6. Xi Jinping, President of the People's Republic of China, Fjala në Kongresin e 19-të PK të Kinës, 2017
7. Democracy Index 2022, Economist Intelligence Unit
8. Dawn Brancati, "Democratic Authoritarianism: Origins and Effects", Annual Review of Political Science, Vol. 17, 2014
9. Hasret Çomak, Burak Şakir ŞEKER, Mehlika Özlem ULTAN, "Global Maritime Geopolitics", Transnational Press London, 2022
10. Admiral James Stavridis, "Russia's sunken warship is a warning to all navies", 2022
11. Kathleen J. McInnis, "The Competitive Advantages and Risks of Alliances," Heritage Foundation, 2019
12. Michael Beckley, "The Myth of Entangling Alliances: Reassessing the Security Risks of US Pacts," International Security 39, no. 4 (Spring 2015)
13. International Energy Agency: "Critical Minerals Market Review 2023". Contributors & Contacts: "Critical Materials: Geopolitics, Interdependence, and Strategic Competition", 2023
14. Italian Institute for International Political Studies, "The geopolitics of Submarine Cables, the Infrastructure of the Digital Age", 2022
15. José Ignacio Torreblanca interview: "A complex world: geopolitical analysis".

LUFTA HIBRIDE: OPERACIONET DHE KËRCËNIMET HIBRIDE NË TË ARDHMEN

Nënkolonel (R) Msc. Kanan HIMAJ
Specialist në IKSHU

Trajtesë e shkurtuar.

Sot, konceptet e luftës dhe të operacioneve speciale vëzhgohen në kontekstin e luftës hibride, duke përfshirë mënyrën se si teknologjitë kibernetike promovojnë mundësi më të mëdha asimetrike për ndikim, kontroll dhe dështim të kundërshtarit. Fushat e kërkimit analizohen në lidhje me operacionet hibride. Qëllimi i studimit analitik është që të vëzhgojmë veçoritë teorike e të aplikuara në hapësirën kibernetik dhe pasojat e mundshme në kuadrin e konflikteve hibride, të cilat janë bërë të shpeshta në botë. Ndërhyrja hibride kërkon të mjegullojë kufijtë midis paqes, krizës dhe konfliktit. Ajo synon të jetë e fshehtë, e paqartë dhe e vështirë. Ndërhyrja hibride përdor dobësitë dhe ndarjet e brendshme tashmë ekzistuese brenda shoqërisë, duke synuar thellimin e tyre më tej. Qëllimet e tij mund të përfshijnë vonimin ose paralizimin e procesit të vendimmarrjes politike (përfshirë vendimmarrjen në mbrojtje dhe siguri) ose dobësimi i besimit të qytetarëve në sistemin kushtetues, demokratik, institucionet dhe mekanizmat strategjikë të drejtësisë.

Kërcënimet hibride, si dhe lufta hibride, janë bërë konstante e shekullit tonë, duke marrë me kalimin e kohës përkufizime të shumta, të cilat qartësojnë pak a shumë këto koncepte të karakterizuara kryesisht nga paqartësia për sa i përket mjeteve, ashtu edhe forcave të përfshira apo zonës gjeografike të luftimit. Mund të konsiderohet si mungesë përpjekja për të përcaktuar një

koncept që lindi nga nevoja për të përfshirë gjithçka që dihet në aspektin e teknikave, metodave dhe mjeteve, por edhe atë që do të shfaqet në një të ardhme jo shumë të largët, falë zhvillimit të shpejtë teknologjik, të përdorur nga aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë, në përpjekje për të arritur qëllimet e tyre politike apo sociale.

Ky punim synon të japë një pasqyrë të shkurtër të literaturës përkatëse mbi kërcënimet hibride, operacionet dhe luftën, duke filluar nga përpjekja e parë për t'i përcaktuar ato dhe deri tek atributet e reja. Mënyra në të cilën ka evoluar lloji i ri i luftës, që specialistët e quajnë «luftë hibride», shpesh mund të përshkruhet më lehtë sesa të përcaktohet. Kjo, nga njëra anë, për faktin se gjërat janë në një zhvillim kaq të përshpejtuar, sa që realiteti në terren shpaloset me një shpejtësi shumë më të madhe se sa mund të konceptohet dhe përcaktohet dhe, nga ana tjetër, sepse metodat shtrënguese dhe shkatërruese të përdorura nga agresori me qëllimin e destabilizimit të kundërshtarit, ndodhin në një zonë me shumë fusha veprimi.

Nevoja është emergjente që të analizojmë karakteristikat, llojet, aktorët e përfshirë dhe objektivat e ndjekura prej tyre, që rezultojnë nga kombinimi i disa teknikave, metodave ose mjeteve.

Fjalë kyçe: kërcënime hibride, luftë hibride, operacion kibernetik, terrorizmi, dezinformim.

HYRJE

Kërcënimet hibride janë kthyer në një problem konstant të shekullit të 21-të, duke qenë të pranishme në shumicën e konflikteve të viteve të fundit dhe duke u manifestuar në të njëjtën kohë në periudha të dukshme paqeje. Nevoja për të studiuar dhe përshtatur legjislacionin dhe praktikën në lidhje me shfaqjen e këtyre llojeve të reja të kërcënimeve u deklarua për herë të parë në Strategjinë e Mbrojtjes Kombëtare të SHBA në 2005. Sfidat e reja me të cilat po përballeshin Shtetet e Bashkuara në atë kohë, u bënë edhe më të dukshme pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001, e shtuan këtë nevojë për rimendim dhe riorganizim të mbrojtjes. Si rezultat, analistët ushtarakë i kanë fokusuar përpjekjet e tyre në teorizimin, por edhe gjetjen e modeleve për të përcaktuar, kuptuar dhe luftuar kërcënimet hibride.

Për më tepër, kërcënimet hibride përpiqen të prishin proceset ekonomike, duke ndikuar në sektorët kryesorë ekonomikë dhe strategjikë, të manipulojnë ose marrin në kontroll mjedisin e informacionit, si dhe të dobësojnë ose ndikojnë në funksionimin e infrastrukturës kritike. Për të arritur këtë, autorët e ndërhyrjes hibride përdorin një shumëllojshmëri të mjeteve, duke përfshirë aktivitetet me qëllim të keq në hapësirën kibernetike.

Ky shkrim synon fillimisht të sqarojë konceptet e kërcënimit hibrid, operacionit hibrid, konfliktit hibrid, fushatës hibride dhe luftës hibride, si dhe të analizojë karakteristikat, llojet, aktorët e përfshirë dhe objektivat që ndiqen prej tyre, si rezultat i kombinimit të disa teknikave, metodave ose mjeteve, të krijuara nga studimi i thelluar i fushës, ndërgjegjësimi i konceptit dhe literaturës në rritje.

Koncepti i kërcënimit hibrid lidhet shumë ngushtë me luftën hibride, pasi ato janë mjete të përdorura para, gjatë dhe pas përfundimit të konfliktit. Në të njëjtën kohë, disa autorë besojnë se qëllimi i një kërcënimi hibrid është të shfrytëzojë dobësitë pa shpallur luftë.

Në të njëjtën kohë, konceptet e funksionimit hibrid, **konfliktit hibrid**¹ ose fushatës hibride ndryshojnë jo vetëm nga këndvështrimi i shpalosjes me kalimin e kohës, por edhe nga ndërgjegjësimi i situatës në të cilën gjenden të gjithë aktorët e përfshirë. Në këtë kuptim, **operacioni hibrid** mund të përfshijë përdorimin e një numri të kufizuar mjeteve për një periudhë më të shkurtër kohore, ndërsa nga pikëpamja konceptuale, **fushata hibride** tenton të kryhet për një kohë më të gjatë dhe përfshin një sërë kërcënimesh të tipit hibrid që ndjek një qëllim të mirë përcaktuar. Nga ana tjetër, të dy konceptet, si **konflikti dhe lufta**, përshkruajnë situatën në të cilën palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre në mënyrë miqësore, duke përdorur instrumente diplomatike ose me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare. Dallimi midis dy koncepteve mund të qëndrojë edhe në kuadrin e tyre ligjor. Kategorizimi i një konflikti si luftë u jep disa të drejta palëve ndërluftuese dhe i detyron ato të respektojnë rregulloret ndërkombëtare.

Koncepti i luftës hibride fillimisht u përdor për të përshkruar veprimet e aktorëve jo shtetërorë dhe aftësinë e tyre për të përdorur mjete ushtarake gjithnjë e më të sofistikuara dhe instrumente joushtarake, duke iu atribuar më vonë edhe aktorëve shtetërorë, për shkak të përdorimit të tyre të kërcënimeve hibride. Strategjia e Mbrojtjes Kombëtare e SHBA-së parashikon ekzistencën e katër llojeve të aftësive dhe metodave: tradicionale, asimetrike, katastrofike dhe përçarëse, si dhe faktin që ato mbivendosen dhe se aktorët pritet të përdorin dy ose më shumë metoda të tilla njëkohësisht, siç ishte rasti në luftërat në Irak dhe Afganistan, ku kryengritësit përfaqësonin një sfidë tradicionale të mbrojtjes dhe një pjesë të mbrojtjes. Frank Hoffman gjithashtu argumenton se

¹ Disa përfundime për të rritur qëndrueshmërinë e sigurisë dhe mbrojtjes sipas Konceptit Strategjik të NATO-s, Madrid 2022; konkluzionet e Këshillit të BE-së mbi përpjekjet plotësuese për të rritur elasticitetin dhe kundër hibridit kërcënimit e miratuara më 10- dhjetor 2019; Strategjia e NATO-s mbi rolin e saj në përballjen me kërcënimet hibride; Koncepti i rishikuar i Bashkimit Evropian për Operacionet dhe Misionet Ushtarake të udhëhequra nga BE-ja miratuar më 2 dhjetor 2019.

“në të ardhmen pritet që të ketë kombinime të veçanta ose kërcënime hibride”².

Lufta hibride, filloi të shikohej me vëmendje të veçantë vetëm pas luftës së Izraelit në Liban kundër Hezbollahut në vitin 2006, kur Izraeli u përball me një forcë kryengritëse të trajnuar mirë dhe të pajisur, të aftë për luftë konvencionale, por që vepronin duke përdorur teknika dhe mjete jokonvencionale³. Lufta midis Izraelit dhe Hezbollahut u trajtua gjithashtu nga Hoffman, i cili e konsideron atë “prototipin e luftës moderne hibride” (Hoffman 2007). Në këtë luftë të parë hibride, ne, pra, gjejmë karakteristikat e këtij lloji të konfliktit, siç ishte parashikuar nga Strategjia e Mbrojtjes Kombëtare e SHBA dhe i përcaktuar për herë të parë nga Hoffman (Hoffman 2007). Karakteri jolinear i kësaj lloji lufte, si dhe përfshirja e aktorëve joshtetërorë që kombinojnë mënyrën konvencionale të luftimit me aftësitë nga spektri asimetric, janë elementët përcaktues të luftës midis Izraelit dhe Hezbollahut.

Me aneksimin e Krimesë nga Federata Ruse në vitin 2014, fenomeni i “luftës hibride” filloi të merrte vrull, kështu që nuk u trajtua më si nocion teorik, por u bë një term i përdorur për të përshkruar gjendjen e pasigurisë dhe sfidat në adresën e sigurisë të shteteve perëndimore, duke vazhduar të jetë një temë me interes midis teoricienëve të tyre hibride, veçanërisht të teoricienëve rusë. Shtetet kanë filluar ta përfshijnë konceptin në politikën e tyre të sigurisë, duke njohur kështu rëndësinë dhe realitetin e ekzistencës së kërcënimeve hibride dhe luftërave hibride, duke krijuar kuadrin legjislativ për marrjen e masave mbrojtëse kundër tyre. Për më tepër, në Strategjinë Kombëtare Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës thuhet se: *“konflikte të tilla hibride mund të përbëhen nga forca ushtarake që marrin një identitet joshtetëror, siç bëri Rusia në Krime, ose mund të përfshijë një organizatë ekstremiste që ka aftësi rudimentare të armëve të kombinuara, siç demonstrohet nga Shteti Islamik në Irak dhe Siri. Konfliktet hibride gjithashtu mund të përbëhen nga aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë që punojnë së bashku drejt objektivave të përbashkëta, duke përdorur një gamë të gjerë armësh, siç kemi dëshmuar në Ukrainën Lindore”⁴* duke identifikuar dhe ilustruar kështu materializimin e karakteristikave të konfliktit hibrid.

Ekzistenca e kërcënimeve hibride dhe nevoja për t’iu kundërvënë atyre në mënyrë të unifikuar dhe efektive përfaqëson një nga objektivat kryesore të

² Hoffman, Fran, Conflict in the 21st century: The Rise of Hybrid Wars. Arlington, Virginia: Potomac Institute for Policy Studies.

³ Schnauffer, Tad A. 2017. “Redefining Hybrid Warfare: Russia’s Non-linear War against the West.” Journal of Strategic Security 10 (1): 17-31.

⁴ Dempsey, Martin. 2015. “The National Military Strategy of the United States of America.” <https://history.defnse.gov/Historical-Sources/National-Military-Strategy/>.

shteteve perëndimore dhe NATO-s apo Bashkimit Evropian. Ky i fundit i përkufizon kërcënimet dhe fushatat hibride si “shumëdimensionale, duke kombinuar masa shtrënguese dhe subversive, duke përdorur mjete dhe taktika konvencionale dhe jokonvencionale (diplomatike, ushtarake, ekonomike dhe teknologjike) për të destabilizuar kundërshtarin. Ato janë krijuar që të jenë të vështira për t’u zbuluar ose atribuuar dhe mund të përdoren si nga aktorët shtetërorë ashtu edhe nga joshetërorë”⁵. Për më tepër, në kuadër të Konceptit Strategjik të fundit, të nxjerrë në vitin 2022⁶, i referohet edhe mbështetjes së Aleancës për anëtarët dhe partnerët e saj, si dhe për koordinimin e veprimeve për të luftuar kërcënimet hibride me aktorë të tjerë përkatës, si Bashkimi Evropian.

1. KËRCËNIM, OPERACION, KONFLIKT APO LUFTË HIBRIDE?

Përdorimi alternativ i termave kërcënim, operacion, konflikt apo luftë, të cilit i shtohet edhe cilësia e hibriditetit, mund të krijojë konfuzion, si te teoricienët ashtu edhe te vendimmarrësit. Ne besojmë se një nga shkaqet e këtij fakti është karakteri i paqartë i operacioneve hibride, si:

- Nuk ka hapësirë të përcaktuar qartë për luftime, një zonë lufte, por, veçanërisht për shkak të mjeteve informative të përdorura, konflikti shpesh i kalon kufijtë shtetërorë;
- aktorët e përfshirë, qofshin ata shtetërorë apo joshetërorë nuk dihen gjithmonë, si p.sh. situata kur një aktor shtetëror sponsorizon një aktor joshetëror që vepron në favor të të parit;
- ekzistenca e një kufiri shumë të hollë midis luftës dhe paqes, të asaj zone gri, për të cilën flitet gjerësisht⁷;
- shenjëstrimi i dobësive të një shteti duke përdorur mjete dhe metoda hibride është një gjendje konstante e gjeopolitikës ndërkombëtare, ku veprime të tilla nuk kategorizohen si akte lufte. Një shembull i kësaj do të ishte përdorimi i propagandës dhe dezinformimit nga Federata Ruse⁸;
- kërcënimi përfshin një situatë hipotetike, potenciale, e cila është ajo që e dallon atë kryesisht nga çdo formë e ngjarjes në vazhdim.

⁵ European Commission. 2018. “Comunicare comună către Parlamentul European, Consiliul European și Consiliu.” <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10242-2018-INIT/ro/pdf>. Galeotti, Mark. 2016. “Hybrid, ambiguous, and non-linear? How new is Russia’s new way of war?” 282-301.

⁶ Koncepti Strategjik i NATO-s, Madrid 2022

⁷ Almäng, Jan. 2019. “War, vagueness and hybrid war.” *Defence Studies* 19 (2): 189-204. - <https://www.tandfonline.com>;

⁸ Veebel, Viljar. 2016. “Estonia confronts propaganda: Russia manipulates media in pursuit of psychological warfare.” 14-19.

Për rrjedhojë, për qartësinë e termave, ndonëse herë kategorizohen si konflikte hibride dhe herë si luftëra hibride, **termin luftë hibride** do ta përdorim për të emërtuar një konflikt të shpallur midis dy ose më shumë aktorëve shtetërorë ose joshetërorë, të cilët përdorin mjete si konvencionale ashtu edhe jokonvencionale për të arritur objektivat strategjikë. Jan Almäng pohon se *“nëse një konflikt kualifikohet si luftë, pjesëmarrësit në konflikt fitojnë të drejta dhe detyra që nuk i kanë pasur më parë”*⁹, gjë që jo gjithmonë i shërben interesave dhe objektivave të forcave luftarake, prandaj qëllimi i përdorimit të kërcënimeve dhe mjeteve hibride bëhet madje edhe për të krijuar një situatë në të cilën ekziston apo jo, kush është lufta, nëse është apo jo shtet. Shmangia e përdorimit të termit luftë çoi në përdorimin më të shpeshtë të termave të tjerë, si: konflikti hibrid, operacioni, aksioni, fushata etj., që të gjithë kanë pak a shumë të njëjtat karakteristika. Dallimi mund të jetë në shkallën e veprimit, nëse forcat luftarake njihen me njëri - tjetrin, ose nëse ka vetëm sulme të çfarëdo lloji nga një aktor i panjohur, etj.

Kërcënimi për sigurinë e një shteti mund të shihet si një kombinim i aftësive, qëllimit dhe mundësive. Karakteri hibrid në këtë situatë rezulton nga lloji i mjeteve të përdorura. Nëse, për shembull, një aktor ka kapacitetin teknik dhe intelektual për të kryer një sulm kibernetik, dhe e ka synimin për ta bërë këtë, për shkak të nevojës për të arritur objektiva të caktuar strategjikë, i lind mundësia për të ekzekutuar sulmin, që më së shpeshti është krijuar nga identifikimi i një cenueshmërie, atëherë, ekziston mundësia që ai aktor të ekzekutojë një aktor tjetër që përbën një rrezik në **fushën kibernetike**. Për ta ilustruar, kujtojmë sulmet kibernetike të udhëhequra nga Federata Ruse ndaj Gjeorgjisë në vitin 2008, të cilat filluan disa muaj para shpërthimit të konfliktit që më vonë u konsiderua “lufta e parë që u zhvillua në ajër, det, tokë dhe hapësirën kibernetike”. Në shembullin e përmendur, ne identifikojmë aftësinë e Federatës Ruse për të përdorur hakerat për të kryer sulme kibernetike (ato iu atribuuan Federatës Ruse vetëm në vitin 2020, qëllimi, i demonstruar nga koordinimi i sulmeve kibernetike me përdorimin e forcave konvencionale dhe situatën politike në Gjeorgji, në interesin e Federatës Ruse që në atë kohë, nuk i shërbente presidentit të ri të Federatës Ruse. Akashvili, u angazhua në afërsi me strukturat perëndimore dhe u përpoq të riintegronte provincat e Osetisë së Jugut dhe Abkhazisë” dhe së fundi, por jo më pak e rëndësishme, mundësia e krijuar nga cenueshmëria e sistemeve gjeorgjiane të IT-së.

Një nga pyetjet më të zakonshme midis studiuesve dhe vendimmarrësve në dekadën e fundit ishte **“Çfarë është lufta hibride?”**. Punime të shumta shkencore kanë trajtuar këtë temë në përpjekje për të përcaktuar dhe deklaruar një sërë karakteristikash specifike të këtij lloji konflikti. Ndër të parët që spikati

⁹ “War, vagueness and hybrid war.” Defence Studies 19 (2): 189-204. - <https://www.tandfonline.com>

dhe dha një kontribut thelbësor është Frank Hoffman, është ai që emërtoi konfliktet e karakterizuara nga përdorimi i njëkohshëm i mjeteve nga disa fusha: ushtarake, IT, psikologjike, ekonomike dhe politike, nga forca të stërvitura mirë dhe fleksibël. Sipas tij, *“lufta hibride përfshin një sërë mënyrash të ndryshme për të zhvilluar një luftë që përfshin aftësi konvencionale, por gjithashtu teknika dhe mjete specifike për luftën asimetrike, aktet terroriste, dhunën pa dallim, detyrimin dhe madje edhe veprimet kriminale (Hoffman 2007)”*. Në të njëjtën kohë, Thornton pohon se: *“një nga karakteristikat kryesore të luftës hibride është se “mënyrat e konfliktit mbivendosen dhe bashkohen. Kështu, hapësira e betejës, siç është, mund të formësohet në një nivel nga operacionet konvencionale dhe aktivitetet e parregullta dhe njëkohësisht, në një nivel më të lartë, nga aplikimi i presioneve themelore politike dhe ekonomike” (Thornton 2015, 40-48).*

Kështu, ne mund të nxjerrim përfundimin se lufta hibride përfshin përdorimin e kombinuar të mjeteve konvencionale, forcave ushtarake dhe instrumenteve, me mjete asimetrike. Nga ana tjetër, nga përkufizimi i luftës hibride, i dhënë nga Giannopoulos, Smith dhe Theocharidou (2021, 11), përkatësisht *“kombinimi dhe sinkronizimi i qëllimshëm i veprimeve, nga një aktor armiqësor, duke synuar në mënyrë specifike dobësitë sistemike në shoqëritë demokratike*», mund të nxjerrim një nga karakteristikat specifike të luftës, duke synuar luftën hibride. Pra, nuk po flasim më vetëm për sulme të drejtuara ndaj forcave ushtarake kundërshtarë, por edhe për identifikimin dhe shfrytëzimin e dobësive të kundërshtarit, duke përfshirë popullatën civile, jo-luftëtare. Gjithashtu, llojet e veprimeve të përdorura dhe kërcënimet e nisura kundër forcave armike apo popullatës civile janë shumë të ndryshme, nga sulmet me raketa balistike, te operacionet psikologjike apo sulmet kibernetike, që zakonisht përdoren njëkohësisht në objektiva të ndryshëm, për arritjen e objektivave strategjikë.

Një tjetër pikëpyetje e madhe për luftën hibride dhe kërcënimet është nëse ato janë të reja apo thjesht një mënyrë tjetër për të emërtuar atë që dihej tashmë. Ka zëra që thonë se luftërat hibride janë po aq të vjetra sa vetë lufta, por ato janë edhe të ndryshme. Në të njëjtën kohë, Giannopoulos (2021) konsiderojnë se evolucioni i luftës drejt kësaj forme hibride jepet kryesisht nga dinamika e mjedisit të sigurisë, nga mjete, koncepte dhe teknologji të reja, të përdorura njëkohësisht për të shfrytëzuar dobësitë. Prandaj, lufta hibride është një koncept relativisht i ri, por ai që përfshin risinë e krijuar nga teknologjia dhe përdorimin e saj për qëllime armiqësore. Në të njëjtën kohë, megjithëse koncepti u prezantua dhe u zhvillua më shumë se pesëmbëdhjetë vjet më parë me nxjerrjen e Strategjisë Kombëtare të Mbrotjes së SHBA-së në 2005, kur për herë të parë identifikuan nevojën për të përshtatur legjislacionin, politikat dhe masat mbrojtëse kundër këtyre llojeve të kërcënimeve, vetëm pas pushtimit

të Krimesë në 2014, koncepti i “luftëbërësve hibride” fitoi një rëndësi dhe vendim të veçantë. Kështu, si NATO ashtu edhe Bashkimi Evropian, filluan të përfshijnë termin “hibrid” në politikat dhe strategjitë e tyre (Mikac 2022).

Një karakteristikë tjetër që konsiderojmë ta përcaktojmë në drejtim të kategorizimit të konfliktit si hibrid, përfaqësohet nga mjegullimi i kufijve të shteteve dhe mungesa e qartësisë në përcaktimin e periudhës së konfliktit. Ajo që synojmë të theksojmë është fakti se mjetet e përdorura në një konflikt hibrid, pavarësisht nëse flasim për sulme kibernetike, propagandë, dezinformim apo sulme terroriste, nuk dalin domosdoshmërisht në kohë konflikti, në kuadrin e një lufte të shpallur, por mund të përbëjnë kërcënim hibrid për sigurinë e shteteve, gjë që e shtyn më tej diskutimin nëse është vërtet një shtet i natyrshëm apo një konkurrencë e natyrshme.

2. LLOJET E KËRCËNIMEVE HIBRIDE

Filozofi Giannopoulos¹⁰ zhvilloi një model konceptual të kërcënimeve hibride për sa i përket aktorëve, mjeteve, fushave të prekura, aktivitetit dhe objektivit, ku ky i fundit u krijua si minues i aftësisë vendimmarrëse. Mjetet e përdorura nuk janë domosdoshmërisht veprime të paligjshme ose hibride. Për shembull, nga lista e gjerë e kërcënimeve hibride, ushtrimet ushtarake apo mbështetja e disa aktorëve politikë nuk janë as aktivitete të paligjshme dhe as nuk përbëjnë kërcënim hibrid të pavarura. Në vend të kësaj, disa kombinime të instrumenteve të tilla, të përdorura njëkohësisht dhe që synojnë destabilizimin e shoqërisë nga pikëpamja politike, ekonomike, sociale ose ushtarake, janë pjesë e kategorisë së kërcënimeve hibride.

Ashtu si me çështje të tjera që lidhen me luftërat dhe kërcënimet hibride, kur bëhet fjalë për identifikimin e llojeve të kërcënimeve hibride, situata nuk është aspak e qartë. Karakteri hibrid jepet nga një sërë faktorësh, nëse vetëm një person ndan një lajm të rremë në një rrjet social, nuk mund të flasim për ekzistencën e një kërcënimi hibrid. Gjithmonë merren parasysh aktorët e përfshirë, kombinimi i mjeteve kinetike dhe jokinetike, qëllimi i kërcënimit, interesat dhe objektivat strategjike dhe sigurisht prania e paqartësisë në të gjitha aspektet e përmendura, për të qenë në gjendje të thuhet se po zhvillohet një luftë apo një operacion hibrid.

Zhvillimi i teknologjisë ka çuar në shfaqjen e inovative të kërcënimeve që shkojnë përtej sferës rreptësisht ushtarake. Ndonëse disa prej tyre kanë ekzistuar për një kohë shumë të gjatë, si operacionet psikologjike, nga të cilat përmendim propagandën dhe dezinformimin, mënyrën e përdorimit të tyre,

¹⁰ Antonios Giannopoulos, Universiteti i Ekonomisë dhe Biznesit të Athinës | AUEB Departamenti i Marketingut dhe Komunikimit, Doktor i filozofisë. Studimi: *Dynamic_Simulation_Research_on_the_Effect_of_Gover.pdf*

masën në të cilën kryhen dhe hollësitë karakteristike përbëjnë probleme të mëdha në identifikimin, parandalimin dhe luftimin e këtyre kërcënimeve hibride. Një studiuese¹¹, thekson se lufta e informacionit e zhvilluar nga Federata Ruse kërcënon të gërryejë besimin në të vërtetat faktike dhe të shkaktojë dëme konkrete përmes dezinformimit.

Sulmet kibernetike zënë një vend të veçantë në llojet e mjeteve të përdorura në një luftë hibride, ndonjëherë edhe duke qenë mjeti kryesor “luftues”. Rusia dihet se përdor taktika të tilla përmes grupeve të hakerëve të financuar nga shteti dhe shembujt janë të shumtë, nga sulmet kibernetike kundër Estonisë në 2007, tek ato kundër Gjeorgjisë në 2008 ose ato kundër Ukrainës si në vitin 2014 me aneksimin e Krimesë, ashtu edhe ato që lidhen me konfliktin aktual.

3. AKTORËT SHTETËRORË DHE JOSHTETËRORË QË PËRDORIN KËRCËNIME HIBRIDE

Kur flasim për luftën hibride, një pjesë e rëndësishme e diskutimit është fokusimi në llojet e aktorëve të përfshirë, lidhjet midis tyre dhe karakteristikat specifike të secilit. Para së gjithash, aktorët ndahen në dy kategori: aktorë shtetërorë dhe aktorë joshtetërorë.

Qoftë për aktorë shtetërorë apo jo shtetërorë, diskutimi nuk mund të jetë bardh e zi, pasi, si në rastin e llojeve të veprimeve të përdorura, kufijve, objektivave, vija e demarkacionit midis dy *kategorive është e paqartë*. Nëse marrim si shembull luftën izraelite në Liban, të përmendur më herët në artikull, shkrimi midis një aktori joshtetëror – Hezbollahut dhe një aktori shtetëror – Libanit është të paktën i dukshëm. Siç sugjeron Hoffman,¹² “*Hezbollahu ka demonstruar një sërë aftësish ushtarake të ngjashme me ato të përdorura nga shtetet, duke përfshirë mijëra raketa dhe predha me rreze të shkurtër dhe të mesme. Ky rast demonstroi aftësinë e aktorëve joshtetërorë për të studiuar dhe dekonstruuar dobësitë e ushtrive të stilit perëndimor*”. Nga ana tjetër, studiuesit për çështjet e luftës hibride¹³ besojnë se përdorimi i aktorëve joshtetërorë nga shtetet ka ndodhur gjithmonë, por *fuqia e aktorëve joshtetërorë është rritur me zhvillimin e teknologjisë dhe shërbimeve financiare*, fusha në të cilat aktorë të caktuar joshtetërorë u bënë ekspertë me

¹¹ Elina Treyger është një shkencëtare e lartë politike dhe është gjithashtu një juriste. Puna e saj në RAND përfshin tema në tre fusha të kërkimit: (1) siguria e vendit (me fokus në migrimin, zbatimin e imigracionit dhe dezinformimin); (2) siguria kombëtare dhe mbrojtja (me fokus në Rusi dhe konkurrencë strategjike pa konflikt); dhe (3) politika e drejtësisë (që përfshin temat në drejtësinë penale dhe civile, teknologjinë dhe ligjin).

¹² Hoffman, Frank. 2007. Conflict in the 21st century: The Rise of Hybrid Wars. Arlington, Virginia: Potomac Institute for Policy Studies. (Hoffman 2007, 35-36).

¹³ Jokinen, Janne și Magnus Normark. 2022.” Hybrid threats from non-state actors: A taxonomy.” Hybrid CoE Research Report.

kalimin e kohës. Rrjedhimisht, gjasat që ato të përdoren nga shtetet janë rritur ndjeshëm. Në të njëjtën kohë, aktorët joshtetërorë mund të gjenden gjithashtu në pozicionin e kundërshtarëve të shteteve.

Një aspekt tjetër për t'u marrë në konsideratë është fakti se pavarësisht nga forma në të cilën paraqitet një aktor joshtetëror, nëse bëhet fjalë për individë, organizata pak a shumë të formuara, grupe të armatosura, etj., ende nuk ka ligje ndërkombëtare që deklarojnë regjimin, rolin apo përgjegjësitë e aktorëve joshtetërorë në mënyrë të qartë¹⁴. Pra, nga kjo situatë përfitojnë si aktorët shtetërorë ashtu edhe ata joshtetërorë, të parët duke përdorur aktorë joshtetërorë për të arritur qëllimet e tyre, ndonjëherë në rrethana të dyshimta dhe aktorë joshtetërorë duke pasur nga njëra anë lirinë për të bashkëpunuar ose jo me shtetet dhe, nga ana tjetër, duke qenë në gjendje të ushtrojnë ndikim në politikat e shteteve.

Rauta¹⁵ sugjeron një klasifikim të aktorëve joshtetërorë që përbëjnë grupe luftarake, duke marrë parasysh marrëdhëniet midis tyre dhe shteteve, në forca përfaqësuese, ndihmëse, zëvendësuese dhe të lidhura kështu:

- forcat përfaqësuese janë grupe të armatosura; ata nuk janë pjesë e forcave të rregullta, por luftojnë për to ose në emër të tyre;
- trupat ndihmëse nuk janë pjesë e forcave të rregullta, por bashkëpunojnë me to, duke u përfshirë në strukturën e forcave;
- zëvendësuesit përdoren nga forcat e rregullta për të plotësuar ato apo edhe për t'i zëvendësuar plotësisht;
- degët janë ata që luftojnë për forca të rregullta, duke mbetur zyrtarisht jashtë konfliktit.

Një klasifikim i tillë rezulton nga mënyra se si shtetet konsiderojnë dhe përdoren aktorët joshtetërorë, përfshirja e tyre dhe mënyra në të cilën ndodh. Disa gjëra në realitet nuk janë aq të qarta pasi lufta hibride dhe aktorët që përdorin kërcënime hibride karakterizohen nga paqartësi dhe përfshirja e aktorëve joshtetërorë nuk është gjithmonë e dukshme, gjë që e bën të vështirë, nëse jo të pamundur, identifikimin dhe katalogimin e të gjithë aktorëve të përfshirë.

Aktorët joshtetërorë ose mund të mbështesin shtetin për arsye të ndryshme, të kenë qëllime të përbashkëta, të ndajnë të njëjtën ideologji, etj., ose janë shtetet që mbështesin, si sponsorë, disa grupe ose organizata për të njëjtat arsye, me ç'rast luftuesi zyrtar është aktori joshtetëror dhe shteti zyrtarisht nuk është i

¹⁴ Kleckowska, Agata. 2020. "States vs. non-state actors – a public international law perspective." Hybrid CoE Strategic Analysis.

¹⁵ Rauta, Vladimir, 2019. "Towards a typology of non-state actors in "Hybrid Warfare": Proxy, auxiliary, surrogate and affiliated forces." Cambridge Review of International Affairs

përfshirë në konflikt. Aktorët joshitetërorë mund të marrin formën e çdo kombinimi të rrjeteve kryengritëse ose terroriste, grupeve të krimit të organizuar, grupeve sociale si klane, fise ose grupe etnike, të cilat të gjitha mund ose nuk mund të mbështeten haptazi ose fshehurazi nga shtetet ose bizneset legjitime¹⁶. Numri i madh i llojeve të aktorëve joshitetërorë, ***aftësitë e tyre që ndonjëherë arrijnë apo edhe tejkalojnë ato të shtetit***, nuk e bëjnë më të lehtë punën e atyre që luftojnë kundër kërcënimeve hibride.

Lidhur me aktorët e përfshirë në operacionet hibride, sfida më e madhe në përpjekjen për të parandaluar ose ***luftuar një kërcënim hibrid është kryesisht identifikimi i tyre*** (Jokinen dhe Normark 2022¹⁷, pasi ka situata ku nuk mund të përcaktohet me saktësi përfshirja e një aktori të caktuar. Shtetet mund të përfitojnë nga kjo situatë, në kuptimin që ata gjithmonë mund të mohojnë dhe hedhin poshtë çdo akuzë për përfshirje në aktivitete hibride dhe, sipas Giannopoulos:¹⁸ “*Shtetet që drejtojnë veprimtari nëpërmjet subjekteve joshitetërore shfrytëzojnë mundësinë për të kryer aktivitete të natyrës së dëmshme kundër vendeve të tjera në mënyrë të fshehtë. Kjo ka avantazhin që e bën më të vështirë për shtetet e synuara zbulimin e aktivitetit në lidhje me gjendjen e dëmshme dhe reagimin përpara se të ndodhë, por gjithashtu pengon aftësinë e shtetit të synuar për t’ia atribuuar operacionin e dëmshëm shtetit të huaj që qëndron pas ngjarjes ose serisë së ngjarjeve”.*

4. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E LUFTËS HIBRIDE

Si çdo konflikt që ka ndodhur ose do të ndodhë, edhe luftërat hibride bazohen në një qëllim, një motivim, në disa objektiva. Në shumicën e rasteve ato bien në sferën politike duke ndikuar në politikat e disa shteteve, duke ulur besimin e popullatës në institucionet shtetërore, me një fjalë duke dobësuar qeverisjen e një shteti apo edhe në rënien e tij. Në të njëjtën kohë, çdo cënueshmëri e shtetit mund të shfrytëzohet brenda një operacioni hibrid, kjo është mënyra e veprimit të kërcënimeve hibride, duke identifikuar dhe shfrytëzuar dobësitë e një shteti ose të mënyrës së luftimit (Hoffman 2007).

Përpara nisjes së një operacioni hibrid, pas përcaktimit të objektivave të ndjekura, hapi tjetër është ***përzgjedhja e objektivit***. Ky veprim është i lidhur ngushtë me identifikimin e dobësive për t’u shfrytëzuar. Sipas Cederberg¹⁹, ato

¹⁶ Giannopoulos, Georgios, Hanna Smith și Marianthi Theocharidou. 2021. The landscape of hybrid threats: A conceptual model. Luxembourg: Publications Office of the European Union.

¹⁷ Jokinen, Janne și Magnus Normark. 2022.” Hybrid threats from non-state actors: A taxonomy.” Hybrid CoE Research Report.

¹⁸ Giannopoulos. The landscape of hybrid threats: A conceptual model. Luxembourg: Publications Office of the European Union

¹⁹ Cederberg, How can Societies be Defended against Hybrid Threats. Geneva Centre for Security Policy.

ato përfshijnë të gjitha aftësitë ushtarake, sigurinë e brendshme, fushën e brendshme dhe të jashtme politike, ekonominë, infrastrukturën, standardin e jetesës dhe qëndrueshmërinë e popullsisë ndaj operacioneve psikologjike²⁰.

Operacioni hibrid zhvillohet në kryqëzimin e cënueshmërisë së identifikuar, aftësisë së sulmuesit për të shfrytëzuar këtë dobësi dhe objektivat e ndjekura nga ky i fundit. Cederberg²¹ argumenton se “operacionet hibride bazohen në përdorimin e asimetrive të identifikuara për t’i bërë operacionet të suksesshme duke u përballur me pikat e forta të dikujt kundër dobësive të njohura të objektivate”. Në artikullin e tij²², pohon gjithashtu se: “mënyra e veprimit në operacionet hibride bazohet në shfrytëzimin e dobësive, por edhe në shmangien e konfrontimit të drejtpërdrejtë”. Në të njëjtën kohë, historia e kohëve të fundit na dëshmon se objektiva të caktuara ende nuk mund të arrihen pa një element aktiv ushtarak, siç është rasti në konfliktin aktual ruso - ukrainas, i cili përfshin gjithçka, nga agresioni i armatosur deri te sulmet kibernetike,²³ ose operacionet psikologjike, sipas BE-së²⁴.

Një arsye e veçantë pse shtetet do të angazhoheshin në veprime hibride, veçanërisht nëpërmjet aktorëve joshtetërorë me aftësi të caktuara, mund të ishte të fitonin akses në infrastruktura ose sisteme të caktuara. Autori e konsideron këtë një shembull shumë të mirë se si shtetet mund të veprojnë nëpërmjet palëve të treta për të ndikuar, ndërhyrë ose penguar punët e të tjerëve për të gjeneruar pasoja negative ose për të krijuar aftësinë për ta bërë këtë kur të dëshirohet.

PËRFUNDIME

Shumëfishimi i kërcënimeve hibride ndaj sigurisë së shteteve, sidomos në luftërat e zhvilluara vitet e fundit ka krijuar polemika dhe dallime mendimesh si në botën akademike ashtu edhe në atë politik. Luftërat hibride dhe kompleksiteti i tyre janë studiuar dhe ndoshta do të studiohen për një kohë të gjatë, veçanërisht ***për shkak se dimensionit i informacionit, i cili shpesh qëndron në themel të shfaqjes së shumë llojeve të tjera të kërcënimeve***, është në zhvillim.

Edhe pse në nivelin e teoricienëve nuk ka konsensus për përdorimin e termave kërcënim, konflikt, operacion apo luftë hibride, mund të konstatojmë se mjetet e përdorura dhe mënyrat e kombinimit të tyre, përfshirja e aktorëve joshtetërorë

²⁰ Po aty

²¹ Po aty (Cederberg dhe Eronen 2015)

²² Po aty (Cirdei 2016, 113-119)

²³ Viasat. 2022. “KA-SAT Network cyber attack overview.” <https://news.viasat.com/blog/corporate/ka-sat-network-cyber-attack-overview>.

²⁴ EU - <https://euvsdisinfo.eu/key-narratives-in-pro-kremlin-disinformation-nazis/>

dhe shtetërorë, synimet e ndjekura dhe, ndoshta më e rëndësishmja, paqartësia e të gjitha aspekteve të sipërpërmendura dhe karakteri i ndonjë elementi hibrid, në të vërtetë të luftës, janë përcaktuese të çdo elementi apo operacioni të konfliktit.

Shfaqja dhe evolucioni i koncepteve të kërcënimeve dhe luftërave hibride nuk janë të reja. Hibriditeti i konflikteve dhe kërcënimeve nuk krijon një koncept krejtësisht të ri, por në një vazhdimësi dinamike, të përshtatur me aftësitë teknologjike të kohës sonë. Edhe pse termi “hibrid” ka hyrë në fjalorin e akademikëve dhe vendimmarrësve politiko-ushtarakë gati 20 vjet më parë, por më e theksuar pas vitit 2014, kjo mënyrë luftimi mund të vërehet edhe në konflikte shumë më të vjetra, veçanërisht kur i referohemi përdorimit të mjeteve joushtarake si propaganda apo dezinformimi. Për më tepër, karakteri hibrid i shtimit të kërcënimeve dhe konflikteve bashkëkohore filloi të lidhej gjithnjë e më shumë me dimensionin e tyre kibernetik. Ky i fundit është një mjet në vetvete por edhe një mjet për zbatimin e llojeve të tjera të kërcënimeve, që gjeneron jo vetëm paqartësi, por edhe mjegullim të kufijve shtetërorë, veprime që shpesh ndodhin në hapësirën kibernetike. Siguria dhe mbrojtja ndaj luftës hibride dhe kërcënimeve kanë qenë dhe do të vazhdojnë të jenë një sfidë, veçanërisht për shkak të paqartësisë së qenësishme, si në aspektin e mjeteve të përdorura, kombinimit dhe sinkronizimit të tyre, ashtu edhe në aspektin e identifikimit të aktorëve të përfshirë. Evolucioni dhe karakteri dinamik i koncepteve të luftës hibride dhe kërcënimit hibrid paraqet një sfidë për sigurinë e shteteve në rajon por edhe të vendit tonë. Karakteristikat e tyre përcaktuese nuk lejojnë më as mbrojtjen individuale dhe as trajtimin e secilit kërcënim veç e veç, por do të kërkohej një qasje e përbashkët e shteteve, planifikim rigoroz i mbrojtjes duke përfshirë të gjitha fushat kryesore të shoqërisë. Këto çështje do të zënë një vend të veçantë tashmë në proceset e planifikimit të mbrojtjes dhe mbështetjes në NATO - NDPP. Për më tepër, identifikimi dhe zbutja e dobësive të shoqërisë përpara se ato të shfrytëzohen nga subjektet armiqësore duhet të jetë një nga qëllimet kryesore të planifikimit por edhe të rishikimit të dokumenteve kryesorë të sigurisë dhe mbrojtjes.

BURIME TË SHFRYTËZUARA

1. Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH, 2014.
2. Strategjia Ushtarake e RSH, 2015
3. Koncepti Strategjik i NATO-s, 2022 https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/2022/6/pdf/290622-strategic-concept.pdf.
4. Doktrina e Përbashkët në Forcat e Armatosura të RSH, 2017.
5. Almwng, *Lufta, paqartësi dhe lufta hibride*. Studime të Mbrojtjes 19 (2):

- 189-204. janar 2019. <https://www.tandfonline.com>;
6. Cederberg, *Si mund të mbrohen shoqëritë kundër kërcënimeve hibride*. Qendra e Gjenevës për Politikën e Sigurisë (9).
 7. Dempsey, Martin. *Strategjia Kombëtare Ushtarake e Shteteve të Bashkuara të Amerikës*. <https://history.defense.gov/Historical-Sources/National-Military-Strategy/>
 8. Giannopoulos, Georgios, Hanna Smith dhe Marianthi Theocharidou, *Peizazhi i kërcënimeve hibride: Një model konceptual*, Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2021.
 9. Hoffman, Frank, *Konflikti në shekullin e 21-të: Ngritja e Luftërave hibride*. Arlington, Virxhinia: Instituti Potomac për Studime Politike, 2007.
 10. “Mendime të mëtejshme mbi kërcënimet hibride.” Small Wars Journal, 2009. “Arafat hibride dhe sfidat.” JFQ (52): 34-48.
 11. Janičatova, Silvie dhe Petra Mlejnková, 2021.” Paqartësia e “arfareve hibride: Një analizë cilësore e përmbajtjes së diskursit politik - ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar mbi aktivitetet armiqësore të Rusisë.” Politika Bashkëkohore e Sigurisë.
 12. Jokinen, Janne dhe Magnus Normark, *Kërcënimet hibride nga aktorët joshitetërorë: Një taksonomi*, Raporti i Kërkimit Hibrid i CoE, 2022.
 13. Mikac, Robert, *Përcaktimi dhe zhvillimi i përkufizimeve dhe koncepteve të kërcënimeve hibride dhe Wars hibride: Krahësimi i zgjidhjeve në nivel të Bashkimit Evropian, NATO-s dhe Kroacisë*. Politika në Evropën Qendrore 18 (3): 355-374, 2022.
 14. Roguski, Przemysław. 2020. “Sulmet kibernetike ruse kundër Gjeorgjisë, atributet publike dhe sovraniteti në hapësirën kibernetike.” <https://www.justsecurity.org/69019/russian-cyber-attacks-against-georgia-public-attributions-and-sovereignty-in-cyberspace/>.
 15. Smith, Brad. 2022. “Mbrotja e Ukrainës: Mësime të hershme nga Cyber Luftw.” <https://blogs.microsoft.com/on-the-issues/2022/06/22/defending-ukraine-early-lessons-from-the-cyber-war/>.
 16. Treyger, Elina, Joe Cheravitch dhe Raphael S. Cohen. 2022. Përpyjekjet ruse për dezinformim në mediat sociale. Santa Monica: RAND Corporation.
 17. Veebel, Viljar. 2016. “Estonia përballet me propagandën: Rusia manipulon mediat në ndjekje të një problemi psikologjik.” Për Concordiam 7 (1): 14-19.

RUBRIKA E DYTË

ARSIMIMI DHE STËRVITJA

AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA, GARANCI NË FORMIMIN E USHTARAKUT SHQIPTAR SI LIDER I ARDHSHËM

Kolonel (R) Dr. Ahmet LEKA
Zëvendësdekan i FMS, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Jetojmë në një kohë kur e gjithë shoqëria ka ndryshuar dhe po ndryshon në shumë plane, në të gjitha drejtimet. Siç dihet, jo të gjitha ndryshimet janë për mirë, e jo të gjitha janë pozitive. Por ndërsa të gjitha shtresat e tjera të shoqërisë kanë trajektoren e tyre të përmirësimit të anëve të ndryshme të jetës, me shtresën e ushtarakëve në Shqipëri dhe jo vetëm, ndodh ndryshe, nëse i referohemi misionit të ushtarakut. Ne themi ushtar profesionist, ushtri profesioniste, e doemos kështu është. Por meqenëse profesioni i ushtarakut është i ndryshëm në ushtrim dhe në funksionim, atëherë nuk mund të jetë njësoj me profesionet e tjera në jetën civile. Për shembull, një inxhinier ose informaticien me të njëjtat njohuri punon si në sektorin privat, ashtu edhe në strukturat e Forcave të Armatosura.

Por mënyra e ushtrimit të profesionit, përkushtimi në ushtrimin e tij, janë e duhet të jenë krejt të ndryshme.

Meqenëse Akademia e Forcave të Armatosura është i vetmi institucion që përgatit oficerin (në çdo specialitet), asaj i bie barra edhe për ngjizjen, formimin e karakterit të oficerit. Sepse këta oficerë që sot studiojnë në auditoret tona, do të jenë komandantët dhe drejtuesit e ardhshëm të Forcave të Armatosura, në të gjitha strukturat.

Skalitja e karakterit të ushtarakut është proces mësimor, por jo i mjaftueshëm. Është përgatitje për specialitetin përkatës, por jo e mjaftueshme. Është mënyra

klasike e mësimdhënies, por jo e mjaftueshme. Zhvillimi karakterial i njeriut, më së shumti praktikisht është “zeje”. Një “zejtari”, që është shumatorja e të gjithave, më saktë një “Kimi” e veçantë, të cilën mund ta realizojë vetëm Akademia Ushtarake, me pedagogët e saj. Ky është qëllimi i këtij punimi të shkurtër, duke menduar se autori ofron mendimin e tij modest, për këtë çështje shumë të rëndësishme.

Ne nuk jemi vend i pa përvojë në formimin e oficerit. Madje kemi zgjedhur për zbatim dhe përshtatje, edhe programet e “West Point”-it

Fjalët kyçe: arsimimi ushtarak, AFA, mjedis i sigurisë, programi afatgjatë i zhvillimit, zhvillim i karakterit ushtarak

“Arsimi është arma më e fuqishme, që mund ta përdorni për të ndryshuar botën”

Nelson Mandela¹

HYRJE

Ndryshimet e mëdha moralo-politike, psikologjike, ushtarako-teknike, sociale, profesionale dhe etike që kanë përfshirë shoqërinë tonë, kërkojnë që edhe rrethi i dijeve, aftësive, shprehive dhe vlerave të ushtarakut shqiptar të ndryshojë shumë. Zhvillimet në FA synojnë të ruajnë një balancë të shëndoshë me shoqërinë dhe komunitetin në tërësi.

Ndryshimi i mjedisit strategjik drejt një bote komplekse dhe të pasigurt, ku kërcënimet po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe ndërlidhura, na vendos përballë sfidave të reja ku arsimimi profesional i oficerëve, drejtuesve të së ardhmes në të gjitha nivelet e FARSH, të aftë për t’u orientuar dhe vepruar në këtë mjedis, kërkon zhvillimin, përmirësimin dhe forcimin e kapaciteteve arsimore, për të përballuar denjësisht sfidat e mjedisit të sigurisë.

Shqipëria, me politikën e saj në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, është kthyer në një partnere serioze dhe të besueshme në rajonin tonë dhe më gjerë. Shqipëria, nga një vend që konsumonte siguri, është kthyer në një vend që prodhon dhe kontribuon në ndërtimin e sigurisë në nivelin kombëtar, rajonal dhe global. Pa diskutim në këtë kuadër një rol shumë të rëndësishëm luajnë Forcat e Armatosura, si një nga instrumentet kryesorë të fuqisë kombëtare, të cilat në bashkëpunim me partnerët euroatlantikë janë garancia e sigurisë, integritetit, sovranitetit dhe prosperitetit të vendit.

Bazuar në Programin Afatgjatë të Zhvillimit, Forcat e Armatosura vazhdojnë procesin e reformimit strukturor, konceptual, doktrinar, si dhe modernizimin

¹ Nelson Rolihlahla Mandela (1918 - 2013), aktivist dhe politikan i Afrikës së Jugut kundër aparteidit, i cili shërbeu si president i parë me ngjyrë i Afrikës së Jugut në vitet 1994-1999.

e tyre me synim transformimin total në një forcë fleksibël, të manovrueshme dhe të aftë, për të kryer detyrat në kuadrin e misionit kushtetues dhe burimeve që rrjedhin prej saj. Theksojmë se në kushtet e rreziqeve dhe sfidave të krijimit të një mjedisi të ri të sigurisë në rrafshin rajonal dhe global, zhvillimit të ekonomisë, zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, ndërvepruese dhe bashkëpunuese me partnerët dhe aleancën, koncepti i përdorimit të FA-ve dhe misioni i tyre merr vlera të reja.

Pa dyshim, një rol të rëndësishëm në zhvillimin e këtyre proceseve luan përgatitja e oficerit dhe profesioni i ushtarakut, të cilat marrin vlera të mëdha në zhvillimin e forcës dhe garantimin për realizimin me sukses të misionit. Në këtë pikëpamje, institucionet arsimore të Forcave të Armatosura dhe veçanërisht Akademia e Forcave të Armatosura, luajnë rol kryesor në arsimimin institucional dhe funksional të personelit ushtarak në tërësi dhe kandidatëve për oficerë në veçanti.

Kryesore në këtë proces është të dallohet ana më esenciale e tij, që ndikon fuqishëm në të gjithë hierarkinë strukturore në FA, ku asnjë funksion apo detyrë nuk mund të jetë e shkëputur nga logjika e trajnimit dhe arsimimit.

1. ZHVILLIMI I KARAKTERIT, DETYRË E AKADEMISË

Akademia e Forcave të Armatosura, si institucioni kryesor i arsimit të lartë ushtarak luan një rol vendimtar në edukimin dhe formësimin e oficerit të ri, e cila me programet e reja të studimit përveç ofrimit të dijeve akademike universitare, i jep një tjetër vlerë formimit të ushtarakut, atë të zhvillimit të karakterit duke ruajtur balancën e duhur ndërmjet liderit dhe menaxherit ushtarak.

Me këtë synim, pas një studimi dhe mendimi të unifikuar, të kualifikuar dhe të bashkërenduar ndërmjet të gjithë faktorëve, u pa e domosdoshme rikonceptimi dhe ristrukturimi tërësor i Akademisë së Forcave të Armatosura, e cila me një vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, u përcaktua si institucioni i vetëm i arsimit të lartë ushtarak dhe kërkimit shkencor në fushën e mbajtjes dhe sigurisë².

Ndryshimi i mjedisit strategjik na vendos përballë sfidave të reja ku arsimimi profesional i ushtarakëve, drejtuesve të së ardhmes në të gjithë nivelet e FARSH, të aftë për t'u orientuar dhe vepruar në këtë mjedis kërkon zhvillimin, përmirësimin dhe forcimin e kapaciteteve arsimore, për të përballuar denjësisht sfidat e mjedisit të sigurisë. Ndryshimet kërkojnë përmirësimin e përhershëm,

² Vendim nr.156, datë 19.02.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare”.

midis të tjerave edhe të sistemit të arsimimit, dhe në këtë kuadër, sot kur ka përfunduar ristrukturimi i radhës për AFA, duhet të shohim përpara në 10 vitet e ardhshme jo vetëm për të parashikuar se cilat do të jenë nevojat për transformimin e arsimimit, por edhe se si do të arrijmë atje. “Arsimimi është arma më e fuqishme që mund të përdoret për të ndryshuar botën” - thoshte Nelson Mandela.

Arsimimi, në çdo shoqëri, për çdo profesion, është parakusht themelor për ekzistencën e vetvetes dhe të brezave që do të vijnë. “

“Arsimimi nuk është përgatitja për jetën, thoshte John Dewey, por vetë jeta,”³- thoshte John Dewey.

Ai i pajis pjesëtarët e shoqërisë me njohuri, aftësi, arsye dhe gatishmëri, për të vepruar. Këto konsiderohen sot, si përmbajtja themelore e konceptit të arsimimit, që kryhet në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Akademia është përgjegjëse për zbatimin e të gjitha politikave të arsimimit të lartë ushtarak në FA, ajo do të sigurojë zhvillimin e programeve akademike në tre ciklet e studimit dhe kualifikimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Ajo është konceptuar, ndërtuar dhe destinuar të funksionojë mbi bazën e sistemit Ligjor të Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë, ligjeve organike në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, përvojës më të mirë të Universiteteve shqiptare dhe vendeve partnere, kryesisht duke marrë për “model”, Akademinë e West Point-it në SHBA.

Një vlerë e veçantë, që i bën të dallueshme akademitë ushtarake në gjithë botën nga institucionet e tjera universitare, është zhvillimi i programit të karakterit në ndërthurje të natyrshme me programin akademik, i cili farkëton te kandidatët e ardhshëm cilësitë më të mira të lidërshiptit e tyre. Një program efektiv dhe i arrirë i karakterit përgatit drejtuesit për përgjegjësitë e shtruara dhe vendos kushtet, për t'i aftësuar ata që të arrijnë rezultate të larta në hierarkinë e komandimit. Akademia e Forcave të Armatosura është institucioni i vetëm në vend që kultivon, zhvillon dhe formon lidërshipt për nevoja të Forcave të Armatosura. Prej ditës së parë të studimeve, studentët e rinj ushtarakë përfshihen në një proces të gjatë zhvillimi dhe formimi, me qëllim pajisjen me cilësi dhe karakteristika të një lideri. Ky “laborator” lidërshipti, mbart tashmë një histori 65-vjeçare shoqëruar me ulje dhe ngritje, ndryshime dhe reforma në organizim, kurrikul dhe infrastrukturë, në kërkim të përmirësimit dhe përshtatjes me kërkesat e një mjedisi sigurie i cili shfaq vetëm një “konstante”: ndryshimin.

Akademia e Forcave të Armatosura ka përcaktuar vizionin e saj, për të qenë

³ John Dewey (20 tetor 1859 - 1 qershor 1952), filozof, psikolog dhe reformator arsimor amerikan.

një kapacitet modern i arsimit të lartë ushtarak, i kërkimit shkencor në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe një “laborator” i ngjizjes dhe formimit të gjeneratës së re të oficerit, liderit të ardhshëm më të mirë në nivel kombëtar.

2. MISION I ZGJERUAR....

Sot kanë ndodhur ndryshime të mëdha në mjeshtërinë e profesionit ushtarak, me një prirje drejt ngushtimit të dallimeve mes detyrave civile dhe atyre ushtarake. Oficeri i ardhshëm duhet të realizojë gjithnjë e më shumë detyra, profesione dhe orientime të përbashkëta, me administratorët civilë. Atij do t’i duhet të demonstrojë aftësi të konsiderueshme në kryerjen e funksioneve ushtarake me natyrë logjistike, inxhinierike, sociologjike dhe psikologjike.

Në këtë kuptim, edukimi ushtarak duhet të synojë ruajtjen e një baraspeshe të përshtatshme midis këtyre funksioneve ushtarake dhe lidershipit, një deduksion ky që mbetet për t’u vlerësuar në të ardhmen. Në këtë këndvështrim, Akademia e Forcave të Armatosura është institucioni ku nëpërmjet zhvillimit të kurrikulave dhe programeve të studimit, ruan dhe ndërthur baraspeshën e duhur të të gjitha këtyre elementeve.

Ndryshimi i vazhdueshëm dhe i paparashikueshëm i mjedisit të sigurisë na dikton faktin se tashmë siguria është një koncept “kontestues”, i cili në varësi të rrezeve dhe mjedisit të sigurisë, evoluon dhe përshtatet. Si shembull konkret, mund të sjellim ndryshimet dramatike të mjedisit të jashtëm të sigurisë së NATO-s, që nga 2010 kur u miratua Koncepti Strategjik i NATO-s në Lisbonë e deri më sot, që me gjasa do të intensifikohet edhe më shumë, dhjetëvjeçarin e ardhshëm. Në këtë kuptim, në materialin përmbledhës të përgatitur për Samitin e NATO-s, në Bruksel, në vitin 2020 doli si përfundim themelor përshtatja dhe riformulimi i konceptit strategjik të NATO-s⁴.

Në këtë pikëpamje, në funksion të ndryshimit të mjedisit të sigurisë dhe koncepteve të reja strategjike, rishikohen praktikatat, programet dhe kurrikulat arsimore në AFA, si dhe zhvillohet procesi mësimor, kërkimor-shkencor dhe inovativ, me qëllim të një qasjeje të re reflektuese në të gjitha elementet e nevojshme në pikëpamjen organizative, strukturore, konceptuale, doktrinare, akademike dhe dokumentet strategjike.

Akademia e Forcave të Armatosura në misionin e saj, siguron zhvillimin e programeve akademike në tre ciklet e studimit dhe kualifikimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare. Ajo përfaqëson alternativën e vetme të besueshme, profesionale, konkurruese, me cilësi përgatitjeje bashkëkohore dhe

⁴ NATO 2030: United for a New Era Analysis and Recommendations of the Reflection Group Appointed by the NATO Secretary General, 25 nëntor 2020.

përshtatje me kërkesat e Forcave të Armatosura dhe nevojave të tjera në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Rëndësi për të ardhmen po i kushtohet formatimit dhe konsolidimit të plotë institucional, si dhe zhvillimit kurrikular dhe i programeve sipas modelit të West Point-it të SHBA-së, por edhe në përputhje me arsimimin e lartë publik kombëtar.

Prioritet i Akademisë do të jetë zhvillimi dhe konsolidimi i saj në përputhje me ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, misionin dhe përgjegjësitë kushtetuese të FARSH, doktrinën tonë kombëtare për mbrojtjen, me kërkesat dhe standardet e NATO-s.

Duke filluar nga ky vit, Akademia e Forcave të Armatosura kalon në zhvillimin e programeve të ciklit “bachelor”, sipas sistemit 4-vjeçar, mbështetur në modelin dhe përvojën e Akademisë së West Point-it, duke ruajtur traditën dhe kriteret ligjore të arsimit të lartë kombëtar.

Përpos kalimit në një sistem 4-vjeçar, një hap tjetër i rëndësishëm është hapja e programeve të reja: “Marrëdhëniet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes” dhe “Shkenca komunikimi në fushën e mbrojtjes”. Akademia e Forcave të Armatosura ka pranuar sfidën dhe po ecën në fushën evropiane të Arsimit të Lartë, duke iu përshtatur nevojave për ndryshim të Forcave të Armatosura, kërkesave të shoqërisë dhe parimeve në dijet shkencore. Sistemi i Bolonjës tashmë është një realitet dhe përvojë e madhe, që jepet për zhvillimin e arsimit, bashkëpunimit dhe forcimit të shoqërive të qëndrueshme, paqësore dhe demokratike, veçanërisht duke pasur parasysh vendet e Evropës Juglindore. Zhvillimet e shpejta të Forcave të Armatosura sipas standardeve të NATO-s, konsolidimi dhe përsosja e vazhdueshme e sistemit arsimor, do të sjellë nevojën e ndryshimeve të domosdoshme në dokumentet themelore të arsimit të personelit të FA.

Të mësojmë duke menduar

Sot edukimi dhe zhvillimi i karrierës së menaxherit dhe liderit të ardhshëm ushtarak paraqet problemin e madh të qartësisë së përvijimeve. Aktualisht, institucionet arsimore ushtarake janë thellësisht të interesuara, nëse ato mund të paraqesin në mënyrë adekuate një imazh të “njeriut të plotë”, me mendime dhe ide të qarta, që do të thotë vazhdimësi të programeve dhe thellim të njohurive shkencore për formimin e tij në fushën civile dhe ushtarake. Pra kërkohet oficeri i gjeneratës së re, që të përmbushë qëllimin e një misioni integral, në shërbim të shoqërisë dhe shtetit. “Të mësuarit pa menduar është punë e humbur, mendimi pa mësim është i rrezikshëm”⁵.

⁵ Konfuci ishte një mendimtar, mësues teorik, politikan dhe filozof kinez, themelues i Konfucianizmit.

Akademia e Forcave të Armatosura, një rëndësi të madhe duhet t'i kushtojë nxitjes dhe promovimit të rinjve ndaj shërbimit publik dhe karrierës ushtarake, me një vizion të qartë për ta në përjetësimin e traditës ushtarake shqiptare dhe të idealit, të vlerave të barasvlershme me ato civile dhe një profesion të garantuar mjaft atraktiv në shoqërinë civile.

Padyshim, që krahas fushave të ndryshme të përgatitjes së oficerit të ardhshëm, rëndësi të posaçme merr edukimi i studentëve ushtarakë rreth çështjeve politiko-ushtarake, ku nëpërmjet “Programit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare” duhet të përqendrohemi në njohjen e marrëdhënieve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, çështje të ndërveprimit dhe bashkëveprimit të Shqipërisë me NATO-n dhe vendet partnere, duke ngritur në nivele më të larta përvojën profesionale.

Vijimi i vazhdueshëm i punës në reformimin dhe konsolidimin e sistemit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fushën e mbrojtjes e të sigurisë dhe promovimi, rritja e bashkëpunimit dhe ndërveprueshmërisë me institucionet e tjera të arsimit të lartë në nivel kombëtar dhe sidomos bashkëpunimi me akademitë e ngjashme të vendeve të NATO-s, është dhe do të jetë një prioritet i vazhdueshëm.

Akademia e Forcave të Armatosura në ambiciet e saj për të ardhmen do të orientohet gjerësisht në krijimin e një mjedisi nxitës dhe krijues, rritjen e cilësisë akademike, infrastrukture moderne akademike, “produkt” sa më cilësor për gjeneratat e ardhshme, duke siguruar një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e procesit akademik. Një rëndësi të dorës së parë merr zhvillimi i brendshëm si një element kyç që duhet të reflektohet në faza të ndryshme të menaxhimit të procesit të performancës së stafit akademik. Në kushtet e ndryshimeve të mëdha rreth nesh, rritja e cilësisë në zhvillimin e arsimit, kualifikimit dhe trajnimeve për personelin e brendshëm akademik, do të përbëjë sfidën kryesore në aspektin profesional dhe do të mundësojë cilësi të mësimdhënies, qëndrueshmëri, besim, integritet, gjykim dhe përgjegjësi të lartë.

“Mësuesi mediokër tregon, mësuesi i mirë shpjegon, mësuesi epror demonstroi, kurse mësuesi i madh frymëzon”⁶.

3. KËRKIMI SHKENCOR

Krahas procesit të mësimdhënies, një rol të rëndësishëm do të ketë kërkimi shkencor, me qëllim kërkimin, studimin, rritjen e njohurive dhe kuptueshmërisë të realitetit të mjedisit të sigurisë dhe dukurive ushtarake. Pasiguritë e së ardhmes kërkojnë që të përshtatemi, çka duhet të aplikohet edhe në sistemin e arsimit universitar ushtarak, veçanërisht në programet

⁶ William Arthur Ward (17 dhjetor 1921 - 30 mars 1994), shkrimtar motivues amerikan.

“master” dhe “doktoratë”, të cilat nuk mund të konceptohen pa kërkime dhe punë aktive shkencore. -“*Në fakt, nuk është asgjë më pak sesa një mrekulli, - thoshte Albert Einstein⁷, - që metodat moderne të mësimdhënies nuk e kanë mbytur ende plotësisht kureshtjen e shenjtë të kërkimit. Sepse kjo bimë e vogël delikate, përveç stimulimit, ka nevojë kryesisht për liri. Pa liri, ajo shkon në shkatërrim dhe rrënim, pa dështuar*”.

Teoricieni i shquar ushtarak Karl Clausewitz⁸ shkroi: “Çdo gjë në luftë është shumë e thjeshtë. Por gjëja më e thjeshtë, është e vështirë”. Shembuj nga historia na tregojnë se si liderët ushtarakë si Aleksandri i Madh, Julius Cezari, Genghis Khan, Mehmeti i II-të “Ngadhënjyesi”, Napoleoni, Bernard Montgomery, Dwight Eisenhower etj., u përballën me këto vështirësi dhe arritën sukses dhe fitore të mëdha (Guy, 2019).


Akademia e Forcave të Armatosura ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë për më shumë se gjysmëshekulli, në prodhimin e elitave drejtuese të Forcave të Armatosura, por edhe përtej tyre. Për sa i përket kontributit dhe vlerave që mbart AFA në këtë fushë, së fundmi është kryer një studim nga pedagogët e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Kapiten Msc. Hekuran Budani dhe Msc. Orgest Xhangolli, rreth formimit dhe zhvillimit të suksesshëm të cilësive të lidershit të studentët ushtarakë. Studimi bazohet në pyetësor, të cilët lidhen me: rëndësinë e lidershit; vlerat morale dhe etike, si patriotizmi, nderi, detyra dhe integriteti; cilësitë psikologjike dhe emocionale, si vetëbesimi, vetëdija, motivimi, etj.

Nga analizimi i të dhënave të mbledhura nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar nga studentët e vitit të parë, na rezulton se përvetësimi dhe zhvillimi i karakteristikave dhe cilësive të liderit nga ana e tyre, arrin në shkallën 5.4 nga 10 sipas pyetësorëve. E përkthyer në përqindje arrin në masën 54%, për vitin e tretë në shkallën 8.05 ose 80.05 %, ndërsa për Kursin e Përgatitjes së Oficerit të Ri, në shkallën 6.6 ose 66% (shiko grafikun nr.1).⁹

⁷ Albert Einstein (14 mars 1879 – 18 prill 1955), fizikan i madh me origjinë gjermane, i njohur për zhvillimin e teorisë së relativitetit.

⁸ Carl Philipp Gottfried (ose Gottlieb) von Clausewitz (1780 – 1831), gjeneral i shquar gjerman dhe teoricien ushtarak. Vepra e tij më e shquar, Vom Kriege (“Për luftën”), megjithëse e papërfunduar pas vdekjes së tij, konsiderohet një traktat themelor mbi strategjinë ushtarake.

⁹ Kapiten Msc. Hekuran Budani, Msc. Orgest Xhangolli, *Akademia e Forcave të Armatosura, një “laborator” i formimit të gjeneratës së re të oficerit*, botuar në librin e konferencës shkencore “Arsimimi ushtarak shqiptar - 65 vjet Akademia e Forcave të Armatosura”, 2023, ISBN 9789928346247.



Interpretim krahasues i të dhënave empirike.

Nga sa më sipër, studimi tregon se përvoja e studimeve 3-vjeçare ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe të dukshëm në adaptimin dhe zhvillimin e studentëve me cilësi dhe karakteristika të lidershit. Në dritën e rezultateve të nxjerra nga ky anketim i thjeshtë, i cili sjell përpara nesh perceptimet individuale mbi zhvillimin e cilësive dhe karakteristikave të lidershit tek studentët gjatë studimeve, dalin qartë gjetjet. Analizimi i pyetësorëve tregon se studimet në Akademinë e Forcave të Armatosura, në programin “Shkenca Ushtarake”, ndikuan në zhvillimin dhe përvetësimin e cilësive të liderit tek studentët me një progres të dukshëm, nga viti i I-rë në vitin e III-të të studimeve. “Zemra dhe shpirti i lidershit, duket se përqendrohen te vendosmëria....”¹⁰

PËRFUNDIME

- Akademia e Forcave të Armatosura mbetet themeli i promovimit, zhvillimit dhe konsolidimit të vlerave civile dhe ushtarake, nëpërmjet zhvillimit të koncepteve bashkëkohore të arsimimit dhe kërkimit shkencor.
- Akademia jep mundësinë e zhvillimit të një profesioni ushtarak me dimensione të reja, i përshtatshëm edhe në fushën civile.
- Akademia e Forcave të Armatosura shfaq avantazh në zhvillimin dhe kultivimin e disa cilësive të veçanta të liderit, në raport me institucionet

¹⁰ James G. Stavridis, *Leader's bookshelf*, Gjenerali Stavridis shërbeu si komandant në Komandën Jugore të Shteteve të Bashkuara (2006-2009) dhe komandant në Komandën Evropiane e Shteteve të Bashkuara dhe Komandant Suprem i Aleatëve të NATO-s për Evropën (2009-2013).

publike të arsimit të lartë në vend. Mendoj se Departamentet duhet ta vrasin mendjen për tema dhe mënyra të ndryshme, të cilat ndikojnë ndjeshëm, në formimin dhe përsosjen e karakterit të oficerit të ardhshëm. Duke i ruajtur personalitetin, por duke e përsosur atë, në lidhje të ngushtë me misionin e tij.

BURIME TË SHFRYTËZUARA

1. “Lufta, Morali dhe Profesioni Ushtarak”, 1998.
2. Libri i konferencës shkencore “Arsimimi ushtarak shqiptar-65 vjet, Akademia e Forcave të Armatosura”, Tiranë 2023.
3. James G. Stavridis, “The Leader’s Bookshelf”.
4. “Fusha e Arsimit të Lartë European” - Karta e Bolonjës, 1999.
5. William Arthur Ward, “Fountains of Faith”, ISBN 978-0837567495.
6. “Për luftën”, Carl Philipp Gottfried (ose Gottlieb) von Clausewitz, gjeneral i shquar gjerman dhe teoricien ushtarak.

MBËSHTETJA LOGJISTIKE E OPERACIONEVE DHE SFIDAT PËR TË ARDHMEN

Kolonel Msc. Avni BILBILAJ
Shef Departamenti në IKSHU

Trajtesë e shkurtuar.

Ky punim synon të trajtojë (me aq sa është e mundur në hapësirën e një shkrimi), mbështetjen logjistike për operacionet e forcave ushtarake dhe faktorët që ndikojnë në këtë proces. Shkurtimisht janë përshkruar përkufizimet për mbështetjen logjistike, parimet e mbështetjes, fushat e veprimit dhe interesit, funksionet dhe shërbimet logjistike, fushat e interesit dhe organizimi i njësisë të logjistikës. Në pjesën e dytë të materialit janë përshkruar mbështetja logjistike, siç ishte parashikuar dhe siç u realizua në disa operacione si: “Cobra” (Francë, Normandi 1944), Stuhia e Shkretëtirës (“DESERT STORM”, Irak 1991), “Agimi i Gjelbër” (“GREEN DAWN”, Irak 2012), si dhe konflikti i fundit në Ukrainë, i cili po vazhdon ende në ditët e sotme.

Sjellja e këtyre operacioneve në këtë punim nuk ka aspak qëllimin “për të bërë histori”. Përkundrazi, trajtohen shkurtimisht në thelbin e tyre, vetëm në lëmin e Logjistikës. Në gjuhën tonë ajo quhet Prapavijë, ose Mbështetje. Por Prapavija vendos fatin e atyre që luftojnë në ballë të frontit (apo të mbrojtjes). Sepse “Ushtarët marshojnë mbi zorrët e tyre” - ka qenë sentenca e kohëve.

Mbi këto operacione bëhen vlerësime krahasuese, se si ishte parashikuar të kryhej mbështetja logjistike, e se si ajo u realizua apo po realizohet sot, në rastin e Ukrainës. Gjatë vlerësimit të tyre janë marrë në konsideratë faktorët kohë, hapësirë, numri i trupave të angazhuara, por edhe faktorë të tjerë si gjuha, klima, infrastruktura dhe qëndrimet e popullatës lokale. Në pjesën e

tretë janë trajtuar zhvillimet e fundit dhe sfidat, që lidhen me mbështetjen logjistike të operacioneve.

Konflikti në Ukrainë zë një vëllim të konsiderueshëm në këtë punim. Edhe pse është shumë herët për përfundime, ajo luftë vazhdon prej kaq kohësh para syve tanë. Edhe në kushtet e informacionit propagandistik respektiv, shumë gjëra e ngjarje, duken me sy të lirë.

Lufta pushtuese e Rusisë mund të ketë vlerë paralajmëruese për çdo forcë që planifikon një luftë të zgjatur. Por ajo është njëherazi një mësim i madh, se si një komb mund të mbrohet kundër një agresioni, që përpiqet të kryejë një operacion të komplikuar, me kërkesa të mëdha mbështetjeje.

Dihet dhe njihet, roli i korrupsionit në kohët e sotme. Ai është më i madhi armik, i kujtdo shteti e i kujtdo kombi në botë. E korrupsioni, nuk kishte se si të mos ekzistonte në radhët e forcave ruse. Ishin përfolur shumë gradime të mirëpaguara “me lobim” (pra të pa merituar) në hierarkinë e Ushtrisë ruse, edhe nga medie të atij vendi, që konsiderohen pranë pushtetit.

Fjalët kyçe: mbështetje logjistike, qëndrueshmëria e operacioneve, furnizimet, transporti, mbështetja mjekësore, mirëmbajtja, sfidat logjistike

HYRJE

Logjistika ushtarake ka qenë një aspekt kritik i luftës, që në kohët e lashta. Ushtritë në gjithë historinë kanë pasur nevojë për të siguruar, transportuar dhe furnizuar forcat e tyre, gjatë betejave dhe operacioneve luftarake. Disa shembuj të njohur të logjistikës ushtarake në histori, përfshijnë linjat efikase të furnizimit të Imperatorit Romak, përdorimin e “la grande armée” nga Napoleon Bonaparti dhe sfidat logjistike gjatë Luftës së Dytë Botërore. Që të ketë sukses një operacion ose betejë, kërkon planifikim e manovrueshmëri të mirëmenđuar, madje dhe taktikat e veprimeve, apo lloji i armatimit, janë thelbësore. Operacionet dhe mënyra e organizimit, patjetër që do të kërkojnë mbështetje me municione, transporte, ushqim, karburante, etj. Kjo mbështetje sigurohet nga trupat logjistike. “Mbështetja logjistike e njohur zakonisht si Mbështetja me Shërbime e Luftimit (Combat Service Support-CSS), mban çelësin e suksesit dhe fitores në çdo operacion ushtarak”¹. Luftërat e mëdha, si Lufta e Parë Botërore, Lufta e Dytë Botërore, Lufta e Vietnamit, Luftërat e Gjirit, Lufta e Afganistanit dhe Ndërhryja Libiane; të gjitha praktikisht u zhvilluan dhe u fituan me forcën e mbështetjes logjistike superiore, që iu dha forcave në luftim². Logjistika në doktrinën ushtarake i referohet artit dhe

¹ Pagonis, G. (2012). “Moving Mountains: Lessons in Leadership and Logistics from the Gulf War”. Cambridge Mass: Harvard Business School Press.

² Morgan, J. (2011), “War Feeding War: The Impact of Logistics”. Journal of Military History, Vol 7 (6) pp.83-116.

shkencës së projektimit, planifikimit, blerjes dhe kryerjes së lëvizjes së forcave, duke përfshirë pajisjet e tyre luftarake dhe furnizimet në fushën e betejës (Thope, 2010).

Po çfarë është logjistika, e si përkufizohet ajo? Logjistika ushtarake, thënë me një fjalë të vetme, është Llogari. Sepse ajo ka të bëjë me planifikimin, koordinimin, zbatimin e lëvizjes, mirëmbajtjes së forcave ushtarake dhe pajisjeve të tyre. Sepse ajo përfshin veprimtari si prokurimi, magazinimi, transporti, shpërndarja e furnizimeve, mirëmbajtja e pajisjeve dhe materialeve, si dhe e personelit, për të mbështetur operacionet ushtarake.

Admirali Henry Eçles e përcaktoi logjistikën si... *“Ura ndërmjet operacioneve ushtarake dhe ekonomisë së një kombi. Ky kombinim përfaqësohet në burimet, proceset dhe sistemet e një vendi, që përdoren për të gjeneruar materiale dhe personel”*³. Sipas përkufizimit të miratuar të NATO-s, “Logjistika ushtarake është shkenca e planifikimit, kryerjes së lëvizjes dhe mirëmbajtjes së forcave”⁴.

Logjistika ushtarake ka të bëjë me të gjitha proceset dhe sistemet e përfshira në gjenerimin, transportin dhe rishpërndarjen e materialeve dhe personelit. Fuqia ushtarake e një vendi varet nga aftësia për të përmbushur funksionet e lartpërmendura. Sa më efikase të jenë këto operacione logjistike, aq më strategjike dhe më fleksible janë politikat e atij vendi. Për më tepër, një komb specifik ka potencialin t’i jepet një pozicion avantazhi. Funksionet e lartpërmendura janë rezultat i një niveli lufte, që mund ta kthejë taktiken në strategjike.

Funksionet e përshkruara më sipër ekzistojnë në çdo nivel lufte (operativ, taktik dhe strategjik). Aspekti më i rëndësishëm i logjistikës është lidhja e të gjithë proceseve, për të ofruar shërbimet e duhura në teatrin operacional. Sfidat më të madhe për të gjithë kombet, është të reagojnë ndaj situatave në ndryshim, në mënyrë që ata të mund të jenë më të suksesshëm në misionet specifike. Sa më fleksibël të jetë një vend i caktuar nga pikëpamja e burimeve dhe kapaciteteve të mbështetjes logjistike, aq më efektiv është ai. Aktiviteti logjistik përqendrohet në ofrimin e mbështetjes, për të përmbushur gatishmërinë luftarake.

Detyra kryesore e zinxhirëve të furnizimit ushtarak, është të sigurojë një qarkullim efektiv të produkteve (ilaje, ushqim, municione, karburante, etj.), për njësitë ushtarake gjatë kohës së paqes ose kohës së luftës.

1. LOGJISTIKA E NIVELIT OPERACIONAL

Nuk ka përkufizim të përbotshtëm të logjistikës operationale. Megjithatë, ka funksione thelbësore të kryera nga ushtritë, që bien brenda përkufizimit të

³ Paparone & Tema, 2014

⁴ NATO Logistics Handbook, Definitions, November 2012

dhënë më parë. Më poshtë është marrë si shembull një përkufizim që i bëjnë Trupat e Marinës së SHBA, i cili ka kuptim përgjithësues: si një udhëzues të përgjithshëm.

“Logjistika e nivelit operacional, është arti i aplikimit të burimeve ushtarake të disponueshme për forcat operative, për të arritur objektivat ushtarake kombëtare në një teatër ose zonë operacionesh, apo për të lehtësuar përmbushjen e misioneve të caktuara në një rajon, teatër ose fushatë ushtarake”⁵. Nëse supozohet se është duke u zhvilluar një operacion, forcat logjistike duhet të orientohen për të plotësuar nevojat e veçanta të operacionit. Kjo përpjekje kërkon planifikim, organizim dhe kapacitetet e nevojshme për rifurnizime, mbështetje të të gjithë njësive në fushëbetejë.

Logjistika operationale e mbështetjes së një pushtimi, ka sfida që shkojnë përtej rifurnizimit normal të një force të angazhuar në operacione në kohë paqeje, apo edhe në mbrojtjen e linjave statike në kushte konflikti. Një ofensivë kërkon lëvizje, kundër një force kundërshtarë. Lëvizjet në shkallë të gjerë të forcave të motorizuara ose të mekanizuara, kërkojnë mbështetje të gjerë logjistike dhe koordinim sa më të plotë.

Në mungesë të një mbështetjeje të tillë, operacioni mund të ndalojë ose të dështojë, thjesht sepse i mungojnë mjetet materiale për të vazhduar.

2. PARIMET E MBËSHTETJES DHE QËNDRUESHMËRISË SË LOGJISTIKËS

Ka tetë parime të mbështetjes. Ato janë integrale për zgjerimin e shtrirjes operationale dhe ruajtjen e fuqisë luftarake. Parimet më thelbësore janë: **1. Integrimi:** kombinimi i qëndrueshmërisë me operacionet, për të siguruar njësinë e përpjekjes dhe qëllimit. **2. Parashikimi,** është përdorimi i gjykimit profesional, për të parashikuar ngjarjet e ardhshme dhe për të përgatitur përgjigjet e duhura për to. **3. Vetëpërgjegjshmëria,** është aftësia për të përmbushur kërkesat që ndryshojnë me shpejtësi, në një periudhë të shkurtër kohe. **4. Thjeshtësia,** synon të zvogëlojë kompleksitetin e qëndrueshmërisë. **5. Ekonomia,** fokusohet në përdorimin më efikas të aseteve, për efektin më të madh të mundshëm. **6. Mbijetueshmëria,** është aftësia për të mbrojtur njerëzit dhe pasuritë nga shkatërrimi. **7. Vazhdimësia,** është ofrimi i pandërprerë i logjistikës në nivelet strategjike, operationale dhe taktike të luftës. **8. Improvizimi,** që është aftësia për tu përshtatur me shpejtësi, ndaj rrethanave të papritura. Këto parime janë të pavarura dhe të ndërlidhura⁶.

Funksionet logjistike dhe shërbimet: Logjistika ushtarake përfshin një gamë të gjerë funksionesh dhe shërbimesh, si: *Prokurimi; Transporti; Furnizimet;*

⁵ US Marines tactics 3-40C, 2016, f. 1-1

⁶ Army Sustainment AT 4.1, 1-1

Magazinimi; Shpërndarja; Mirëmbajtja dhe Riparimi; Mbështetja Mjekësore; Mbështetja me karburante dhe energji; Shërbimet fushore të trupës, etj.

Në ditët e sotme, faktorët më të rëndësishëm që shkaktojnë aktivitetin e tregut global dhe kanë një ndikim të madh në proceset logjistike, janë: globalizimi dhe zhvillimi i shpejtë i teknologjive të reja.

Sfidat aktuale në mbështetjen logjistike ushtarake, kanë ndryshuar. Sfida më e madhe për të gjitha proceset logjistike, është ofrimi i shërbimeve dhe furnizimeve në *kohën e duhur, produktin e duhur, sasinë e duhur, gjendjen e duhur, vendin e duhur, klientin e duhur dhe me çmimin e duhur.*

Njësitë e logjistikës ushtarake organizohen për t'u ofruar mbështetje dhe mirëmbajtje, forcave ushtarake gjatë operacioneve. Organizimi i tyre mund të ndryshojë në varësi të madhësisë dhe llojit të forcës ushtarake.

Sistemet dhe pajisjet logjistike: Njësitë logjistike përdorin shumë sisteme dhe pajisje për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efikase. Në këto pajisje e sisteme përfshihen: *Mjetet e transportit tokësor e ajror; Magazinat dhe depot; Infrastruktura me pajisje, orendi e aksesorë; Pajisjet dhe modulet mjekësore; Pajisjet dhe modulet e mirëmbajtjes; Mjetet e karburantit dhe të ujit; Sistemet e komunikimit; Aeroplanët dhe helikopterët; Pajisjet inxhinierike e të xhenios.*

Këto pasuri logjistike janë të domosdoshme për të siguruar që forcat ushtarake të jenë të mirëpajisura, të furnizuara dhe të mbështetura gjatë operacioneve, duke kontribuar në suksesin e misionit të njësisë.

3. ZINXHIRI I FURNIZIMEVE LOGJISTIKE “LOGISTICS BLOCKCHAIN”

Koncepti i ri që lidhet me mbështetjen me furnizime të materialeve logjistike “Logistics Blockchain” ka për bazë teknologjinë globale të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit. *Blockchain* është një regjistër digjital i shpërndarë dhe i decentralizuar që ruan sigurisht transaksionet nëpër shumë kompjuterë, duke krijuar një seri të madhe me *database*-in të të dhënave të inventarit, prodhuesve, furnitorëve, kontrolluesve, përdoruesve, etj. Çdo *database* është i kriptuar, duke garantuar integritetin dhe paprekshmërinë e të dhënave. Në kontekstin e logjistikës, teknologjia *blockchain* ofron disa përfitime dhe karakteristika që mund të transformojnë mënyrën se si operojnë zinxhirët e furnizimit.

“Logistics Blockchain” aplikohet për të bërë të mundur gjurmimin e produktit, mallrave, kryerjen e pagesave dhe transaksioneve, kryerja e procedurave të zhdoganimit të mallrave, financimet në këtë fushë, etj.

Zinxhiri i furnizimeve

Ka pak dyshim se mbështetja e logjistikës dhe elasticitetit të zinxhirit të furnizimit merren në shqyrtim apo përmenden përtej asaj të komuniteteve

të logjistikës ushtarake. Ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit të lidhura me pandeminë COVID-19 sollën në pah logjistikën globale dhe zinxhirët e furnizimit, me pasojat e mungesës që prekin individët në nivel personal. Pandemia zbuloi brishtësinë e rendit ekonomik global nga i cili varet pasuria dhe siguria jonë për disa, por të tjerë e panë rikthimin ekonomik si një reflektim të qëndrueshmërisë së përgjithshme të qasjeve të globalizuara ndaj logjistikës. Optimizmi mund të ketë rënë në fillim të vitit 2022, kur pushtimi rus i Ukrainës u përkeqësua, ndikoi në betejat e logjistikës botërore, ndërsa zbuloi gjendjen e bazës industriale dhe teknologjike të mbrojtjes si të papërgatitur për asgjë tjetër, përveç operacioneve në shkallë të vogël dhe “biznesit si zakonisht. Sigurimi i logjistikës globale ka ecur me një ritëm të shpejtë dhe tani ne shohim që kombet perëndimore përpiqen të shkëputin teknologjinë dhe bazën e tyre industriale nga varësia nga kombet më pak miqësore (ose konkurrentët e drejtpërdrejtë strategjikë) duke krijuar marrëveshje të reja për të ndarë njohuritë dhe kapacitetin.

Ne, si ushtarakë të logjistikës dhe një pjesë e vogël e diskutimeve më të mëdha për sigurinë kombëtare në vendet tona, shqetësohemi se ku bëhen gjërat dhe nga kush. Prodhimi dhe tregjet e municioneve kanë treguar se funksionojnë shumë nën kapacitetin e dëshiruar dhe rifurnizimi i tyre ka arritur interesin e nivelit të qeverive në një mënyrë të paparë prej vitesh. Fuqia detare është bërë një ndihmës virtuale për sigurinë detare dhe të zinxhirit të furnizimit, pasi tregtia që u jep jetë kombeve tona kërkon mbrojtjen e flotës së anijeve, të cilat vetë janë produkti i kapaciteteve industriale të globalizuara.

Në ditët e sotme, proceset e transportit, shërbimet mbështetëse dhe akomodimi, po e bëjnë koston e operacioneve shumë të lartë. Si rezultat, vendet përpiqen të minimizojnë koston, duke ia përcjellë një pjesë të saj nënkontraktorëve. Përdorimi në rritje i nënkontraktorëve private, është bërë i dukshëm. Shtetet anëtare të BE-së janë më të gatshme të përdorin kompanitë private, që ofrojnë burime të jashtme. Kjo zgjidhje ka shumë avantazhe ekonomike por edhe *disa dizavantazhe*. Mund të zvogëlojë koston totale të operacioneve dhe të ndihmojë në rritjen e cilësisë së procesit. Disavantazhi më i madh është se operacionet ushtarake mbështeten në partnerë të jashtëm, të cilët janë të fokusuar në tregun e biznesit. Mund të ketë edhe disa vështirësi me marrëveshjen formale ndërmjet partnerëve (qeveria dhe kompanitë private). Burimet private mund të jenë më të rrezikshme për operacionet ushtarake kur merret parasysh siguria e proceseve të furnizimit. Në raste krizash në Evropë, kompanitë e jashtme do të përballen me nivele të rritura të koston, sepse ato nuk po disponojnë kapacitetet e tyre dhe duhet të rezervojnë në tregun global.

Mbështetja logjistike garanton suksesin e operacioneve ushtarake. Faktori më i rëndësishëm për çdo operacion është ekipi i njerëzve përgjegjës për

vlerësimin e të gjithë përcaktuesve. Operacionet ushtarake janë shpesh të paparashikueshme, që do të thotë se drejtuesi i ekipit të logjistikës duhet të jetë në gjendje të reagojë logjikisht, me përgjegjësi dhe shpejt. Një drejtues i mirë logjistik mund të kontribuojë në mënyrë indirekte, në suksesin e një operacioni ushtarak.

Në përfundim të kësaj pjese, niveli i operacioneve logjistike mund të jetë më i larti gjatë gjithë kohës. Edhe nëse batalioni ka një plan strategjik perfekt, pa mbështetjen e duhur (akomodim, pajisje, ushqim, armë), ai nuk mund të realizohet. Çdo mision logjistik kërkon një udhëheqës logjistik, i cili mund të reagojë shpejt në situata të ndryshme. Sa më fleksibël të jetë një ekip logjistik, aq më efikase janë disa operacione. Është thelbësore të krijohet një ekip logjistik, i cili përfshin specialistë në fusha të ndryshme, të lidhura me mbështetjen logjistike. Njerëzit e pa kualifikuar mund të bëjnë gabime, që mund të jenë të rrezikshme për misionet ushtarake.

4. TRE OPERACIONE NË HISTORI DHE....

Operacioni “Cobra”, Normandi gusht 1944.

Në Luftën e Dytë Botërore, gjatë operacioneve sulmuese, njësitë do të konsumonin normalisht një sasi shumë më të madhe karburanti sesa ishte planifikuar, dhe anasjelltas një sasi më të vogël municioni. Fillimisht kjo nuk ishte një shqetësim për divizionin, korpusin apo ushtrinë, pasi rezervat ishin të mëdha. Përveç karburantit, divizioni filloi të kërkonte një sasi më të madhe municionesh sesa ishte parashikuar norma ditore e fishekëve (Combat Load ammo). Dhe nuk ishte e vetmja njësi, por të gjithë njësitë e kishin rritur kërkesat sapo u përballën me fortifikimet gjermane. Dukej se municioni ishte një prioritet i lartë për të gjithë njësitë. Nga analiza e misionit pas përfundimit të këtij operacioni, rezultoi se batalioni mjekësor funksionoi shumë afër doktrinës, me kompanitë vartëse që lëviznin me ekipet e tyre në fushëbetejë⁷.

Nga njësitë e tjera si Divizioni i III-të i mekanizuar, mbështetja realizohej nga strukturat logjistike që kishte në organikë. Kjo njësi (divizioni i blinduar) konsumonte mesatarisht, 15.000 gallona benzinë në ditë (57.000 litra) dhe 80 ton municione⁸. Përveç karburantit dhe municioneve kishte edhe shqetësime të tjera logjistike. Në raportin e tij pas veprimit, Nënkolonel Clarence M. Eymer (Shefi i Logjistikës së Divizionit), vuri në dukje se kishte mungesa të mëdha të furnizimit si thikat e luftimit, granatahedhës dhe dylbi⁹.

⁷ Major Leo B. Burgin, *Historical Records and History of Organization, 1st Medical Battalion* (Marigny: HQ, 1944).

⁸ Zaloga, 44. “heavy” armored divisions. “Order of Battle, World War II,” http://www.3adorg/wwii/wwii_order_of_battle.html.

⁹ *After Action Report, G4 Section (JUN 44-DEC 44 & DEC 45)*, 25. G4’s AAR inputs (ÇB, Tank Bn, truck coy, etc)

Në mënyrë të pabesueshme, në fazat e hershme të operacionit, nuk rezultuan në humbje të mëdha të pajisjeve. Ka pasur një sërë mësimesh bashkëkohore të nxjerra nga Divizioni I-rë i Këmbësorisë gjatë Operacionit COBRA. Edhe pse mbajtja e forcave funksionoi mirë gjatë gjithë operacionit, kishte disa çështje të qenësishme që nuk u zgjidhën kurrë realisht, deri në fund të luftës. Në përfundim të Luftës së II Botërore, gjenerali Aizenhauer mbledhi një seri studimesh të njohura si “Bordet e Përgjithshme”, “Forcat e SHBA” dhe “Teatri Evropian”, për të analizuar të gjitha aspektet e Teatrit Evropian të Operacioneve. Këto borde ishin ndoshta Rishikimet më gjithëpërfshirëse pas Veprimit, që ishin kryer ndonjëherë pas operacioneve. Megjithatë, ata nuk zgjidhën dot çdo problem, e as nuk mund të parashikonin problemet e ardhshme.

Në vitin 1948 kur ushtria publikoi Tabelat e reja të Organizimit të dhe Pajisjeve, ku një divizion këmbësorie, u rrit sasia e personelit deri në 19.000 ushtarë¹⁰.

Në fund të fundit, logjistika ishte kthyer në një mundësues luftarak dhe jo një faktor kufizues për Operacionin. Gjenerali Collins më vonë vuri në dukje: “Nuk mund të kujtoj asnjë vështirësi reale të furnizimit që pengoi funksionimin aktual¹¹.”

“Stuhia e shkretëtirës”- Irak, shkurt 1991.

Gjatë operacioneve sulmuese, furnizimet më kritike janë klasa III, V dhe IX (karburantet, municionet dhe pjesët e këmbimit për mirëmbajtjen). Sfida më e madhe do të ishte mbajtja e këtyre furnizimeve mbi linjat e zgjeruara të furnizimit¹². Sasitë e furnizimeve ishin shumë të mëdha. Planifikuesit e mbështetjes logjistike mbajtën për bazë faktorët e konsumit prej 4.500 tonësh municioni në ditë, për një divizion të blinduar në operacionet mësimëse¹³. Për këtë, kërkohej një njësi rezervë që menaxhonte një pikë të përparuar furnizimi me municione, me 20 rimorkio të ngarkuara me municion, për të mbështetur një brigadë këmbësorie. Asetet e transportit dukeshin qartë se ishin një faktor kufizues, me mjete të përshtatshme në terrene shkretëtire¹⁴. Kërkoreshin aq shumë mjete transporti, saqë duhej të linin të gjitha materialet e tjera të mbështetjes logjistike, për të marrë 2 ngarkesa bazë me municione¹⁵.

¹⁰ Sayen, 74. Actually there was one other TO&E published in 1945 but this was the last of the WWII era.

¹¹ “VII Corps in Operation COBRA (1),” *Lieutenant General J. Lawton Collins Papers, Box 5* (July 1944), 16

¹² *Forward Support Battalion*, 9-1 – 9-11

¹³ Dunnigan and Bay, 289

¹⁴ LTC Edwin L. Buffington (December 13, 1991), 20

¹⁵ 1st Inf. Division Staff, *Lessons Learned during Operation Desert Storm* (APO NY: 1st Infantry Division, 1991), 12.

Përdorimi i tankeve rriti kërkesën për karburante, e nisur edhe nga aktivitetet e shumta të divizionit, një sasi e madhe e karburanteve nuk u evidentuan, gjë e cila bëri që me këtë detyrë të merreshin drejtpërdrejt batalionet e mbështetjes logjistike Megjithatë divizionit nuk i mbaroi asnjëherë karburanti¹⁶.

U evidentuan 26 mësimet të nxjerra për mbështetjen logjistike nga Divizioni i Parë i Këmbësores në raportin pas operacionit. Doli qartë, mungesa e GPPS, pushkëve të lehta M16A2 dhe odometra (matësit e rrugëve), që lexonin në kilometra. Shumë nga mësimet e nxjerra, janë të zbatueshme edhe sot. Çdo automjet me karburant dhe mallra duhet të jetë një automjet i tipit “HEMTT”, me qëllim që të ruajë tempin e furnizimeve, apo për të mundur avancimin në terrene të ashpra¹⁷. Për të realizuar prokurimet lokale, u shfaq mungesa e oficerëve kontraktues me njësitë e manovrës.

Përfundimi ishte se asgjë nuk dështoi, për shkak të logjistikës. Ushtria Amerikane pasi kishte projektuar arkitekturën logjistike për të mbështetur manovrat operacionale kundër forcave sovjetike gjatë Luftës së Ftohtë, i testuan këto doktrina e kapacitete në vitin 1991. Rezultatet treguan se sistemi i mbështetjes logjistike të SHBA, ishte plotësisht i aftë për të mbështetur operacionin dhe manovrat, gjatë Stuhisë së Shkretëtirës¹⁸.

Operacioni “Green Down”, Irak 2012.

Planifikuesit ushtarakë bëjnë supozime të vlefshme dhe të nevojshme, për të vijuar më pas me procesin e planifikimit. Për operacionin Agimi i Gjellbër “Green DOWN”, u patën parasysh shumë mësimet të nxjerra dhe rekomandime, për të reduktuar sasinë e furnizimeve dhe të pajisjeve mbështetëse, duke i zëvendësuar ato me shërbimin *kontraktorë* dhe nga *mbështetja e vendit pritës*. Gjithsesi siguria e trupave, furnizimi i tyre, mbështetja me karburante e me transport, mbeten shqetësimet më të mëdha në këtë aspekt për komandantët dhe personelit mbështetës. Në këtë operacion, një brigadë e mekanizuar dhe me mjete të blinduara, do të konsumonte 84.000 gallona (320.000 litra), ndërsa brigade e këmbësores do të konsumonte 22,000 gallona (83.000 litra), brigada e zjarrfikësve do të konsumonte 44.000 gallona (166.000 litra) dhe brigada e aviacionit luftarak konsumonte 107.000 gallona (405.000 litra) në ditë. Shuma ishte për të gjitha njësitë e divizionit të parë, sasia totale e karburantit që konsumohej në një ditë do të ishte 423.000 gallona (1.601.230 litra)¹⁹. Thënë ndryshe, kjo sasi do të ishte e barabartë me 1.25 milionë gallona

¹⁶ LTC David W. Marlin, *History of the 4th Battalion, 37th Armor Regiment in Operation Desert Shield/Desert Storm* (Saudi Arabia: 4-37 AR, 1992), 421-423.

¹⁷ *Lessons Learned during Operation Desert Storm*, 12-17

¹⁸ *Lessons Learned during Operation Desert Storm*, 32-34

¹⁹ *Combat Service Support Battle Book*, 4-5 – 4-9. Appendix J for the logistical results, consumption data, usage rate, loss rates, and operational readiness rates

(4.731.765 litra) karburant për Divizionin e Parë të Këmbësores, gjatë operacionit treditör. Përvoja e luftimit kudo tjetër, përveçse në rërën e pasur me naftë të Irakut jugor dhe Kuvajtit, ky do të ishte faktor kufizues në vetvete. Pavarësisht pengesave, sistemi i logjistikës së nivelit operacional, duhet të ishte në gjendje të mbante ritmin me normat e konsumit të karburantit, për brigadën e rëndë të mekanizuar. Sasia e karburantit rezultonte e madhe dhe kapacitetet e depozitave ishin të pa mjaftueshme²⁰. Gatishmëria teknike e automjeteve gjatë tre ditëve të operacionit ishte 100%. Rreth 18 % e teknikës së rëndë u dëmtuan, por riparimi i tyre bëhej në njësitë e mirëmbajtjes së divizionit. Vetëm një pjesë e vogël pësoi dëmtime të rënda, që kërkonte mirëmbajtje të specializuar²¹. Faktor kufizues në këtë operacion, ishte vetëm koha e kufizuar. Mbështetja logjistike, pavarësisht kërkesave të larta për furnizime, u krye pa mungesa të mëdha, duke rezultuar në suksesin e këtij operacioni. Mësimet e nxjerra dhe analiza që i është bërë këtij operacioni 3 ditor, në lidhje me mbështetjen logjistike, janë reflektuar në faktorin planëzues të operacioneve luftarake të divizionit të këmbësores dhe atij të mekanizuar të forcave amerikane²².

5. KONFLIKTI NË UKRAINË

Nëse më lart trajtuam se çfarë pritej të ndodhte e çfarë ka ndodhur në fakt, në konfliktin në Ukrainë ende janë duke u zhvilluar luftimet, por fillimet e këtij konflikti rezultuan me disa problematika, që do të trajtohen më poshtë. Pyetja shtrohet: -A ishte planifikuar mbështetja logjistike e trupave ruse për një pushtim të tillë? Nëpërmjet kësaj pyetjeje, analizohen operacione në drejtimet kryesore të trupave ruse. Dhe kjo analizë shtrohet për nivelin operacional, sepse duket se është sektori ku fushata e përgjithshme ruse, pësoi pengesat e saj fillestare.

Forcat e mbështetjes logjistike, nuk ishin strukturuar ose organizuar, për të mbështetur një pushtim.

Planet fillestare të Rusisë për fushatën në Ukrainë, ishin për një kapje të shpejtë të territorit. Qëllimi ishte një fitore e shpejtë taktike, më pas “prerja e kokës” së regjimit ukrainas. Udhëheqësit ushtarakë rusë vunë në lëvizje “një grusht shteti të rrezikshëm për të marrë Kievin”, duke besuar shumë, në shpejtësinë dhe befasinë e këtij sulmi²³. Supozimi i Rusisë ishte se rezistenca e lehtë do të lejonte lëvizje dhe përforsim të shpejtë, pa asnjë kërkesë të rëndësishme, për materiale logjistike apo furnizime.

²⁰ 1st Inf. Division Staff, *Lessons Learned during Operation Green Down*, 12

²¹ 1st Inf. Division Staff, *Lessons Learned during Operation Green Down*, 18

²² *Combat Service Support Battle Book*, 4-14 – 4-16

²³ Berkowitz, B., & Galocha, A. (2022). *Why the Russian military is bogged down by logistics in Ukraine*. *The Washington Post*, March 30

Duke qenë se kushtet për këtë operacion nuk ishin ideale, struktura e forcës logjistike ka të ngjarë të ishte e pamjaftueshme që në fillim. Siç u parashikua në diskutimin hipotetik, kërkesat për ushtarët mbështetës individualë, për të lëvizur efektivisht dhe për të koordinuar mbështetjen, nuk ishin të zbatueshme, qoftë edhe në rrethanat më të mira²⁴.

Planifikimi nuk u krye për mbështetjen e përparuar me Transport.

Forcat ruse me doktrinën që kishin, të realizonin planin e transportit mbështetës për të siguruar një lëvizje të mirëmbështetur, duke përdorur armë të kombinuara. Megjithatë, për të arritur befasinë, Rusia i mbajti të fshehta synimet e saj nga të gjithë, përfshirë forcat e veta, derisa sulmi ishte i pashmangshëm. Kjo mungesë planifikimi dhe koordinimi, çoi në mungesa në shumë fusha, të cilat u paralizuan nga mungesat logjistike. Për shembull, moskomunikimi i qëllimit, ndikoi shumë negativisht në brigadat e pushkëve me motor, e në “Rosgvardia” (trupat e gardës kombëtare ruse).

Këto trupa, i morën udhëzimet e duhura, më pak se 24 orë para fillimi të ofensivës për pushtimin e Ukrainës. Për pasojë, ata nuk realizuan dot fushatën metodike të përparimit dhe shfrytëzimit nga skalionet e njëpasnjëshme, siç e diktonte Doktrina e tyre, madje as nuk u mbështetën nga artileria mjaftueshëm, çka konsiderohet thelbësore.

Forcat përpiqeshin të përparonin, pa përgatitjet e fushëbetejës. Ata avanconin pa pasur me vete furnizimet me 5 ditë furnizimi, që do të ishin të nevojshme në planifikimin normal²⁵.

Linjat e furnizimit dhe rrjeti rrugor.

Rusia besonte se do të siguronte një fitore të shpejtë. Lëvizjet fillestare të ushtrisë ruse synoheshin si përparime të shpejta dhe ajo arriti të çonte përpara, një forcë të konsiderueshme. Megjithatë, në tentativën për këtë përpjekje, forcat ruse nuk u përpoqën të siguronin linja të përshtatshme furnizimi. Forcat kishin për qëllim të kryenin një sulm të shpejtë me një kolaps të shpejtë, e jo një fushatë të zgjatur. Forcat ruse ishin të pajisura dhe të trajnuara dobët, për të mbrojtur linjat e zgjatura të mbështetjes²⁶. Nga ana tjetër forcat ukrainase i kuptuan dhe i shfrytëzuan këto kufizime, duke sulmuar në fronte të shumta dhe duke i detyruar njësitë ruse të mos përparonin, por të qëndronin një pozicion mbrojtës. Njësitë ruse, të pa përgatitura për mbrojtjen në thellësi, nuk arritën

²⁴ Po aty.

²⁵ Skoglund, P., Listou, T., & Ekström, T. (2022). Russian Logistics in the Ukrainian War: Can Operational Failures be Attributed to logistics? *Scandinavian Journal of Military Studies*, 5(1), pp. 99–110.

²⁶ Vershining, A. (2021). Feeding the bear: A closer look at Russian army logistics. *War on the Rocks*.

të zmbraipsin sulmet, gjë që rezultoi në humbjen e materialeve dhe humbje në njerëz²⁷. Në përgjigje të këtyre situatave, trupat sulmuese ruse u detyruan të dërgonin një numër të madh trupash mbrapa, përgjatë korridoreve për të mbrojtur linjat e furnizimit, duke ngadalësuar tempin e lëvizjes, krahasuar me fillimin e konfliktit²⁸.

Ky ritëm i shpejtë bëri që njësitë të ndaheshin, gjë që çoi në probleme komunikimi dhe, nga ana tjetër, një paaftësi për të menaxhuar në mënyrë efektive kërkesat e logjistikës. Trupat e përparuara ruse, ose nuk komuniknin me forcat mbështetëse në lidhje me nevojën dhe vendndodhjen, ose ata po komuniknin në telefona celularë civilë, lehtësisht të përgjuar dhe të pakriptuar. Në rastet kur komunikimet përgjoheshin lehtësisht, forcat ukrainase ishin në gjendje të lokalizonin dhe sulmonin forcat e furnizimit²⁹.

Trupat tokësore nuk u mbështetën me zjarr nga ajri, e kjo rriti shpenzimin e municioneve dhe kërkesën për furnizime, pa arritur në Kiev.

Mbështetja me zjarr nga ajri, mund të lehtësojnë barrën mbi artilerinë dhe transportin tokësor. Në të vërtetë, doktrina ruse e mbështetjes me zjarr, kërkon përdorimin e aviacionit me krahë fiks, si për të plotësuar, ashtu edhe për të zëvendësuar përdorimin e fuqisë së zjarrit në tokë³⁰.

Megjithatë, mbështetja me zjarr nga ajri, duhet të ishte realizuar pas një koordinimi të plotë midis trupave në tokë dhe mjeteve ajrore, e për këtë patjetër që duhet të ishin trajnuar trupat, çka nuk ishte kryer. Për shkak se ky trajnim nuk ishte kryer, forcat ajrore ruse nuk luajtën asnjë rol të rëndësishëm në betejën tokësore. Rezultati i kësaj mbështetjeje jo efektive, ishte se Rusia përdori edhe më shumë zjarrin e artilerisë, si në pushtimin e saj fillestar, ashtu edhe në fushatat pasuese. Nga ana tjetër, përdorimi i një zjarri të tillë kërkonte përdorimin e transportit tokësor për të rifurnizuar bateritë e artilerisë, duke iu shtuar asaj që vetiu ishte tashmë, një sistem i mbingarkuar. Kjo kërkesë shtesë për artileri nuk pritej, por ishte rezultat i mosplanifikimit të saktë nga ana e Rusisë, për të vendosur epërsi ajrore dhe për të ofruar mbështetje ajrore me zjarr³¹.

²⁷ Listou, T., & Ekström, T. (2022). Russland i Ukraina: uten logistikk skjer det lite på slagmarken. Stratagem.

²⁸ Berkowitz, B., & Galocha, A. (2022). Why the Russian military is bogged down by logistics in Ukraine..

²⁹ Borger, J. (2022, March 28). The drone operators who halted Russian convoy headed for Kyiv. *The Guardian*

³⁰ Grau, L. W., & Bartles, C. K. (2016). *The Russian way of war: Force structure, tactics, and modernization of the Russian ground forces*.

³¹ Swartz, S. M., & Johnson, A. W. (2004). *A multimethod approach to the combat air forces mix and deployment problem. Mathematical and Computer Modelling*, 39(6–8), 773–797.

Mbështetja në një rrjet të kufizuar rrugor, krijoi bllokime dhe ngarkesa të mëdha të trafikut.

Lëvizshmëria në rrjetin e kufizuar rrugor në Ukrainë, përbënte një sfidë serioze për forcat tokësore ruse, veçanërisht për forcat logjistike. Megjithëse “mjetet e gjurmara mund të jenë në gjendje të lëvizin përgjatë rrugës ku terreni është mjaft i lejueshëm, kamionët që transportojnë municion, karburant ose ushqim nuk mundin, gjë që ka penguar në mënyrë thelbësore përparimin rus”. Sipas doktrinës ruse, batalionet e logjistikës duhet të lëvizin me një ritëm avancues prej 20-30 kilometra në ditë, ndërsa lëvizja reale në fillim të fushatës, ishte më pak se gjysma e asaj distance³².

Kolona të gjata automjetesh u panë të ndaluara pranë trafiku në rrugë prej ditësh. Kolonat ruse u sulmuan gjithashtu nga forcat tokësore ukrainase, që nuk ishin pastruar nga zonat e pasme ruse. Kurse artileria ukrainase mund të arrinte në rrugët e përdorura, për dërgimin e furnizimeve. Këto kushte e bënë jashtëzakonisht të vështirë mbajtjen e sulmeve në Kiev³³. Këto vështirësi varionin nga riarmatimi, deri në evakuimin e personelit të plagosur. Siç raportoi një burim në lidhje me evakuimin mjekësor, “linjat e zgjatura të komunikimit, e bënë të vështirë transportimin e ushtarëve të plagosur në spitale, duke rritur numrin e vdekjeve në mënyrë të panevojshme”. Ndikimi real në moralin e forcave, nga kjo pamundësi për t’u evakuuar, nuk dihet në mënyrë të saktë. Por efektet e kombinuara të mbështetjes së pa dorëzuar dhe më pas mungesa e urgjencës në evakuimin e të plagosurve, ndikojnë patjetër në sasinë e të vrarëve dhe në moralin e trupës.

Mungesat fillestare të mbështetjes logjistike për zhvillimin e operacionit.

Lëvizjet në shkallë të gjerë të forcave të motorizuara ose të mekanizuara kërkojnë mbështetje të gjerë logjistike dhe koordinim. Kjo mbështetje përgjithësisht, nuk ishte e disponueshme për ushtrinë ruse në fazat e hershme të luftës, e ky faktor, shkaktoi dështimin fillestar për të arritur objektivat. Forcat sulmuese u detyruan të ndalonin, teksa kishin arritur në periferi të Kievit. Njësitë ruse braktisën automjetet dhe u larguan nga fusha (Jones, 2022). Këto disfata ndodhën, pjesërisht sepse forcat sulmuese nuk mund të mbroheshin kundër armatimit ukrainas, por edhe sepse forcat mbështetëse nuk mund të garantonin me siguri furnizimin e forcave, që supozohej se do të kryenin një sulm, në vend që të mbronin zonat e pasme dhe linjat e furnizimit. Dështimi për të arritur objektivat, rezultoi në riorientimin e forcave larg Kievit dhe drejt zonave lindore, që ishin diskutuar prej vitesh. Megjithëse ky devijim në zonat

³² SR. (2022). *Militäranalytiker om konvojen: “Kan ha logistikproblem”*.

³³ Skoglund, P., Listou, T., & Ekström, T. (2022). Russian Logistics in the Ukrainian War: Can Operational Failures be Attributed to logistics? *Scandinavian Journal of Military Studies*, 5(1), 12

lindore mund të kishte paraqitur më pak sfida logjistike operacionale, nuk ishte lufta që Rusia kishte planifikuar dhe u shfaqën mangësi të ndryshme.

Mungesat dhe problematikat në lidhje me furnizimin e vazhdueshëm normal, pas fillimit të operacionit.

Folëm për përgatitjen fillestare të logjistikës para fillimit të agresionit, sepse kjo ishte gjëja e parë që dështoi. Megjithatë, në fazën tjetër të fushatës, ku linjat ishin kryesisht statike, forcave ruse u mungonin furnizimet kryesore, për të vazhduar luftën. Kjo trajtohet më së paku, si një dështim i qëndrueshmërisë së operacioneve³⁴. Kështu që, nga mesi i marsit 2022, forcat ruse po përballeshin me mungesa të gjithçkaje, nga karburanti, e deri te municionet precize. U mungonin furnizimet mjekësore qysh në fillim të luftës, gjë që bashkë me evakuimin, mendohet se çoi në humbje të shtuara të personelit të saj. Këto mungesa, në një farë mase, ishin pasojë e çështjeve të transportit të shqyrtuara më lart. Por në disa raste, këto mungesa vazhduan, edhe kur forcat ishin efektivisht statike³⁵.

Pasi dështoi në arritjen e qëllimit të saj fillestar, për të kapur me shpejtësi Kievin, Rusia e zhvendosi fushatën në fillim të prillit 2022, për t'u fokusuar në Ukrainën lindore dhe jugore. Për shkak se forcat ruse që operonin nga Donbasi, ishin në gjendje të përparonin në fronte të gjera dhe të siguronin zonat e tyre të pasme, rrjeti rrugor nuk imponoi aq shumë kufizime, si në rastin e sulmit kundër Kievit. Për më tepër, afërsia e territorit të pushtuar nga Rusia dhe rrjeti i tij hekurudhor, i pakësoi sfidat e mbështetjes logjistike. Vendndodhja në afërsi të furnizimit me municion, i lejoi bateritë të mbanin një breshëri pothuajse të vazhdueshme, në pozicionet ukrainase. Pra, nëse njësitë ndodheshin në afërsi të rifurnizimit, ato mund të funksiononin.

Korrupsioni dhe mosfunksionimi i armëve.

Dihet dhe njihet, roli i korrupsionit në kohët e sotme. Ai është më i madhi armik, i kujtudo shteti e i kujtudo kombi në botë. E korrupsioni, nuk kishte se si të mos ekzistonte në radhët e forcave ruse. Ishin përfolur shumë gradime të mirëpaguara (pra të pa merituar) në hierarkinë e Ushtrisë ruse. Pa vënë në diskutim korrupsionin e drejtimit civil atje, që ka qenë fakt i pamohueshëm, edhe sipas vetë mediave ruse, pranë qeverisë së atij vendi. Korrupsion, që varion nga vjedhja e plotë e materialeve, e deri te raportimi i gënjeshtreve sistematike për gatishmërinë reale, mund të ketë luajtur një rol në kolapsin e furnizimit³⁶. Lloje të ndryshme korrupsioni ishin mesa duket të pranishme në

³⁴ US Army JP 4-0, 2019)

³⁵ Berkowitz, B., & Galocha, A. (2022). Why the Russian military is bogged down by logistics in Ukraine. *The Washington Post*, March 30

³⁶ G. Kessler, "Fact checking Putin's speech on Ukraine", *The Washington Post*, 23 February, 2022

ushtrinë ruse dhe kompleksin e saj mbështetës. Ndikimi i korrupsionit u bë i dukshëm shumë herët në fushatën ruse, për shembull me llogaritë e njërive që operonin me racione, që kishin skaduar shtatë vjet më parë.

Në një farë mase, dështimi për të siguruar furnizimin me artileri është një çështje e logjistikës operacionale dhe mangësive që kemi përmendur më lart. Megjithatë, nevoja e vazhdueshme për të kaluar në goditje të pa drejtuara dhe për t'i mbajtur forcat larg nga angazhimet e menjëhershme, flet për një problem më të gjerë të mbështetjes. Shumë armë të përdorura nga trupat ruse, nuk funksionuan siç duhet, për shkak të mungesës së mirëmbajtjes. Për shembull, “ndërsa Rusia shpenzoi mbi 1.900 raketa me rreze të shkurtër dhe të mesme në Ukrainë gjatë dy muajve të parë, performanca dhe efekti kanë qenë të dobëta, me një shkallë të raportuar të dështimit ditor, deri në 60% për disa lloje”.

Industria ushtarake e mbrojtjes ruse ishte shumë e vogël dhe shumë e varur nga perëndimi, për t'u përballur me sanksionet.

Rusia para luftës, kishte një industri të konsiderueshme të mbrojtjes që përbënte afërsisht 20 përqind të sektorit të saj të prodhimit. Rusia ishte në gjendje të projektonte, zhvillonte dhe prodhonte një gamë të plotë të sistemeve të avancuara ajrore, tokësore, raketore dhe detare. Edhe pse që nga viti 2010, ajo ka importuar sasi të kufizuara të pajisjeve ushtarake nga disa vende, duke përfshirë Republikën Çeke, Francën, Iranin, Izraelin, Italinë, Turqinë dhe Ukrainën. Buxheti i saj i mbrojtjes në vitin 2019 vlerësohej në 104 miliardë dollarë. Deri vitin e kaluar, Rusia ishte eksportuesi i dytë më i madh në botë i armëve, pas Shteteve të Bashkuara³⁷.

Duke ofruar këto përfundime për konfliktin në Ukrainë, nuk mund të themi se dështimet e logjistikës operacionale, të mbështetjes ose të logjistikës strategjike, ishin, të vetmet, vendimtare. Në të vërtetë, rezultati i luftës në përgjithësi mbetet ende për t'u vendosur. Megjithatë, ne e dimë se sistemet dhe proceset e shumta logjistike dhe mbështetëse dështuan, sepse i lanë ushtarët rusë pa mjetet për të luftuar dhe ndikuan negativisht, në moralin e tyre. Lufta pushtuese e Rusisë, mund të ketë vlerë paralajmëruese për çdo forcë që planifikon një luftë të zgjatur. Por ajo është njëherazi një mësim i madh, se si një komb mund të mbrohet kundër një agresioni, që përpiqet të kryejë një operacion të komplikuar, me kërkesa të mëdha mbështetjeje.

6. ...SFIDAT E ARDHSHE NË MBËSHTETJEN LOGJISTIKE

Një nga çështjet që meriton të trajtohet, janë aspektet dhe sfidat e logjistikës deri tani të pazgjidhura dhe që janë akoma relevante të cilat janë evidentuar gjatë operacioneve të mbështetjes së trupave ushtarake. Adresimi i këtyre

³⁷ CIA reports, 2022

sfidave nuk është një detyrë e thjeshtë, ato kanë kohë që janë bërë objekte diskutimi në komunitetet logjistike ushtarake. Treguesit aktualë sugjerojnë se sistemi i mbështetjes logjistike ushtarake duhet të jetë më fleksibël, më i adaptueshëm dhe më elastik se kurrë, kryesisht për shkak të ndikimeve të pa parashikuara teknologjike, të cilat tashmë kanë filluar të kenë një efekt të madh në këtë drejtim.

Në këtë mënyrë, përdorimi na duhet akoma që të blejmë, transportojmë, mirëmbajmë, ruajmë dhe asgjësojmë materialet dhe sistemet ushtarake, duhet të vijohet që të mendohet sesi përdoren kapacitetet e mbështetjes në të ardhmen.

Tregtia nëpërmjet kompjuterit

Shumë është bërë nga tendencat në tregtinë elektronike dhe ndikimi që ka ai në zinxhirin e furnizimit. Shpërndarja e porositë është një ndër elementet që po e vlerësojnë kompanitë e ndryshme postare. Për shembull, “Amazon” vazhdon të eksplorojë përdorimin e shpërndarjes me dronë për ngarkesa të vogla brenda një largësie të caktuar të kufizuar, duke përcaktuar se sa do të jetë çmimi, afatet kohore që do kryhen, e a do mundet që këto elemente të tërheqin vëmendjen e klientëve? Një citim interesant nga një vëzhgues i industrisë dhe shitjeve on-line të produkteve:

“Do të jetë veçanërisht e rëndësishme për menaxherët e logjistikës që të peshojnë me të vërtetë përfitimet e përdorimit të informacionit të zinxhirit të furnizimit, kundrejt aftësisë për të zbatuar përmirësime në strategjinë e tyre logjistike”³⁸.

Përdorimi në rritje i printerëve 3-D në aplikacionet komerciale do të ketë një ndikim për mbështetjen logjistike ushtarake. Sfida e mëparshme e rifurnizimit të pjesëve të këmbimit për teknikën dhe pajisjet ushtarake do të zëvendësohet me sfidën e rifurnizimit të mediave të printimit (plastike dhe metalike), së bashku me harduerin kompjuterik dhe sistemet e energjisë të nevojshme për funksionimin e printerëve industrialë 3-D. Gjithashtu printerët 3-D kërkojnë platforma shumë të qëndrueshme për të lejuar prodhimin e artikujve kompleksë në nivele të larta tolerance, të cilat mund të mos jenë të realizueshme, nëse trupat ushtarake po kryejnë operacionet në distanca të largëta dhe që funksionojnë në kushte të vështira. Agjencia Amerikane e Logjistikës së Mbrojtjes (Defense Logistics Agency-DLA) është duke punuar për të ndërtuar një program për të siguruar kontrolle efektive për paketat e të dhënave që janë të disponueshme vetëm për një rrjet të klasifikuar të printerëve komercialë 3-D kur ata marrin porosi (komanda) nga njësitë ushtarake në terren.

³⁸ Hayden Marshall “SIX STRATEGIC CHALLENGES FOR DEFENCE LOGISTICS”. 2018
Director-General Strategic Logistics at Joint Logistics Command

Siguria kibernetike

Dëshmitë që lidhen me risitë në zinxhirin e furnizimit në përgjithësi kanë lidhje me menaxhimin e përmirësuar të informacionit, përmirësime të softuerëve kompjuterik dhe përdorimit të mjeteve inteligjente më efikase dhe efektive. Dobësia e rrjeteve kompjuterike dhe pajisjeve inteligjente ndaj sulmeve kibernetike ka marrë një vëmendje të shtuar në dekadën e fundit duke krijuar jo pak probleme në struktura të niveleve të larta të shteteve të ndryshme dhe bizneseve duke arritur deri në bllokimin apo mohimin e shërbimeve të ndryshme. Sulmet kibernetike tashmë nuk kanë si objektivat/target vetëm industrinë dhe institucionet e TI. Ato dita-ditës po drejtohen edhe ndaj rrjeteve qeveritare dhe liderëve politikë botërorë. IoT është një term që përdoret për të përshkruar numrin në rritje të pajisjeve të lidhura në internet. Këto pajisje përfshijnë pajisjet shtëpiake inteligjente, si termostate dhe frigoriferë, sensorë mjekësorë, sisteme sigurie dhe alarmi, të tjera pajisje të ngjashme me to.

Rritja e shumëllojshmërisë së pajisjeve të teknologjisë së përdorimit/operimit (Operational Technology—OT) dhe pajisjeve industriale e internetit (Internet of Things—IoT), ka çuar në rritjen e krimit kibernetik dhe hakerimit, që janë vjedhja e të dhënave nëpërmjet aksesit në të dhënat sensitive, si; fjalëkalimet, numrat e kartave të kreditit, por edhe informacionet që kanë lidhje, me shëndetin e individëve. Ne gjithashtu duhet të jemi të vetëdijshëm se kundërshtarët e mundshëm ka të ngjarë të kenë më shumë se një interes jo të rastësishëm, në të dhënat tona logjistike. Grumbullimi i suksesshëm i informacionit nga burime të pa klasifikuara, mund të sigurojë të dhënat mbi stoqet dhe disponueshmërinë e mirëmbajtjes, që mund të jenë zona të cënueshmërisë ose shfrytëzimit të mundshëm.

7. LOGJISTIKA E INTEGRUAR DHE LUFTA E GJENERATËS SË KATËRT

Një ndër iniciativat që SHBA me vendet e Aleancës dhe ato partnere po vijojnë të zhvillojnë, është integrimi global i burimeve dhe resurseve logjistike, të cilat mund të mbështesin më mirë operacionet si dhe të përmbushin plotësisht kërkesat strategjike, në kushtet kur përballen me burime të kufizuara ushtarake. Koncepti propozon përdorimin e logjistikës së integruar globalisht, për të mbështetur operacionet e ardhshme të përbashkëta të cilat do të karakterizohen nga nevoja për të grumbulluar me shpejtësi forcat e shpërndara në territore të ndryshme të globit, në vartësi të situatës apo misionëve të marra. Logjistika e integruar globalisht shihet si aftësi për të shpërndarë dhe gjykuar mbështetjen logjistike në një shkallë globale, për të maksimizuar efektivitetin dhe përgjegjshmërinë, dhe për të pajtuar kërkesat konkurruese për burime të kufizuara logjistike, bazuar në prioritetet strategjike. Ky integrim do të shtrihet në; 1) Rrjetin global të shpërndarjes; 2) Ndërgjegjësimin e gatishmërisë globale; 3) Aftësitë e përgjegjshme të planifikimit të logjistikës.

Lufta e Gjeneratës së Katërt (4GW).

Teoricienët modernë ushtarakë, të inkurajuar nga idetë e William Lind, po përmendin shfaqjen e një lloji të ri të luftës, ku shtetet sovranë po humbasin monopolin e tyre mbi luftën. Konflikti i ardhshëm do të lidhet me çështjet kulturore, e jo me sovranitetin. Legjitimiteti i shteteve do të sfidohet, luftërat do të jenë të pashpallura dhe gara do të jetë më shumë për supremacinë e ideve, në krahasim me betejat tradicionale të territorit.

Lufta e gjeneratës së tretë bazohej në “Blitzkrieg” ose në luftën e manovrimit të shpejtë pas Luftës së Parë Botërore. Taktikat e shpejtësisë dhe befasisë për të “anashkaluar dhe rrëzuar” forcat e armikut, përfaqësojnë një sfidë të rëndësishme për logjistikën ushtarake me mbështetje të madhe në logjistikën e decentralizuar, për të mbështetur forcat e shpërndara në venddislokime të ndryshme. Në ditët e sotme sfidat e 4GW, janë shtruar për diskutim dhe po adresohen nga personeli i mbështetjes logjistike, e sotme dhe e nesërme.

Një vëzhgim interesant nga Parag Khanna, komentator i marrëdhënieve ndërkombëtare, në librin e tij të fundit, sugjeron se... “Zinxhirët e furnizimit dhe lidhjet, e jo sovraniteti dhe kufijtë, do të jenë parimet organizuese të njerëzimit në shekullin e 21-të”³⁹. Si për strategët ushtarakë, ashtu edhe për drejtuesit e logjistikës, sfida për të kuptuar zinxhirët e furnizimit dhe varësitë e tyre, do të jetë shumë e rëndësishme, Ajo që duhet të merret në konsideratë në vijim, është kuptimi për interesat e palëve të tjera, në të njëjtët zinxhirë furnizimi.

Ne, duhet t'u japim përgjigje gjashtë pyetjeve të mëposhtme:

1. Çfarë masash duhen marrë parasysh, për të siguruar që zinxhirët e furnizimit të mbrohen siç duhet, ndryshe nga qasjet tradicionale ushtarake?
2. A merren parasysh vlerësimet tona të gatishmërisë, variablat e zinxhirit të furnizimit?
3. A duhet të verifikohet zbatueshmëria në mjetet e hartës së zinxhirit të furnizimit?
4. Cilat aktivitete të mbështetjes logjistike, do të vazhdojnë të kryhen nga personeli ushtarak?
5. Si mund ta bëjmë kalimin në mbështetjen logjistike të gjeneratës së V-të?
6. A e kuptojmë vërtet shkallën e ndryshimit në horizont, për mbështetjen logjistike që lidhet me teknologjitë e reja, e që nuk janë më, në botën e fantashkencës, por janë realiteti i sotëm?

³⁹ Khanna, P., Connectography: Mapping the Global Network Revolution. 2016 Posted on June 15, 2018 by logistics in war

PROBLMATIKA DHE PËRFUNDIME

Të gjitha forcat e armatosura të vendeve të ndryshme, në këtë periudhë janë në proces të transformimit dhe zhvillimit për t'iu përgjigjur sfidave të reja të sigurisë. Programet dhe mënyra e menaxhimit të kapaciteteve të mbështetjes logjistike, kanë ndryshuar së tepërmi. Pajisjet dhe materialet tradicionale po zëvendësohen me pajisje më të reja dhe shumë më të afta, që kërkojnë të menaxhohen nën regjime shumë të ndryshme të mirëmbajtjes/mbështetjes. “Ekosistemet industriale”, po diktojnë mundësi të reja për opsionet e mbështetjes logjistike. Kështu për shembull, mirëmbajtja e pajisjeve ushtarake të reja për mbrojtjen ka ndryshuar, pasi këto të fundit nuk kanë nevojë që të kryhet mirëmbajtja periodike (parandaluese) dhe ato shfaqin më pak defekte. Kërkesat e mbështetjes logjistike për forcën e ardhshme, do të jenë thelbësisht të ndryshme nga kërkesat e mbështetjes logjistike të forcës së sotme. Rritja e përdorimit të teknologjisë për diagnostikimin e sistemeve, do të sigurojë që aktivitetet e mirëmbajtjes të përcaktohen qartë, e t'u jepet prioriteti i duhur. Nga ana tjetër, teknologjitë e reja dhe sistemi i shkëmbimit të të dhënave, do të ulë shumë nivelin e stokeve të rezervës, për shkak të pamjes së qartë të burimeve dhe funksionimit të rrjeteve të furnizimit globale. Për shumë komponentë, nuk ka asnjë vlerë riparimi i ndonjë dëmtimi të mundshëm, pasi është më i lirë dhe më i shpejtë, zëvendësimi me pajisje të re. Nanoteknologjia po ofron mundësi të mëtejshme për përmirësime në elektronikë, terapi mjekësore, shfrytëzimin e energjisë dhe përmirësimin e mjedisit, që do të riformësojë gjithashtu kërkesat e mbështetjes logjistike. Rritja e përdorimit të inteligjencës artificiale do të zëvendësojë në mënyrë progresive shumë fusha që aktualisht piren ndaj gabimeve dhe paragjyqimeve, që aktualisht çojnë në rezultate nën optimale. Me pak fjalë, e ardhmja duket të jetë shumë më ndryshe. Mendoj se duhet të kemi në qendër të vlerësimit, vazhdimisht parasysh:

Më sipër janë paraqitur disa nga zhvillimet dhe sfidat që mendoj se do të përballemi në të ardhmen e afërt, që kanë lidhje me mbështetjen logjistike të trupave në operacione. Këto janë sa për të ngacmuar mendimin, diskutimin, pse jo debatin, për të identifikuar ndikime të tjera në mbështetjen logjistike dhe se në çfarë mënyre ne, duhet t'u përgjigjemi ndryshimeve të reja në fushën e mbrojtjes. Me përfundimin e konfliktit në Ukrainë dhe analizën e mësimave të nxjerra nga ajo, besojmë dhe shpresojmë se do të identifikohen më shumë sfida, opsione dhe alternativa, që do të kërkojnë zgjidhje. Ajo se çfarë komuniteti logjistik ushtarak i ofron komandantëve operacionalë, është besimi se sistemi logjistik, do të jetë mjaft elastik dhe i përgjegjshëm, për të mbështetur kërkesat e misionit.

BURIME TË SHFRYTËZUARA

1. Pagonis, G.(2012). "Moving Mountains: Lessons in Leadership and Logistics from the Gulf War". Cambridge Mass: Harvard Business School Press.
2. Morgan. J. (2011), "War Feeding War: The Impact of Logistics ". Journal of Military History, Vol 7 (6) pp.83-116.
3. NATO Logistics Handbook, Definitions, Nov 2012
4. US Marines tactics 3-40C, 2016, f. 1-1
5. Army Sustainment AT 4.1, 1-1
6. Steve R. Waddell, US Army Logistics: the Normandy Campaign (Westport: Greenwood Press, 1994), 65
7. James S. Corum, "Supplying the Big Red One," Forbes (June 5, 2008), under "France--July 1944," <http://www.forbes.com/2008/06/05/logistics-wwii-usarmy-tech-logistics08-cx-jc-0605normday.html>
8. Captain John J. King, 1st QM Company: Report After Action (Coutances: 1st Quartermaster Company, 1944), 1.
9. LT Colonel Clarence Eymer, 1st Infantry Division: Administrative Order (France: 1st Infantry Division G4, 1944), 2
10. After Action Report, G4 Section (JUN 44-DEC 44 & DEC 45), 25. Ammunition Supply Point.
11. Captain Raymond G. Huntoon, 701st Ordnance Light Maint. Coy: After Action Report (France: 1st Inf. Div, 1944), 2.
12. Major Leo B. Burgin, Historical Records and History of Organization, 1st Medical Battalion (Marigny: HQ, 1944).
13. Zaloga, 44. "heavy" armored divisions. "Order of Battle, World War II," http://www.3ad.org/wwii/wwii_order_of_battle.html.
14. After Action Report, G4 Section (JUN 44-DEC 44 & DEC 45), 25. G4's AAR inputs (ÇB, Tank Bn, truck coy, etc)
15. Combat Service Support Battle Book, 4-5 – 4-9. Appendix J for the logistical results, consumption data, usage rate, loss rates, and operational readiness rates
16. Combat Service Support Battle Book, 4-14 – 4-16
17. Skoglund, P., Listou, T., & Ekström, T. (2022). Russian Logistics in the Ukrainian War: Can Operational Failures be Attributed to logistics? Scandinavian Journal of Military Studies, 5(1), pp. 99–110.
18. Vershining, A. (2021). Feeding the bear: A closer look at Russian army logistics. War on the Rocks.
19. Listou, T., & Ekström, T. (2022). Russland i Ukraina: uten logistikk skjer det lite på slagmarken. Stratagem.

KLAUZEVIÇI MBI LUFTËN DHE LUFTA NË UKRAINË

Nënkolonel Msc. Nikolin LAZRI
Oficer shtabi në Forcën Tokësore

Trajtesë e shkurtuar.

Konflikti i armatosur mes Rusisë dhe Ukrainës shënon rikthimin e luftimeve me intensitet të lartë në Evropë. Që nga data 24 shkurt 2022, opinioni mbarëbotëror është dëshmitar i acarimit i marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy shteteve, që çoi deri në luftë të armatosur mes Rusisë dhe Ukrainës. Fuqitë njerëzore dhe fuqitë e zjarrit të dislokuar në këtë operacion nuk janë parë në tokën evropiane që nga Lufta e Dytë Botërore.¹

Megjithëse përmendet data 24 shkurt 2022, si akti i fillimit të agresionit rus ndaj një shteti të pavarur, që ka të drejtën e tij legjitime për të marrë vendime të padiskutuara nga askush, simptomat e këtij konflikti kishte kohë që ishin parë dhe diagnostikuar si një premisë e pashmangshme për luftë. Përtej çdo parashikimi, deri tani (gusht 2023) rezistenca ukrainase ka treguar dhe ka vërtetuar se, përpos fuqisë numerike, përparësisë në teknologji, qëllimit armiqësor dhe dhunës së pamëshirshme të sulmuesit (në këtë rast Rusia), janë edhe disa elemente të tjera si ndjenja kombëtare, morali, guximi, krenaria etj., që i mundësojnë mbrojtësit (në këtë rast Ukraina) të ketë forcë dhe kurajë që jo vetëm të mos pranojë imponimin e dhunës së sulmuesit, por, madje, ta vendosë në kushte të atilla, që pala sulmuese (Rusia) të ribënte edhe njëherë llogaritë e kësaj e lufte.

Analiza, mendime, opinione, parashikime, kritika dhe shpallje fituesish e

¹ Édouard Jolly. *Clausewitz in Ukraine*. Burimi elektronik: <https://www.irsem.fr/publications-de-l-irsem/breves-strategiques/strategic-brief-no-34-2022-clausewitz-in-ukraine.html>.

humbësish janë tema e ditës për këtë konflikt. Në këto përpjekje nuk mungojnë edhe parashikimet për fituesin, për humbësin e madh, për kohëzgjatjen, për rezistencën, për përfundimin e luftës, për paqen, duke e mbajtur debatin e hapur dhe të zjarrtë. Tendenca është për të parë ku qëndron sekreti i rezistencës ukrainase si dhe ku qëndron pamundësia e palës ruse për të përfunduar një luftë të shpejtë për 3-4 ditë.

Në këtë punim nuk ofrohet as fituesi as humbësi, as se kur do të përfundojë lufta, as si do të vendoset paqja, por ajo që po ndodh në luftën në Ukrainë është tentuar të shihet nga thjerrëzat e mendimit të strategut të madh ushtarak, Karl Fon Klauzeviç². Gjërat, të cilat do trajtohen në vijim, dhe që dukshëm nuk e kanë humbur vlerën e kohës së thënies së tyre nga Klauzeviç, do të jenë objekt i të shikuarit të asaj që ka ndodhur, po ndodh dhe mund të ndodhë në mes palëve ndërluftuese në luftën në Ukrainë, gjithmonë i parë nga këndvështrimi i Klauzeviçit.

Fjalë kyçe: Klauzeviç, Ukrainë, Rusi, luftë, paqe, aleat, dhunë, sulmues, mbrojtës, fitues, humbës, agresor.

HYRJE

Klauzeviçi, me librin e tij “Mbi luftën”, është cilësuar si mendimtari Kushtarak më i shquar, i cituar dhe i studiuar në shkollat më të njohura e të rëndësishme në botë, duke ruajtur vlerën e thënieve të tij, pas afro 200 vitesh. Analiza të shumta janë bërë rreth luftimeve ndër vite dhe të asaj që po ndodh aktualisht në Ukrainë, duke e parë luftën në dritën e teorisë së Klauzeviçit.

Në këtë frymë, edhe ky punim është ndërtuar duke marrë në konsideratë disa nga përcaktimet më të rëndësishme të Klauzeviçit, të jetësuar në veprën e tij “Mbi luftën”, e që cekin rolin e politikës, mjetet e luftës, planin e luftës, fërkimin në luftë, sulmin, mbrojtjen, përfundimin e luftës dhe paqen. Këto përcaktime janë vendosur në kontekstin e luftës në Ukrainë. Qëllimi nuk është ndarja si me thikë e triumfuesit apo humbësit, aq më pak dhënia e recetës që “kështu ndodhi dhe do ndodhë” dhe “ky do të jetë përfundimi”, por, për të parë nëse teoria dhe koncepti i Klauzeviçit për luftën ka pasur dhe ka përputhshmëri me atë që ka ndodhur dhe po ndodh me Ukrainën në dekadat e fundit.

Nëse analizojmë përcaktimet e Klauzeviçit dhe ngjarjet që po zhvillohen në tokën ukrainase, duke marrë në konsideratë angazhimin dhe mbështetjen e faktorit ndërkombëtar në favor të Ukrainës, synohet të jepet një këndvështrim i përgjithshëm mbi qëndrueshmërinë dhe zbatueshmërinë e mendimit të Klauzeviçit nga palët ndërluftuese (ruse - ukrainase), pavarësisht se fushëbeteja

² Karl Fon Klauzeviç, gjeneral dhe teoricien ushtarak prusian, (1780 – 1831). Libri i tij “Mbi luftën” (1832) është një nga librat filozofik ushtarak më me ndikim i të gjitha kohërave.

e sotme është shumë më e ndërlikuar dhe në aktivitetet luftarake përfshihen edhe burime të cilat nuk ekzistojnë në shekullin e 19-të.

Për vetë rëndësinë e kësaj ngjarje në tokën evropiane, dhunën e shkaktuar, humbjet e mëdha në jetë njerëzish të pafajshëm, shkatërrimin e qyteteve të tëra dhe efektet që janë ndjerë përtej rajonit të konfliktit, sidomos në cungimin e mundësisë së furnizimit me grurë të popullsisë tjetër të botës, pa lidhje me luftën, është krejt me vend të ngrihen pyetje të tilla si: Pse filloi lufta?; A ishin në dijeni ukrainasit, evropianët dhe amerikanët për agresionin rus?; A do të vazhdojë të rezistojë Ukraina?; A do të heqë dorë Rusia nga agresioni në Ukrainë?; A do të ketë zgjidhje të krizës dhe paqe? Nga këndvështrimi i këtij punimi, disa përgjigje mund të dalin në pah nëpërmjet pyetjes: Si do e shihte Klauzeviçi luftën në Ukrainë?

Ky punim mund të vijë në ndihmë të të gjithë atyre që janë të interesuar dhe të orientuar drejt përgatitjes së vlerësimeve dhe analizave të krizave, konflikteve dhe luftërave, duke u mbështetur në filozofinë klauzeviçiane. Trajtimi dhe lidhja e përcaktimeve të Klauzeviçit me luftën në Ukrainë është një qëndrim i pavarur dhe personal i autorit dhe nuk përfaqëson mendimin apo qëndrimin e institucionit ku punon, institucioneve të tjera shtetërore dhe jositetërore vendase dhe të huaja dhe nuk kufizon të drejtën e kujtdo për ta parë këtë luftë në këndvështrime të ndryshme.

1. SHKAKU I LUFTËS

Që në krye të herës vlen të citohet Klauzeviçi, i cili thotë se: *“Lufta nuk shpërthen në mënyrë të papritur dhe nuk përhapet brenda një çasti”*.³ Fillimi i agresionit rus në Ukrainë nuk ishte një “rrufe në qiell të pastër”. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe, bazuar në analiza të sakta të sjelljes së makinerisë propagandistike dhe ushtarake ruse, kishin vënë në dijeni autoritetet ukrainase se sulmi ishte i pashmangshëm. Por çfarë kishte ndodhur dhe pse përplasja ishte e pashmangshme? Duke u kthyer mbrapa në kohë, e duke ndjekur gjurmët e zhvillimeve në rajonin e konfliktit, konstatohet që pikënisja ka sfond të theksuar politik. Nëse interpretohet nga deklarimi i Klauzeviçit se: *“Politika është mitra ku zhvillohet lufta”*.⁴, shihet qartësisht se “fara e politikës” ruse ishte hedhur në fushën e luftës me Ukrainën, më shumë se dy dekada përpara fillimit të luftës. Ishte politika ruse e propaganduar dhe e shprehur haptas dhe zyrtarisht nga presidenti Putin, duke filluar nga viti 2001, brenda doktrinës së ashtuquajtur “Bota Ruse”, që filloi të lëshojë rrënjë dhe të zhvillohet si një qasje agresive, me synime dhe qëllime armiqësore ndaj vlerave perëndimore në përgjithësi dhe Ukrainës në veçanti. Pas

³ Carl von Clausewitz. *Mbi luftën*, (Tiranë: Helga's Secrets, 2020), 27.

⁴ Po atë, 166.

“Revolucionit Portokalli” në vitet 2004 - 2005 ku u tentua por nuk u arrit që të silllej në pushtet një udhëheqje politike e Ukrainës, e cila të ishte e orientuar dhe e varur nga Kremli, kjo kornizë u përforcua me idetë e Vladimir Putin-it për “komunitetin e popujve sllavë”, “në vijën e ndarjes së popullit rus” etj.⁵ Nëpërmjet kësaj vije politike, Rusia kërkonte të ndryshonte rregullat e lojës, të prishte ekuilibrat e sigurisë të vendosura në arenën ndërkombëtare dhe të rikthente kohët e saj të perandorisë. Në frymën e kësaj vije politike, presidenti Putin duket se ndante të njëjtën pamje me Zbiginiev Brzezinski-n i cili deklaronte se: “pa Ukrainën, Rusia pushon së qeni një perandori, por me një Ukrainë të nënshtruar dhe të varur, Rusia bëhet automatikisht një perandori”.⁶

Ndërkohë që Rusia kishte qasje dhe qëllime armiqësore jo vetëm ndaj Ukrainës, por edhe ndaj shteteve të tjera, pjesë e sferës së varësisë dhe ndikimit të kaluar sovjetik (Gjeorgjia dhe Moldavia), ndaj të cilëve ushtrohej trysni, dhunë politike e ushtarake, nga ana e saj, Ukraina, sidomos pas dështimit për kontroll politik të udhëheqjes së saj nga ana e Rusisë, kishte shpallur haptas politikën për shpëputjen përfundimtare nga influenca ruse dhe përfshirjen e saj në procese për t’u bërë pjesë e strukturave të përbashkëta perëndimore (NATO, BE). Siç edhe shihet, drejtimet politike që kishin marrë palët ndaheshin qartësisht dhe nuk mund të puqeshin: njëra (Ukraina) orientim dhe frymë në të drejtën legjitime dhe të patjetërsueshme të shteteve për të vendosur në mënyrë të pavarur dhe të pakushtëzuar për fatin dhe të ardhmen e saj dhe tjetra (Rusia) vijë politike kushtëzuese, me ndërhyrje haptas dhe të pa justifikuar ligjërisht në proceset politike që po zhvilloheshin në Ukrainë, me pretendimin se politika ukrainase dhe proceset integruese në organizma perëndimore të Ukrainës kanë ndikim për ekzistencën e shtetit rus.

Vitet e fundit, Rusia, vijën politike të mbështetur nga një makineri e fuqishme propagandistike, e kishte materializuar me veprime të njëanshme dhe të papranueshme nga faktori ndërkombëtar, duke ndërhyrë ushtarakisht në Gjeorgji në vitin 2008 dhe duke aneksuar Krimenë, pjesë e Ukrainës, në vitin 2014. Pra, udhëheqja ruse kishte krijuar një pamje të lexueshme, e niste me politikë, e mbështeste me propagandë dhe e përgjakte me luftë. Fati i keq i kësaj politike të përgjakur do ishte kësaj radhe edhe për popullin e ukrainas. Kështu pra, “fara politike ruse” kishte nxjerrë “filizat e luftës”.

⁵ Shulzhenko, Fedir, Gaudulin, Aleksandr. *Legal and political aspects of war in Ukraine: Philosophical reflection on the scene of battles*. 2022, 150. Burimi elektronik: <https://doi.org/10.32849/2663-5313/2022.2.23>

⁶ François Heisbourg. *How to end a war: Some historical lessons for Ukraine?* Burimi elektronik: <https://www.iiss.org/online-analysis/survival-online/2023/07/how-to-end-a-war-some-historical-lessons-for-ukraine/>

2. PËRDORIMI I MJETEVE TË TJERA

Klauzeviç ka thënë: “..lufta nuk është vetëm një akt politik, por edhe një instrument i vërtetë politik, një vazhdim i marrëdhënieve politike, një realizim i tyre me mjete të tjera”.⁷ Rusia, pas më shumë se dy dekadash politike agresive, tentativave për vendosjen e një regjimi pro rus, aneksimit të Krimesë, trazirave në rajonet me popullsi rusisht folëse në Ukrainë, e kaloi luftën politike me Ukrainën në një stad tjetër, duke vënë në përdorim mjetet e tjera (mjetet e dhunës), me qëllim arritjen e objektivave politikë. Kështu, më 24 shkurt 2022, siç edhe pritej, Rusia ndërmori një agresion në shkallë të gjerë duke sulmuar Ukrainën, me synimin për të kapur kryeqytetin ukrainas, Kievin dhe më pas për të pushtuar të gjithë vendin.

Acarimi i situatës që çoi në përdorimin e dhunës nga pala ruse, duket se shkon përshtat me përcaktimin e Klauzeviçit, i cili ka thënë: “*Lufta nuk është gjë tjetër veçse një duel në shkallë më të gjerë. Lufta është pra një akt dhune që synon ta detyrojë kundërshtarin të zbatojë vullnetin tonë*”.⁸ Mjetet e dhunës u përdorën me të gjithë fuqinë e tyre. Dhuna ruse ishte e pamëshirshme, duke mos kursyer as objektet civile apo popullsinë e pafajshme. Humbje jetë njerëzish nga të dy palët. Dhuna e makinerisë ruse kërkonte të mposhte rezistencën ukrainase dhe të diktonte vullnetin e politikës së udhëhequr nga presidenti Putin. Mjetet e rezistencës (ushtria, territori dhe popullsia, aleatët) ukrainase ishin në funksion të mos lejimit të realizimit të objektivave politikë dhe ushtarakë rus. Ukraina, e detyruar të luftojë fort në këtë duel, pasi nuk e zgjodhi luftën, ajo iu imponua nga sulmi rus, aktit të dhunës ruse iu përgjigj me një forcë reaguese të jashtëzakonshme dhe befasuese, jo vetëm për agresorët (rusë) por ndoshta edhe të paparashikuar nga shumë aktorë me ndikim të padiskutueshëm në arenën ndërkombëtare, të cilët po i ndiqnin me vëmendje zhvillimet në këtë rajon lufte. Vullneti i sulmuesit (Rusisë) nuk u arrit të imponohej te mbrojtësit (Ukraina). Dhuna shkaktoi dëme por nuk arriti atë që kërkonin ideuesit, planëzuesit dhe zbatuesit e kësaj lufte. Dueli në shkallë të gjerë vazhdon. Ukrainasit janë në mbrojtje të vendit të tyre dhe po përballojnë, përtej çdo parashikimi, një makineri ushtarake që paraqitet si fuqi ushtarake botërore. Lind pyetja: Nga buroi gjithë kjo forcë qëndrese ukrainase? Sipas Klauzeviçit, *mbrojtja jo vetëm që është më e fortë se veprimet sulmuese të kundërshtarit, por mbrojtja ka gjithashtu akses te mjetet shitesë. Këto mjete janë forcat ushtarake, territori, populli, populli nën armë dhe aleatët*.⁹ Nëse e vendosim në kontekstin e asaj që po zhvillohet në terren, shihet që në

⁷ Carl von Clausewitz. *Mbi luftën*, (Tiranë: Helga's Secrets, 2020), 45.

⁸ Po aty, 20.

⁹ Olivia Garard. *Some Clausewitzian thoughts on the Ukrainian defense*. Burimi elektronik: <https://mwi.westpoint.edu/some-clausewitzian-thoughts-on-the-ukrainian-defense/>

aktivitetet luftarake mbrojtëse të zhvilluara deri tani, nga ana e Ukrainës janë përdorur me efikasitet këto mjete. Forcat e Armatosura ukrainase, popullsia e mobilizuar dhe e vënë nën armë, si dhe ndihmat e mbështetja e aleatëve kanë qenë vendimtare në organizimin e mbrojtjes, përballimin dhe mos lejimin e forcave ruse për të pushtuar Kievin. Mbrojtja ukrainase e Kievit ofron një shembull modern të dëshirës për luftë të Klauseviçit dhe idesë së tij për të gjithë popullin në luftë. Raportet e ditëve të para të luftimit tregonin civilë ukrainas që në bashkëpunim me Forcat e Mbrojtjes Territoriale dhe Brigadën e 72-të të Këmbësorisë së Mekanizuar kryen me sukses mbrojtjen e Kievit.¹⁰

Megjithatë, duke marrë në konsideratë edhe faktin që Ukraina nuk ka arritur të mbajë një pjesë të territorit të saj, mbrojtja nuk është zgjidhja më e mirë për të siguruar integritetin territorial të vendit. Në fazën e parë (le ta quajmë kështu momentin e përballimit të agresionit rus), organizimi dhe zhvillimi i operacionit mbrojtës iu përgjigj më së miri furisë së sulmit rus, që, gjithsesi nuk e ndaloi dot të mos i pushtonte pjesë të territorit të saj. Kështu, në pikën e agresionit, në periudhën mars - prill 2022, rusët pushtuan afërsisht 140.000 km², më shumë se 1/5 e territorit të Ukrainës, ndërsa aktualisht trupat e Moskës mbajnë afërsisht rreth 109.395 km².¹¹ Ashtu siç ndodhi në fushën e betejës, në duelin: mbrojtje (Ukrainë) - sulm (Rusi). Për mbrojtjen Klauseviç ka thënë: *“luftimi mbrojtës nuk ka aq shumë nevojë sa të mundë forcat e kundërshtarit sesa të mos lejojë armikun për të arritur objektivin e sulmit. Mbrojtja është pikë së pari dhe mbi të gjitha për të qëndruar, duke e kthyer pritjen në mundësi. Përkohshmëria e mbrojtjes strategjike nënkupton t’i përgjigjes shpejtësisë me durim...”*¹²

Duke i parë zhvillimet nga ky këndvështrim, si dhe duke marrë në konsideratë përgatitjet e Ukrainës për të kaluar nga operacionet mbrojtëse në ato sulmuese (kundërofensiva) shihet që mbrojtja ukrainase ka qenë veprim i përkohshëm, duke mos lejuar rusët të realizonin objektivin e tyre për pushtimin e Kievit dhe të gjithë vendit. Tashmë, gjithnjë e më tepër flitet për përgatitje të forcave ukrainase për ta kthyer pritjen, në një mundësi për të realizuar një kundërofensivë, me qëllim rimarrjen e territoreve të pushtuara nga rusët. Sa do të arrihet, mbetet për t’u parë. Problemi më i madh i kundërofensivës ukrainase, megjithëse janë në territorin e tyre të ligjshëm, do të jetë që tashmë forcat ruse kanë kaluar në mbrojtje në vijën e kapur, e cila përfshin brenda vetes rreth 109.395 mijë km² të territorit ukrainas, e për këtë do i duhet të ndeshet fort, duke marrë në konsideratë epërsitë e mbrojtjes. Përgatitja e

¹⁰ Antulio J. Echeverria II. Clausewitz’s “Warlike element and the war in Ukraine”. Burimi elektronik: <https://www.militarystrategymagazine.com/article/clausewitzs-warlike-element-and-the-war-in-ukraine/>

¹¹ François Heisbourg. *How to end a war: Some historical lessons for Ukraine?* Burimi elektronik: <https://www.iiss.org/online-analysis/survival-online/2023/07/how-to-end-a-war-some-historical-lessons-for-ukraine/>

¹² Édouard Jolly. *Clausewitz in Ukraine*. Burimi elektronik: <https://www.irsem.fr/publications-de-l-irsem/breves-strategiques/strategic-brief-no-34-2022-clausewitz-in-ukraine.html>

kundërofensivës ukrainase ka edhe mbështetjen e gjerë ndërkombëtare, pasi është në të drejtën e saj për të rimarrë në zotërim territorin e pushtuar, por do ndeshen me një forcë mbrojtëse që do të përdorë çdo mjet dhune, të ligjshëm e të paligjshëm (*referuar në kontekstin e së drejtës ndërkombëtare*), për të mbrojtur territorin që ka pushtuar.

Sido që të ndodhë, në këto momente për Ukrainën nuk duket se ka zgjidhje tjetër përveç se për të menduar rimarrjen e territoreve të pushtuara. Nga ana tjetër duket që Rusia nuk ka forcë për të vazhduar përpara. Palët, nëpërmjet veprimeve sporadike, përpiqen të vënë njëra-tjetrën në pozitë të heqjes dorë nga lufta dhe të pushojnë qëndresën, në këtë “*lojë lufte*”, ku në vijën e zjarrit janë jetë njerëzish, të cilat nuk po kursehen. Ukraina e ka të pamundur të pushojë qëndresën e të heqë dorë nga sakrificat, pasi ka humbur një pjesë të territorit, e duhet t’i tregojë agresorit që ka mundësi dhe është e gatshme të vazhdojë qëndresën, të sakrifikojë dhe se ka fuqinë e nevojshme reaguese. Për këtë, forcat ruse që janë në territorin që kanë pushtuar, duhet të vendosen në një gjendje pamundësie për ta mbajtur këtë territor, për të cilën Klauzeviç ka thënë: “*Në qoftë se duam pra të detyrojmë kundërshtarin, me anë të veprimeve luftarake, të zbatojë vullnetin tonë, duhet ose ta vëmë në një gjendje ku ai të jetë me të vërtetë i pafuqishëm ose ta ndjejë veten të kërcënuar për një mundësi të tillë.*”¹³ A do të ndodhë? Ukraina po përgatitet që ta bëjë të mundur të ndodhë. Aleatët e Ukrainës e mbështesin dhe presin të ndodhë. Por...?

3. MJEGULLA E LUFTËS DHE FËRKIMI

Lufta e filluar ndaj Ukrainës nuk prodhoi rezultatet e dëshiruara nga pala ruse. Ajo që për palën ruse dukej si çështje marshimi drejt Kievit dhe marrjes nën kontroll të plotë të Ukrainës doli të ishte krejt e kundërta. Në fakt, Klauzeviçi ka thënë: “*Në luftë gjithçka është shumë e thjeshtë, por gjëja më e thjeshtë nuk është e lehtë. Vështirësitë grumbullohen dhe prodhojnë një fërkim*”.¹⁴ E thjeshtë duhet të jetë konceptuar nga rusët kjo luftë, për të cilën kishin siguruar bindjen se qëndresa ukrainase do pushonte së ekzistuari për çështje ditësh. Megjithatë, në front dhe në përballje gjërat janë ndryshe. Pavarësisht përparësive teknologjike që mund të ketë një palë ndërluftuese është e pamundur që të sigurohet i gjithë informacioni i plotë, në detaje, për kundërshtarin. Do ketë gjithmonë paqartësi apo mungesë informacioni, të cilat në këndvështrimin e Klauzeviçit janë mjegulla e luftës. Ato llogari që bëhen dhe përfshihen në planet e luftës marrin në konsideratë gjëra të matshme, fjala bie aftësi dhe fuqi fizike, por nuk kanë mundësi të matin forcën e faktorëve të tjerë të cilët janë përcaktues në luftë. E një ndër to, që nuk mund të matet,

¹³ Carl von Clausewitz. *Mbi luftën*, (Tiranë: Helga’s Secrets, 2020), 24.

¹⁴ Po aty, 112.

është edhe fuqia morale e luftuesve. Pak kush e priste që presidenti Zelenski të rezistonte, madje u përgatiten plane dhe u ofruan mbështetje për një largim të përkohshëm dhe të sigurt nga Ukraina. Në fakt ai qëndroi, duke u kthyer në personin kyç të mbajtjes së moralit lart, jo vetëm për Forcat e Armatosura dhe popullin ukrainas, por edhe për aleatët të cilët mbështesin një Ukrainë jashtë influencës ruse. Kështu, nga ajo që ishte planëzuar tek ajo që ndodhi në realitet u prodhua një fërkim i madh, për të cilin Klauzeviçi ka thënë: *“Nocioni fërkim është i vetmi që i përshtatet në mënyrë mjaft të përgjithshme asaj që e dallon luftën e vërtetë nga ajo që lexohet në libra..”*¹⁵

Siç duket, vlerësimi i fuqisë luftarake të Ukrainës nga librat, hedhja e tyre në letër (plan) dhe krahasimi i fuqisë fizike (fuqisë luftarake nga pikëpamja ushtarake), për të cilët rusët mendonin se ishin superior të padiskutueshëm, ngeli thjesht në letra, duke i detyruar të rishikojnë nga fillimi planet e luftës dhe të ripërcaktojnë objektivat e dëshiruara për t’u arritur. Për llogari dhe vlerësime të tilla, të cilat përcaktojnë fatin e luftës, Klauzeviçi ka thënë: *“Po qe se duam ta thyejmë kundërshtarin duhet që përpjekjet tona t’i llogarisim në përputhje me aftësinë e tij të qëndruesës. Ky parim është produkti dy faktorëve të pandashëm: sasia e mjeteve që ai ka dhe forca e vullnetit të tij. Sasia e mjeteve që ai zotëron mund të përcaktohet pasi jepet me shifra, por nuk ndodh kështu me forcën e vullnetit.”*¹⁶ Ishte dhe është vullneti ukrainas, i pathyer deri tani, që ka bërë të mundur moslejimin e forcave ruse në realizimin e objektivave të fillimit të luftës, duke i dhënë një rrjedhë tjetër luftës. Aspekte të kësaj lufte që prodhuan befasinë më të madhe ishin vullneti dhe qëndresa e ukrainasve për mbrojtjen e rajoneve me popullsi rusishtfolëse, të cilat pala ruse i kishte konsideruar si zona të sigurta, e që nuk do i kërkonin fare përpjekje për t’i marrë nën kontroll. Kështu, rezistenca ukrainase në zonat rusishtfolëse përbën ndoshta formën më surprizuese të fërkimeve në planin rus të luftës. Plani rus dështoi në llogaritjen e rezistencës substanciale të popullsisë, e cila i shkaktoi një fërkim të konsiderueshëm në aksin e përparimit të Karkivit.¹⁷ Për palët ndërluftuese, në ditët në vijim, edhe nëse do të ketë mjegull të luftës, do të prodhohen ngjarje dhe surpriza të tjera, pasi janë pjesë e natyrës dhe karakterit shoqëruar të luftës, ka rëndësi që të merret në konsideratë thënia Klauzeviçit se: *“Sa kohë që nuk e kemi thyer kundërshtarin, duhet që ne vetë të kemi frikë mos thyhemi prej tij.”*¹⁸ Deri tani, ajo që dihet është se rusët nuk arritën të thyenin ukrainasit.

¹⁵ Carl von Clausewitz. *Mbi luftën*, (Tiranë: Helga’s Secrets, 2020), 113.

¹⁶ Po aty, 25.

¹⁷ Jack Tribolet. *The russo-Ukrainian war in Clausewitzian perspective*. Burimi elektronik: <https://defense.info/re-thinking-strategy/2022/07/the-russo-ukrainian-war-in-clausewitzian-perspective/>

¹⁸ Carl von Clausewitz. *Mbi luftën*, (Tiranë: Helga’s Secrets, 2020), 25.

4. REAGIMI NDËRKOMBËTAR

Lufta në Ukrainë nuk zhvillohet si një konflikt që ka lidhje dhe prek vetëm territorin dhe interesat e dy palëve. Një Ukrainë e nënshtuar dhe një Rusi triumfuese në këtë luftë do të jetë një ngjarje e cila do të ketë ndikim të padiskutueshëm në arenën ndërkombëtare, pasi Rusia do të kërkojë të shtojë oreksin, duke rritur presionin politik dhe ushtarak, sidomos me vendet që në të shkuarën ishin pjesë e çadrës sovjetike. Në këtë kontekst, faktori ndërkombëtar nuk është thjesht spektator që sheh, studion strategjitë e palëve në luftim dhe pret kush do të fitojë. Përkundrazi, jo vetëm shtete të caktuara që kanë ndikim në arenën ndërkombëtare, veçanërisht SHBA-të, por edhe organizma të tillë si OKB, NATO, BE janë të alarmuar dhe në unison kanë reaguar duke e dënuar sulmin rus ndaj Ukrainës. Për këtë kanë marrë vendime dhe masa të karakterit politik, diplomatik dhe ekonomik ndaj të gjithë ideuesve, planëzuesve dhe financuesve rusë të luftës, por pa përfshirë masa për ndërhyrje ushtarake në krah të Ukrainës.

Ukraina në fakt, përtej ndihmës dhe mbështetjes ndërkombëtare që e dënon sulmin rus, ka nevojë për mbështetje ushtarake nga aleatët. Kjo pasi vlera e fuqisë ushtarake ruse është me madhe se ajo ukrainase. Megjithatë, dëshira dhe nevoja ukrainase për mbështetje të plotë ushtarake nuk është aq e lehtë për t'u ofruar. Ukraina ishte në kërkim të aleatëve, si mundësia e fundit për të përballuar makinerinë ushtarake ruse. Sytë e veshët u drejtuan te pozicionimi i SHBA-ve dhe reagimi i tyre, pasi ato janë fuqia e vërtetë ekonomike dhe ushtarake në botë. Në mars 2022, presidenti Biden sinjalizoi që nuk do të dërgojë armë sulmuese në Ukrainë, por pas një muaji SHBA-të ndryshuan taktikë duke dërguar artileri dhe mjete të blinduara. Veprimet e SHBA-ve i janë përgjigjur edhe shtete të tjera si Britania e Madhe, Gjermania, Polonia etj., të cilat janë deklaruar në mbështetje të Ukrainës në të drejtën e saj legjitime për mbrojtjen e integritetit territorial, duke dërguar mjete dhe pajisje ushtarake tepër të domosdoshme për organizimin e sistemit të mbrojtjes ajrore si dhe fuqizimin e njësive për përgatitjen e kundërofensivës. Në “luftën për aleatë”, Ukraina ka mbështetje të gjerë botërore. Aleatët e Ukrainës janë në mbrojtje të së drejtës së shteteve për vetëvendosje, janë aleatë me qëllime mbrojtëse, ndërsa aleatët e Rusisë, e cila në këtë luftë është agresori, shfaqen më tepër si abstenues (rasti i vendimeve në OKB), ose mbështetës të sulmit të saj, duke pasur në mendje ide të ngjashme për aneksimet terriroresh (Kina me pretendimet e saja për Tajvanin). Aleatët e mbrojtësit nuk janë të çfarëdoshëm, do thoshte Klauzeviçi, pasi ato janë “*thelbësisht të interesuar në mbrojtjen dhe mbajtjen e territorit të tyre*”. Ato nuk janë si aleatët që sulmuesi mund të ketë për arsye se interesat e aleatëve të mbrojtësit burojnë nga kushtet e formës së luftës.¹⁹

¹⁹ Olivia Garard. *Some Clausewitzian thoughts on the Ukrainian defense*. Burimi elektronik: <https://mwi.westpoint.edu/some-clausewitzian-thoughts-on-the-ukrainian-defense/>

Kështu, sigurimi i mbështetjes dhe pasja në krah e aleatëve të tillë si SHBA-të, vendet e NATO-s, BE-së etj., është treguesi më i mirë se në këtë luftë qëndresa, mbrojtja dhe fitorja janë interesi jo vetëm i Ukrainës por edhe i aleatëve të saj. Vlen të theksohet se mbështetja dhe përpjekjet e aleatëve janë të përqendruara jo vetëm në aspektin ushtarak të këtij konflikti. Aktorë të veçantë, fjala bie Turqia, janë thellësisht të angazhuar në sjelljen e këtij konflikti në rrugën e zgjidhjes, zbutjen e efekteve negative të shkaktuara nga pushtimi dhe bllokimi i hapësirave tokësore dhe detare të Ukrainës (bllokimi i grurit), si/ edhe gjetjen e formulës së dakordësisë në mes palëve, në rastin më optimal ndërprerjen e luftimeve dhe në rastin ideal vendosjen e paqes.

5. ZGJIDHJA E KRIZËS DHE PAQJA

Përfundimi i luftës dhe vendosja e paqes do jetë opsioni më i favorshëm dhe më i pashmangshëm për palët ndërluftuese. Nuk ka një luftë në historinë botërore që të ketë nisur dhe mos të ketë përfunduar. Edhe në këtë rast lufta do të vazhdojë deri në atë pikë ku palët do të kuptojnë se sakrificat e kryera e ato që priten të bëhen në të ardhmen nuk e justifikojnë vazhdimin e saj. Duke folur për kushtet që duhet të arrihen për vendosjen e paqes Klauzeviçi ka thënë: *“Dy gjëra mund të bindin mbi pamundësinë për të qëndruar dhe shërbejnë si shkaqe për paqen. E para, kur ka pak të ngjarë që të arrihet suksesi dhe e dyta, sakrificat shumë të mëdha që do të ishin të nevojshme për vazhdimin e luftës.”*²⁰ Ajo që ka treguar fusha e betejës së deritanishme është se suksesi i pretenduar rus nuk ka ndodhur. Ukraina nuk ka rënë, ka qëndruar me sakrifica dhe duket e gatshme për të bërë sakrifica të tjera sado të mëdha që të jenë, pasi nuk ka zgjidhje tjetër. Ndërkohë që palët janë të përfshira në luftime, herë me sulme ajrore e herë me përdorimin e njësive tokësore, në korridoret e diplomacisë vijojnë përpjekjet për zgjidhjen e kësaj krize dhe sjelljen e palëve në tryezën e bisedimeve. Turqia, nëpërmjet presidentit Erdogan, është tepër aktive në interes të vendosjes së palëve në tryezën e bisedimeve dhe gjetjen e pikave të përbashkëta për vendosjen e armëpushimit dhe paqes. Nga ana tjetër, presidenti Putin, nëpërmjet mjeteve të propagandës, deklaroi se është i gatshëm për të zhvilluar dialog lidhur me një marrëveshje politike me Ukrainën. Propozimet për paqe vijnë edhe nga Kina, por që deri tani nuk pranohen nga pala ukrainase, pasi konsiderohen haptas në mbështetje të Rusisë. Në fakt, si mund të ketë marrëveshje për paqe nga Ukraina kur ajo që kërkon agresori është të pranojë vullnetin e tij, e t’i njohë pushtimin e territoreve? Pranimi i kësaj lloji paqeje nga Ukraina nuk do të justifikonte sakrificat e bëra deri tani dhe do të ishte një zhgënjim për ndihmën dhe përpjekjet e aleatëve, të cilat janë të konsiderueshme. Atëherë, në terma politikë, një kthim te situata ushtarake para datës 24 shkurt 2022 mund të plotësojë një kusht të vendosur

²⁰ Carl von Clausewitz. *Mbi luftën*, (Tiranë: Helga's Secrets, 2020), 53.

nga Ukraina për të hapur bisedime thelbësore.²¹ E për këtë këmbëngul me forcë presidenti ukrainas Zelenski: paqe vetëm në një Ukrainë me territore të pa pushtuara. Megjithatë për të plotësuar këtë kusht nuk është aq e lehtë. Rusia kërcënon deri në përdorimin e armëve bërthamore dhe ka vënë në dispozicion të mbrojtjes së territoreve të pushtuara të gjitha mjetet e luftës. Ka nxjerrë akte legjislative duke i trajtuar si pjesë integrale të tyren dhe duke pretenduar se sulmi ndaj këtyre territoreve është sulm ndaj Rusisë. Me ligjet e veta i ka bërë pjesë të tyren, pavarësisht se jemi në kushtet e ndryshimit të kufijve me dhunë, të papërligjur nga e drejta ndërkombëtare. Në kushtet kur Ukraina është në të drejtën e saj për të shkuar në bisedimet e paqes e pa pushtuar dhe kur Rusia pushtimin e territoreve ukrainase e quan fakt të kryer, e të pa negociueshëm, lind pyetja: A ka mundësi për të gjetur rrugën e paqes? Në këtë situatë, këndvështrimi i Klauzeviçit do të ishte: *“Nëse mendojmë se lufta shkaktohet nga një qëllim politik, është e natyrshme që ky shkak fillestar, prej nga ajo rrjedh, të vazhdojë të jetë elementi kryesor dhe më i rëndësishëm i zhvillimit të saj.”*²² Deri në këto momente, qëllimi armiqësor politik rus vazhdon të jetë i mbështetur, veçanërisht nga presidenti Putin dhe ka pak gjasa që të ndryshojë. Mosndryshimi i këtij qëndrimi dhe kursi politik e vështirëson rrugën drejt paqes, për të mos thënë e bën të pamundur mundësinë e uljes së palëve në tryezën e bisedimeve për paqe, megjithëse një ditë do të ndodhë.

PËRFUNDIME

Klauzeviçi, me librin e tij “Mbi luftën”, njihet për trinitetin e tij, i cili është pranuar si nënkuptim për ushtri – popull - qeveri. Mirëpo, Klauzeviçi ka folur shumë, më shumë se kaq. Ka folur për artin, strategjinë, mjegullën e luftës, fërkimet në luftë, qendrën e rëndesës, mbrojtjen, sulmin, moralin, marshimet, furnizimet, vijat e operacionit, pushimet operacionale, etj. A kanë gjetur të gjitha këto zbatim në këtë luftë? Natyrisht që jo. Fushëbeteja ka ndryshuar shumë që nga koha kur Klauzeviçi ka shkruar veprën e tij. Lloje të reja luftimi, njësi speciale dhe teknologji të përparuara i kanë dhënë një tjetër dimension luftës. Megjithatë, pavarësisht inovacionit sa i takon teknologjisë, strategjisë dhe kapaciteteve, disa nga mendimet e Klauzeviçit janë ende të vlefshme në termat e natyrës së luftës.

Qëndresa ukrainase, pavarësisht përpjekjeve dhe mjeteve të dhunës së përdorur nga Rusia, ka marrë një vëmendje të veçantë. Klauzeviçi përcaktonte se: *“për të mposhtur kundërshtarin duhen mposhtur forcat ushtarake, duhet pushtuar*

²¹ François Heisbourg. *How to end a war: Some historical lessons for Ukraine?* Burimi elektronik: <https://www.iiss.org/online-analysis/survival-online/2023/07/how-to-end-a-war-some-historical-lessons-for-ukraine/>

²² Carl von Clausewitz. *Mbi luftën*, (Tiranë: Helga's Secrets, 2020), 45.

territori si dhe duhet mposhtur vullneti kombëtar”. Vullneti kombëtar ukrainas ka rezultuar i pathyeshëm deri tani, duke garantuar qëndresën.

Lufta në Ukrainë ka marrë vëmendjen e gjithë botës. Aleatët e saj, të cilat kanë fuqi dhe ndikim në arenën botërore, e mbështetin dhe e përkrahin të drejtën e popullit ukrainas për mbrojtjen e vendit të tyre. Dhe kjo mbështetje është materializuar me ndihma ushtarake të teknologjisë së fundit, duke ndikuar realisht në qëndresën dhe aftësitë reaguese të Ukrainës.

Pavarësisht se çfarë ndodh në fushëbetejë, diplomacia ndërkombëtare vazhdon përpjekjet për t’i vendosur palët në tryezën e bisedimeve dhe për të shkuar drejt paqes. Megjithatë zhvillimet e deritanishme nuk janë shumë optimiste. Ukraina e ka të pamundur të diskutojë me Rusinë për paqen, ndërkohë që një pjesë e territorit është e pushtuar.

Lufta është bërë objekt i analizave, debateve, studimeve, parashikimeve dhe thelbi është: Kush do e fitojë këtë luftë? Mbase përgjigjja gjendet në thënien e Klauzeviçit: “Çdo luftim është një gur prove i përgjakshëm dhe shkatërrimtar i forcave fizike dhe morale. Ai që ruan deri fund sasinë më të madhe të tyre, është fitimtar.”²³

BURIME TË SHFRYTËZUARA

1. Carl von Clausewitz. *Mbi luftën*, (Tiranë: Helga’s Secrets, 2020).
2. Shulzhenko, Fedir, Gaudulin, Aleksandr. *Legal and political aspects of war in Ukraine: Philosophical reflection on the scene of battles*. 2022, 150. Burimi elektronik: <https://doi.org/10.32849/2663-5313/2022.2.23>
3. Olivia Garard. *Some Clausewitzian thoughts on the Ukrainian defense*. Burimi elektronik: <https://mwi.westpoint.edu/some-clausewitzian-thoughts-on-the-ukrainian-defense/>
4. Antulio J. Echeverria II. Clausewitz’s “Warlike element and the war in Ukraine”. Burimi elektronik: <https://www.militarystrategymagazine.com/article/clausewitzs-warlike-element-and-the-war-in-ukraine/>
5. François Heisbourg. *How to end a war: Some historical lessons for Ukraine*. Burimi elektronik: <https://www.iiss.org/online-analysis/survival-online/2023/07/how-to-end-a-war-some-historical-lessons-for-ukraine/>
6. Édouard Jolly. *Clausewitz in Ukraine*. Burimi elektronik: <https://www.irsem.fr/publications-de-l-irsem/breves-strategiques/strategic-brief-no-34-2022-clausewitz-in-ukraine.html>
7. Jack Tribolet. *The russo-Ukrainian war in Clausewitzian perspective*. Burimi elektronik: <https://defense.info/re-thinking-strategy/2022/07/the-russo-ukrainian-war-in-clausewitzian-perspective/>

²³ Carl von Clausewitz. *Mbi luftën*, (Tiranë: Helga’s Secrets, 2020), 327.

RUBRIKA E TRETË

SHKRIME HISTORIKE

BRIGADA IV SULMUESE DHE VEPRIMTARIA E SAJ LUFTARAKE NË OPERACIONIN E DIMRIT

Prof. Asoc. Dr. Edmond BRANESHI
Shef Grupi në FMS, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Zgjerimi i luftës së armatosur, shndërrimi i saj shkallë-shkallë në kryengritje të përgjithshme, shtroi nevojën e krijimit të një qendre të vetme ushtarake për drejtimin e saj. Për këtë qëllim, më 10 korrik 1943, u formua Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Detyra e tij ishte organizimi dhe drejtimi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, duke realizuar udhëheqjen strategjike e operative të luftës së armatosur. Menjëherë pas krijimit, Shtabi i Përgjithshëm mori një varg masash organizative. Ai u përqendrua në organizimin e Ushtrisë së rregullt, mbi bazën e reparteve partizane të ngritura deri në atë kohë. Nga 15 gushti deri në fund të vitit 1943 u krijuan Brigada I, II, III dhe IV Sulmuese.

Në këtë shkrim, fokusi do të jetë Brigada IV Sulmuese, situata politiko-ushtarake në prag të krijimit të saj, formimi i brigadës si një formacion i rregullt i UNÇSH dhe roli e veprimtaria luftarake e saj në Operacionin e Dimrit. Brigada u krijua në një situatë, kur Operacioni i Dimrit kishte filluar dhe veprimet luftarake të gjermanëve po zgjeroheshin në të gjithë vendin, për pasojë edhe në zonën e Korçës. Për këtë arsye, në këtë qark ishte domosdoshmëri krijimi i një njësie të mirëfilltë të organizuar për të qëndëruar veprimtarinë e të gjithë batalioneve e çetave që vepronin deri në atë kohë. Brigada IV Sulmuese luftoi jo vetëm në krahinat e Korçës, në Skrapar, në Kolonjë e në Pogradec, por dhe më tej, si në zonat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut.

Shtabi brigadës dhe komandantët trima të batalioneve treguan vendosmëri e pjekuri në vendimmarrje, gjithashtu trimëri dhe siguri në veprimet luftarake. Ata shpeshherë u përballën me sfida të vështira që ia dolën me sukses.

Ky shkrim është edhe një kujtesë e 80-vjetorit të krijimit të Shtabit të Përgjithshëm që ishte një ngjarje me rëndësi politiko-ushtarake për vendin, sepse e orientoi Ushtrinë Nacionalçlirimtare dhe popullin shqiptar drejt një lufte të organizuar me strukturat e saj (brigadë, e më vonë divizione, korparmata) pa kompromis kundër pushtuesve italo-gjermanë dhe forcave kolaboracioniste.

Fjalë kyçe: Brigada IV Sulmuese, Operacioni i Dimrit, Shtabi i Përgjithshëm, Lufta Nacionalçlirimtare, Ushtria Nacionalçlirimtare, këshillat nacionalçlirimtarë, batalion, veprimet luftarake, sulm, rrethim, partizanë, forca gjermano-ballistë, tradhtarë, kuislingë, fitore, zonë, krahinë.

HYRJE

Në fillim të vitit 1943 u shtuan në mënyrë të ndjeshme radhët e forcave partizane me luftëtarë të rinj nga të gjitha krahinat e vendit. Kjo krijoi kushtet për formimin e njësive të mëdha të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe për përsosjen e organizimit të tyre ushtarak. Në maj u krijuan batalionet e para partizane, kurse në fillim të korrikut, në vend numëroheshin 20 batalione dhe një numër i madh çetash partizane, që zhvillonin luftime të përditshme me armiqtë. Për këtë qëllim, më 4 korrik 1943, në Labinot të Elbasanit u mblodh Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, i cili vendosi krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Më 10 korrik, Këshilli i Përgjithshëm, me anë të një proklamate të posaçme njoftoi popullin për krijimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm solli një varg masash organizative. Më kryesorja ndër to ishte urdhri për organizimin e Ushtrisë së rregullt Nacionalçlirimtare, mbi bazën e reparteve partizane që vepronin në të gjithë vendin. Në të njëjtën kohë, Shtabi i Përgjithshëm përpunoi strukturën organizative të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Hallka e kësaj strukture do të ishin shtabet e qarqeve dhe shtabet e grupeve, që kishin filluar të formoheshin përpara krijimit të Shtabit të Përgjithshëm¹. Formacioni më i madh i Ushtrisë së rregullt Nacionalçlirimtare do të ishte brigada që do të varej drejtpërdrejt nga Shtabi i Përgjithshëm. Brigada I-rë Sulmuese u formua më 15 gusht 1943 në Vithkuq të Korçës, me partizanë nga të gjithë anët e Shqipërisë. Në këtë kohë, efektiv i Ushtrisë Nacionalçlirimtare arrinte në 10 mijë vetë, përveç 20 mijë luftëtarëve të çetave territoriale të fshatrave e të njësive guerile që vepronin në qytete.

¹ “Historia e popullit shqiptar”, vëllimi IV, Shtëpia botuese “Toena”, (Tiranë 2008), ISBN: 978-99943-1-452-2, faqe 65.

Në këtë periudhë, në mjaft zona u ndërmorën veprime luftarake në shkallë të gjerë kundër armikut, si në Pojskë, Qafë-Thanë e Pogradec, në Burrel, në Qafë-Buall, në Dibër, në Reç-Shkodër, në rrugën Tiranë-Elbasan² dhe në zona të tjera të vendit. Në ditët e para të gushtit u bënë përpjekje për përfshirjen e Frontit Nacionalçlirimtar dhe Ballit Kombëtar në luftë kundër pushtuesit, por ajo mbeti thjesht në letër. Kjo u pa qartë me kapitullimin e Italisë dhe me ardhjen e pushtuesve gjermanë, të cilëve Balli Kombëtar në vend të luftës do t'u ofronte bashkëpunimin.

Konferenca e Dytë Kombëtare Nacionalçlirimtare, e mbajtur më 4 shtator 1943, miratoi vijën politike që kishte ndjekur deri atëherë Fronti Nacionalçlirimtar. Ajo vuri në dukje se kjo vijë dhe, përgjithësisht platforma e drejtë dhe e hapur e Frontit kishte dhënë frytet e saj. Në radhët e Frontit dhe të Lëvizjes Nacionalçlirimtare qenë përfshirë mjaft atdhetarë nga të gjitha krahinat, orientimet e besimet fetare. Konferenca përpunoi, gjithashtu dhe një sërë masash për forcimin e këshillave nacionalçlirimtarë. Ajo i shpalli ato si pushtetin e vetëm në Shqipëri, duke e bërë kështu të qartë se nuk lejohej asnjë pushtet tjetër, veç atij të këshillave. Gjithashtu, ajo vuri detyrë formimin e këshillave nacionalçlirimtarë në të gjithë vendin.

Duke parashikuar kapitullimin e afërt të Italisë dhe rrezikun e pushtimit të vendit nga Gjermania naziste, Konferenca ritheksoi qëndrimin e vendosur të Ushtrisë Nacionalçlirimtare për të vazhduar lëvizjen e armatosur edhe kundër agresorëve hitlerianë nëse ata do të sulmonin Shqipërinë.

Menjëherë sapo u shpall kapitullimi i Italisë fashiste, vendin e saj e zuri pushtuesi i ri, nazizmi gjerman. Shqipëria po ngjallte gjithmonë e më tepër interes në qarqet e larta drejtuese gjermane. Ky interes bazohej në pozitën gjeografike të saj. Gjermanët nuk mund të injoronin faktin që përtej ngushticës së Otrantos tashmë ndodheshin trupat e aleatëve anglo-amerikanë dhe kërcënimin real që paraqiste prania e tyre. Plani operativ për pushtimin e Shqipërisë u përgatit pak kohë para kapitullimit Italian³. Shtabi i Përgjithshëm i Vermahtit spekulonte jo vetëm mbi kapitullimin e ushtrisë italiane por edhe mbi një zbarkim të mundshëm të forcave aleate në Ballkan. Pushtuesit gjermanë dislokuan në Shqipëri forca të shumta ushtarake. Në tetor 1943 numri i trupave gjermane në Shqipëri arriti në 57 mijë veta. Ndërsa në dimrin e vitit 1943 dhe në verën e vitit 1944 numri i tyre arriti në afro 70 mijë veta⁴. Angazhimi i një force kaq

² “*Historia e popullit shqiptar*”, Shtëpia botuese e librit shkollor, (Tiranë 2008), ISBN: 99927-2-257-6, faqe 256.

³ Marenglen Kasmi, “*Pushtimi gjerman i Shqipërisë 1943-1944*”, Shtëpia botuese “Filara”, (Tiranë 2013), ISBN: 978-9928-142-24-5, faqe 53.

⁴ “*Historia e popullit shqiptar*”, Vëllimi IV, Shtëpia botuese “Toena”, (Tiranë 2008), ISBN: 978-99943-1-452-2, faqe 78.

të madhe ushtarake në një territor të vogël siç ishte Shqipëria, lidhej para së gjithash, me rëndësinë që merrte ajo në zhvillimet e pritshme si dhe me objektivat konkrete që ishin planifikuar të arriheshin.

1. SITUATA POLITIKO-USHTARAKE NË QARKUN E KORÇËS NË PRAG TË KRIJIMIT TË BRIGADËS IV SULMUESE

Në thirrjen e lëshuar më 10 shtator të vitit 1943 nga Këshilli i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe nga Shtabi i Përgjithshëm udhëzohej populli dhe Ushtria Nacionalçlirimtare që të luftonin me të njëjtën vendosmëri kundër pushtuesve të rinj, nazistëve gjermanë. Në përgjigje të këtij udhëzimi, njësitë partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare i pritën kudo më armë trupat hitleriane. Luftime të ashpra u zhvilluan në Xhyrë, në urën e Kardhiqit, në rugën Elbasan-Tiranë, në Krujë, në afërsi të Konispolit, në Delvinë e në Sarandë, në rugën Korçë-Janinë etj. Veçanërisht e ashpër ka qenë përleshja me trupat gjermane në Drashovicë, ku hitlerianët u detyruan të tërhiqeshin, duke lënë në fushën e betejës shumë të vrarë e të plagosur, si dhe sasi të mëdha materiali luftarak⁵. Në zonat e çliruara u vendos pushteti i këshillave nacionalçlirimtarë. Trupat naziste u vendosën në qendrat kryesore të vendit. Në Shqipëri u vendos Korpusi XXI i Vermahtit me qendër në Tiranë dhe reparte të Korpusit XXII në Jug të vendit.

Në këtë kuadër, Lufta Nacionalçlirimtare kundër nazistëve dhe kolaboracionistëve kishte marrë përpjesëtime të mëdha në të gjitha krahinat e vendit. Në bazë të direktivave dhe urdhrave të Shtabit të Përgjithshëm, shtabet e forcave partizane të qarqeve po merrnin një seri masash të reja organizative, ku më të rëndësishmet ishin: organizimi i këshillave nacionalçlirimtare në vendet e çliruara, forcimi dhe ngritja e njërive dhe reparteve të reja partizane në të gjithë Shqipërinë, demaskimi e Qeverisë Kuislinge dhe organizatave tradhtarë si Balli Kombëtar etj., si bashkëpunëtorë të ushtrisë naziste.

Populli, i frymëzuar nga luftimet që zhvilloheshin në vijimësi nga çetat dhe batalionet partizane, si dhe nga formacionet bazë të sapokrijuara të Ushtrisë Nacionalçlirimtare (Brigada I, II dhe III Sulmuese)⁶ po përgatitej për beteja

⁵ “*Historia e popullit shqiptar*”, Shtëpia Botuese e librit shkollor, (Tiranë 2008), ISBN: 99927-2-257-6, faqe 259.

⁶ Brigada I-rë Sulmuese u formua më 15 gusht 1943 në fushën e Makërzës, gjithsej 556 veta të organizuar në fillim në 4 batalione, pas kapitullimit të Italisë fashiste, më 9 tetor 1943 u formua batalioni partizan “Antonio Gramshi” me 137 ushtarë italianë, që u rreshtua në këtë brigadë; Brigada II Sulmuese u formua më 28 nëntor 1943 në Shëngjergj të Tiranës me partizanë e kuadro nga Tirana, Elbasani, Berati, Gjirokastra dhe krahina të tjera të vendit, përbëhej prej 450 vetash të organizuar në tri batalione; Brigada III Sulmuese u formua më 9 tetor 1943 në fshatin Arbanë të Tiranës mbi bazën e batalionit të Ishmit dhe me pjesëtarë të njësiteve guerile të Tiranës, kishte gjithsej 379 partizanë e kuadro të rreshtuar në tri batalione, një bateri artilerie 75 mm, si dhe një kompani mortajash 81 mm. (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1985, faqe 115).

të reja edhe më të ashpra në rrugë për çlirimin e plotë të vendit nga pushtuesi gjerman dhe bashkëpunëtorët e tij.

Edhe në Qarkun e Korçës (Korçë, Pogradec, Bilisht, Ersekë, Leskovik) ishin organizuar çeta e batalione që luftonin armikun dhe, njëkohësisht mbronin popullin e zonës dhe pushtetin e tij të ngritur me gjak e sakrifica. Lufta partizane udhëhiqej dhe koordinonte veprimtaritë e çetave dhe batalioneve në të gjithë zonën, nga shtabi i forcave partizane të qarkut të Korçës me qendër në Voskopojë.

Në tetor – nëntor të vitit 1943, në qarkun e Korçës ushtronin veprimtaritë e tyre luftarake në mënyrë të organizuar këto batalione: batalioni “Hakmarrja”, që vepronte në zonën e Ersekës e Leskovikut (Kolonjë), batalioni “Reshit Çollaku” që vepronte në zonën e Pogradecit dhe krahinën e Mokrës, batalioni “Fuat Babani” në zonën e Bilishtit (Devoll), batalioni “Çlirimi” në Opar, batalioni “Skënder Çaçi” dhe “Ali Këlmendi” në Gorë, batalioni “Themistokli Gërmenji” në Rrëzë, batalioni “Shqiponja” në Rrëzë e Fushën e Korçës; përveç tyre ishin edhe batalionet dhe çetat e tjera territoriale dhe komandat e vendit (gjithsej bëheshin më tepër se 3500 veta)⁷. Intendenca e qarkut ndodhej në veri të Voskopojës (Bakull). Roli i saj ishte që të grumbullonte ndihmat e popullit dhe të furnizonte batalionet, sidomos gjatë aksioneve të kombinuara që organizonte shtabi i Qarkut larg bazave të tyre.

Strukturat përkatëse të Partisë Komuniste kishin zhvilluar një punë të madhe sqaruese dhe mobilizuese me popullin e qarkut të Korçës. Klasa punëtore e qytetit dhe fshatarësia e zonës përkrahnin me të gjitha forcat Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe mbanin një qëndrim heroik ndaj pushtuesit, përkrahnin moralisht dhe materialisht çetat dhe batalionet partizane dhe demaskonin organizatat tradhtarë të Ballit Kombëtar etj., si dhe krerët e tyre që kishin rënë në prehrin e armikut.

Vlen për t’u përmendur që në mesin e vitit 1943, në Voskopojë u bë një miting ku rreth 200 të rinj korçarë lanë bankat e shkollës dhe dolën vullnetarë për lirinë e atdheut kundër robërisë fashiste. Në këtë miting ku u manifestua vendosmëria e popullit dhe e rinisë për të qenë të gatshëm të derdhnin gjakun e tyre për lirinë e vendit, midis të tjerëve foli dhe profesori i matematikës së Liceut, Raqi Qirinxhi. Ndër të tjera ai u tha nxënësve të vet: “*Sot, që të gjithë ju e keni zgjidhur ekuacionin, prandaj të gjithë meritoni notën shkëlqyeshëm*”⁸. Dhe vërtet, të zgjidhje atë ekuacion do të thoshte të rrokje armët dhe të luftoje për atdheun dhe për popullin dhe jo të prisje nën mëshirën e fatit dhe t’i

⁷ AQFA, Fondi Lufta Nacionalçlirimtare, Brigada IV Sulmuese, Dosja nr. 66, Viti 1944: Historiku i krijimit të Brigadës IV Sulmuese si dhe veprimet luftarake të saj gjatë vitit 1944, faqe 3-4.

⁸ Benard Zotaj, Arben Zavalani, “*Spiro Shalësi, për Artin Ushtarak Shqiptar*”, Shtëpia Botuese M&B, (Tiranë 2021), ISBN: 978-9928-353-09-2, faqe 35.

nënshtroheshe sundimit të huaj. Të gjithë këta të rinj e të reja u bënë pjesë e formacioneve partizane që vepronin në zonën e Korçës. Veprimtaria e këtyre formacioneve sa vinte e merrte përmasa edhe më të gjëra.

Çetat dhe batalionet partizane të udhëhequra nga bijtë më të mirë të popullit godisnin pa mëshirë armikun në qendrat e tij, në rrugët e komunikacionit, dhe nga Kolonja e Devolli, Opari dhe Gora, Rrëza e Mokra ziente pushka partizane. Populli krenohet me ushtrinë e tij të re që po lindte. Në Kolonjë, Mokër, Gorë, Opar dhe Devoll ishin likuiduar plotësisht institucionet vendore të qeverive kuislinge. Tashmë, këshillat nacionalçlirimtarë të fshatrave dhe krahinave qeverisnin popullin.

Forcat gjermane dhe tradhtarë të vendit, duke parë zgjerimin e Luftës Nacionalçlirimtare në mbarë vendin organizuan Operacionin e Dimrit për të asgjësuar Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe forcën e tyre të armatosur, Ushtrinë Nacionalçlirimtare si dhe të vendosnin pushtetin kuisling në krahinat e çliuara. Në këtë operacion, krahas katër divizioneve të ushtrisë naziste, morën pjesë dhe forca kolaboracioniste vendëse të përbëra nga xhandarë, ballistë e të tjerë. Në këtë mënyrë, Balli Kombëtar i dha fund politikës së pritshmërisë dhe bashkoi forcat me pushtuesin gjerman për të luftuar kundër Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Operacionet kundër forcave partizane do të ishin të mirëkoordinuara midis forcave të Ballit Kombëtar, administratës qendrore e lokale kolaboracioniste në shumë qytete dhe qarqe. Bashkëpunimi i gjermanëve me forcat e Ballit Kombëtar nuk u kufizua vetëm në organizimin e operacioneve të përbashkëta, por edhe në furnizimin e tyre me armatime. Kjo është një e vërtetë e pohuar dhe e dokumentuar nga të dyja palët. Furnizimet me armë të Ballit Kombëtar i kanë konfirmuar përmes dokumenteve gjermane edhe konsulli i përgjithshëm gjerman në Tiranë Shliep dhe i dërguari i posaçëm Nojbaher⁹.

Operacioni i Dimrit (që njihet me termin Mësymja e Përgjithshme armike e dimrit 1943-1944) filloi me operacionin e Pezës, më 5 nëntor 1943 dhe vijoi me operacione të tjera po në atë muaj në Dibër, Berat, në Mallakastër; në dhjetor në Çermenikë – Shëngjergj – Martanesh, në Luginën e Shushicës; në janar e në shkurt në zonat Korçë – Berat, Vlorë – Gjirokastrë etj. Të gjitha këto operacione u karakterizuan nga luftime të përgjakshme¹⁰. Në këtë kuadër, Shtabi i Përgjithshëm mori vendim që rezistenca kryesore kundër armikut të bëhej në Jug me forcat e Brigadës së I-rë Sulmuese që ishte formuar me kohë, të Brigadës II dhe III që sapo ishin formuar të cilat do të kalonin në Jug, duke pasur edhe mbështetjen e të gjitha forcave të tjera të Jugut, që ishin të organizuara në qarqe e zona operative.

⁹ Paskal Milo, “*Shqipëtarët në Luftën e Dytë Botërore, Vëllimi II*”, Shtëpia Botuese: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (Tiranë 2021), ISBN: 978-9928-339-57-7, faqe 195-196.

¹⁰ “*Fjalori Enciklopedik Shqiptar*”, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1985, faqe 700.

Për këtë, shtabi i qarkut të Korçës u urdhërua që me forcat e tij, të mbante me çdo kusht krahinën e Mokrës e cila do të vlente si urë kalimi për forcat që vinin nga Shqipëria e Mesme. Shtabi i qarkut të Korçës, me forcat e tij partizane e plotësoi këtë detyrë, por bashkimi i Brigadës III me forcat e qarkut të Korçës, sipas planit të Shtabit të Përgjithshëm nuk e realizuan dot (përveç një kompanie të batalionit të parë) për arsye të rezistencës që hasi kjo brigadë në anën perëndimore të lumit Shkumbin nga forcat e armikut e, sidomos nga pamundësia e kalimit të lumit, për shkak të vërshimeve të mëdha¹¹ (nëntor 1943).

Megjithëse armiku pati dëme të mëdha nga batalionet e qarkut të Korçës, luftimet i dhanë mundësi atij që gjatë kësaj kohe me forca të pakta të pastronte krahinat e Devollit dhe të Kolonjës dhe të detyronte forcat partizane të këtyre krahinave që kishin mbetur të kalonin në rajonin e Voskopojës. Armiku sa vinte po shtonte presionin e tij dhe po përmirësonte pozitat për fillimin e operacionit në plan të gjerë kundër forcave partizane që ishin grumbulluar në një territor relativisht jo shumë të gjerë. Në këto kushte, për të përballuar situatën e krijuar dhe për të pasur një forcë goditëse të qëndrueshme dhe të lëvizshme, me efektivitet më të madh, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm u organizua Brigada IV Sulmuese e përbërë prej katër batalionesh.

2. FORMIMI I BRIGADËS IV SULMUESE, SI FORMACION I RREGULLT I UNÇSH - 28 DHJETOR 1943

Në dy javët e fundit të dhjetorit 1943, filluan të grumbullohen në Voskopojë forcat partizane që do të krijonin Brigadën IV Sulmuese. Vendimi i Shtabit të Përgjithshëm që, në ato ditë, në atë situatë të rëndë e të ndërlikuar të krijohej Brigada IV Sulmuese e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, synonte që forcat partizane të qarkut të kishin një njësi të madhe, të fuqishme e kompakte për të përballuar operacionin armik, për të mbrojtur krahinat e çliruara e për t'i shkaktuar sa më tepër dëme armikut. Voskopoja në atë kohë ishte një fshat me rreth 200 shtëpi, por shumica e tyre të djegura e të plaçkitura nga fashistët italianë e gjermanë. Ajo shtrihet në kodrat e kreut të një luginë, që rreth e rrotull ka male të mbuluara me pisha. Në luginë gjarpëron rruga automobilistike Voskopojë – Korçë, 18 km e gjatë. Voskopoja që prej fillimit të vitit 1943 ishte e çliruar nga çetat partizane dhe ishte kthyer në një bazë të fuqishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në qark. Në Voskopojë ushtronte pushtetin këshilli nacionalçlirimtar i fshatit. Aty kishte kazerma italiane, të cilat megjithëse të dëmtuara u përdorën për strehimin e partizanëve. Gjithashtu, afër Voskopojës, në Bakull e në Punëmirë ishin depot e intendencës së qarkut, nga ku u bë furnizimi me ushqime, veshmbathje dhe armatime i brigadës.

¹¹ AQFA, Fondi Lufta Nacionalçlirimtare, Brigada IV Sulmuese, Dosja nr. 66, Viti 1944: Historiku i krijimit të Brigadës IV Sulmuese si dhe veprimet luftarake të saj gjatë vitit 1944, faqe 5.

Përbërja e komandës dhe e seksionit politik të brigadës, ishte caktuar dy muaj më parë nga Shtabi i Përgjithshëm, komandat e batalioneve u caktuan nga komanda e brigadës në bashkëpunim me komitetin qarkor dhe shtabin e qarkut të Korçës. Komandat e kompanive u caktuan nga komandat e batalioneve dhe u miratuan nga komanda e brigadës, kurse komandantët e skuadrave u caktuan nga komandat e kompanive dhe u miratuan nga ato të batalioneve¹².

Në të vërtetë, përgatitja për krijimin e brigadës kishte filluar që nga mesi i tetorit, kur u caktua numri i partizanëve dhe i kuadrove që do të dërgonte çdo batalion partizan dhe filloi grumbullimi i veshmbathjeve, armatimeve, kafshëve etj.

Në organizimin e Brigadës IV Sulmuese u fut i gjithë batalioni “Shqiponja”. Ai numëronte 260 partizanë e kuadro, midis të cilëve 4 vajza partizane. Partizanët e kuadrot e batalionit “Shqiponja” kishin fituar një përvojë të madhe në luftimet e zhvilluara sidomos në muajt tetor – dhjetor 1943 kundër gjermanëve dhe tradhtarëve në Mokër, Gorë e Rrëzë (Korçë) përkrah batalioneve të tjera. Nga batalioni “Fuat Babani” morën pjesë 70 partizanë e kuadro, midis të cilëve 2 vajza partizane. Partizanët e kuadrot e këtij batalioni kishin marrë pjesë në shumë aksione e luftime si në Braçanj, Pojan, Boçisht, Leskovik, Përmet, në Grykën e Glloboçit, Bravdicë, Polenë, Guri i Kamjes e gjetkë. Nga batalioni “Hakmarrja” morën pjesë 60 partizanë e kuadro, midis të cilëve kishte dhe 5 vajza. Efektivi i këtij batalioni kishte fituar përvojë në luftimet e zhvilluara në Leskovik, Urën e Helmësit, Kuqar, Qafën e Qarrit, Blush, Kurtezë etj. Nga batalioni “Tomorri” morën pjesë 60 partizanë e kuadro, midis të cilëve 4 vajza. Partizanët e këtij batalioni kishin marrë pjesë në shumë luftime, por ato më të rëndësishmet janë në Leskovik e sidomos në Barmash, ku iu dha goditja e parë forcave pushtuese hitleriane që futeshin në Shqipëri, si dhe në Polenë, Voskop, Vithkuq, Tomorricë, Qafën e Qarrit, Kurtezë etj. Nga batalioni “Reshit Çollaku” ishin 20 partizanë e kuadro, midis të cilëve 6 vajza. Partizanët e këtij batalioni kishin fituar përvojë në luftime të ndryshme, si në Grabovë, Pojskë, Pogradec, Guri i Kamjes etj. Nga batalioni “Gorë-Opar” ishin 20 partizanë e kuadro. Edhe partizanët e kuadrot e këtij batalioni kishin kryer veprime luftarake në Grabovicë, Bellovodë, Voskopojë, Snoam, Koçan, Leskovik, Përmet, Maliq, Gjonmadh, Kurtezë, Guri i Kamjes, Dushar, Prenisht etj. Një numër partizanësh e kuadrosh erdhën nga shtabi i qarkut të Korçës¹³. Gjithashtu erdhën dhe të rinj komunistë nga qyteti i Korçës dhe nga terreni, pjesëmarrës të njësive guerile.

¹² Mihallaq Konda, “*Historiku i Brigadës se IV Sulmuese*”, Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja”, (Tiranë 1998), faqe 8.

¹³ Po aty, faqe 9.

Më 28 dhjetor 1943 u formua Brigada IV Sulmuese në Voskopojë. Në situatën kur u formua ajo nuk mundi të bëjë ceremoninë e inaugurimit¹⁴ por menjëherë mori detyrën të shkonte në Skrapar në ndihmë të forcave të Qarkut të Beratit kundër forcave mercenare që kishin dalë në Tomoricë e Skrapar si pararojë e forcave gjermane dhe operonin në këtë krahinë.

Brigada IV Sulmuese me komandant Nexhip Vinçani dhe komisar politik Pëllumb Dishnica u formua në bazë të këtyre batalioneve¹⁵ territorialë: batalioni i parë, kryesisht nga batalioni “Fuat Babani” me komandant Zija Kambo; batalioni i dytë, me bazë batalionin territorial “Hakmarrja” me komandant Petrit Dume; batalioni i tretë, me bazë batalionet territorialë “Shqiponja” dhe “Themistokli Gërmenji” me komandant Spiro Shalësi; batalioni i katër, me bazë batalionet territorialë “Ali Këlmendi” dhe “Çlirimi” me komandant Agush Gjergjevica. Çdo batalion kishte nga tri kompani dhe çdo kompani tri deri në katër skuadra. Ajo përbëhej nga 550 partizanë e kuadro¹⁶, midis tyre 70 ishin komunistë (21 të themelimit të Partisë) dhe 140 të rinj.

Lajmi mbi formimin e Brigadës IV Sulmuese ngjalli entuziazëm të madh në popullin e qarkut të Korçës dhe rriti më shumë besimin për fitore mbi armikun. Forcat e tjera që mbeten u organizuan përsëri në çeta dhe batalione të vendit dhe u vunë nën komandën e shtabit të Brigadës IV Sulmuese për periudhën e operacionit.

3. LUFTIMET E BRIGADËS IV SULMUESE NË OPERACIONIN E DIMRIT

Sulmet e forcave partizane krijuan bindjen tek autoritetet gjermane se populli shqiptar nuk kish ndërmend të pushonte qëndresën dhe të pajtohej me regjimin e pushtimit. Në rrethana të tilla, komanda gjermane e pushtimit vendosi të ndërmarrë një operacion në shkallë të gjerë për të shkatërruar ushtrinë partizane dhe për të asgjësuar Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Operacioni, që do të vazhdonte gjatë gjithë dimrit 1943-1944, përbënte një pikë kulmore në ballafaqimin e ushtrisë hitleriane me qëndresën e armatosur shqiptare. Në këtë kuadër, Brigada IV Sulmuese mori detyrë për të vepruar në zonën Skrapar - Tomoricë si më poshtë: me batalionin I dhe III të likuidonte forcat balliste deri në 500 veta në Dushar dhe, duke zënë qafën e Gjarpërit të dilte në Tomoricë, ndërsa batalioni II dhe IV, duke siguruar krahun e majtë të tyre të zinte Qafën e Beçit dhe të asgjësonte forcat reaksionare në Kuç të Skraparit. Detyra u

¹⁴ Ceremonia e inaugurimit të Brigadës IV Sulmuese u bë më 9 maj 1944. Vetëm pas katër muaj e gjysmë u krijuan kushtet për grumbullimin e katër batalioneve dhe u bë inaugurimi i saj i plotë (shënim i autorit).

¹⁵ AQFA, Fondi Lufta Nacionalçlirimtare, Brigada IV-t Sulmuese, Dosja nr. 66, Viti 1944: Historiku i krijimit të Brigadës 4-t Sulmuese si dhe veprimet luftarake të saj gjatë vitit 1944, faqe 5.

¹⁶ Mihallaq Konda, “*Historiku i Brigadës se IV Sulmuese*”, Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja”, (Tiranë 1998), faqe 10.

plotësua dhe Brigada IV Sulmuese në bashkëpunim me forcat partizane të Beratit asgjësoi forcat armike në pellgun e lumit të Tomorricës, dhe i ndoqi ato këmba-këmbës deri në Qafën e Dardhës, duke zënë më se 300 robër, nga forcat partizane pati vetëm 4 të plagosur.

Gjatë ditëve 28 dhjetor 1943 deri 7 janar 1944, Brigada IV Sulmuese organizoi përsëri këshillat në krahinat Tomorricë dhe Skrapar dhe shtoi radhët e saj me elemente të rinj nga këto krahina.

Në këtë kohë, forcat gjermane kishin filluar operacionin e tyre dhe, duke thyer rezistencën e forcave partizane të batalioneve territoriale arritën të zinin vijën Qar, Vithkuq, Dershevik, Voskop, Vinçan, Birraj, Maliq, Guri i Kamjes. Veprimet e tij, armiku i filloi me dalje të shkurtra në fshatrat e Rrëzës, Korçës me qëllim që të kapte pozita dominuese për vazhdimin e mëtejshëm të operacionit, të grumbullonte forca balliste dhe t'i përdorte ato për zbulim dhe të bënte diversione për të ulur moralin e forcave partizane.

Krahinat e Devollit, Kolonjës dhe të Mokrës ishin të pushtuara nga armiku. Qëllimi përfundimtar i armikut ishte që me sulme të shpejta dhe në shumë drejtime të rrethonte forcat e Brigadës IV Sulmuese dhe forcat e tjera të qarkut të Korçës në rajonin Opar, Gorë, Voskopojë dhe, duke dhënë goditjen kryesore në drejtim të Korçës me forca deri një Divizion Fanterie me detyrë të kapte Qafën e Martës dhe Qafën e Beçit, ndërsa atë ndihmuese me forca deri një Regjiment Fanterie të sulmonte nga Berati, Tomorricë, Dushar, Qafën e Beçit të mbyllte rrethin e forcave partizane, të ngushtonte darën e rrethimit dhe të pengonte manovrimin e tyre për t'i asgjësuar ato. Më pastaj të bënte pastrimin e këtyre krahinave dhe të vendoste pushtetin e kuislingëve përpara se të vinte pranvera (figura nr. 1).

Shtabi i Brigadës IV Sulmuese, duke parë se armiku po fillonte operacionin në masë të gjerë, u nis me shpejtësi me të gjitha forcat nën varësi nga Skrapari e Tomorrica dhe urdhëroi në ecje e sipër batalionet që gjatë datës 7 janar të kapin vijën Vithkuq, Gjergjevicë, Voskopojë, Krushovë; të kundërsulmojnë armikun dhe ta detyrojnë atë të heqë dorë nga mësymja e mëtejshme. Luftime të përgjakshme u zhvilluan gjatë datës 8 janar në këto pozicione. Armiku detyrohet të lërë pozitat e zëna.




Figura nr. 1 - Skema e veprimeve luftarake të forcave gjermano-balliste dhe të Brigadës IV Sulmuese në Operacionin e Dimrit¹⁷

Gjatë datës 9 janar armiku përsëriti sulmet e tij dhe vazhdoi presion, por pa rezultat. Duke parë situatën, shtabi i Brigadës IV Sulmuese mori vendimin që të kalojë në mbrojtje në vijën, batalioni II: Guri i Bardhë, Mali i Kurorës (mbi Vithkuq); batalioni I: Kullat e Gjergjevicës, Voskopojë; batalioni III: Voskopojë, Shipkë, Krushovë, një pjesë e forcave territoriale në Lozhan – Bode. Ndërsa batalioni IV në rezervë të shtabit të brigadës në pozicionet në Qafën e Fikut me detyrë: me veprime aktive dhe kundërsulme t'i shkaktojë humbje të rënda armikut, të ndalojë përparimin e tij të mëtejshëm dhe ta detyrojë atë të heqë dorë nga vazhdimi i mësymjes (figura nr. 2).

Më datën 10 Janar, armiku i përforcuar me artileri dhe mortaja përsërit sulmet e tij dhe arrihet deri në përleshje e granata dore sidomos në Kullat e Gjergjevicës, Shtyllë, Vithkuq, Gjonmadh, Voskopojë. Në këtë situatë, shtabi i Brigadës IV Sulmuese për t'ju shmangur luftës pozicionale me armikun vendosi që gjatë natës së 10 janarit të organizojë kundërsulm me batalionin IV dhe I në drejtimin Kulla e Gjergjevicës, Lavdar, Dërsnik, ndërsa batalioni II të kundërsulmonte në krahun e djathtë Shtyllë, Vithkuq, Gjanç dhe batalioni III

¹⁷ AQFA, Fondi Lufta Nacionalçlirimtare, Brigada IV-t Sulmuese, Dosja nr. 66, Viti 1944: Historiku i krijimit të Brigadës 4-t Sulmuese si dhe veprimet luftarake të saj gjatë vitit 1944, faqe 18.

të kundërsulmonte në drejtimin Voskopojë, Gjonomadh.



Figura nr. 2 - Operacioni i Dimrit në Qarkun e Korçës 1944¹⁸

Dita e 11 janarit u karakterizua nga veprime dhe luftime të ashpra në të gjitha drejtimet, luftimet vazhduan në të gjithë frontin, gati pothuaj për gjithë ditën. Armiku pati dëme të mëdha, 40 të vrarë e të plagosur vetëm në sektorin e kompanisë së dytë të batalionit parë, gjithsej nga deklaratat e komandës së batalioneve dhe të partizanëve, armiku pati më tepër se 100 të vrarë e të plagosur. Nga forcat partizane pati vetëm 16 të plagosur rëndë dhe 10 të vrarë¹⁹.

Megjithatë, armiku mundi të thyejë kundërsulmin dhe të zërë Vithkuqin, Gjergjevicën, Krushovën, Voskopojën në mbrëmjen e kësaj date. Pasdrekën e po kësaj dite, forcat e Brigadës IV Sulmuese që ndodheshin në luftime të ashpra në të gjithë frontin po përballonin me vështirësi sulmet e përsëritura të armikut. Në këtë kuadër, shtabi i brigadës mori vendim që gjatë natës së 11 janarit, duke lënë pararojë të fortë për të mos humbur kontaktin me armikun, forcat të tërhiqen në pozicione të reja në vijën: Shtyllë (batalioni II), Çemerice - Lekaj (batalioni IV), në perëndim të Tudasit (batalioni I) dhe Bakull – Osojë (batalioni III).

¹⁸ Po aty, faqe 19.

¹⁹ Po aty, faqe 8.

Luftimet filluan përsëri gjatë ditës më 12 janar. Ato ishin të përgjakshme me sulme e kundërsulme nga të dy anët, në krahun e majtë u thyen tri herë sulmet e gjermanëve për të marrë Osojën dhe pozicionet u mbajtën deri në mbrëmjen e datës 12 janar. Gjithashtu në krahun e djathtë në drejtim të Gurit të Bardhë dhe Shtyllë u thyen katër herë me radhë sulmet e gjermanëve. Pozicionet e zëna u mbajtën nga forcat e Brigadës IV Sulmuese gjatë gjithë ditës, por u krijua një situatë e rëndë për të. Arsyeja ishte e tillë: ndërsa të gjitha forcat e Brigadës po luftonin me heroizëm të pashembullt prej Osojës deri në Shtyllë, prapa krahëve të saj, duke mos gjetur rezistencë të fortë nga forcat territoriale të Qarkut të Beratit, një regjiment gjerman doli në Dushar dhe pararoja e tij zuri Mazrekën dhe Oparin, duke dalë kështu në shpinë të Brigadës IV Sulmuese dhe të forcave të tjera të Qarkut të Korçës.

Një forcë tjetër prej 60 gjermanësh doli në Gjinikas. Rrethi i manovrimit të Brigadës IV Sulmuese po ngushtohej. Armiku po mbyllte darën për rrethimin dhe asgjësimin e plotë të brigadës dhe të forcave të qarkut të Korçës. Në pellgun Tudas, Lavdar, Protopapë ishin grumbulluar me mijëra vetë, përfshi dhe popullsinë civile, gra, fëmijë, pleq, të plagosur, robër italianë etj. Gjithashtu ishin grumbulluar njësitë partizane të Qarkut të Beratit dhe Elbasanit, të zbathur, pa fishekë (municion) nga pamundësia e rezistencës kundër armikut superior në numër. Me shtabin e Brigadës ndodheshin edhe disa anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë e të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (Ramadan Çitaku, Haxh Lleshi dhe Medar Shtylla). Në këtë situatë të vështirë duhej marrë një vendim i studiuar mirë, i shpejtë dhe me logjikë që t'i paraprinte veprimeve luftarake pasardhëse. Në mbledhje merrte pjesë edhe Koçi Xoxe, komandanti i shtabit të forcave partizane Teki Kolaneci e të tjerë. Shtabi i brigadës, duke vlerësuar që forcat e përqendruara në Opar ishin plotësisht të qarkuara propozoi që të çante rrethimin. Kursi i veprimit do të ishte si më poshtë: Gjatë natës 12 – 13 janar të shkëpusë kontaktin me armikun, të tërheqë të gjitha forcat në drejtim të Qafës së Beçit, të çajë rrethimin në Qafë Beç – Faqekuq, të dalë në rajonin e Skraparit dhe të Dangëllisë, që ishin zona të lidhura ngushtë me Luftën Nacionalçlirimtare dhe prej andej, në bashkëveprim me forca të tjera partizane, të veprojnë në krah të armikut. Ndërsa Koçi Xoxe këmbëngulte një variant krejtësisht ndryshe, që Brigada IV Sulmuese të copëzohej në njësi të vogla dhe të shpërndahej duke u futur prapa shpinës së armikut për t'u fshehur derisa të kalonte kjo situatë dhe pas kësaj të formohej përsëri, ose të tërhiqej në drejtimin Ura e Moglicës, Shënepremte. Arsyetimi konsistonte se, meqenëse pararoja armike ka dalë në Mazrek dhe, për rrjedhojë rrezikon të kapë Qafën e Beçit, brigada do të detyrohej të bjerë në luftime të ashpra dhe nuk do të plotësojë dot detyrën e vënë; kurse kështu do të mund të shpëtojnë nga kjo situatë e krijuar dhe më vonë të riorganizohet përsëri, ose po të shkojë nga Moglica ajo është e lirë dhe

mund të shpëtojë forcat. Ndërsa anëtarët e shtabit të brigadës arsyetonin me të drejtë krejt ndryshe: “Shpërndarja e brigadës dhe e forcave të tjera të qarkut do t’i linte partizanët në duart e armikut, pa bërë fjalë për popullsinë civile, të plagosurit etj. Ky vendim do të ishte vdekjeprurës për brigadën. Gjithashtu, do të ndikonte në uljen e moralit të forcave partizane dhe të popullit, të lëkundurit do t’i dorëzoheshin armikut ose do të hynin në qytet të dëshpëruar. Armiku dhe Balli Kombëtar do ta shfrytëzonin këtë situatë dhe do të përpiqeshin të godisnin besimin e popullit që kishin te Lëvizja Nacionalçlirimtare. Copëzimi i strukturave të brigadës ishte një përvojë e hidhur që kishte dhënë rezultate negative në Brigadën III Sulmuese.

Kurse vendimi i propozuar nga komanda e Brigadës për çarjen e rrethimit dhe manovrimit të forcave në krah dhe në shpinë të armikut kishte këto anë pozitive: së pari, megjithëse mund të kishte vështirësi (humbje) për kapjen e Qafës së Beçit, do të ruheshin forcat kryesore të brigadës, shpirti luftarak i saj dhe do të vazhdohej lufta e pandërprerë me armikun; së dyti, do të goditej armiku në befasi dhe atje ku nuk e priste; së treti, do të shpëtohej popullsia, të plagosurit dhe të tjerët që ndodheshin me Brigadën IV Sulmuese; së katërti, duke çarë në drejtim të Skraparit kishte mundësi të bashkoheshin me forca të tjera partizane, siç ishte Brigada I-rë Sulmuese (që shtabi kish dijeni që ndodhej në Qarkun e Gjirokastrës), ose me forca të tjera partizane të Zonës së Gjirokastrës. Komanda e brigadës e mbrojti vendimin e saj, me gjithë kundërshtitë e vazhdueshme. Debatet mbi vendimin për këtë situatë të vështirë u ashpërsuan për shkak të mosdakordësisë që shfaqën disa anëtarë të shtabit epror. Madje, këmbëngulja e komandantit të brigadës arriti deri në atë pikë, sa ai do të kërkonte dorëheqje nëse nuk do të miratohej propozimi i tij, pra ai do të preferonte të bëhej partizan i thjeshtë i kësaj brigade, por jo të urdhëronte si komandant shpërndarjen e brigadës²⁰.

Në këtë vendim një kontribut të madh dhanë komandantët e batalioneve të cilët mbështetën kursin e veprimt të komandës së tyre dhe morën përsipër që t’i plotësonin detyrat e vëna, sidomos komandanti i batalionit II, Petrit Dume, që siguroi se duke qenë në pararojë me batalionin e tij do të shpartallonte pararojën gjermane në katundin Mazrek dhe do të kapte Qafën e Beçit përpara tyre. Por kryesore në këtë vendimmarrje ishte atdhetarizmi dhe heroizmi i partizanëve të Brigadës IV Sulmuese, besimi që kishin ata te komanda e tyre për të zbatuar një vendim kaq të vështirë, por të drejtë dhe shpëtimtar për fatet e brigadës dhe forcave të qarkut të Korçës për atë situatë. Ky ishte vendimi i vetëm i drejtë për atë situatë, i cili u realizua me sukses. Megjithëse ai u mor me vonesë, për shkak të diskutimeve të ashpra në shtabin e brigadës, por

²⁰ AQFA, Fondi Lufta Nacionalçlirimtare, Brigada IV Sulmuese, Dosja nr. 66, Viti 1944: Historiku i krijimit të Brigadës së 4-t Sulmuese si dhe veprimet luftarake të saj gjatë vitit 1944, f. 10.

gjithsesi u realizua në kohë²¹.

Referuar urdhrat të shtabit të brigadës, nxjerrë nga ditari i zotit Gaqo Yrka theksohej, që të rezistohet me këmbëngulje gjatë ditës së 12 janarit; të mbahen pozicionet e zëna, të mos lejohet armiku të mbyllë rrethimin ose të çajë formacionin tonë, duke pasur parasysh që “çdo veprim që bëhet qoftë edhe nga një skuadër e vetme të jetë e lidhur ngushtë dhe e mbështetur nga toga, kompania, batalioni dhe forcat e tjera”²². Përqendrimi i forcave në Qafën e Beçit u arrit si rezultat i masave për lajmërimin e tyre në kohë²³, i qëndrimit joaktiv i kolonës gjermane që kishte dalë në Opar, si dhe i veprimit energjik për tërheqjen e një pjese të materialeve, në radhë të parë të municioneve, nga depot e Punëmirës u ngarkuan 15 kafshë dhe 200 robër italianë me municione dhe ushqime²⁴. Në mbrëmjen e 13 janarit të gjitha forcat vihen në lëvizje në një kolonë. Gjermanët në Faqekuq gjatë natës, e ndriçonin vazhdimisht vendin me raketa, ndërsa partizanët kaluan në qafën e malit pa u diktuar fare nga ata. Me manovër të shpejtë, brigada doli në krah të forcave gjermane në rajonin e Potomit, ku pati në pasditen e 14 janarit një përpjekje për disa orë. Ndërsa brigada po përgatitej për të goditur gjermanët, ata u tërhoqën në drejtim të Beratit. Kjo me sa duket, ishte rezultat i humbjes së rëndë që pësuan hitlerianët në betejën e Tendës së Qypit nga forcat e Brigadës I Sulmuese. Gjeneralmajor Spiro Shalësi, në kujtimet e tij për këtë betejë, botuar në gazetën “Luftëtari”, më 7 maj 1964 shprehet: *“Ishte sukses i madh për Brigadën IV Sulmuese që diti të manovrojë dhe të dalë nga rrethimi pa humbje të rëndësishme, ndërsa mendohej se për ta nxjerrë atë jashtë rrethimit mund të kishte humbje deri në një batalion partizanësh”*²⁵.

Në luftimet që zhvilloi Brigada IV Sulmuese, për tetë ditë e net pa pushim, kundër forcave të mëdha gjermane, plotësoi denjësisht detyrën për përballimin e operacionit armik të dimrit 1943-1944. Gjermanët dhe tradhtarët duke përdorur forca pesë deri gjashtë herë më shumë dhe një epërsi edhe më të madhe në armatime mundën të hyjnë në krahinat e çliruara, por nuk arritën objektivin kryesor asgjësimit të forcave partizane dhe shkatërrimin e pushtetit të këshillave nacionalçlirimtare. Brigada i dëmtoi forcat armike dhe ruajti forcat e saj. Nazistët e tradhtarët e paguan me gjak çdo pëllëmbë tokë. Ajo

²¹ Benard Zotaj, Arben Zavalani, “*Spiro Shalësi, për Artin Ushtarak Shqiptar*”, Shtëpia Botuese M&B, (Tiranë 2021), ISBN: 978-9928-353-09-2, faqe 53-54.

²² AQFA, Fondi Lufta Nacionalçlirimtare, Brigada IV Sulmuese, Dosja nr. 66, Viti 1944: Historiku i krijimit të Brigadës IV Sulmuese si dhe veprimet luftarake të saj gjatë vitit 1944, faqe 9.

²³ Këtu ndikoi pozitivisht linja telefonike e rregullt, nëpërmjet së cilës iu dha detyra gjithë forcave të brigadës (shënim i autorit).

²⁴ Benard Zotaj, Arben Zavalani, “*Spiro Shalësi, për Artin Ushtarak Shqiptar*”, Shtëpia Botuese M&B, (Tiranë 2021), ISBN: 978-9928-353-09-2, faqe 53-54.

²⁵ Po aty, faqe 56.

çau me luftime dy rrethime, kompakte e me shpirt të lartë sakrifice, duke i shkaktuar armikut 83 gjermanë e 43 ballistë e xhandarë të vrarë, 123 të plagosur, 68 robër, shumica ballistë e xhandarë²⁶.

Shtabi i Brigadës IV Sulmuese me shtabet e qarqeve Korçë e Berat në mes të muajit janar organizuan në Gjergjovë (Skrapar) një mbledhje ku shqyrtuan situatën dhe detyrat për të kaluar në veprime kundërmësymëse. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm Ramadan Çitaku, Haxhi Lleshi etj. U ritheksua edhe njëherë porosia e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, se lufta kundër pushtuesit e veglave të tyre duhej të mbante karakterin e vërtetë të mësymjes së pandërprerë. Në këtë kuadër, strukturat e Brigadës IV Sulmuese, sipas planeve të detajuara kalojnë në mësymje për çlirimin e krahinave të shkelura nga gjermano-ballistët në ditët në vijim. Kështu deri në mesin e shkurtit 1944 çlirohen fshatrat Treskë, Panarit e Opar, zhvillohen luftime të ashpra në Vithkuq e Kolonjë, Qafëzes e Gostivisht, shpartallohen forcat armike në Shënepremte, Grabovë etj. Edhe në këto luftime doli në pah taktika, bashkëveprimi, iniciativa dhe trimëria e treguar nga partizanët nën drejtimin e komandantëve të tyre. “Atmosfera pozitive” për Brigadën IV shfaqet dhe nga vetë Enver Hoxha, në letrën drejtuar Nako Spiros në lidhje me përballimin e vështirësive të krijuara nga Operacioni armik i Dimrit, ku ndër të tjera ai vlerëson veprimet e saj luftarake. Ai shprehet: “*Brigada IV po vepron me sukses në gjithë krahinën e Korçës*”²⁷.

Brigada IV Sulmuese, shtabi i saj dhe ato të të gjitha shkallëve të tjera, në drejtimin e luftimeve, u përpoqën që ato të mos kishin karakter pozicional, por të ishin aktivë me sulme e kundërsulme dhe me mundësi manovrimi, duke mbajtur bashkëveprim të pandërprerë. Bashkëpunimi i ngushtë i komandave me këshillat nacionalçlirimtare e me gjithë fshatrat ushqeun një gjendje të lartë moralo-politike. Kuadrot treguan aftësi organizative e drejtuese. Ata u ndodhën aty ku rreziku ishte më i madh, aty ku kërkohej vendosmëri e shpirt sakrifice. Morali i partizanëve u rrit jashtëzakonisht, duke përballuar këto situata të vështira dhe besimi në fitore u forcua më shumë. Mbi të gjitha u thye miti se gjermanët ishin të pathyeshëm.

²⁶ Mihallaq Konda, “*Historiku i Brigadës së IV Sulmuese*”, Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja”, (Tiranë 1998), faqe 43.

²⁷ Enver Hoxha, “*Vëpra II, nëntor 1943 – nëntor 1944*”, botim i Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, (Tiranë 1968), faqe 117.

PËRFUNDIME

Brigada IV Sulmuese u krijua si një domosdoshmëri për të përballuar ndërmarrjen e veprimeve luftarake mësimëse të planëzuar nga komanda gjermane e pushtimit në qarkun e Korçës. Ajo u formua mbi bazën e batalioneve që vepronin në Pogradec, Mokër, Bilisht, Gorë, Opar, Korçë, Ersekë e Leskovik. Forcat partizane kishin përfituar një përvojë luftarake, duke qenë motivuese dhe plot shpresë për popullin dhe, njëkohësisht frymëzuese për rininë.

Qëllimi i armikut për rrethimin, asgjësimin e Brigadës IV Sulmuese dhe të forcave partizane të qarkut të Korçës dështoi plotësisht. Strukturat e Brigadës IV u treguan si një njësi e organizuar, me vetëdije e moral të lartë. Forca e saj qëndronte në lidhjet e ngushta me popullin e zonës, që e ndihmoi dhe e mbështeti pa marrë parasysh sakrificat që kërkoheshin.

Rol të rëndësishëm në përballimin e Operacionit armik të Dimrit luajtën dhe këshillat nacionalçlirimtarë. Ato u dhanë përkrahje të madhe forcave partizane, duke u siguruar ushqime, veshmbathje, mjete transporti, e veçanërisht duke shtuar radhët me luftëtarë të rinj vullnetarë.

Komandat e batalioneve e të kompanive, morën pjesë në shumë luftime në vijën e parë. Kështu ata udhëhoqën partizanët jo vetëm me urdhra e këshilla, por edhe me shembullin e tyre vetjak. Ata çmuan drejt dhe shpejt situatën, vlerësuan mirë si forcat e veta ashtu dhe ato të armikut dhe, në përputhje me këtë morën vendime të drejta, me pikësynim të qartë mbrojtjen e forcave partizane dhe dëmtimin sa më tepër të armikut.

Brigada IV Sulmuese dhe forcat territoriale të qarkut të Korçës, ditën t'i shkaktonin humbje të rënda armikut, duke luftuar me vendosmëri dhe heroizëm të pashembullt në kushte të vështira atmosferike dhe jetese. Ata mishëruan karakteristikat dhe veçoritë e luftës partizane, guximin, shpirtin sulmues, manovrën, befasinë dhe përvojën e krijuar, duke dalë nga dara e rrethimit armik, duke i ruajtur forcat e saj të gjalla, duke zhvilluar dhe aftësuar më tepër iniciativën e partizanëve për të përballuar situatën e vështirë dhe duke krijuar një përvojë efikase për luftimet e ardhshme.

BURIME TË SHFRYTËZUARA

1. AQFA, Fondi Lufta Nacionalçlirimtare, Brigada IV Sulmuese, Dosja nr. 2, Viti 1944: Urdhra operacioni të Shtabit të Brigadës së IV Sulmuese.
2. AQFA, Fondi Lufta Nacionalçlirimtare, Brigada IV Sulmuese, Dosja nr. 66, Viti 1944: Historiku i krijimit të Brigadës IV Sulmuese si dhe veprimet

luftarake të saj gjatë vitit 1944.

3. Marenglen Kasmi, “Pushtimi gjerman i Shqipërisë 1943-1944”, Shtëpia Botuese “Filara”, Tiranë 2013, ISBN: 978-9928-142-24-5.
4. Mihallaq Konda, “Historiku i Brigadës së IV Sulmuese”, Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja”, Tiranë 1998.
5. Paskal Milo, “Shqipëtarët në Luftën e Dytë Botërore, Vëllimi II”, Shtëpia Botuese: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2021, ISBN: 978-9928-339-57-7.
6. Benard Zotaj, Arben Zavalani, “Spiro Shalësi, për Artin Ushtarak Shqiptar”, Shtëpia Botuese M&B, Tiranë 2021, ISBN: 978-9928-353-09-2.
7. Fjalori Enciklopedik Shqiptar, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1985.
8. “Historia e popullit shqiptar” - Vëllimi IV, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2008, ISBN: 978-99943-1-452-2.
9. “Historia e popullit shqiptar”, Shtëpia Botuese e librit shkollor, Tiranë 2008, ISBN: 99927-2-257-6.

MARRËDHËNIET USHTARAKE MIDIS SHQIPËRISË DHE JUGOSLLAVISË, 1945-1948. PËRPJËKJET PËR UNIFIKIMIN E DY USHTRIVE

Kapiten MSc. Hekuran Budani

Pedagog në FMS, AFA

MSc. Orgest Xhangoli

Pedagog në FMS, AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Në fillimet e marrëdhënieve të ngushta mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, një rol të veçantë kishte dhe organizimi i ri i Ushtrisë Shqiptare, veçanërisht duke pasur parasysh problemet me çështjen e kufirit greko-shqiptar. Edhe në këtë drejtim, kërkesat për mbështetje dhe këshillim u drejtuan kah Jugosllavisë.*

Qëllimi i këtij punimi është analizimi i marrëdhënieve ushtarake mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1948 dhe më konkretisht të shqyrtojë përpjekjet e bëra nga të dyja palët për unifikimin e dy ushtrive. Bazuar në dokumentet arkivore të Arkivit Qendror Shtetëror dhe Arkivit Qendror Forcave të Armatosura dhe burime të tjera dytësore ky punim pasqyron disa përpjekje të bëra nga udhëheqja e kohës për unifikimin e dy ushtrive në çështje të tilla si: unifikimi ideopolitik me ushtarët dhe oficerët, asistencë e oficerëve jugosllavë në nivele të ndryshme, unifikimi doktrinar; një plan unik operacional në rast lufte me ushtrinë jugosllave, legjislacioni po ashtu, ushtria shqiptare të përfshihej në buxhetin e ushtrisë jugosllave etj.

Fjalët kyçe: marrëdhëniet ushtarake, unifikim, Shqipëri, Jugosllavi, platformë, promemorie, radiogram.

HYRJE

Pas Luftës së Dytë Botërore, Jugosllavia ishte vendi i parë që njohu qeverinë shqiptare dhe vendosi marrëdhënie diplomatike me të. Si rezultat i ftohjes me perëndimin, orientimi i ri i Shqipërisë do të ishte kah fuqive komuniste dhe meqenëse Moska nuk shfaqte ndonjë interes të veçantë për Shqipërinë, kjo e fundit u drejtua kah Jugosllavisë fqinje.

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave pas Luftës Dytë Botërore deri në vitin 1948, u zhvilluan mbi platforma unifikuese politike, ekonomike dhe ushtarake. Traktati i Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke midis dy vendeve (9 korrik 1946) do të ndiqej nga një varg marrëveshesh ekonomike. Ndër to kryesonte “Konventa për Koordinimin e planeve ekonomike, për Bashkimin doganor dhe Barazimin e monedhave” (27 nëntor 1946). Në fushën ushtarake, marrëdhëniet arritën kulmin sidomos në gjysmën e dytë të vitit 1947, kur përpjekjet për bashkim tashmë me hapjen e arkivave i gjejmë plotësisht të dokumentuara.

E gjithë kjo strategji jugosllave ndaj Shqipërisë bëhej me dijeni dhe leje të Stalinit. Në takimin që Tito kishte pasur me Stalinin në Moskë, në maj 1946, ky i fundit i kishte sugjeruar Titos të nënshkruante sa më shumë marrëveshje bilaterale me Shqipërinë, me qëllim që bashkimi midis dy vendeve të kërkohej nga poshtë, nga vetë shqiptarët. Ishte pikërisht një muaj pas këtij takimi, në qershor 1946, kur Enver Hoxha u ftua në Beograd, ku u përgatit traktati i Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke Shqipëri-Jugosllavi. Muajt e mëvonshëm ishin mbushur me nënshkrime marrëveshesh dypalëshe ekonomike, financiare, ushtarake, kulturore etj. “Në praktikë bëjmë Federatën”, do të shprehej J. B. Tito në këtë kohë.



Në foto

D. Mugosha, E.Hoxha, M.Popoviç

Në maj-qershor 1947, kur fronti i luftimeve të Ushtrisë Demokratike Greke me forcat e Ushtrisë Kombëtare Greke ishte zhvendosur në kufi me Shqipërinë, në malet e Vicit e Gramozit, roli i Shqipërisë për bllokun komunist që po formësohej fitoi peshë për Moskën. Enver Hoxha u thirr me urgjencë nga Stalini në Moskë (14-26 korrik 1947), kurse Tito forcoi presionin mbi udhëheqjen komuniste shqiptare për përfshirjen e Shqipërisë në një federatë të përbashkët. Përfshirja e Shqipërisë në Jugosllavi do të forconte pozitën gjeostrategjike të Jugosllavisë, duke i dhënë asaj një vijë bregdetare që shtrihej nga Adriatiku

deri në Jon; ndërsa një Maqedoni e bashkuar (ku do të përfshihej Maqedonia e Vardarit, e Pirinit dhe e Egjeut) brenda federatës jugosllave do rriste kredibilitetin e kësaj të fundit te popujt sllavë të jugut.

Bashkimi Sovjetik, me indiferencën dhe me moskujdesin për Shqipërinë dhe preferencën e hapur për Jugosllavinë e Titos, i la kësaj të fundit dorë e fushë të lirë veprimi, që të shtrinte dalëngadalë ndikimin dhe ndërhyrjen e vet në Shqipëri deri në atë shkallë sa të rrezikonte seriozisht pavarësinë dhe integritetin e saj territorial.

Është fakt se deri sa hynë vetë në konflikt me Titon, udhëheqësit sovjetikë kurrfarë shqetësimi e interesimi nuk treguan e nuk shfaqën për fatin e Shqipërisë e të shqiptarëve në tërësi. Tek ata mbizotëroi mendimi se “me ta le të merren jugosllavët”. Vetë Molotovi, numri dy në udhëheqjen sovjetike në atë kohë, deklaronte se “ndihmat ekonomike për Shqipërinë ne i japim nëpërmjet Jugosllavisë”¹. Në mbështetje të këtij pohimi vjen dhe deklarimi i bërë nga V. Stojniçi në Plenumin II, se “Ju jeni te vegje!”, e “Pa Jugosllavinë nuk mund ta mbani situatën. Prandaj, perspektiva e juaj është “një Konfederatë dhe më tutje”².

1. PËRPIJËKJET PËR UNIFIKIMIN E DY USHTRIVE

“Autorët Malltezi dhe Plasari në botimin e tyre të disa dokumenteve mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet 1945-1948, pohojnë në faqen 90 të librit, ku thonë se ‘E. Hoxha...ka qenë plotësisht për bashkimin e Ushtrisë Shqiptare me Ushtrinë Jugosllave’.”

Nisur nga kjo tezë e hasur edhe në artikuj, debate shkencore dhe tekste të historiografisë, vendosëm të hulumtojmë dokumente arkivore dhe burime të tjera, të cilat, siç do ta shohim dhe me poshtë, sjellin shume fakte dhe ngjarje që na mundësojnë një interpretim më të thelluar rreth kësaj teze.

Hapi i parë drejt marrëdhënieve ndërshtetërore mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë është hedhur në 20 shkurt të vitit 1945 në Beograd, ku është nënshkruar traktati mbi aleancën dhe ndihmën e ndërsjellë midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë⁴. Traktati, i nënshkruar nga Josip Broz Tito nga ana e Komitetit Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë dhe Myslim Pezës në emër të qeverisë shqiptare, kishte për qëllim zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve të mira të fqinjësisë dhe miqësisë midis popujve aleatë të Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Në traktat vihen në dukje fakti që këto marrëdhënie u krijuan me një “përzemërsi të veçantë”

¹ E. Hoxha, *Titistët*, Tiranë, f. 198.

² *AQSH*, Fondi 14, Procesverballi i Mbledhjes së Plenumit IX të KQ të PKSH, shtator 1948.

³ Plasari, N. & Malltezi. L. (1996), *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948 Dokumente, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave*.

⁴ Krisafi, Ledion (2017) *Shqiperia dhe Jugosllavia 1945-1948*, Tiranë

gjatë luftës kundër pushtuesve nazi-fashistë. Bashkëpunimi ndërmjet dy partive komuniste të vendeve respektive ishte i madh, mjaft jugosllavë u vendosën në institucionet e shtetit tonë në cilësinë e ekspertëve. Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u forcuan edhe më tepër pas vizitës që Enver Hoxha bëri në Jugosllavi, më 23 korrik 1946⁵. Fusha e Bashkëpunimit midis dy vendeve komuniste padyshim u shtri edhe në anën e fushës ushtarake. Në maj të vitit 1946, Koci Xoxe i shkruan Aleksandër Rankovicit, ministrit të brendshëm jugosllav në lidhje me organizimin e shërbimit të fshehtë ku nuk linte mënjane edhe detajet për ushtrinë shqiptare.

Një këshillim të ngjashëm me jugosllavët, por për çështjen e ushtrisë shqiptare, e kërkon dhe Enver Hoxha në fund të vitit 1946 në një letër dërguar Titos. “Me anën e kësaj letre dëshiroja të këshillohesha me ju për disa probleme që kanë lidhje veçanërisht me ushtrinë tonë dhe me veprimet që mendojmë të bëjmë gjatë vitit 1947” e fillon letrën Enver Hoxha⁶. Më tej vazhdon duke dhënë detaje për ushtrinë shqiptare. “Që të jetë e qartë ekspozoja ime, dëshiroj t’ju vë në dijeni juve shkurtimisht mbi situatën e Ushtrisë sonë Kombëtare. Kjo ka një forcë komplekse prej 44.015 vetash, duke përfshirë prej kësaj shume forcat e policisë”.

Më tej, Enver Hoxha numëron 2 mijë e 927 oficerë, 5 mijë e 321 nënoficerë, 34 mijë e 937 ushtarë dhe 800 nxënës ushtarakë. Skicon dhe paraqitjen organike të numrave që sapo ka përmendur më lart duke përcaktuar se sa prej tyre janë hedhur në ushtri në vitet 1942-43-44, përkatësisht 8 mijë e 987 veta, sa prej tyre janë thirrur rezervistë në muajin gusht të vitit 1946 dhe sa në tetor të po të njëjtit vit⁷. Gjithashtu, në dokumente të zbuluara në Arkivin e Forcave të Armatosura kemi konstatuar një radiogram ku kabineti ushtarak i Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë i dërgon atasheut ushtarak shqiptar në Jugosllavi ku ndër të tjera shprehet: “Kërkoni pranë shtabit Jugosllav mundësisht të na sjellë projektligjin mbi mobilizimin, rekrutimin e ushtarëve dhe shërbimin paraushtarak⁸. (Shih fig.1).

Këto përpjekje të qeverisë shqiptare për një ushtri sa më të unifikuar me atë jugosllave do të kishte dhe kulmin e saj. Në një promemorie të vitit 1947 drejtuar Enver Hoxhës, Mehmet Shehu i shkruante dhe se duhej sa më parë unifikimi i dy ushtrive përkatëse ku sqaronte dhe pikat kryesore që duhej të ndërmerrnin. Enver Hoxha jo vetëm që dha pëlqimin, por në një letër tjetër ai thekson edhe disa çështje që mund t’i shërbejnë unifikimit të dy ushtrive por

⁵ Lala, Brisejda, projekti i federatës ballkanike në marrëdhëniet shqiptare – jugosllave në 1945-1948, aktet vi, 5: 486-490, Tiranë 2013.

⁶ Arkivi Qendror i Shtetit (F14/AP, dosja 5, viti 1946), Tiranë

⁷ Arkivi Qendror i Shtetit (F14/AP, dosja 5, viti 1946), Tiranë

⁸ Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (F1, dosja 116, viti 1946), Tiranë

që mungonin në promemorian e Mehmet Shehut. Këto çështje ishin të tilla si: “1) Unifikimi i punës ideo-politike me ushtarët dhe oficerët. 2) Unifikimi i organizimit të organeve politike. 3) Oficerët jugosllavë do të dërgohen: një në Shtatmadhori dhe një në mbrapavijë; do të sjellin vijën ose do të napin vijën e zhvillimit të njëjtë në të gjithë sektorët e ushtrive tona. 4) Buxheti të jetë i njëjtë, jo i ndarë, kjo për çështje administrimi dhe për evitimin e konfuzioneve që mund të lindin etj.” (Shih fig. 2)




Figura nr. 1 : AQSHF. F1, dosja 116, viti 1946




Figura nr. 2: AQSHFA. F2, dosja 32, viti 1947

⁹ Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (F2, dosja 32, viti 1947), Tiranë

Pranë ushtrisë shqiptare u vendosën këshilltarë dhe instruktorë ushtarakë jugosllavë. Ata u shpërndanë në Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare, pranë drejtorive, divizioneve, regjimenteve dhe shkollës së oficerëve etj.

Në një vizitë në Beograd, delegacioni shqiptar partiak dhe qeveritar në dhjetor 1947, i përbërë nga E. Hoxha, K. Xoxe, H. Kapo dhe K. Themelko u prit nga Tito, Kardeli dhe anëtarë të tjerë të Byrosë Politike të PKJ. Në këtë takim Tito shprehu kënaqësinë që “KQ i PKSH e ka parë mirë vijën që duhet ndjekur”. Për ushtrinë, ai tha se “Shqipëria nuk mund të mbajë gjithë shpenzimet, se rëndojnë ekonominë. Prandaj gjithçka, pajisje dhe armatime, do të futen në buxhetin jugosllav”. Ndërkohë Hoxha deklaroi se “stërvitja dhe organizimi do të jenë të njëjtë”.

Për të vënë në zbatim këto vendime në sektorin ushtarak, më 24 deri më 27 dhjetor 1947, erdhi në Shqipëri një delegacion i lartë jugosllav, i kryesuar nga gjenerallejtënant Rade Hamović, shefi i Drejtorisë Operative të Shtatmadhorisë. Në të merrnin pjesë dhe gjenerallejtënant Sava Dërlević, komandant i prapavijës dhe gjeneralmajor Branko Petriçević, zëvendësshef i Drejtorisë Politike të ushtrisë jugosllave.

Pas diskutimeve, dolën me përfundimin për një platformë unifikuese të ushtrisë shqiptare me atë jugosllave. Platforma fillon me këto fjalë¹⁰: “Në interes të mbrojtjes së vendeve tona dhe të përforcimit të Ushtrisë Shqiptare, u diskutua për probleme të ndryshme ushtarake dhe u konstatuan pikëpamje të njëjtoja për të gjitha çështjet, të cilat pikëpamje do t’u parashtrihen për propozim komandantëve Supremë të Ushtrisë Jugosllave dhe të Ushtrisë Shqiptare, për t’u sanksionuar me aprovimin e tyre.” Pika e parë e kësaj Platforme ishte:

1. Të kalojmë sa më parë në unifikimin e ushtrisë shqiptare me ushtrinë jugosllave:

- ushtria shqiptare duhej të kishte një plan unik operacional në rast lufte me ushtrinë jugosllave;
- të gjitha urdhëresat e ushtrisë jugosllave do të ishin të vlefshme edhe për ushtrinë shqiptare;
- legjislacioni po ashtu;
- ushtria shqiptare të inkorporohej në buxhetin e ushtrisë jugosllave.

2. Njëkohësisht propozimet theksonin se:

- “pranë Ministrisë së Mbrojtjes Popullore të Shqipërisë do të vinte një delegat i Ministrisë së Mbrojtjes Popullore Jugosllave;

¹⁰ Lalaj, Ana “Platforma e unifikimit të ushtrisë shqiptare me atë jugosllave në vitin 1947”, Tiranë 2014.

- shefi i Shtatmadhorisë, gjeneral-kolonel M. Shehu të largohej dhe në vend të tij të vendosej kolonel Beqir Balluku; dhe në ushtrinë shqiptare nuk kishte më nevojë që të vinin instruktorët sovjetikë ushtarakë që ishin paralajmëruar.”

Arsyet që çuan në dështimin e unifikimit.

Me gjithë përpjekjet e palëve ushtria shqiptare nuk u bashkua me ushtrinë jugosllave, as në vitet 1946-47 kur marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë ishin në kulmin e afritetit të tyre.

Konflikti i Jugosllavisë me BS dhe vendet e tjera socialiste, dënimi dhe përjashtimi i saj nga kampi socialist dhe nga Lëvizja Komuniste Ndërkombëtare në vitin 1948 u reflektuan menjëherë dhe në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.

Grindja midis Jugosllavisë dhe partnerit të saj Sovjetik arriti kulmin në një mbledhje të Byrosë Informative Komuniste në Bukuresht. Më 28 qershor 1948, Partia Komuniste Jugosllave u akuzua për devijim nga vija e ashpër marksiste e Stalinit. Stalini nuk do ta shihte me sy të mirë forcimin gjithnjë e më të madh të shtetit jugosllav në Ballkan dhe politikën pothuajse asnjëse që po ndiqte Tito kohët e fundit¹¹. Në 13 prill 1948 mbërriti në Shqipëri kopja e letrës së KQ të PK të BRSS-së e 27 marsit, që akuzonte PKJ dhe udhëheqësit e saj për vijën e tyre antisovjetike dhe antimarksiste¹².

Shqipëria, nga ana e saj kishte kohë që ishte e pakënaqur nga pala jugosllave. Presioni që ushtronte qeveria jugosllave tek qeveria shqiptare, për ta përfshirë atë në Federatën Jugosllave ishte i padurueshëm, ndaj dëshira më e madhe e udhëheqësve shqiptarë ishte distancimi nga Jugosllavia. Kjo letër i erdhi si dhuratë nga qielli E. Hoxhës, i cili në kushtet e krijuara nuk kërkonte gjë tjetër veçse të distancohej nga ndikimi jugosllav.

Stalini filloi të interesohej për vendin tonë kur marrëdhëniet me Jugosllavinë po i vinte fundi. Në këtë rast Shqipëria do të kishte rëndësi të dorës së parë për sovjetikët pasi do i siguronte atyre daljen në detin Adriatik. Shqipëria kishte një pozitë të favorshme gjeografike, ajo ishte fqinje e Greqisë (zonë e influencës Britanike) dhe ishte vetëm pak kilometra në rrugë detare nga Italia. “Nga ana tjetër, pas prishjes së marrëdhëniet sovjeto-jugosllave, edhe Stalinit i nevojitej një Shqipëri e pozicionuar kundër Jugosllavisë së Titos, për të ngushtuar rrethin e izolimit për udhëheqësin heretik jugosllav, që kishte guxuar ta kundërshtonte”

¹¹ Lala, Brisejda, projekti i federatës ballkanike në marrëdhëniet shqiptare – jugosllave në 1945-1948, aktet VI, 5: 486-490, Tiranë 2013.

¹² Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH 1949, D. 18: 11), Tiranë.

Në këto rrethana Shqipëria u bë gjithnjë e më tepër qendra e vëmendjes për sovjetikët. Kështu E. Hoxha bëri një lëvizje të zgjuar pasi u nda nga Jugosllavia duke i shprehur besnikërinë e tij BRSS dhe eliminoi kundërshtarët e tij politikë. Në këtë kuadër një sërë anëtarësh të Byrosë Politike, ndërmjet tyre edhe K. Xoxe, Ministër i Brendshëm u ekzekutuan me pretekstin se konsideroheshin tradhtarë të popullit pasi kishin bashkëpunuar me qeverinë jugosllave për të përmbysur qeverinë në pushtet. Partia e Punës së Shqipërisë nuk ngurroi për asnjë sekondë për t'u shkëputur nga ndikimi jugosllav. Kjo ishte shpëtimtare për regjimin komunist dhe për vetë Hoxhën personalisht.

Më 1 korrik të vitit 1948, Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë i dërgoi dy letra përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë në të cilat shkruhej se të gjithë ekspertët jugosllavë që gjendeshin në Shqipëri në të gjitha dikasteret duhet të largoheshin brenda 48 orëve dhe në të njëjtën kohë Shqipëria hiqte dorë nga çdo marrëveshje që kishte nënshkruar me Jugosllavinë¹³.

PËRFUNDIME

Ky punim kishte për qëllim të hidhte një vështrim mbi marrëdhëniet ushtarake mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948 dhe me konkretisht të ilustronte me dokumente arkivore përpjekjet për unifikimin e ushtrisë shqiptare me atë jugosllave.

Bazuar në dokumentet arkivore të Arkivit Qendror Shtetëror dhe Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura dhe burime të tjera dytësore, kemi dalë në përfundimin se mes dy qeverive të asaj kohe ka pasur plane konkrete për unifikim, por realizimi faktik dështoi edhe për shkak të faktorëve të jashtëm që tejkalonin edhe marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Marrëdhëniet e Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë do të kishin një ndikim të madh në marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik edhe në të ardhmen.

Zgjedhja e Jugosllavisë si “partner i parë” nuk ishte plotësisht vullnet i udhëheqjes shqiptare. Takimet midis Titos dhe Stalinit tregojnë se shqiptarët kërkonin me ngulm të shkonin në Moskë në fillim pastaj në Beograd, por udhëheqësi sovjetik mendonte të kundërtën. Më së shumti ishte një zgjedhje e Bashkimit Sovjetik që përcaktoi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.

Kur Bashkimi Sovjetik u kthye në partnerin kryesor për Shqipërinë dhe do e ndihmonte atë në rrugën drejt komunizmit, Shqipërisë jo vetëm që nuk i erdhi keq nga shkëputja e marrëdhënieve me Jugosllavinë, përkundrazi ajo u ndie e çliruar prej tyre dhe u drejtua nga Bashkimi Sovjetik, duke gjetur tek ai një aleat politik dhe ekonomik.

¹³ Krisafi, Ledion (2017) Shqipëria dhe Jugosllavia 1945-1948, Tiranë

BURIME TË SHFRYTËZUARA

- Arkiva

1. AQSH - Arkivi Qendror i Shtetit, Tiranë
2. AQFA - Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Tiranë

- Tekste dhe Artikuj

1. Plasari, N. & Malltezi, L. (1996), “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948 Dokumente, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave.”
2. Krisafi, L. “Shqiperia dhe Jugosllavia 1945-1948”, Tiranë 2017.
3. Smirnova, N. “Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX”, Tiranë 2004.
4. Gurakuqi, R. “Problemi i federatës shqiptaro–jugosllave”, Korrik, Tiranë 2011.
5. Gjilas, M. “Fytyra e Totalitarizmit”, Tiranë 2006.
6. Hoxha, E. “Titistët”, Tiranë 1982.
7. Lala, B. “Projekti i federatës ballkanike në marrëdhëniet shqiptare – jugosllave në 1945-1948”, aktet VI, 5: 486-490, Tiranë 2013.
8. Lalaj, A. “Platforma e unifikimit të ushtrisë shqiptare me atë jugosllave në vitin 1947”, Tiranë 2014.
9. Duka, V. “Histori e Shqipërisë 1912-2000”, Tiranë 2007.

KONFLIKTI SIRIAN

Major Msc. Kujtim ZEKA
Koordinator në FMS, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Tema mbi konfliktin sirian vazhdimisht ka ngjallur interes dhe vijon të ketë një qasje gjithëpërfshirëse e të vazhdueshme në shoqërinë tonë dhe veçanërisht faktorin ndërkombëtar. Me anën e këtij punimi, kam synuar të nxjerr në pah shkaqet dhe pasojat e konfliktit në Siri.

Ky punim trajton kryesisht rolin dhe përpjekjet e faktorit ndërkombëtar për parandalimin e konfliktit dhe vendosjen e paqes. Vlen të nënvizojmë rezolutat e shumta që janë ndërmarrë nga OKB, BE për të parandaluar konfliktin, e për të rivendosur paqen. Gjithashtu në këtë punim, janë trajtuar edhe shumë aspekte të konfliktit, të cilat analizohen me qëllim për të përcaktuar të veçantat dhe dinamikat e këtij konflikti.

Çështjet më të rëndësishme në këtë punim janë zhvillimi i konfliktit sirian, roli i politikës ndërkombëtare dhe karakteristikat e konfliktit sirian. Duke e analizuar këtë konflikt kuptojmë sfidat që ka shoqëria siriane dhe faktori ndërkombëtar për të arritur sa më shpejt paqen e dëshiruar. Gjithashtu vihet theksi te karakteristikat themelore të konfliktit sirian, ku ndërthuren planet dhe interesat e shteteve të ndryshme në këtë konflikt shumë të përgjakshëm, si dhe evidentohen kostot dhe pasojat mjaft të rënda që solli ky konflikt. Për përgatitjen e këtij punimi, kam shfrytëzuar botime të ndryshme dhe literaturë, e cila pasqyron dhe trajton aspekte të ndryshme të konfliktit sirian.

Fjalët kyçe: konflikti sirian, regjimi i Assad-it, faktor ndërkombëtar, opozita siriane, SHBA, Irani, Turqia, Rusia, revolucioni sirian.

HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është të sjellë në vëmendjen e lexuesit përmasat dhe pasojat shumë të rënda që po sjell konflikti në Siri. Nisur nga rrethanat dhe pasojat e deritanishme të këtij konflikti, vlen të theksohen shumë elemente, të cilat duhen vlerësuar dhe analizuar me qëllim njohjen e shkaqeve dhe faktorëve që ndikuan në përhapjen dhe zhvillimin e këtij konflikti kaq të përgjakshëm. Duke e parë situatën në këndvështrimin historik dhe analitik, mund të kemi një qasje më koherente me situatën e sigurisë rajonale dhe sfidat që ka edhe shteti shqiptar dhe Forcat e Armatosura në kuadrin e parandalimit të terrorizmit, e në përmbushjen e detyrimeve për rritjen e sigurisë së brendshme në vendin tonë. Vendet që u dalluan prej fillimit të revolucionit me politikat e qëndrueshme për Sirinë janë **Turqia, Rusia dhe Irani**. Ndërkohë që Turqia mbështet opozitarët sirianë, Rusia dhe Irani vazhdojnë të qëndrojnë pranë regjimit të presidentit Bashar al-Assad. Ndërkaq Shtetet e Bashkuara të Amerikës përjetojnë batica dhe zbatica në politikat e Sirisë¹.

Më 30 shtator 2015, Rusia filloi fushatën e ajrit me kërkesë të qeverisë së Sirisë.² Presidenti Assad mbetet në pushtet, pavarësisht luftimeve dhe ndarjes së vendit, shkruan agjencia Associated Press. Në aspektin ekonomik, Siria është e shkatërruar. Vendi është ndarë në tri pjesë. Një grup i lidhur me Al Kaedën dominon provincën veriperëndimore të Idlibit, me rebelët e mbështetur nga Turqia që kontrollojnë vijën përgjatë kufirit turk. Forcat kurde siriane të mbështetura nga Shtetet e Bashkuara, mbajnë rreth një të katërtën e vendit në verilindje. Pjesën tjetër e kontrollojnë forcat e presidentit sirian, Assad.

1. NJË VËSHTRIM HISTORIK MBI KONFLIKTIN SIRIAN ROLI I POLITIKËS NDËRKOMBËTARE

Cilat ishin ngjarjet kryesore që shkaktuan luftën civile në Siri?

Mars 2011: Një grup personash u ndaluan pasi kishin vendosur mbishkrime anti-qeveritare në murin e shkollës së tyre në qytetin Dara. Ndalimi i tyre ngjalli protesta. Më 15 mars, një tubim u mbajt edhe në pjesën e qytetit të vjetër në kryeqytetin Damask. Më 18 mars, katër njerëz u vranë pasi forcat e sigurisë qëlluan ndaj protestuesve në Dara. Aktivistët thanë se këto ishin viktimat e para të kryengritjes. Pas kësaj ngjarjeje, protestat u përhapën në gjithë vendin, sikurse edhe shtypja nga ana e forcave të sigurisë.

¹ Can Acun, ekspert i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politikave të jashtme pranë Fondacionit për Kërkime Politike, Ekonomike dhe Sociale (SETA) në Ankara, *“Lufta me Prokurë në Siri”*, (analizë), burimi elektronik: <https://www.trt.net.tr/shqip/opinione/2020/09/18/>

² Gazeta Dita *“Një pikturë murale në Siri paraqet fazat e konfliktit sirian”*, publikuar më 25 nëntor 2015.

Prill 2011: Në qytetin e tretë më të madh të Sirisë, Homs, policia sulmoi mijëra protestues, të cilët u përpoqën të krijonin një atmosferë proteste sikurse në sheshin Tahrir të Kajros. Ky shesh ishte epiqendra e protestave kundër sunduesit të atëhershëm të Egjiptit, Hosni Mubarak.

Më 4 shkurt 2012, përballë intensifikimit të konfliktit, Këshilli i Sigurimit hodhi për votim një projekt-rezolutë që kërkonte largimin e presidentit sirian Bashar al-Assad. Kjo rezolutë ishte modeluar në planin e daljes nga kriza të Lidhjes arabe. Për të dytën herë në vetëm katër muaj, Kina dhe Rusia zgjodhën t'i kundërviheshin zbatimit të saj. Në korrik të të njëjtit vit, shtrëngimi i sanksioneve ndaj regjimit sirian në rast vazhdimi të përdorimit të armëve të rënda kundër opozitës dhe zgjatja e misionit të vëzhguesve në terren, u hodhën përsëri poshtë. Rusia e konsideroi këtë rezolutë si një mbështetje për opozitën, që ajo e konsideron si “terroriste”. Ky është fundi i planit Annan.

18 qershor 2012: Në Damask, gjatë një mbledhjeje të zyrtarëve të nivelit të lartë ku po trajtohej kriza në vend, shpërtheu një bombë nga e cila mbetën të vrarë katër zyrtarë, përfshirë kunatin e presidentit Bashar al-Assad, si dhe ministrin e Mbrojtjes së Sirisë.

Korrik 2012: Luftimet e kryengritësve kundër forcave qeveritare përhapen edhe Alepo, qytetin më të madh të Sirisë dhe njëherësh kryeqendra tregtare e vendit.

20 gusht 2012: Presidenti i atëhershëm amerikan, Barack Obama, duke folur për situatën në Siri tha se përdorimi i armëve kimike në konflikt, do të ishte një “vijë e kuqe”, e cila do ta ndryshonte kalkulimin e tij për ndërhyrje në luftën civile.

19 mars 2013: Qeveria siriane dhe opozita bënë akuza të ndërsjella për sulmin me gaz, që la të vrarë 26 persona në qytetin verior, Khan al-Assal. Më vonë Organizata e Kombeve të Bashkuara zhvilloi një hetim për këtë rast dhe erdhi në përfundimin se ishte përdorur gazi nervor sarin. Megjithatë, OKB-ja nuk e emëroi fajtorin për përdorimin e tij.

Maj 2013: Grupi militant Hezbollah i Libanit, zyrtarisht përfshihet në konfliktin sirian në mbështetje të Assadit, duke sulmuar dhe vendosur nën kontroll më vonë qytetin kufitar, Kusair.

21 gusht 2013: Nga një sulm kimik në lindje të Damaskut vriten qindra persona. Shtetet e Bashkuara dhe disa vende tjera fajësojnë për sulmin forcat qeveritare siriane. Presidenti Obama kërcënon me sulme, por më vonë tërhiqet.

27 shtator 2013: Këshilli i Sigurimit i OKB-së urdhëron Sirinë të japë përgjegjësi për sulmet dhe të shkatërrojë rezervat e saj të armëve kimike. Masa e Këshillit të Sigurimit erdhi pas një marrëveshje të befasishme midis

Uashingtonit dhe Moskës që shmangu sulmet e SHBA-ve.

14 tetor 2013: Siria nënshkruan Konventën për Armët Kimike, sipas së cilës vendit i ndalohej prodhimi dhe përdorimi i armëve kimike.

23 qershor 2014: Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike njoftoi se ka larguar edhe sasinë e fundit të armëve kimike të Qeverisë siriane. Por, zyrtarët e opozitës siriane thanë se rezervat e armëve kimike të qeverisë nuk ishin llogaritur plotësisht dhe se ajo ende posedonte sasi të tyre.

30 qershor 2014: Grupi i Shtetit Islamik (ISIS) shpall të ashtuquajturin kalifat në zonat që kontrollonte në Irak dhe Siri. Në këtë periudhë përshkallëzohet kriza e refugjatëve.

23 shtator 2014: Shtetet e Bashkuara fillojnë sulmet ajrore ndaj objektivave të grupit militant ISIS në Siri.

28 mars 2015: Qyteti Idlib në veriperëndim të Sirisë bie nën kontrollin e militantëve islamikë të udhëhequr Fronti Al-Nusra, një organizatë e lidhur me Al-Kaidën.

6 maj 2015: Presidenti sirian Assad pranon se ushtria e tij po përballet me vështirësi serioze.

2 shtator 2015: Në një plazh në Turqi gjendet trupi i 3-vjeçarit Aylan Kurdi. Fotografia që u shpërnda me shpejtësi në tërë botën, ngjalli vëmendjen për gjendjen e refugjatëve sirianë, të cilët po përballeshin me vështirësi e rreziqe të shumta për të arritur në vendet evropiane.

30 shtator 2015: Rusia fillon operacionin e sulmeve ajrore në Siri në mbështetje të forcave të Assadit.

Gusht 2016: Forcat turke hyjnë në veri të Sirisë Veriore, duke vënë nën kontroll zonë përgjatë kufirit, të cilat mbaheshin nga grupi Shteti Islamik.

Dhjetor 2016: Pas një ofensive të forcave qeveritare siriane të mbështetura nga rusët, kryengritësit sirianë tërhiqen nga pjesët lindore të Alepos të kontrolluara nga rebelët.

4 prill 2017: Në qytetin Khan Sheikhoun të Idlibit që kontrollohej nga rebelët, vriten të paktën 58 persona. Mjekët thanë se vrasja e tyre mund të jetë bërë përmes një sulmi me gaz nervor. Dëshmitarët thanë se avionët rusë ose sirianë kryen sulmin. Moska dhe Damasku mohuan përgjegjësinë.

6 prill 2017: Shtetet e Bashkuara sulmojnë Sirinë me një breshëri raketash, në përgjigje të incidentit në Khan Sheikhoun. Ky ishte sulmi i parë i drejtpërdrejtë amerikan kundër forcave të Qeverisë siriane.

Maj 2017: Rebelët tërhiqen nga zona e fundit që kontrolluan në Homs. Ky

qytet dikur quhej edhe kryeqyteti i revolucionit.

20 janar 2018: Në enklavën veriore të Afrinit, Turqia fillon një operacion të madh ushtarak kundër luftëtarëve kurdë sirianë.

Prill 2018: Forcat e Qeverisë siriane marrin nën kontroll të gjitha rrethinat e Damaskut duke i ofruar një lloj sigurie pushtetit të Assadit.

14 prill 2018: Në rrethinat e Damaskut u pretendua se sërish është kryer sulm kimik. Aktivistët thanë se mbi 40 persona u vranë. Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe dhe Franca kryen sulme ushtarake në Siri, kundër forcave të Assadit, si ndëshkim për vdekjen e këtyre personave.

10 tetor 2019: Pas tërheqjes së trupave amerikane, Turqia filloi një ofensivë tokësore kundër luftëtarëve kurdë në veri të Sirisë.

5 mars 2020: Presidenti i Turqisë, Recep Tayip Erdogan dhe ai i Rusisë, Vladimir Putin, thanë se kanë arritur një marrëveshje për armëpushim në veriperëndim të Sirisë. Luftimet në këtë zonë kishin rritur mundësinë e një konflikti të forcave ruse dhe atyre turke. Armë pushimi gjithashtu ndaloi një sulm qeveritar sirian të mbështetur nga Rusia në Idlib, bastioni i fundit i rebelëve.

Me qëllim zbutjen apo parandalimin e konfliktit në Siri, janë ndërmarrë vazhdimisht hapa të rëndësishëm nga faktori ndërkombëtar, ndër të cilat mund të theksojmë: SHBA - 29 Prill 2020 sanksione shtesë. BE: embargo armësh. Ndalim importi naftë, ngjirje pasurish.

17 qershor 2020: Hyjnë në fuqi sanksionet e Shteteve të Bashkuara për ata që mbështesin përpjekjet ushtarake siriane në luftime. Sanksionet e reja mund të përdoren për të shënjestruar mbështetësit kyç të Assadit: Rusinë, Iranin dhe grupin militant të Libanit, Hezbollah³.

Vendet evropiane votuan për bojkotimin e naftës siriane, ndërsa aleati i tyre, Irani ndërhyri duke kompensuar Sirinë me miliarda dollarë.

Amerikanët kërkuar në OKB dhe në Lidhjen Arabe që të ndërmerreshin aksione të përbashkëta kundër Presidentit Bashar al-Assad, që të largohet nga vendi me vullnetin e tij të lirë. Ata u përpoqën që të përdorin stimuj, e të hyjnë në bisedime me aleatët e Sirisë me qëllim që të largojnë Bashar al-Assad nga pushteti⁴. Që nga fillimi i konfliktit sirian, më 15 mars 2011, OKB-ja i ka shumëfishuar projektrezolutat përpara Këshillit të Sigurimit, për rezultate shumë të rastësishme.

³ <https://www.evropaelire>, publikuar me 15 mars, 2021 Përgatiti: Kestrin Kumnova.

⁴ Flamuj të Zinj, Ngritja e ISIS, JOBY WARRICK, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2017, fq 328.

Pesëmbëdhjetë rezoluta të adoptuara që nga fillimi i konfliktit.

Rezoluta e votuar në 19 dhjetor ndjek kortezhin e katërmëdhjetë teksteve të tjera të adoptuara nga Këshilli i Sigurimit për Sirinë. Pas dështimeve të shumta pas fillimit të luftës civile, teksti i parë i votuar ka qenë rezoluta 2042, e votuar në prill 2012, e quajtur “plani Annan”. I propozuar nga ish-Sekretari i Përgjithshëm Kofi Annan, emisar i Kombeve të Bashkuara dhe i Lidhjes Arabe, ai bazohej mbi dhjetë pika themelore: dialogu politik, fundi i dhunës, vazhdimi i kursit të ndihmave humanitare, fundi i burgosjeve arbitrare, liria për gazetarët dhe liria për sirianët.

Nëpërmjet rezolutës 2043, në prill të 2012-ës, OKB-ja u pajis me një mandat për të mbikëqyrur pushimin e dhunës. Por ky plan paqeje dhe prania e vëzhguesve, nëse mundësuan një periudhë pushimi, nuk mundën gjithsesi të parandalonin intensifikimin e konfliktit.

Presidenti sirian Bashar al-Assad u shfaq për herë të parë që nga nisja e konfliktit sirian 8 vjet më parë, në aleatin e tij më të afërt rajonal, Iran, duke takuar atje liderin suprem të Iranit, Ayatollah Ali Khamenei, në Teheran, më 25 shkurt. Lajmi u raportua nga Televizioni Shtetëror Sirian.

Izraeli dhe Rusia do të punonin bashkë për të siguruar largimin e forcave të huaja nga Siria, njoftoi më 3 mars Kryeministri izraelit Benjamin Netanjahu, pasi vizitoi Moskën, për të mbrojtur qëndrimin kundër pranisë së Iranit në vend. Izraeli shqetësohej se përforcimi dhe mbështetja që i vinte nga Irani do të bënte që edhe milicia libaneze Hezbollah, me bazë në Teheran, do të qëndronte, e madje mund të shndërrohej edhe në një front të ri të luftës⁵.

Thuajse 7 muaj më vonë, më 5 tetor, Presidenti turk Taip Rexhep Erdogan njoftoi se operacioni turk në Siri ishte i pashmangshëm. Erdogan tha se Turqia do nisë një sulm ajror dhe tokësor, përmes ushtrisë së saj, në lindje të lumit Eufrat në Siri, në deklaratën e tij më të qartë e të fortë për një sulm të papritur, që nga koha kur Ankaraja dhe Uashingtoni zyrtar vendosën ta quajnë atë një “Zonë të Sigurtë”: “Ne përfunduam përgatitjen, kemi gati planin operacional dhe kemi dhënë urdhrat e domosdoshëm. Është koha të gjejmë rrugën tonë drejt paqes, për të cilën është vendosur e për të cilën kemi nisur punën. Dikush mund të thotë se mund të sulmojmë sot ose nesër. Ne do veprojmë me këtë operacion në tokë, por edhe nga ajri. Dhe nuk kemi asnjë dyshim se vëllezërit tanë në Siri do të jenë në anën tonë, me të gjithë fuqinë e tyre”. Më 7 tetor, Presidenti amerikan Donald Trump kërcënoi aleatin e NATO-s, Turqinë, me shkatërrimin e ekonomisë së saj nëse Ankaraja çon deri në fund planet e saj për sulme ushtarake në Siri, edhe pse vetë lideri i SHBA-ve i kishte hapur

⁵ Denisa Pasholli, “Konflikti Sirian 2019-2020”, A2 CNN, publikuar më: 13:26, 21 nëntor 2020.

derën një sulmi turk: “I kam thënë Turqisë se nëse ata bëjnë diçka jashtë asaj çka ne quajmë njerëzore, atëherë ata do të vuajnë zemërimin e një ekonomie ekstremisht të shkatërruar”⁶.

Marrëdhëniet mes Rusisë dhe SHBA-së u përkeqësuan edhe më tej, pasi administrata Obama njoftoi se në kuadër të marrëveshjes për ndalimin e konflikteve në Siri ka marrë vendim për ndalimin e kontakteve me Rusinë. “Të gjithëve na është sosur durimi me Rusinë”, tha zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, Josh Earnest. Ai ka fajësuar presidentin rus Vladimir Putin dhe qeverinë e tij për bombardimet në Siri, të cilat kanë vrarë njerëz të pafajshëm. “Rusët kanë qenë bashkëfajtorë në tragjedinë siriane. Nuk kemi më asgjë për të biseduar me Rusinë”, tha Earnest⁷.

Rusia dhe Turqia dështuan në arritjen e një marrëveshjeje në bisedimet që u mbajtën në Moskë në shkurt, 2020 me synim për të sheshuar tensionet mbi provincën siriane të Idlib. Sergei Lavrov tha: “Sa i përket rezultatit të bisedimeve ruso-turke, të mbajtura dje dhe pardje në Moskë, dua të them se dështuam në arritjen e një vendimi final mbi mënyrën se si marrëveshjet mes Putin dhe Erdogan do të implementohen sa i përket Idlibit. Ne nuk bëmë asnjë kërkesë të re, ne besojmë në nevojën e implementimit të asaj për çka liderët ranë dakord”. Presidenti Erdogan njoftoi më 29 shkurt se kishte biseduar me homologun rus Putin, që Rusia të bëhej mënjane në Siri dhe të lejonte vetë Turqinë që të merrej vetëm me forcat qeveritare siriane. Erdogan tha se vetëm në Stamboll kishin kaluar kufirin 18 000 emigrantë: “Ja thashë edhe zotit Putin. Çfarë po bëni atje? Nëse doni të ngrini një bazë atje, bëjeni, por ikni nga rruga jonë, na lini vetëm përballë regjimit sirian. Ne do të bëjmë çka është e nevojshme me regjimin”⁸. Rusia nuk do të ndalojë së luftuari terrorizmin në rajonin Idlib të Sirisë, në përpjekje për të zgjidhur krizën e emigrantëve në Evropë, tha ministri i Jashtëm rus Sergei Lavrov në një konferencë për shtyp më 3 mars. Komentet e tij erdhën pasi emigrantët vazhdonin të mblidheshin në kufirin grek, pasi Turqia tha se nuk do t’i pengojë më refugjatët sirianë, të zhvendosur pas luftimeve në Idlib, e që kërkonin të arrinin në Evropë, nga toka dhe deti: “Por, ne nuk mund të asistojmë në zgjidhjen e problemeve të emigrantëve, në përgjigje të luftës kundër terrorizmit, gjë që po sugjerohet nga disa politikanë në Evropë”⁹.

Erdogan u shpreh se marrëdhëniet mes Turqisë dhe Rusisë ishin në pikun e tyre dhe qëllimi ishte që lidhjet mes dy vendeve të thelloheshin. Gjatë

⁶ Po aty.

⁷ <https://www.gazeta-shqip.com/publikuar> me 04.10.2016, 09:50, konflikti në-Siri, përkeqësohen marrëdhëniet SHBA - Rusi.

⁸ Denisa Pasholli, “Konflikti Sirian 2019-2020”, A2 CNN Publikuar më: 13:26, 21 Nëntor 2020.

⁹ Po Aty.

takimit të tyre, dy liderët ranë dakord që Turqia dhe Rusia të vendosin një korridor të sigurisë, përgjatë autostradës lindje-perëndim të Idlibit dhe do të ngrihej edhe një njësi patrulle e përbashkët nga 15 marsi, në përpjekje për të lehtësuar tensionet në mbarë rajonin. Të dy palët thanë se korridori i sigurisë do të zgjatej për 6 km në veri dhe 6 km në jug, në autostradë: “Marrëveshja e armëpushimit do të jetë efektive duke nisur nga mesnata. Në përpjekje për ta bërë atë funksionale dhe që të zgjasë, janë të nevojshme të gjithë aksionet, për ta bërë funksionale menjëherë, por mbi të gjitha efikase. Qëllimi ynë është që të parandalojmë përkeqësimin e krizës humanitare në rajon. Ne do të punojmë bashkë për të furnizuar sirianët me çdo ndihmë, pa diskriminim dhe asnjë kusht”¹⁰. Palët kundërshtarë në luftën civile siriane ranë dakord të ulen bashkë në Gjenevë, për të negociuar për Kushtetutën, tha i dërguari special i OKB-së, Geir Pedersen, më 19 maj. Pas konfliktit 9-vjeçar, Pedersen foli për një “qetësi të brishtë” në enklavën e fundit të mbajtur nga rebelët në Idlib, si mundësinë për të ndërtuar besimin. Ai i kërkoi Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë, që mbështesnin të dy palët kundërshtarë, që të nisinin bisedimet dhe të nisin procesin e paqes. Ai nuk dha një datë për komitetin kushtetues, e cila edhe këtë nuk shënoi asnjë arritje, ndërsa tha se për këtë çështje mbledhjet “on-line” nuk janë një option: “Menjëherë sapo të na e mundësojë situata pandemike, siç ata janë dakordësuar për të ardhur në Gjenevë, jemi dakordësuar që takimi i radhës do të jetë për këtë çështje. Ju e dini, ne kemi marrë shumë vendime, ndaj shpresoj që sapo koha të na e lejojë, do të takohemi në Gjenevë dhe do të bëjmë një diskutim të mirë”. Presidenti rus Vladimir Putin mbajti një samit në resortin e Detit të Zi në Sochi, për të diskutuar të ardhmen e Sirisë, me homologun turk Taip Rexhep Erdogan dhe Presidentin iranian Hassan Rouhani. Në samit, Putin tha se Rusia, Turqia dhe Irani u dakordësuan për të ndërmarrë hapa të mëtejshme, të paspecifikuara, për të pastruar rajonin sirian të Idlibit, që nga liderët u cilësua si një pikë e nxehtë e terroristëve, por Kremlini tha se atje nuk do të ndërmerret asnjë operacion ushtarak.

Presidenti sirian Bashar Al-Assad njoftoi më 17 shkurt se Shtetet e Bashkuara nuk do t’i mbrojnë ata që varen prej tyre, duke iu referuar këtu luftëtarëve kurdë, që kontrollojnë pjesën më të madhe të veriut të vendit: “Ne i themi atyre grupeve që besojnë tek Amerika, se amerikanët nuk do të mund t’ju mbrojnë. Amerikanët nuk do t’ju kenë as ndër sy e as në zemër. Amerikanët duan t’ju kenë në xhep, që t’ju kenë si një lojë në dorë dhe kanë nisur ta bëjnë këtë gjë. Nëse ju nuk përgatiteni për veten tuaj, për të mbrojtur vendin tuaj dhe për të rezistuar, do të shndërroheni në skllevër të otomanëve. Ju do të mbroheni, por nga vetë qeveria juaj. Nuk do të mbroheni nga ushtria arabo-siriane”¹¹.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Denisa Pasholli, “Konflikti Sirian 2019-2020”, A2 CNN Publikuar më: 13:26, 21 nëntor 2020.

Për të lehtësuar gjendjen e më shumë se 200.000 refugjatëve nga Siria, që gjenden në vendet fqinje për shkak të luftës civile në atë vend, Gjermania dëshiron të shtojë ndihmat humanitare. Këtë e njoftoi ministri i Jashtëm gjerman Guido Westerwelle (FDP) gjatë një vizite në kampin e refugjatëve Satari në Jordani. Gjermania është e gatshme të pranojë edhe në Gjermani refugjatë nga Siria, tha Westerwelle, por fokusi i ndihmës gjermane megjithatë “është shumë i qartë: ndihma dhe furnizimi i refugjatëve” në kampet ku ndodhen aktualisht. Ndihma gjermane për refugjatët sirianë shkon në 24 milionë euro. Megjithatë sipas vlerësimeve të OKB-së të nevojshme janë ndihma prej rreth 275 milionë eurosh¹². Mes vetove dhe rezolutave të votuara – një retrospektivë mbi vendimet e Këshillit të sigurimit të OKB-së gjatë konfliktit sirian. Këshilli i sigurimit të OKB-së adoptoi, me 19 dhjetor 2016, në unanimitet, dërgimin e vëzhguesve për të garantuar mbarëvajtjen e evakuimeve të civilëve dhe rebelëve nga lagjet lindore të Alepit. Dyshimi për pozicionimin e Rusisë ka rënduar për një kohë të gjatë, por “Zoti niet” (nofka që i kanë vënë pas vetove të shumta ruse), Sergei Lavrovi, ministri rus i punëve të jashtme, tha më në fund “po”.

Në 23 dhjetor 2012, banorë dhe mjekë të Homs-it dëshmojnë për përdorimin e armëve kimike nga regjimi gjatë sulmit të qytetit. Një zyrtar amerikan kishte paralajmëruar paraprakisht se Damasku ishte duke grumbulluar lëndët e nevojshme kimike për prodhimin e gazit sarin. Barack Obama kish deklaruar asokohe se përdorimi i këtyre armëve përbënte një “vijë të kuqe” për qëndrimin e Shteteve të Bashkuara përballë regjimit të Bashar Al Asadit. Përballë protestave të zjarrta dhe kërcënimeve për ndërhyrje ushtarake në Siri, Rusia votoi pro rezolutës 2118, e adoptuar në shtator 2013, duke urdhëruar shkatërrimin e arsenalit kimik sirian, por edhe bashkëpunimin e qeverisë dhe forcave të armatosura me Organizatën për ndalimin e armëve kimike. OKB-ja procedoi më pas, në rezolutën 2235, me hapjen e një strukture hetimore në Siri, që do të merrej me në shqyrtimin e përdorimit të armëve kimike.

Megjithatë, ndikimi i këtyre rezolutave në terren ishte thjesht minimal. Tekstet e ndryshme nuk parashikonin sanksione në rastin e mosaplikimit të tyre dhe mjaftoheshin me një dënim moral të krimeve të kryera nga regjimi dhe nga grupet e armatosura të pranishme.

Së fundmi Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi krijimin e një organizate të pavarur për të hetuar fatin e mijëra personave që mbeten të zhdukur në Siri që nga shpërthimi i luftës në vitin 2011, duke tejkaluar kundërshtimet nga Damasku.

¹² Autor dpa/afp, “Konflikti sirian: Klinton skeptike për marrëveshje me Rusinë”, publikuar me datë 10.09.2012.

Sipas grupeve joqeveritare, rreth 100 mijë njerëz rezultojnë të zhdukur që nga fillimi i një goditjeje brutale të protestave antiqeveritare, gjithashtu më shumë se gjysmë milioni njerëz janë vrarë.

“Pas 12 vitesh konflikti dhe dhune në Republikën Arabe Siriane, është arritur pak përparim në zbutjen e vuajtjeve të familjeve duke dhënë përgjigje për fatin dhe vendndodhjen e të gjithë personave të zhdukur”, thuhet në rezolutën, e cila u miratua me 83 vota pro, 11 kundër dhe 62 abstenime.

Por Siria, së bashku me Rusinë, Kinën dhe Iranin, kundërshtuan krijimin e organizatës së re, duke thënë se nuk ishte konsultuar për rezolutën.

Institucioni i Pavarur për Personat e Zhdukur në Siri do të zbulojnë fatin dhe vendndodhjen e të gjithë personave të zhdukur dhe do të ofrojë mbështetjen e duhur për viktimat, të mbijetuarit dhe familjet e të zhdukurve.

Rezoluta i kërkon sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, komisionerit të lartë të OKB-së për të drejtat e njeriut dhe palëve të tjera përkatëse që të përcaktojnë mandatin e organizatës së re në 80 ditë e ardhshme¹³.

2. KARAKTERISTIKAT E KONFLIKTIT SIRIAN

Natyra e luftës në Siri në vetvete mund të konsiderohet si një luftë jo e mirëfilltë civile, por mund të themi se është një luftë civile ku marrin pjesë shumë aktorë, të cilat mbështesin palët ndërluftuese, për interesa të caktuara. Në këtë konflikt janë përfshirë shumë shtete, të cilat kanë interesa të drejtpërdrejta ekonomike. Siria është një ndër vendet e para në botë për prodhimin e naftës. Si rrjedhojë, shtetet e rajonit synojnë të shtrijnë influencën e tyre, me qëllim kontrollin e tregut të naftës. Kjo luftë nuk mund të konsiderohet thjesht si një luftë e brendshme civile. Në këtë konflikt shtetet aleate të Sirisë, ose aleatët e forcave opozitare, qëndrojnë pothuajse në prapaskenë dhe aktivizohen rast pas rasti, kur vihen në rrezik interesat e tyre strategjike. Shtetet aleate mbështesin palët në konflikt, ku synojnë të përmbushin planet dhe interesat e tyre, duke marrë parasysh edhe kostot e rënda që ka ky konflikt. Kohëzgjatja e këtij konflikti na bën të mendojmë se interesat ekonomike dhe politike të palëve në konflikt, si dhe të shteteve që mbështesin presidentin Bashar al-Assad, apo opozitën, mund të jenë më të rëndësishme se paqja. Turqia, Rusia, Irani apo shtetet e tjera, luajnë “marionetat” e tyre, me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre. Në vitet e para të revolucionit sirian, vendet perëndimore, veçanërisht **Shtetet e Bashkuara të Amerikës**, mbështetën opozitarët sirianë kundër regjimit, ndërsa hoqën dorë nga mbështetja me fitimin e hapësirës nga organizata terroriste **DAESH** dhe ndërhyrjen e Rusisë. Shtetet e Bashkuara të

¹³ “Hetim për të zhdukurit në Siri që nga nisja e luftës, OKB miraton krijimin e organizatës”, Agjencia e Lajmeve Zhurnal, e premtë, 30 qershor, 2023.

Amerikës hynë në një angazhim ushtarak me **YPG**-në, fraksionin e organizatës separatiste terroriste **PKK** në Siri, dhe krahun e saj politik **PYD**, ndërsa krijuan një sferë të ndikimit, veçanërisht në veri-lindje të vendit. Nga ana tjetër, vendet e tjera perëndimore e konsiderojnë ende opozitën siriane si të ligjshme, por nuk ofrojnë më mbështetje konkrete. Ndërkohë, SHBA-ja vazhdon të jetë akoma a pa vendosur në çështjen e politikës së saj për Sirinë. Ndërsa po deklaronte vijat e kuqe gjatë periudhës së Obama-s dhe më pas u tërhoq shumë herë, kohët e fundit është zbuluar se **Obama** në të vërtetë la hapësirë për ndërhyrjen ushtarake të Rusisë në Siri në shtator të vitit 2015. Gjatë periudhës së presidentit Trump kishte një vullnet për të tërhequr trupat amerikane, por personat në pozicione të ndryshme në SHBA arritën ta pengonin Trump-in që të tërhiqej plotësisht. Aktualisht, trupat amerikane vazhdojnë të kontrollojnë rajonet e pasura me naftë në lindje të Eufratit nga rajoni Rimelan deri në Deir ez Zor dhe gjithashtu vazhdojnë të mbështesin edhe organizatën separatiste PYD/YPG nën çatinë e **Forcave Demokratike Siriane**¹⁴.

Nga përvoja e konflikteve civile në të kaluarën, vërejmë se nuk kanë zgjatur kaq shumë, e me pasoja kaq të rënda si në Siri. Me sa duket akoma nuk është realizuar kompromisi i duhur ndërmjet palëve, të cilat mund të kenë në dorë paqen në Siri. Në konfliktet civile që kanë ndodhur në të kaluarën, faktori ndërkombëtar ka arritur të gjejë zgjidhje më të shpejta e të arsyeshme, të cilat kanë ndikuar në vendosjen e paqes. Edhe sa kohë mund ti duhet palëve në konflikt, e faktorit ndërkombëtar, për të vendosur paqen. Kjo mbetet një dilemë e madhe. Shkaqet e kësaj lufte si konteksti etnik, diktatura absolute, shkeljet e të drejtave të njeriut, korrupsioni politik, rënia ekonomike, papunësia, varfëria etj. detyruan sirianët të shkojnë drejt kësaj lufte. Numri i madh i refugjatëve në shtetet fqinjë, numri i madh i të zhvendosurve sirianë nga zonat e nxehta të luftimeve, rritja e grupeve të fuqishme të armatosura ekstremiste në Siri dhe ndërthurja e interesave të huaja, janë faktorë që ndikojnë negativisht në mjedisin e sigurisë rajonale në Lindjen e Mesme dhe në Evropë. Qeveria e Sirisë vazhdon të fajësojë terroristët për dhunën. Opozita kërkon që një qeveri tranzicioni të zëvendësojë Assad-in. Asnjëra palë nuk tërhiqet, dhe perspektiva për paqe, stabilitet apo reforma demokratike mbetet një sfidë e vështirë. Lufta në Siri vazhdimisht ka pasur trajtën e një lufte e cila vështirë se mund të përcaktohet saktësisht se e çfarë lloji mund të jetë ajo. Në bazë të analizave dhe vëzhgimeve të vazhdueshme ndaj këtij konflikti kaq të gjatë, mund të shprehemi, e të dalim në përfundimin se konflikti në Siri është zhvilluar duke pasur një ndërthurje të shumë elementeve, të cilat herë ngajnë me luftën në

¹⁴ <https://www.trt.net.tr/shqip/opinione/2020/09/18/>, lufta me prokurë në Siri, analizë nga Can Acun, ekspert i Marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politikave të jashtme pranë Fondacionit për Kërkime Politike, Ekonomike dhe Sociale (SETA) në Ankara.

qendrat e banuara, e ndërkohë në shumë raste të tjera, shfaqen elementë të një lufte me tipare terroriste, ku në shumë raste, forcat qeveritare kanë zhvilluar sulme ushtarake me intensitet të lartë duke përdorur avionin dhe armët kimike, duke shkelur parimet themelore të ligjit të konfliktit të armatosur, si dhe të drejtat themelore të njeriut. Të gjitha palët ndërndërluftuese, përpiqen të përdorin taktikën e rrethimit, me qëllim që të nënshtrojnë sa më shpejt njëra-tjetrën.

Në një intervistë për Brookings, Charles Lister, një ekspert i njohur mbi opozitën e armatosur në Siri, flet për konfigurimin në terren të forcave kundër regjimit të Bashar al-Assad, por edhe përplasjet e ashpra mes tyre, procesin e bisedimeve të paqes në Vjenë, si dhe mbi mënyrën sesi po evoluon konflikti. Në cilësinë e drejtuesit të “Qendrës mbi terrorizimin dhe rebelimet” në Londër, ai ka pasur kontakte personale me udhëheqësit e më shumë se 100 grupeve të armatosura siriane të opozitës në Turqi, Suedi, Norvegji dhe Holandë. Ai i ka përmbledhur këto eksperiencë në një libër të ri të publikuar këtë muaj “Xhiahadi sirian: Al-Kaeda, Shteti Islamik dhe Evoluimi i një Kryengritje”. Ai është gjithashtu autor i librit “Shteti Islamik: Një hyrje të shkurtër”.

BURIME TË SHFRYTËZUARA

1. Joby Warrick, *Flamuj të Zinj, Ngritja e ISIS*, Shtëpia botuese 55, Tiranë, 2017.
2. Can Acun, Lufta me prokurë në Siri. Burimi elektronik : <https://www.trt.net.tr/shqip/opinione>.
3. DPA/AFP, *Konflikti sirian: Klinton skeptike për marrëveshje me Rusinë*, publikuar në dt. 10.09.2012.
4. Redjon Shtylla, <https://kohajonë.com/> publikuar me 23.12.2015.
5. Burimi elektronik: <https://www.gazeta-shqip.com>, publikuar me 04.10.2016, 09:50, *Konflikti në Siri, përkeqësohen marrëdhëniet SHBA-Rusi*.
6. Analiza: *Siria, ja cili është konfigurimi i forcave në fushëbetejë*, 29 Nëntor 2015. <http://www.panorama.com.al/>
7. Burimi elektronik: <https://sq.globalvoices>.Përgatitur nga Ivan Sigal, publikuar më 29 dhjetor 2016.
8. Syrine Attia, *Mes vetove dhe rezolutave të votuara - një retrospektivë mbi vendimet e Këshillit të sigurimit të OKB-së gjatë konfliktit sirian*, më 21 dhjetor 2016. Burimi elektronik: <http://Veritas.com.al/>
9. Denisa Pasholli, *Konflikti Sirian 2019 – 2020*. A2 CNN. Publikuar më 21 nëntor 2020.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në:

Adresa: Akademia e Forcave të Armatosura, (AFA)
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU)
Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit
Nr. Tel: 516 /1515
Adresa elektronike: ikshu.afa@aaf.mil.al
Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri